



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 14, 15 DHE 19 MARS 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14., 15. I 19. MARTA 2013. GODINE**

**MARS - MART
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i amendamenteve 23 dhe 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
4. Zgjedhja e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për blegtorinë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ujërat e Kosovës,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Razmatranje amandmana 23 i 24 Ustava Republike Kosova, predloženih od Vlade Republike Kosova,
4. Izbor guvernera Narodne Banke Republike Kosova,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o pravima palih boraca, invalida, veterana, pripadnika Oslobodilačke vojske Kosova, civilnih žrtava i njihovih porodica,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Agenciji za upoređivanje i proveravanje imovine,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o medicinskim proizvodima i medicinskoj opremi,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o tretiranju izgradnje bez dozvole,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o stočarstvu,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o zemljišnom prevozu opasnih roba,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o vodama Kosova,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Agenciji za menađiranje memorijalnih kompleksa Kosova.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, ministra,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit parlamentar 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta. Replika nuk ka në këtë pikë të rendit të ditës. Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Përshëndetje kryetar,
Përshëndetje ministra, kolegë deputetë,
Ne si komision e kemi pranuar një kërkesë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës për çështjen e aflatoksinës, e cila ka qenë temë e këtyre ditëve në Kosovë dhe kemi kërkuar nga kjo agjenci, meqë e ka bërë një raport, në të cilin i kanë marrë masat dhe mostrat prej 42 produkteve të qumështit, 20 prej të cilave kanë dalë pozitive.

Ata e kanë arsyetuar këtë te ne në komision si rrjedhojë e misrit që ka ardhur nga Serbia, tani edhe e grurit po ashtu që ka ardhur me metale të rënda, nga domatet edhe produktet tjera, të cilat kanë ndikuar edhe te mishi, te vezët, te pulat, te të gjitha. Prandaj, në këtë drejtim është kërkuar, dhe ne i kemi dhënë mbështetje agjencisë si komision, pikërisht për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve tanë me këtë raport, sepse është çështje e ndjeshme dhe në këtë aspekt kemi mundësuar që t'i dalim në ndihmë agjencisë në mbrojtje të qytetarëve tanë që këto produkte të hiqen nga qarkullimi, ndërsa kemi pasur reagime nga shtypi, po ashtu edhe nga Shqipëria duke na akuzuar se dikush qëndron prapa tyre. Ne mendojmë që këtu nuk qëndron askush, por këtu qëndron një bombardim i produkteve të helmuara me metale të ndryshme nga Serbia që i bëhet Kosovës pikërisht për shkatërrimin e shëndetit në mënyrë afatgjatë.

Prandaj, kërkojmë nga agjencia drejtpërdrejt që edhe publikisht të dalë në mbrojtje të qytetarëve dhe në mbrojtje të produkteve tona dhe në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve që t'i konsumojnë produktet tona vendore, sepse janë më të shëndetshme dhe më të mbrojtura nga të gjitha ato që vijnë nga jashtë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Imri Ahmeti.

IMRI AHMETI: Faleminderit, zoti kryetar!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,
Çështjen që do ta ngre në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës është aprovimi i shpejtë i dorëheqjes së zëvendës drejtorit të Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës nga Presidentja dhe Kryeministri i Kosovës.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së veprimit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës e ka pranuar dhe një vendim nga Kryeministri dhe Presidentja për aprovimin e kësaj dorëheqjeje, i cili vendim absolutisht nuk e shpjegon asnjë arsye pse ka ardhur deri te kjo çështje.

Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon që kjo çështje të bëhet transparente dhe të bëhet e ditur për publikun për arsyet e kësaj dorëheqjeje. Nuk ka dorëheqje vullnetare asnjëherë, në parim nuk ka dorëheqje vullnetare. Nëse është çështje shëndetësore, nëse është çështje e shkeljeve ligjore, nëse është çështje e avancimeve tjera, ndoshta për ndonjë zëvendësguvernator a guvernator, a ku e di unë për çfarë çështje tjetër, është mirë t'i bëhet publike opinionit, sepse qytetarët e këtij vendi kanë të drejtë ta dinë arsyen e dorëheqjes të zëvendësdrejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

Është njeriu i dytë i kësaj agjencie, i cili disponon me shumë të dhëna, me shumë njohuri, i cili për katër vjet rresht ka qenë zëvendësdrejtor i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, ndërkaq asnjë shpjegim nuk është dhënë në vendimin që e kemi marrë si Komision Parlamentar për aprovimin e kësaj dorëheqjeje.

Shqetësimi i Lidhjes Demokratike është edhe më i madh për faktin se këtij Parlamenti, nëpërmjet Komisionit për Mbikëqyrjen e kësaj agjencie i pamundësohet mbikëqyrja e ligjshmërisë së veprimit të saj. Pse po them i pamundësohet? Ne si komision jemi absolutisht në pamundësi të funksionojmë për ta mbikëqyrur këtë agjenci në mungesë të verifikimit të sigurisë së këtyre deputetëve që ky Parlament i ka zgjedhur në këtë komision.

Po bëhen gati dy vjet prej kur anëtarët e këtij komisioni kanë drejtuar kërkesë në agjenci nëpërmjet kryetarit të Parlamentit, zotit Jakup Krasniqi, për ta parë mundësinë që t'i kenë certifikatat e sigurisë, në mënyrë që të bëhet mbikëqyrja e ligjshmërisë të kësaj agjencie. Edhe sot e kësaj dite, me gjithë faktin që kjo agjenci ka kryer mbi 1 600 verifikime të sigurisë për zyrtarë të lartë shtetërorë, nuk ka mund ta kryejë verifikimin e sigurisë për 9 ose 10 deputetë të këtij Parlamenti. Shtrohet çështja, ku është qëllimi i kësaj? Pse po bunkerizohet kjo mundësi e mbikëqyrjes të ligjshmërisë të kësaj agjencie?

Unë kërkoj publikisht që zot kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi, të deklarohet para deputetëve pse e mban peng këtë kërkesë të deputetëve, sepse drejtori i agjencisë ka deklaruar publikisht që akoma nuk i ka shkuar kjo kërkesë nga kryetari i Parlamentit. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe pse nuk lejohet replika, unë dua t'i them 2-3 fjalë në foltore si deputet.

Të nderuar deputetë,

Unë edhe dhe e kam dëgjuar nëpërmjet medieve të informimit këtë që e dëgjuam edhe tani. Dhe konsideroj që as Kuvendi si Kuvend, as deputetët dhe as komisionet, dhe as të gjithë ata që merren me politikë nuk duhet ta tregojnë në këtë nivel të ulët, potencën e tyre vendimmarrëse dhe potencën e tyre për t'i ditur gjërat ashtu siç janë.

Deputetët janë të emëruar fillimisht si kandidatë nga partitë politike dhe partitë politike duhet ta dinë se cilët janë kandidatët që i propozojnë për deputetë, cila është biografia e tyre, e para.

E dyta, deputetët janë të zgjedhurit e qytetarëve të Kosovës, nëse vërtet ata i kanë zgjedhur, nëse nuk i kanë zgjedhur është punë e deputetëve që janë ulur në Kuvend edhe unë nuk dua të merrem me atë çështje. Por, për mua, si kryetar i Kuvendit, si njeri që merrem me politikë dhe kam një obligim qytetar, por edhe si kryetar i Kuvendit, më është dukur tepër nënçmuese që nga një institucion jo i konsoliduar dhe konsideroj pa kompetencë të mjaftueshme për t'u marrë me verifikimin e deputetëve, në mënyrë të veçantë me verifikimin e deputetëve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë të Inteligjencës së Kosovës.

Kjo është arsyeja pse mua më është dukur krejt e paarsyeshme që unë ta kërkoj një verifikim të tillë. Në fund të fundit, shefi i Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës e ka ditur kërkesën e komisionit. Ai ka mundur ta bëjë atë edhe pa kërkesën time. Dhe, në fund të fundit, nëse anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Inteligjencës së Kosovës kanë dyshim në vetvete, ata të mos pranojnë të jenë anëtarë të komisionit. Për hir të qytetarëve të Kosovës, për hir të zgjedhjeve që kanë bërë ata, nëse e kanë bërë, unë nuk kam dashur ta bëj një kërkesë të tillë. Kjo është arsyeja pse nuk e kam bërë, por Agjencia Kosovare e Inteligjencës ka mundur të japë sqarime, nëse vërtet i ka verifikuar dhe e ka pasur kapacitetin për t'i verifikuar anëtarët e Komisionit, ka mundur ta bëjë këtë.

Fjalën e ka deputeti Florin Krasniqi.

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë e kuptoj shumë mirë se kjo pikë nuk ka replika, por si kryetar i këtij komisioni ndiej përgjegjësi morale, por edhe legale të them diçka.

Ne si komision veprojmë tash më shumë se dy vjet dhe është shumë e vërtetë se nuk e kemi kaluar procesin e verifikimit, që në fakt është një hendikep për ne.

Dua ta sqaroj një gjë për ju deputetë dhe për qytetarët e Kosovës, se në asnjë rast, as drejtori i agjencisë, e as inspektori i përgjithshëm, nuk i kanë refuzuar pyetjet dhe kërkesat tona, duke përfshirë edhe nivelet më të larta, deri në sekret. Nuk kemi pasur një pyetje që ndërhyr në nivelin top-sekret, por deri në nivelin sekret edhe drejtori, edhe inspektori, na janë përgjigjur në të gjitha pyetjet. Andaj, ne si komision nuk mendoj që duhet ngritur deri në nivelin sa kolegu deputet e ngriti. Në qoftë se kolegu deputet ose deputetë tjerë të këtij komisioni kanë pyetje ose kërkesa specifike për këtë komision, ne bashkërisht mund të shkojmë dhe t'i sqarojmë.

E kam thënë edhe një herë tjetër, po e përsëris, të krijojmë diçka kombëtare. Ju lutem! Një, një! E kemi politizuar çdo gjë. E kemi politizuar familjen, shoqërinë e kemi politizuar. Ta bëjmë një agjenci që është e Kosovës, kombëtare. Krejt çka kërkojmë është kjo. Në qoftë se dikush ka ndonjë pyetje specifike, unë jam i hapur për të gjithë, për ju,

për qytetarët. Së bashku shkojmë në agjenci dhe i sqarojmë të gjitha gjërat. Mos e politizoni këtë agjenci, ju lutem! Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Nuk ka më shumë se një muaj që e festuam 5-vjetorin e pavarësisë, ndërsa tash edhe muajin e Epopesë së UÇK-së, kur nga të gjithë krerët qeveritarë u ngrë në pedestal kontributi i të gjithë atyre që e bënë luftën, e që në saje të kontributit të tyre ne sot jemi këtu. Por, shtrohet pyetja: Çfarë kemi bërë ne si shtet për këto kategori?

Viti 2008 filloi me shpërbërjen e TMK-së, një forcë e cila ishte pasardhëse e UÇK-së në të gjitha rastet e një shteti, i cili reformat dhe ndryshimet i bën në mënyrën më të mirë të mundshme, që transformimet të jenë në nivel të duhur, e jo të dhimbshme e mburrëse për Qeverinë, që e kanë bërë një arritje duke e shkatërruar një arritje edhe më të madhe, e cila ishte dhe funksiononte.

Jemi të gjithë dakord që ka qenë nevoja e transformimit nga UÇK-ja në TMK, po ashtu edhe nga TMK-ja në FSK, por të gjitha prapë ndodhën me gabime, jo vetëm të njëjta, por të shtuara, e aq më keq transformimi i TMK-së dhe mospërfshirja e 1 800 pjesëtarëve, duke i lënë anash dhe pa përkujdesje.

Ish-pjesëtarët e TMK-së të mbetur pa punë dhe në harresë nga institucionet e Kosovës janë në pozitë shumë të dobët ekonomike.

Pse po harrohen tash ata që luftuan dhe u angazhuan me gjithë qenien që t'i vënë themelet e Ushtrisë së Kosovës? Ata që me vullnet e gatishmëri e dhanë kontributin e tyre për lirinë dhe çlirimin e Kosovës, pse nuk i dëgjoni tash? Ata sot bredhin rrugëve për një punë ditore, e në shumë raste të papunë dhe të harruar. Askush nuk kujdeset as për ata, e as për familjet e tyre.

Ata nuk kërkojnë lëmoshë, por kërkojnë sistemim. Ata nuk dëshirojnë të trajtohen si kategori sociale, por të trajtohen si luftëtarë të lirisë.

Përkujdesja e shtetit ndaj ushtarëve të UÇK-së dhe ish-pjesëtarëve të TMK-së ia kthen dinjitetin dhe krenarinë luftës sonë të drejtë çlirimtare.

Vetëm atëherë kur çmohen e trajtohen si duhen veteranët, invalidët, familjet e dëshmorëve dhe ish-pjesëtarët e TMK-së, mund të konsiderojmë se shteti po ecën rrugës së duhur. Por, e kujton kush se nga këta djem e vasha, që dikur ishin krenaria në luftë, ishin mbrojtja në paqe dhe e kishin besimin më të madh në popull si institucion i respektuar dhe me disiplinë të lartë, tani disa prej tyre i kanë zgjedhur vetëvrasjet si mjet i dhënies fund të jetës së tyre, duke mos pasur përkrahje institucionale dhe të lënë në harresë, duke mos e pasur as mundësinë e të ushqyerit e familjeve të tyre, e këta janë me dhjetëra të tillë.

Këta djem e vajza i kanë përfaqësuesit e tyre, të cilët i kanë zgjedhur që t'i përfaqësojnë. Por, sa dëgjohet zëri i tyre? Sa lexohen kërkesat e tyre drejtuar Qeverisë? Ato kërkesa, jo vetëm që nuk lexohen e shqyrtohen, por ato hedhen në koshin e mbeturinave si letra të pavlera.

Këta djem e vajza që dhanë aq shumë për ndërtimin e vendit, meritojnë për të gjithë ne jo vetëm respektin më të madh në shoqëri, por e meritojnë edhe dinjitetin ta kenë në këtë shoqëri, sepse tani lufta më e madhe për ta është mbijetesa për ata dhe familjet e tyre.

Përderisa kemi ende mundësi, përderisa kemi kohë, edhe pse jemi të vonuar, por siç thotë populli 'më mirë vonë se kurrë', Qeveria duhet ta hartojë një plan duke bashkëpunuar me ta për sistemin, për një zgjidhje së bashku që t'i integrojmë në shoqëri, sepse nuk kërkojnë lëmosh, nuk kërkojnë të mbahen dhe të jetojnë në kurriz të popullit për të cilin u flijuan, por kërkojnë të punësohen, ta gjejnë veten dhe me mundin e djersën e tyre t'i mbajnë familjet.

Nëse ne dëshirojmë të mburremi, duhet të mburremi me veprën e tyre në luftë, në paqe, dhe duhet të mburremi edhe tani me kurajën dhe qëndrueshmërinë që janë duke e bërë në luftë për ekzistencë dhe për mirëqenie.

Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet, por edhe ne, të nderuar deputetë, nuk guxojmë të heshtim për këtë çështje, sepse historia do të na gjykojë.

Mua më vjen mirë që sot është ministri Çeku këtu dhe e ka për obligim që të bëjë shumë më shumë për këtë kategori, e cila është lënë në harresë. Faleminderit!

KRETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Faleminderit, kryetar!

Poštovani predsjedniče,

Predstavnici Vlade,

Zastupnici i zastupnice Parlamenta Kosova,

Poštovani građani,

Formiranje opština u regijama gde je Bošnjačka zajednica većinska, Župa, Gora, Vitimirica, je od nacionalnog značaja i opstanka zajednice Bošnjaka na prostoru Republike Kosova.

Nakon pilot-projekata 2005. i dodele dveju opština većinskoj zajednici i jednu opštinu Turskoj zajednici, te nakon proglašenja nezavisnosti i decentralizacije 5 opština za Srpsku zajednicu, popisom stanovništva 2011. godine ispunjen je i zadnji preduslov kako bi zajednica Bošnjaka dobila pravo na lokalnu samoupravu.

Zahtev za lokalnu samoupravu u regionu Župe, Rečane, koji čini 30% teritorije opštine Prizren i broji 14 naselja sa oko 15 hiljada stanovnika, gde je Bošnjačka zajednica većinska, je predat Ministarstvu za lokalnu samoupravu još 2009. godine.

Krajnje je vreme da Vlada Kosova ozbiljno pristupi rešavanju decentralizacije već marginalizovane zajednice Bošnjaka.

Poštovani premijeru,
Ministri, kolege zastupnici,
Mi više ne možemo čekati. Moja se zajednica suočava sa velikim stepenom migracije ka zemljama zapadne Evrope.

Smatram da je vreme da Vlada Kosova pruži ruku Bošnjacima u procesu integracije i zaštite prava zajednica, unutar kosovskog društva. To se može ostvariti jedino procesom decentralizacije, što je preduslov Evropskih integracija, koji je cilj ove Vlade.

Na osnovu elaborata ekonomske održivosti regije Župe, odnosno Rečane, kao nova opština bi imala veće sopstvene prihode, oko 400 hiljade eura godišnje, od zbirno nekoliko već formiranih dosadašnjih opština. Možete se svi lično uveriti uvidom Vladinog budžeta za 2013. godine, odnosno zadnjih 20. stranica.

Bošnjaci Kosova traže od ovog Parlamenta, predstavnika vlade Republike Kosova, nadležnog ministarstva i međunarodnih faktora primenu Ustavnih odredbi iz paketa Ahtisarija, pravo na lokalnu samoupravu, koja će im obezbediti multifunkcionalnost, tesno povezana sa idejom integracije zajednica, diskreciona ovlašćenja, koja su u vezi sa kapacitetom lokalnih samouprava, pomaganje da se preko opština, u kojima je nevećinska zajednica u većini, Kosovo približi ispunjavanju NUS-standard programa decentralizacije, koji je uslov ulaska Kosova u Evropskoj uniju.

Povećavanje korišćenja pred pristupnih sredstava iz ruralnih fondova, čime bi se posle formiranja opštine u regiji Župa, povećali sopstveni prihodi i dveju opština, opštine Prizren i opštine Župa, sa najmanje 20% u odnosu na sadašnje, koje variraju na cifri od 5 miliona evra. To bi direktno uticalo na povećanje zaposlenosti svih naših građana na te teritorije.

Zatim, ovlašćenje sa samostalno oporezivanje, reprezentaciju, odnosno sopstveni samostalni prihodi.

Takođe, neprimerna dosadašnja pasivnost, pogotovu političkom angažovanju Bošnjačke zajednice, nije bila korektna prema svojim građanima, imajući u vidu američku demokratiju da lokalna politika predstavlja kamen temeljac demokratije, zbog toga što omogućava najveći stepen direktne participacije građana u lokalnoj samoupravi.

Pošto smo uvereni da svi delimo zajedničke principe, na kojima počivaju pravni poredak, i samo organizacija Republike Kosova, ne sumnjamo da će se izostati pravedno postupanje primenjujući za Bošnjačku zajednicu ista pravila i iste univerzalne principe, koji su važili za svaku zajednicu, počev od većinske, koja je sa dve nove opštine, koja se našla na mapi opština u Republici Kosova po pilot-programu, zajedno sa pilot opština u Mamuši i za Tursku zajednicu, pa sve do Srpske zajednice, koja je sa 5 posle nezavisnosti, takođe našla na mapi opština u Republici Kosova.

Kao zajednica, duboko smo uvereni da su načela međunarodnog prava i poretka suštinska nadmoćnija u upoređenju sa bilo kojim oblikom primene pravnog ignorisanja. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani poslanici,

O značaju autoputa Vrmica - Merdare puno se govorilo koliko je značajan i koliko je važan za normalnu komunikaciju i povezivanja država regiona kao i približavanja Kosova Evropi i ispunjavanje evropskih standarda.

Gospodo poslanici,

Ja danas neću govoriti o autoputu i njegov značaju, jer smo dovoljno informisani o samom projektu, kao i o važnosti projekta.

Ja ću danas da pokušam da vam predočim i ukažem na zabrinutosti i strahove naših građana u opštini Gračanica i selo Uglara oko traseja autoputa koji prolazi kroz katastarsku zonu Uglare.

Kao poslanik izražavam svoju zabrinutost oko načina eksproprijacije zemljišta u selu Uglare, a na odluku Ministarstva prostornog planiranja, kao i na način na koji sve tu urađeno. Zbog toga ću pokušati da vam ukažem na šta se građani selo Uglara najviše žale, i gde su njihova prava ugrožena, a njihovo nezadovoljstvo su iskazali potpisivanjem peticije, gde imamo potpise 66 naših domaćina.

1. Sam početak postupka eksproprijacije, u smislu obaveštenja i odluka o eksproprijaciju su dostavljeni isključivo na Albanskom jeziku, čime je povređen član 5. Ustava Kosova o pravu upotrebe službenog jezika.

2. Odluka o eksproprijacije nisu dostavljena na propisa način, već na veoma ponižavajući, ostavljajući odluke po kafanama i lokalnim prodavnicama, pri čemu nije uzet u obzir da pojedini vlasnici parcela ne žive u selu, ili čak na Kosovu. Zbog netransparentnosti i načina na koji je to urađeno, većina vlasnika parcela koje su eksproprijisane nisu mogli da podnesu žalbu, jer mi je rok istekao, a da meštani nisu znali za odluke eksproprijaciji, pri čemu je došlo do povrede člana 24. Ustava, koji govori da su svi jednaki pred zakonom.

3. Kada je u pitanju cena zemljišta po kvadratnom metru, moram reći da je cena ponižavajuća, jer je daleko manja od tržišne cene zemljištu u tom delu, pa su građani veoma nezadovoljni kako kažu o tom ponižavajućim cenom njihove imovine, čime je povređen član 46. Ustava, koji se odnosi na zaštitu imovine.

Kada govorimo o ceni imovine naših građana, moramo uzeti u obzir šta bi mu u stvari bilo plaćeno, da li cele parcele ili samo odelovi parcela koje zahvata autoput, a ostatak parcele ostaje i dalje u vlasništvu, iako onih taj deo više ne bi mogli nikako da obrađuju i

da koriste zbog nemogućnosti fizičkog prilaza poljoprivrednih mašina u delovima tih parcela.

Poštovana gospodo poslanici,
Kao što vidite,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe 2 minuta fjalën!

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!
...građani imaju razlog za nezadovoljstvo i na odgovore.

Zašto je sve tako bilo urađeno? Da li je za to neko odgovoran, ili ko će odgovarati za svoj rad, ili još bolje reći nerad?

Na osnovu svega iznetog, dolazimo do zaključka da se direktno krše ljudska prava građanima Srpske zajednice, kao i član 21. Ustava i zakona, koji govori o ljudskim pravima i osnovnim slobodama.

Da bi se nezadovoljstvo građana do negde oblažilo, i da bi smo mogli da ispoštujemo svoj Ustav i svoje zakone, sa ovog mesta pozivam ministra Prostornog planiranja da uloži sav svoj autoritet, kako bi moglo da utiče na zaposlenost u svom ministarstvu i ispravi greške koji su napravljene, a koje su direktno proizašli iz Ministarstva prostornog planiranja.

Da bi građani bili do negde zadovoljni, kako bi se iz poštovali zakoni i Ustav, mora se uraditi sledeće:

Dostavljene odluke i obaveštenja mora biti na Srpskom jeziku;

Dostavljene odluke i obaveštenja putem pošte, dostavljanje na ruke ili primaocu, čije se imovina eksproprijše.

Produženje rokova za žalbe, jer su isti istekli odavno, a da stranke u postupku nisu obavestene.

Povećanja cene zemljišta na tržišnu cenu.

Dolazak ministra na razgovor sa meštanima sela Uglara, kako bi se pronašla prihvatljiva rešenja u postupku eksproprijacije, i samo na ovaj način bi građani mogu da zaštite svoje interese, a da projekat autoputa ide svojim postavljenim tempom, i da se završi u roku koji je predviđen za okončanje radova. Hvala!

KRYETARI: Deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem poštovani!

Poštovani ministri,

Poštovane kolege,

Osećam obavezu da demantujem neistinu koja ovih dana širena i plasirana od strane poslanice Emilije Redžepi, vama kolegama u Skupštini, ministrima, premijeru, njegovim savetnicima, usmeno presreću vas po hodnicima ili SMS porukama o mom navodnom susretu sa Aleksandrom Vulinom tokom njegove zadnje posete Kosovu i Dragašu. Pomenuta osoba, bez imalo stida, odgovornosti, bez političke kulture, i bez ikakvih dokaza, podstaknuto jedino političkom zavidnošću i strahom od boljeg i kvalitetnijeg, širi laži i nanosi štetu svim poslanicima ovog predstavničkog doma. Ona misli da će ovakvim izmišljotinama oprati svoju političku prošlost i političku prošlost svoje porodice, koja vrlo diskutabilna i sramna.

Poštovane kolege,

Ovakvih slučaj dezinformacija ćete verovatno čuti ubuduće od ove poslanice, jer je njena politička filozofija zasniva na širenju neistine i kleveta o svojim političkim suparnicima, sa krajnim ciljem da za sebe pribavi lažni politički ponos. Tema koja se ona htela dotaći, odgovaranjem i decentralizacija. Od samog početka, dobro znamo gde smo je tražili, gde je tražimo, i gde ćemo nastaviti da je tražimo. Moja aktivnost u Parlamentu od početka bila usmerena ka tome, a to se ne dokazuje čestim nastupima za ovom govornicom tražiće ostvarivanje mog i našeg cilja, a to je stvaranje opština sa Bošnjačkom većinom, uvek poštujući u skladu sa zakonima Republike Kosova. U tim nastojanjima očekujemo i nadamo se vašoj iskrenoj pomoći. Hvala vam na sadašnjem razumevanju!

KRYETARI: Deputeti Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka një kohë të gjatë që po flitet për sigurinë e ushqimit në Kosovë. Agjencia Ushqimore e Kosovës, edhe pse është organi kompetent për ta garantuar sigurinë e ushqimit te ne, e kam përshtypjen se ka shumë probleme me të cilat duhej të merrej, por duhet të merret njëkohësisht edhe institucioni ku jemi tash, por edhe Qeveria e Kosovës.

Ka probleme në infrastrukturën ligjore, institucionale e fizike për të arritur që kjo siguri e ushqimit të jetë e plotë.

Dy ligje, të cilat merren me ushqimin, Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve, dhe Ligji për ushqimin nuk janë kompatible ndërmjet tyre, nuk janë të harmonizuara, nuk kanë sinergji dhe janë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Këto dy ligje duhet të merren parasysh nga komisionet dhe duhet të trajtohen në mënyrën e duhur, që ta japin efektin e tyre.

Po ashtu, Ligji i ushqimit duhet të ndryshohet me qëllim që Agjencia Ushqimore e Kosovës të kthehet në Ministrinë e Bujqësisë nga Kryeministria. Aty e ka vendin edhe për faktin se me konstatimin e alfatoksinës në produktet e tashme ushqimore veç u

dëshmuar që kontrolli i ushqimit duhet të bëhet në zinxhirin e prodhimit. Dhe, ky është një fakt i mjaftueshëm për ta kthyer këtë agjenci te Ministria e Bujqësisë.

Po ashtu, arsyeja e dytë që duhet të merremi me këtë problem është se ne duhet të investojmë për ngritjen profesionale të njerëzve që janë në AUK për të arritur që të menaxhohet ky sektor më mirë sesa po e menaxhojnë tash.

Edhe mekanizmat qendrorë të kontrollit ne nuk i kemi në ushqim. Është pak e çuditshme kjo. Ne kemi mekanizma të kontrollit për pensionet, për kontrollin e Ibër-Lepencit, për KEK-un, për një varg institucionesh, por nuk kemi për Agjencinë Ushqimore. Domethënë nuk e kemi një institucion që e mbikëqyrë punën e agjencisë as në nivel në nivel të Kuvendit.

Ndoshta është mirë që përfaqësuesi ynë në CEFT-a ta trajtojë këtë problem brenda vendeve të rajonit, me qëllim që të krijohet një mekanizëm alarmi, i cili do të ishte i gatshëm që të alarmojë me kohë për gjendjen e ushqimit që e kemi në regjion.

Dëshiroj ta inkurajoj AUK-un që ta zbatojë nenin 30 të Ligjit për ushqimin edhe ta akreditojë laboratorin e vet. Është laborator shumë modern, i cili duhet të jetë i besueshëm në vlerësimin e analizave që ai realisht i bën. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Në seancën e 28 shkurtit kemi debatuar lidhur me kompensimin e pensionistëve të Kosovës për kontributet e dhëna deri në vitin 1999. Në fund të debatit, u votuan unanimisht rekomandimet me afat prej dy javësh për t'u plotësuar. Sot bëhen saktë dy javë nga ajo seancë. Po jua përkujtoj se Gjykata e Strasburgut për të Drejtat e Njeriut ua ka dhënë të drejtën në të dyja rastet e çiftit Grudiq dhe Kelmendi dhe e ka paralajmëruar Republikën e Serbisë që të përgatitet për të gjitha rastet tjera të mbi 60 mijë pensionistëve kosovarë.

Republika e Serbisë e formoi Komisionin ndërministror dhe më 22 shkurt të këtij viti e shpalli formularin me listën e dokumenteve të nevojshme që duhet t'i plotësojnë pensionistët tanë, në mënyrë që t'i marrin pensionet që u takojnë. Këtij procesi iu caktua afati prej 60 ditësh për paraqitje, pra deri më 22 prill. Por, problemi është se dokumentet që pranohen janë vetëm dokumente të vërtetuara nga institucionet e Serbisë, gjë që i pamundëson qytetarët e shtetit të Kosovës t'i plotësojnë këto kërkesa. Këto dokumente mund të plotësohen vetëm nëse pensionistët tanë bëhen shtetas të Serbisë, me ç'rast ata diskriminohen edhe një herë. E pyes Qeverinë dhe zotin kryeministër, i cili nuk është këtu, a është bërë ankesa në Gjykatën e Strasburgut për qasjen diskriminuese të Serbisë, e cila po i pamundëson pensionistët tanë t'i marrin pensionet e tyre të ndalura, si me kohë, ashtu edhe procedura?

Nën dy, sipas rekomandimeve të seancës të 28 shkurtit, a e keni formuar Komisionin e ekspertëve, të cilët do të japin udhëzime profesionale se çka të bëjnë pensionistët tanë, në

mënyrë që ta gëzojnë të drejtën e tyre për pensione, për të cilat kanë paguar kontribute, e drejtë kjo e siguruar me të gjitha konventat për të drejtat e njeriut.

Nën tre, a jeni duke e siguruar dokumentacionin e nevojshëm për pensionistët tanë që ta kërkojnë të drejtën e tyre pa qenë të diskriminuar, pasi ata janë të hutuar dhe pa informata të sakta. Këto përgjigje, por edhe veprime të shpejta dhe të sakta, zoti kryeministër, i cili nuk jeni këtu, ua keni borxh pensionistëve të Kosovës dhe obligim ndaj rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

KRYETARI: Deputeti Berat Buzhala, pyetje për ministrin Ramë Buja.

BERAT BUZHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Buja,

Pyetja ime ka të bëjë me atë se sa është numri i përgjithshëm i doktorëve të shkencave në Republikën e Kosovës dhe sa prej tyre kanë doktoruar pas vitit 1991, e sa pas vitit 1999? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër Buja, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra dhe zëvendëskryeministër,

I nderuar deputet Buzhala,

Nga themelimi i Universitetit të Prishtinës e deri në vitin '86 kanë doktoruar 300 doktorë shkence. Nga viti '90 deri '99 kanë doktoruar 150, nga viti '99 deri në vitin 2013 kanë doktoruar 416. Nga këto shifra del se numri total i të doktoruarve në Universiteti e Prishtinës, nga themelimi deri më sot, është 866 në të gjitha fushat.

Ndërkohë, në vitin 2008, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, respektivisht Departamenti i Arsimit të Lartë ka filluar edhe me njohjen e titujve të doktoraturave të fituara në universitete ndryshme ndërkombëtare. Titujt e doktoraturave të fituara jashtë vendit sipas vitit dhe numrit janë: më 2008 janë 4 njohje të doktoraturave, më 2009 janë 25 njohje, më 2010 janë 45 njohje, më 2011 janë 50 njohje, më 2012 janë 85 njohje dhe më 2013 janë 18 njohje. Totali i doktoratave të njohura nga qendra "Narik", nga viti 2008 deri në vitin 2013, është 227.

Numri total të doktoruarve në Universitetin e Prishtinës dhe jashtë shtetit është 1 113, duke mos i përjashtuar këta që u certifikuan, të them kushtimisht, ose u aprovuan dje, 58 tjerë.

Të gjitha punimet e doktoraturave që janë mbrojtur në Universitetin e Prishtinës janë të ruajtura në arkivat e fakulteteve përkatëse të Universitetit të Prishtinës, kurse për ata që

kanë mbaruar jashtë vendit janë të ruajtura në arkivin e qendrës “Narik”, në Departamentin e Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë? Nuk ke. Vazhdojmë! Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për zëvendësministrin Slobodan Petroviq. Nuk është këtu, do ta bësh pyetjen? Jo. Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Ramë Buja. Deputete, e ke fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Programi për rikualifikimin e mësimitdhënësve që e kanë të përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike është ndërprerë. Ka mbetur edhe një numër jo i vogël i mësimitdhënësve që nuk janë përfshirë në këtë program. Pyetja ime për ju ministër është: Pse është ndërprerë ky program dhe kur do të fillojë rikualifikimi edhe për pjesën tjetër të mësimitdhënësve?

KRYETARI: Ministër Buja, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuara deputete,

Unë besoj që ju e dini që nuk është ndërprerë kjo, por pasi e keni bërë pyetjen për sqarim për opinionin qytetar dhe kjo është mirë. Faleminderit për pyetjen që e keni bërë, sepse programi i avancimit të kualifikimit të mësimitdhënësve, që është i njohur me shkurtesën AKM, ka filluar në vitin 2010. Programi nuk është ndërprerë dhe normalisht vazhdon edhe tani.

Deri më tani janë përfshirë dy gjenerata, me 2 700 mësimitdhënës. Në gjeneratën e parë kanë diplomuar 1 000 studentë-mësimitdhënës, ndërsa në gjeneratën e dytë janë përfshirë 1 700 të tjerë.

Për vitin akademik 2012/2013, deri më tani është përfunduar semestri i gjashtë, kurse semestri i shtatë vazhdon nga muaji prill.

Grupi tjetër, i treti, pritet të fillojë nga mesi i dytë i vitit, pas përfundimit të gjeneratës së dytë të këtyre studentëve-mësimitdhënës. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e mësimit të gjeneratës së tretë, duke e siguruar edhe buxhetin, ndërkaq është në fazën finale të përgatitjes së anës teknike të të dhënave sipas drejtimeve lëndore të nivelit të caktuar.

Sipas të dhënave, kanë mbetur pa u përfshirë edhe 2 698 mësimitdhënës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, ministër!

Por, kur thashë është ndërprerë, në fakt, këtë vit, në vitin shkollor 2012/2013, nuk ka pasur grup tjetër që ka filluar. Kanë vazhduar ata, se ne jemi në Kosovë ministër. Megjithatë, pyetja ime është: Kanë mbetur në këtë numër që ju po e përmendi, që janë mbi dy mijë e

sa, por janë edhe 120 studentë nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci. A do të përfshihen edhe këta studentë dhe në çfarë forme do ta vazhdojnë edhe këta rikualifikimin?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Deputete, nuk fillon gjenerata pa përfunduar paraprakja, andaj këtu është problemi i kohës, por jo i ndërprerjes në asnjë çast dhe në asnjë mënyrë.

Çështja e numrit, thashë se është 2 698 që kanë mbetur në Kosovë dhe 124 janë nga Presheva, Medvegja e Bujanoci, dhe këtë e kemi biseduar me përgjegjësit e asaj ane dhe do ta organizojmë gjithsesi këtë nivel të avancimit të kualifikimit, o në Gjilan, o në Preshevë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Alma Lama, pyetje për ministren Vlora Çitaku. Ministrja nuk është këtu, dëshironi ta bëni pyetjen?

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja ime kishte të bëjë në lidhje me asqui communautaire, në fakt me numrin e madh të pyetjeve dhe të këtij materiali, të cilin Kosova do të duhej ta përkthente, në mënyrë që të punojë për procesin e integritetit evropian. Pyetja ime për ministren ishte se pse nuk bashkëpunohet me Shqipërinë, pasi ne si komision e kemi pasur mundësinë që të zhvillojnë takime me deputetët e Shqipërisë dhe, duke qenë që ky dokument e ka një kosto shumë të lartë dhe duke qenë se Shqipëria e ka përkthyer në gjuhën shqipe, do të ishte mirë që ky dokument të merrej. Një gjë të tillë e ka bërë edhe Shqipëria në raport me Maqedoninë. Prandaj, do të dëshiroja ta pyes ministren se pse një gjë e tillë nuk po bëhet nga Kosova, në mënyrë që të shkurtohet kostoja buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Halit Krasniqi, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi. Deputet, e ke fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Njoftimet që dalin nga zyra juaj janë inkurajuese për qytetarët dhe sidomos për ata që aspirojnë në sistemin e drejtësisë që të reformohet.

Kapitulli i punëve tuaja që quhet reformë në drejtësi e ngre jashtëzakonisht besueshmërinë e qytetarëve në punën e Ministrisë. Unë e kam një preokupim timin, që nuk është veç imi, por i një pjese të qytetarëve. Duam të dimë se në këtë reformë, a janë paraparë që të largohen nga sistemi i drejtësisë të gjithë ata ish-gjykatës, ish-prokurorë dhe ish-administratorë burgjesh, të cilët kanë bërë shkelje të të drejtave të njeriut, të qytetarëve të Kosovës në të kaluarën? Edhe unë, edhe gjithë ata që e kanë një koncept për zhvillimet e shoqërisë tonë, nuk janë për t'i lënë këta njerëz pa punë, nuk janë për t'i lënë në rrugë, por mendimi im dhe disponimi i të gjithëve është që ata të mos frekuentojnë më në sistemin e drejtësisë. Të gjenden vende punë në administratën shtetërore adekuate me përgatitjen e tyre profesionale. Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Faleminderit zoti Krasniqi për komentimet dhe për pyetjen tuaj,

Më lejoni që t'i ndaj dy çështje këtu.

E para, ajo që ka të bëjë me Shërbimin Korrektues të Kosovës, ku unë jam përgjegjës për atë, duhet të them që kemi bërë verifikimin e të gjitha pozitave të larta që parashihen me ligj dhe në këtë drejtim të gjitha informatat që kanë ardhur nga Agjencia Kosovare për Inteligjencë i kam respektuar në tërësi dhe ka raste, katër sosh, që ua kam ndryshuar vendet e punës.

Në raste të tjera, për gjyqtarë dhe prokurorë, ju e dini që Ministria e Drejtësisë, respektivisht Qeveria e Kosovës, nuk ka mandat në verifikimin e tyre, në emërimin e tyre dhe disiplinimin e tyre, dhe në këtë drejtim nuk mund të jap përgjigje. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

HALIT KRASNIQI: Jo, nuk kam pyetje shtesë, por do ta bëj një konkludim dhe një sintetizim të gjithë asaj që po ndodh tani.

Ne e kemi trajtuar edhe në komision këtë problematikë, që ka qenë pak hendikep për sistemin e drejtësisë, sepse kriteret për pranimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve ka qenë një afat prej 12-13 vjetësh prej pasluftës e këndej. Rrjedhimisht, pas luftës, asnjë nga juristët nuk ka mundur ta ketë këtë përvojë pune, që nënkuptohet vetvetiu, sepse koha nuk u ka mjaftuar, por tani, ngaqë kërkohet ky kriter dhe këtë kusht mund ta plotësojnë juristët e krijuar, e diplomuar dhe me përvojë të pasluftës, kërkoj që gjithë ata që janë me ndikim në sistemin e drejtësisë, pra edhe aty ku nuk mund të ketë ndikim Ministria e Drejtësisë, ta kenë në konsideratë këtë preokupim dhe këtë shqetësim të qytetarëve dhe të atyre që janë të brengosur për shkeljen e të drejtave të njeriut...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Mirë, zëvendëskryeministri Kuçi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, kryetar!

Besoj që zoti Krasniqi tash në çështjen e dytë e preku atë që është edhe kompetencë imja, por dua të besoj që do ta kem mbështetjen edhe të Kuvendit të Kosovës.

Që nga ardhja ime në krye të Ministrisë së Drejtësisë kam menduar sesi ta freskojmë Ministrinë e Drejtësisë, por në veçanti Gjyqësorin dhe Prokurorinë në Kosovë.

Kemi qenë në fazën e emërimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe çdo ndryshim i kriterëve do të merrej si tendencë imja për partinë që i përkas në sistemin e drejtësisë.

Më 1 janar 2013 janë plotësuar të gjitha vendet për gjyqtarë dhe prokurorë dhe shumica dërmuese e tyre, sidomos ata më të vjetër, tanimë e kanë mandatin e përgjeshëm. Unë do të kërkoj dhe e kam planin tim që këtë vit të bëjmë amendamentimin e Ligjit për gjykata, amendamentimin e Ligjit për Prokurorinë dhe për të gjitha ligjet që kanë të bëjnë në emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe do të jem shumë fleksibil në emërimin e tyre, në kuptimin e kushteve dhe përvojës së punës dhe do ta ekuivalentoj punën në gjykata dhe Prokurori me punën që bëhet në drejtësi, qoftë në mësimdhënie, avokati, apo në institucione të tjera.

Po ashtu, në planin tim, dhe unë do ta bëj këtë, do ta propozoj në Kuvend themelimin e Akademisë së Drejtësisë. Për mua si ministër është e papranueshme që një individ që mund ta ketë përvojën deputet i Kuvendit të Kosovës, sekretar i një ministrie, apo edhe ministër i Drejtësisë, duhet të shkoj në arsimin fillor, ose një profesor i drejtësisë për 20 vjet. Unë i kam parë disa komente që po i jepni, për 20 vjet profesor i drejtësisë duhet të shkojë në arsimim fillestar që të bëhet prokuror apo gjyqtar.

Në anën tjetër, ka qenë dhe mbetet një diskriminim, po e quaj kështu, për gjeneratat e reja. Në këtë drejtim pres mbështetjen tuaj që t'i hapim dyert për njerëzit e rinj. Në vitet e '90-ta, njerëzit nuk kanë pas shanse, shumica prej nesh që i kemi nga 40-42, t'i kemi 12 vjet përvojë pune, do ta thyejmë këtë kriter dhe do ta barazojmë me kriteret tjera. Nuk është ky ndonjë qëllim yni që të futim njerëz që nuk e meritojnë në Gjyqësor, por njerëz që puna e tyre ekuivalentohej edhe jashtë Gjyqësorit, që kanë mundësi ta japin kontributin e tij edhe në drejtësi.

Shumë korrekt do të jem, edhe s'po e përmend vetëm profesorin....

KRYETARI: Vazhdoje edhe një minutë!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, kryetar!

Po e përmend profesor Demollin, që është këtu. Është profesor i së drejtës apo i çështjeve penale, ka qenë ministër i Drejtësisë. Nëse dëshiron që të bëhet prokuror, duhet të shkojë në arsimin fillestar, duhet të shkojë në Prokurorinë Themelore, ose në Gjykatën Themelore, e kjo është jo e dinjitetshme, edhe për të, edhe për dikë si ky. Besoj edhe për të tjerë, meqë ka me qindra të tjerë, por sikur do të jepej mundësia që njerëzit e tillë, me një përgatitje të tillë, të kenë mundësi të aplikojnë në Gjykatën Supreme, ose Prokurorinë e Shtetit, besoj se ka njerëz të mjaftueshëm.

Pra, në këtë drejtim, ju premtoj që ndryshimet e reja për gjykata, po e marr shembull edhe veten, jo vetëm profesor Demollin apo dikë tjetër, se nuk e kam atë ambicie, por ka njerëz të rinj që e kanë kryer shkollimin jashtë vendit, kanë përvojë të mirë dhe duhet t'i vëmë në mundësitë që ata të jenë në sistemin e drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Mursel Haljilji, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Ministri nuk është këtu. Deputet, mund ta bësh pyetjen.

MURSEL HALJILJI: Hvala, predsedniče Skupštine!

Članovi Vlade,

Ja ću da postavim pitanje, dame i gospodo poslanici,

Pre godinu dana, posle tragedije koja zadesila porodicu Reka i meštane sela Restelica, opštini Dragaš, u delu deklarisanja van dnevnog reda pokrenuo sam pitanje mapiranja kriznih tačaka na celoj teritoriji Kosovo, u smislu prevencije od mogućih izlivanja Slivova Reka, odrona kamenja na putevima, mogućih klizišta, kao i snežnih glavina u zimskoj periodu. Pitanje: Da li je Ministarstvo pokrenulo ovo pitanje, i da li je uređeno nešto povodom ovoga, s obzirom na okolnost da postoje jedna poznata činjenica da jedna Austrijska komisija nakon te tragedije boravila na terenu u opštini Dragaš, konkretno blizini sela Restelice, i napravila je neku procenu i mapu nekih kriznih tačaka. Da li Ministarstvo ima veze sa ovom Komisijom, ili da li je preduzelo nešto po vodom ovoga? Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu i ka dy pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Do t'i bësh pyetjet, deputet?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Kur të jetë ministri këtu, do t'i parashtroj pyetjet.

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në fillim të këtij viti duket se ka filluar ose ka vazhduar në një farë mënyre procesi i ndërrimit të njësorëve mekanikë me ata elektronikë në Kompaninë Kosovare për Distributum dhe Furnizim.

Pra, pikërisht pas nënshkrimit të kontratës për shitjen e kësaj ndërmarrjeje, 8 milionë euro të kompanisë publike po shpenzohen për këtë investim në atë që shpejt do të jetë kompani private. Pra, në njëfarë mënyre kjo është një lloj subvencionimi. A mund të na tregoni pse po e subvenciononi këtë kompani, të cilën e shitët edhe me arsyetimin për t'i ikur subvencionimit?

KRETARI: Ministër Beqaj, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Deputet Ymeri,

Planet e Korporatës Energjetike të Kosovës për zëvendësimin e pikave matëse nga njëhisorët mekanikë në njëhisorët elektronikë kanë filluar në vitin 2006. Që nga viti 2006 e deri më tani janë zëvendësuar 14 122 grupe matëse me mundësi leximi e komunikimi nga

distanca për llogaritjen e energjisë e trafostacioneve dhe të konsumatorët me konsum të lartë të energjisë elektrike. Kostoja totale e blerjes së këtyre njësorëve është 4,4 milionë euro.

Gjithashtu, nga viti 2006, KEK-u ka fillua me vendosjen e njësorëve të thjeshtë elektronikë, të cilët gjithsej janë vendosur 97 600 te konsumatorët në amvisëri, me kosto prej 4,56 milionë euro. Nga muaji mars i vitit 2012 e këndej nuk ka asnjë blerje dhe asnjë porosi të njësorëve elektronikë.

Njësorët që janë zëvendësuar janë bërë në bazë të nevojës dhe prioritizimit që të gjitha pikat e sistemit elektroenergjetik në kufirin KEK - KOST, konsumatorët industrialë dhe të gjitha nënstacionet 1004 kilovoltë.

Planet e KEK-ut të konsumatorët e amvisërisë janë të fokusuara në zëvendësimin e njësorëve që janë më të vjetër se 40 vjet. Njësorët e vjetër mekanikë nuk kanë regjistruar në mënyrë të duhur kohën dhe hapësirën ndërmjet tarifave të ulëta dhe tarifave të larta, prandaj është konsideruar dhe ky raport është aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë që të bëhet ndërrimi i këtyre njësorëve.

Ndërrimi i njësorëve nga elektromekanikë në digjitalë ka mundësuar matje më së saktë të energjisë së konsumuar sipas sistemit tarifor të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Njësorë digjitalë, përveç saktësisë së lartë, e cila është në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës, mundësojnë edhe ruajtjen e historikut të gjendjes në 12 muajt paraprakë. Pra, nuk kemi asnjë lloj subvencionimi, nuk është e vërtetë, për hir të opinionit, që brenda këtij viti kemi subvencionuar 8 milionë dhe ka filluar tash. Ky projekt ka filluar në vitin 2006 dhe prej marsit të vitit 2012 asnjë porosi për njësorë të rinj nuk është bërë, prandaj nuk mund të jetë subvencionim.

Për më shumë, këtë plan për ndryshimin e njësorëve digjitalë e ka aprovuar Zyra e Rregullatorit të Energjisë në fillim të vitit 2012 sipas procedurave të rregullta dhe atëherë nuk ka qenë fare procesi i privatizimit. Pra, Zyra e Rregullatorit të Energjisë e ka aprovuar në gusht fillimin e kësaj procedure për blerjen e fundit dhe arritja e fundit e orëve digjitale, ka ndodhur në gusht të vitit 2012, kurse kontrata është nënshkruar në nëntor të vitit 2012.

Pra, për hir të qytetarëve dhe për hir të juve deputetë, nuk është e saktë që kemi ndërrim dhe që kjo kushton këtë vit 8 milionë. Ky proces ka filluar në vitin 2006 dhe është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë, por është mirë ta administrosh kohën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Pra, ka të bëjë me një vendim të Rregullatorit, i cili e ka aprovuar një proces të tillë për avancimin e sistemit energjetik. Dhe, kisha dashur që të mos ofrohen dezinformata, as për Kuvendin, as për qytetarët e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket shifrës 8 milionë euro, kjo ka qenë nëpër media, mbase edhe ka qenë gabim, por ju e thatë që veç krejt projekti kushton 8 milionë euro. Pra, nuk është dezinformatë, askund nuk e kamë thënë që 8 milionë euro janë shpenzuar në këtë vit. Nuk e ke lexuar mirë pyetjen, por në rregull është kjo.

E dyta, ju thatë që është bërë me miratimin e ZRRE-së. Po pajtohem plotësisht, por kërkesa sigurisht është bërë nga KEK-u, apo jo, se ZRRE-ja nuk e ka miratuar pa një kërkesë të KEK-ut, e kjo kërkesë e KEK-ut i ka shkruar një kompanie publike, e cila është 100% në pronësi të Qeverisë, pra në përgjegjësi, në një farë mënyre, tuajën.

Dhe, çështja është se nuk është e vërtetë që procesi i privatizimit ka nisur në nëntor të vitit 2012. Ai ka përfunduar në nëntor të vitit 2012. Pra, edhe në mars të vitit 2012 nuk është që nuk e keni ditur që po e shitni, se në qershor i keni hapur ofertat dhe e keni ditur. Domethënë, kur është marrë vesh, kur Qeveria përfundimisht ka arritur vendim për ta privatizuar, pse janë investuar para publike në një kompani, e cila tash më do të privatizohet. Edhe për më tepër, a janë llogaritur këto në çmimin e shitjes, se nëse ky projekt kushton 8 milionë...

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë, le të themi se këtu qasje konceptuale dhe kuptim konceptual të procesit.

Nën një, po e them edhe një herë, procesi ka filluar në vitin 2006, është në planet afatgjate të KEK-ut. KEK-u është ndërmarrje e cila operon, është ndërmarrje publike, kurse Qeveria i bën vetëm politikat publike të ndërmarrjes, ndërsa KEK-u, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, monitorohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Ministria e Zhvillimit Ekonomikë as Qeveria nuk e kanë asnjë kompetencë për ta monitoruar KEK-un dhe planet e tij investive. Ato mund të monitorohen ekskluzivisht vetëm nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Prandaj, çdo kërkesë që shkon nga KEK-u duhet të aprovohet nga Rregullatori, dhe Rregullatori, po e përsëris edhe një herë, i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pra, flasim për një proces të rregullt, të cilin duhet ta kuptoni.

Ndërsa, nuk kisha dashur që një deputet i Kuvendit të Kosovës të bazohet në informata apo informata të gabuara nga mediet dhe të japë shifra të pasakta për qytetarët e Kosovës.

Deputeti ka të drejtë ta marrë informacionin e plotë në KEK, në Ministri, në Rregullator dhe të vijë me informata të plota, e jo të vijë me atë çfarë shkuan një gazetë, apo dikush tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është mirë të shikohet Ligji për menaxhimin e kompanive publike. Deputeti Visar Ymeri, pyetje ministrin për Besim Beqaj.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Kjo ka të bëjë me një çështje tjetër, po ashtu prapë prej medieve. Në Kuvendin e Nëntë të Odës Ekonomike Amerikane, citoheni të keni thënë se vizioni i juaj për ekonominë është ristrukturim i reformave, gjë që automatikisht më shtyn mua të paktën të mendoj që reformat e deritashme nuk paskan pasur sukses për shkak se po u nevojitka ristrukturimi i tyre dhe që reformuesit e pasuksesshëm deri më tash vështirë se mund të jenë ristrukturues të suksesshëm. Pra, a mund të na tregoni çfarë keni nënkuptuar me këtë vizion dhe ç'është ky ristrukturim i reformave?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Mendoj që prononcimet e mia publike dhe çështjet e medieve janë interesante për deputetë të selektuar të Kuvendit. Unë personalisht konsideroj që është gabim teknik, sepse gabim teknik mund të jetë në media dhe prapë keni ardhur me një informatë, e cila është gabim teknik. Si do që të jetë, në rast se kemi nevojë për shpjegim profesional të reformës strukturale, reforma strukturale është definuar si transformim i kornizës institucionale dhe rregullativave të tregut me qëllim të funksionimit më të mirë të këtij tregu. Reformat sipas definicioneve të mirënjohura ndahen në reforma ekonomike strukturale- reale dhe ato fiskale. Realet kanë të bëjnë me reformat në treg, fiskalet kanë të bëjnë me reforma, të cilat merren me aspektet e reformimit të institucioneve financiare.

Sigurisht, që Qeveria deri më tani përmes këtyre reformave ka arritur që të ketë rritje ekonomike edhe në vitin e kaluar të ketë prognozë për rritjen ekonomike në këtë vit dhe që është për dallim nga shumë njerëz, të cilët mendojnë nga brenda dhe nga institucionet ndërkombëtare, konsiderohet që është model për rritje ekonomike, stabilitet makroekonomik dhe reforma në sektorin real dhe në sektorin financiar.

Sigurisht, që për më shumë informacione, sa i përket terminologjisë profesionale ka vende të tjera, ku mund të edukoheni. Faleminderit!

KRYETARI: A ke pyetje shtesë, deputet?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Pra, ju thatë si e kuptova unë, që nuk keni thënë ristrukturim i reformave, po keni thënë reformë strukturale, që po pajtohem, ka domethënë kuptimin plotësisht të ndryshëm. Pra, paskeni qenë të keqinterpretuar në media edhe pse nuk e keni demantuar këtë deri tash, po mirë që e demantuat tash.

Po, mua tash po më intereson pse kaq befasisht u bë ky vizion juaji, kur kjo reformë strukturale, siç na është thënë, ka nisur prej vitit 1999. Prej vitit 1999, Kosova është duke privatizuar, duke ristrukturuar ekonominë dhe tash ky u bë vizion juaji, a është vizion i ri apo vetëm po e vazhdoni një vizion të tjetërkujt dhe a jeni të sigurt që mund ta zbatoni vizionin, që dikush tjetër e ka, nëse e keni kuptuar mirë qysh duhet atë vizion?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar deputet!

Unë i referohem një dokumenti që është publik në Republikën e Kosovës, një dokument i kësaj Qeverie, i cili përcakton që vizioni ekonomik për zhvillimin e Republikës së Kosovës, është që të kemi rritje ekonomike, që të kemi sektor privat më të zhvilluar, që të kemi tërheqje të shtetit nga bërja e ekonomisë, që të kemi reformë në nivelin qendror dhe në nivelin lokal të administratës, të subjekteve ekonomike, fuqizim të sektorit privat. Këto janë elemente të cilat kërkojnë pak më shumë njohuri profesionale. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë! Deputetja Albulenë Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Më datën 13.2.2013, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar një vendim, me të cilin është aprovuar kërkesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për kompensimin e stimulimeve dhe shtesave për prokurorët specialë dhe zyrtarët e Prokurorisë Speciale. Me këtë vendim janë ndarë gjithsej 148 mijë e 176 euro, të cilat do të ndahen nga rezervat e Qeverisë, konkretisht mjete financiare të paparashikuara.

Në veçanti vërehet një tejkalim i çdo arsyeshmërie kur vjen deri te përcaktimi i stimulimit të zëvendëskryeprokurorit, ku është paraparë stimulimi prej gjithsej 900 eurosh, përkatësisht 800 euro për nëntë prokurorë tjerë specialë.

Dhe, pyetja është se a e konsideroni këtë vendim si diskriminues ndaj prokurorëve në prokuroritë themelore, atë të apelit dhe prokurorisë së shtetit? Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

E nderuara deputete Haxhiu, faleminderit për pyetjen!

Më lejoni, që t'i jap disa informata lidhur me këtë çështje.

Në vitin 2011, me vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe me mbështetjen edhe të EULEX-it, por edhe të Prokurorisë së Kosovës, është themeluar Task-Forca Antikorrupsion. Në këtë kohë janë kërkuar që t'i kemi prokurorët vendorë dhe ndërkombëtarë dhe në këtë task-forcë bëjnë pjesë së paku 5 prokurorë vendorë dhe po ashtu edhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe 30 ekspertë të hetuesisë së policisë dhe 5 ekspertë, që janë për krim financiar, shpëlarje të parave dhe veprime apo krime të tjera, sikur që mund të jenë ato kibernetike, e kështu me radhë.

Fokusi ynë ka qenë që ta stimulojmë këtë Prokurori, që t'i krijojmë kushtet e domosdoshme për punë dhe që të krijojmë sigurinë e domosdoshme.

Më lejoni, që t'i përmend katër kompetencat kryesore, që ka kjo prokurori. Ka të bëjë dhe merret:

1. Me krimin e organizuar dhe korrupsionin e nivelit të lartë;
2. Ka të bëjë dhe merret me shpëlarjen e parave;
3. Ka të bëjë dhe merret me luftimin e terrorizmit dhe me veprat penale që kanë të bëjnë me krime të luftës, përveç kompetencave tjera supstidiare.

Andaj kemi menduar që t'i stimulojmë njerëzit që të konkurrojnë. U them me bindje të plotë që në fillim kanë hezituuar një numër i madh i prokurorëve, që të marrin pjesë në këtë prokurori, por me stimulimin e tyre, qoftë financiar, qoftë me kushte tjera për punë, por jo vetëm për prokurorët, po për të gjithë të punësuarit në Prokurorinë Speciale dhe këtë shtesë në shuma të ndryshme e marrin që të gjithë.

Më lejoni të theksoj se për këtë kemi diskutuar edhe me Këshillin Prokurorial të Kosovës, kemi marrë kërkesë nga Prokuroria Speciale dhe e kemi miratuar.

Unë mendoj që është pozitive që po e stimulojmë një prokurori, e cila do të fokusojë imazhin e drejtësisë në Kosovë dhe imazhin e drejtësisë përballë Bashkësisë Ndërkombëtare dhe njerëzit të cilët janë të ekspozuar ndaj kritikave, kërcënimeve dhe vërejtjeve të ndryshme. Nëse Këshilli Prokurorial mendon që është një gjë e tillë diskriminim dhe unë mendoj që është pozitive, jo negative, unë që sot ju garantoj që Qeveria e Kosovës i bllokoi ato mjete. Por, ka ardhur kërkesë nga ata, e kundërta s'do të ishte mirë.

Por, më lejoni të theksoj që prokurorët edhe gjyqtarët në Kosovë, që nga viti 2011 sipas ligjeve tona, sipas buxhetit tonë, kanë pagën ekuivalente me të ministrit, kryetarët ose kryeprokurorët, me të kryeministrit.

Dhe unë dua të them që kjo është një dallueshmëri e madhe, prej pagës që ka qenë, po e them publikisht, nja 120% është më shumë tash se sa e kanë pasur përpara. Prokurorët në këtë vend kanë instrumente të mjaftueshme, kanë mbrojtje të mjaftueshme, kanë pagë të mjaftueshme, kërkohet që të punojnë dhe t'i implementojnë ligjet. Natyrisht, kërkesën e tyre e kemi miratuar. Nëse e tërheqin atë kërkesë, ne e tërheqim mbështetjen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër! Deputete, e ke pyetjen shtesë.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne jemi për rritje të buxhetit në tërë sistemin e drejtësisë, meqë me megjithatë buxhet që është, atë që e kemi, 1% e buxhetit ndahet për sistemin e drejtësisë dhe kjo është shumë shqetësuese. Dhe, e dimë se me çka merret Task-forca, veç faleminderit që

më tregove edhe një herë, mirëpo, ajo është dashur të merrej realisht me ato punë, mirëpo s'po merret, sepse krimi dhe korrupsioni po lulëzon në Kosovë.

Çështja tjetër është se Ligji për prokurorinë speciale të Republikës së Kosovës nuk parasheh një veçim në aspektin e pagave dhe stimulimeve të prokurorëve specialë dhe mendoj që ky është një vendim i kundërligjshëm dhe përbën ndërhyrje në ndikimin e pushtetit ekzekutiv në sistemin e drejtësisë. Pra, ekziston një tendencë që pikërisht se është në pyetje Prokuroria Speciale, e cila merret me çështje delikate, pra krimin dhe korrupsionin, ekziston tendenca e ekzekutivit, që të kontrollojë këtë task-forcë. Gjithashtu, kjo krijon një disbalanc dhe demotivim në tërë sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Por, çka është më shqetësuese, është se tërë këto stimulime...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A ke përgjigje zëvendëskryeministër?

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, deputete Haxhiu! Besoj, si juriste duhet të mendoni pak më ndryshe. Nëse unë nuk do ta miratoja, Qeveria e Kosovës, kërkesën e tyre, ju do të thoni që po e dëmtoni prokurorinë, po nëse ne ua rrisim pagat, iu ofrojmë siguri njerëzve që merren me ne, se ata merren me profilin e lartë, përfshirë nga presidentja, kryeministrat, deputetët, ministrat, e kështu me radhë, dhe ky është një stimulim për ata.

Në anën tjetër, unë ju premtoj që në këtë vend ka vështirësi që të gjenden njerëz që punojnë në ambiente të tilla, që merren me profile të tilla dhe të cilët nuk do të kishin ndonjë stimulim të veçantë dhe do të punonin aty, në një hapësirë ku secili njihet me secilin.

Po ashtu dua të them, se kjo është një fuqizim i kësaj prokurorie dhe unë kam në plan ta propozoj Ligjin për gjykata, themelimin e departamentit të veçantë në Gjykatën Themelore të Prishtinës, që do të merret me rastet e Prokurorisë Speciale.

Nëse i marrim shembujt, kudo tjetër edhe në rajon dhe më larg, do të shohim që kemi prokurori të tilla dhe kemi departamente apo gjykata të tilla. Kjo është një fuqizim i gjyqësorit. Nëse ata tërheqin, po e them publikisht, kërkesën, por po e them edhe një fjalë publikisht, nuk ka kërkesë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që ka ardhur në Qeverinë e Kosovës e që nuk e kemi miratuar.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë! Pyetja e fundit, deputeti Halit Krasniqi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!
Zoti ministër,

Unë ruaj respekt të vjetër për juve dhe aktualisht konsiderata të veçanta edhe tani për kondicionin tuaj në morinë e problemeve që manifestohen në funksionimin e Ministrisë së Brendshme.

Konsideroj se një pjesë e këtyre problemeve derivojnë edhe nga ndikimi i strukturave të SSHS-ë, të ish-SSHS-së, të ish-KOS-it dhe të ish njësive speciale të së kaluarës dhe dëshiroj të di edhe unë sikur edhe shumë qytetarë të Kosovës, sa është prania e tyre në strukturat e Ministrisë së Brendshme sot dhe a keni ndonjë program që të rishikoni gjithsesi dhe me vlerësime të duhura? Dhe, për këtë preokupim kam formuluar një pyetje, e cila nuk domethënë, që të ketë përgjigje të plotë.

I nderuar ministër, a keni të dhëna për praninë e këtyre kontingjenteve, të akomoduar në Ministrinë e Brendshme, sot dhe nëse po, a keni ndonjë program për të korrigjuar diçka organizimin e Ministrisë së Brendshme? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar Krasniqi!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Krasniqi, faleminderit për respektin!

Është pak vështirë të përgjigjem në këtë pyetje, por do të filloj kronologjikisht që gjatë periudhës së rekrutimit fillestar të policisë është bërë nga UNMIK-u, pra rekrutimi edhe i stafit edhe i stafit menaxhues në Policinë e Kosovës.

Procesi i verifikimit ka qenë i udhëhequr nga procedura të ndryshme, në kohë të ndryshme të rekrutimit të zyrtarëve policorë. Lidhur me verifikimin e të kaluarës, Policia e Kosovës tanimë i ka standardizuar këto procedura, por që trajtimi dhe grumbullimi i informacioneve inteligjente dallon nga informacionet të cilat mund të përdoren për nevoja tjera.

Policia e Kosovës në vazhdimësi përmes kontrollit të brendshëm inteligjent, mbikëqyr veprimtarinë dhe siguron mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, por edhe operacionet e saja.

Me themelimin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, përgjegjësia kryesore është bartur në strukturat përgjegjëse të kësaj agjencie, Ligji për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë. Në zbatim të përgjegjësive tona institucionale për ofrimin e sigurisë publike, por edhe përgjegjësitë tona në fushën e sigurisë nacionale, ne në bashkëpunim me Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, kemi filluar dhe procesin e verifikimit të sigurisë për të gjithë punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilët në bazë të pozitës së tyre, apo vendit të tyre të punës kanë qasje në informacionet e klasifikuara.

Njëra nga pikat, në të cilat strukturat e AKI-së do t'i trajtojnë rastet, është edhe lojaliteti ndaj Republikës së Kosovës dhe rendit dhe vlerave të saja kushtetuese, preferencat për

të ndihmuar organizatat apo qeveritë e huaja, në mënyrë të dëmshme për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës, apo sjellje të cilat ngrisin dyshime rreth përgjegjshmërisë së personit për t'i mbrojtur informacionet e klasifikuara.

Konsiderojmë se para nesh është një proces mjaft i vështirë, marrë në bazë periudhën kohore të veprimit të strukturave të sigurimit nga ish- Federata Jugosllave edhe nga vetë Republika e Serbisë, në territorin tonë, konsiderojmë se me një bashkëpunim ndërinstitutional dhe në mënyrë graduale do të arrijmë të ngremë nivelin e sigurisë në kuadër të Agjencive të sigurisë.

Ministria e Punëve të Brendshme në zbatim të legjislacionit në fuqi do të bashkëpunojë ngushtë me Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, në të gjitha fazat e verifikimit të sigurisë.

Më duhet t'ju informoj, se MPB-ja dhe AKI-ja lidhur me çdolloj indikacioni që marrin për çështjet e ndonjë spiunazhi, bashkëpunojnë përmes strukturave përgjegjëse në institucione...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë?

HALIT KRASNIQI: Pas kësaj përgjigje nuk kam pyetje shtesë, por dua të bëj një konkludim, pak a shumë që vjen nga zhargoni edhe nga pasuria e leksikut popullor.

KRYETARI: Duhet ta kesh parasysh se ne nuk e kemi Ligjin për lustrim. Deputetët janë të obligueshëm ta bëjnë një ligj e pastaj të kërkojnë zbatimin e ligjit.

HALIT KRASNIQI: Desha të bëj një konkludim, por tash po nxjerr një sintezë të asaj që thuhet në popull: “o bre, ky ministri është melaqe, po aty është zabel”, për shembull që i kam dëgjuar me “dreqër” e me “bir” e me sende...

Kështu, po ndërroj konkluzion, se desha të bëj diçka tjetër. Prandaj më ka motivuar ky shqetësim i qytetarëve për ta formuluar këtë pyetje. Faleminderit në përgjigje, ministër!

KRYETARI: Për të vazhduar pikën e tretë të rendit të ditës na duhet prania fizike e 106 deputetëve që i kanë kartelat.

Regjia, i bini ziles!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i amendamenteve 23 dhe 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Në pajtim me nenin 124, paragrafi 1 të Kushtetutës së Kosovës, Qeveria ka propozuar amendamentet 23 dhe 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Amendamentet e propozuara, kryetari i Kuvendit ia ka adresuar Gjykatës Kushtetuese për t'i vlerësuar, nëse të njëjtat pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuar në kapitullin e dytë të Kushtetutës.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka shqyrtuar amendamentet kushtetuese të propozuara nga Qeveria e Kosovës, si dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj zëvendëskryeministrin që t'i arsyetojë amendamentet.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, t'i prezantoj para jush propozimet për ndryshimin e amendamenteve, dy shosh. I pari ka të bëjë me përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe e dyti ka të bëjë me Institutin e Amnistisë.

Lidhur me amendamentimin e parë, që ka të bëjë me përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më lejoni të theksoj që Qeveria e Republikës së Kosovës ka pasur dhe ka vazhdimisht orientim të plotë krijimin e kushteve dhe pavarësisht të plotë në të gjitha sferat, sa i përket pavarësisë së gjyqësorit në Republikën e Kosovës.

Një veprim i tillë tanimë ekziston në Kushtetutë, qoftë në emërimin e gjyqtarëve, në disiplinimin e tyre në mandatin e përhershëm dhe po ashtu, ekuivalentimin e pagave të tyre me nivele të tjera të pushteteve.

Arsyeja e sjelljes së këtij ndryshimi është sjellja e përzgjedhjes së gjyqësorit krejtësisht në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, rekomandimi që ka të bëjë me pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve.

Ky rekomandim, në mes tjerash, thekson, më lejoni të citoj: "Autoriteti i cili merr vendimin për përzgjedhjen në karrierën e gjyqtarëve duhet të jetë i pavarur nga pushteti dhe administrata, në mënyrë që të sigurohet pavarësia e tij, rregullat dhe ligjet duhet të sigurojnë, që për shembull një anëtar i tij, që zgjidhet në gjyqësor, të vijë nga një trup, që vendos kryesisht apo në shumicë nga gjyqtarët".

Për të siguruar përmbushjen e këtij kriteri shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë interpretuar atë si kërkesë, që së paku shumica e anëtarëve të Këshillit i cili për zgjedhë gjyqtarët, të jenë nga radhët e vetë gjyqtarëve. Dhe, sot me këtë amendamentim po i japim mundësi që Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nga 13 prej tyre, 7 të jenë të zgjedhur nga vetë gjyqtarët.

Prandaj, të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndonëse Kushtetuta jonë garanton një nivel të lartë të pavarësisë së gjyqësorit duke i lejuar që ata të funksionojnë kryesisht të pavarur, ky do të jetë një element i fundit shtesë, që do të mundësojë që ky institucion, gjegjësisht Këshilli Gjyqësor i Kosovës të funksionojë nga gjyqtarët dhe për gjyqtarët, natyrisht në interes të qytetarëve të Republikës.

I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuara zonja dhe zotërinj,
Më lejoni që të theksoj apo të përmend dhe ta prezantoj Institutin e Amnistisë, që është amendamentimi i dytë i Kushtetutës për sot.

Jam i nderuar që prezantoj amendamentimin kushtetutes, që sjell një risi tejet të rëndësishme në vendin tonë. Sot, besoj të gjithë së bashku deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, do të votojmë dhe të vendosim, që kompetenca do t'i shtohet duke marrë parasysh se janë përfaqësues direkt të qytetarëve të vendit tonë, për të amnistuar kategori të ndryshme të personave të dënuar.

Instituti i Amnistisë, ka kohë që është kërkuar në vendin tonë nga pjesë të ndryshme të shoqërisë, Megjithatë, për shkak të historisë sonë të trazuar, situatës së ndjeshme politike dhe në përgjithësi të nivelit të stabilitetit të vendit tonë, shpeshherë deri më tani është konsideruar, që kjo nuk është e mundur të arrihet politikisht dhe shpeshherë është dhe penguar Kuvendi i Republikës së Kosovës apo institucionet tjera, ta përfshijnë këtë qoftë në Kushtetutë apo në ligje të veçanta.

Prandaj sot, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, pas amendamentimit të Kushtetutës së Kosovës në shtatorin e vitit të kaluar, që kemi bërë mbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, sot me kënaqësi mund të them, që Kuvendi i Kosovës po e merr edhe një kompetencë dhe po e dëshmon rritjen e ndjeshme dhe të mëtejme të besimit në organe tona shtetërore.

Pasi që tashmë e kemi marrë aprovimin e duhur të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në lidhje me përmbajtjen e kushtetutshmërisë së propozimit të Qeverisë së Kosovës, më lejoni të bëj një prezantim substancial të amnistisë si institut i ri për Kuvendin, po edhe për Kosovën.

Amnistia është një institut, përmes të cilit kategori të ndryshme personash të dënuar dhe kategori të caktuara të veprave penale, lirohen pjesërisht apo krejtësisht nga vuajtja e dënimit. Duhet bërë me dije, për dallim nga falja që është institut i faljes së dënimit për persona të caktuar dhe është kompetencë e presidentit të Republikës së Kosovës, amnistia është falje për kategori dhe vepra të caktuara që është kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ministria e Drejtësisë ka filluar përgatitjet, për të sjellë ndryshimin e tillë tashmë një kohë të gjatë. Përveç punës në formulimin dhe draftimin e çështjes, ne kemi punuar edhe në hulumtimin e duhur për të siguruar gjithë atë që ky proces të jetë transparent, i plotë po edhe në përputhje të plotë me normat vendore dhe ato ndërkombëtare.

Më lejoni të theksoj që sot me këtë amendamentim do t'i tërheqim apo do t'i vëmë tri theksime të veçanta.

E para që kompetenca për të amnistuar i takon vetëm Kuvendit të Republikës së Kosovës.

E dyta që amnistia jepet përmes ligjit, i cili miratohet nga ky Kuvend i respektuar, dhe

E treta, ky ligj duhet të miratohet me 2/3-at e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës.

Sa i përket elementit të parë duhet cekur se sot po ia shtojmë një kompetencë Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe arsyeja se pse kjo kompetencë është tejet e rëndësishme, nuk i është lënë asnjë institucioni tjetër në vendin tonë dhe është pikërisht pozita e këtij organi në rendin tonë kushtetues dhe përbërja e tij si përfaqësues të Republikës së Kosovës.

Kuvendi është organi më i lartë i vendit tonë dhe njëherësh trup, në të cilin shkrihen opinionet e panumërta të qytetarëve tanë dhe vendi ku bashkohen dhe dëgjojnë zërat e të gjithë qytetarëve të Republikës.

Prandaj vetëm me ligj, i cili miratohet me shumicën absolute tuajën, do ta ketë legjitimitetin e duhur për ta amnistuar një kategori të caktuar të veprave apo të personave.

Kur jemi te elementi i dytë i këtij amendamenti, duhet theksuar se amnistia do të jepet vetëm dhe vetëm me ligj. Dhe, arsyeja pse kjo është rregulluar të jetë pikërisht kështu, është që procedurat dhe kushtet e saj të jenë të rregulluara me një akt të veçantë, siç është ligji.

Natyrisht, këtë ligj do ta iniciojnë aktorët e autorizuar me Kushtetutë dhe me ligj në vendin tonë, sikurse janë: presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e tij apo e saj, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose së paku 10 mijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me nenin 79 të Kushtetutës së vendit tonë.

Prandaj, është e rëndësishme të ceket që amnistia mund të nisët nga shumë aktorë, përfshirë këtu edhe vetë qytetarët e Republikës, por fjalën e fundit për ta pranuar apo jo do ta keni ju, të zgjedhurit legjitim të popullit tonë.

Elementi tjetër, që është shumë me rëndësi dhe i cili është garantues kryesor i këtij instituti është kushti për të miratuar këtë ligj apo ligjin për amnisti dhe do të duhen 2/3-at e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës. Meqë kjo është një çështje tejet e ndjeshme dhe do të amnistohen kategori veprash dhe personash, vetëm atëherë do të ketë konsensus të plotë shoqëror dhe kjo minimizon mundësinë, që pushteti, kushdo që mund

të jetë në pushtet, të keqpërdorë amnistinë për kategoritë e padëshiruara, ngase për të së pari duhet të sigurohet përkrahja e të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe të gjithë ne e dimë, që kjo nuk është e lirë të bëhet.

Më lejoni të cek, se kemi menduar edhe përkufizimet për amnisti. Kemi menduar se duhet të kemi kategori të caktuara, të cilat nuk duhet të amnistohen. Të gjitha këto cilësi të amnistisë: përkufizimet, karakteristikat, objektet dhe gjithësi kufizimet, do të jenë të përcaktuara me një ligj, me ligjin të cilin do ta miratoni ju, të nderuar deputetë të Kuvendit dhe për të cilin Ministria e Drejtësisë, gjegjësisht Qeveria është e gatshme ta sjellë shumë shpejt në Kuvendin e Republikës.

Për mënyrën e rregullimit të kësaj kemi shqyrtuar mënyrat e rregullimit të amnistisë në shumë vende evropiane dhe në disa në rajon. Duhet cekur se shumica dërmuese e vendeve që parashohin këto institute në kushtetutën e tyre, nuk parashohin kufizimet në kushtetutë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që ato nuk do të kenë kufizimi, po as ato që i përcaktojnë me ligjet e tyre, do të hyjnë në detaje. Të këtilla janë sikur Holanda, Franca, Italia, Bullgaria, Rumania, Mali i Zi, Portugalia, Maqedonia dhe shumë vende të tjera.

Dhe, ne kemi zgjedhur këto modele për t'i përcaktuar si modele më të mira praktikë e avancuara dhe që garantojnë nivelin e lartë të besueshmërisë, në tërë procesin e amnistisë.

Të nderuar deputetë,

Duke përcjellë praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ne kemi parë që janë për t'u respektuar edhe obligimet ndërkombëtare që i merr Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Ligji i ardhshëm për amnisti do të përjashtojë nga amnistia çfarëdo krimesh që kanë të bëjnë me ato me rastet e vrasjeve të rënda, me krimet kundër integritetit seksual apo dhunës në familje, krimet që dëmtojnë interesin e rendit shoqëror, sikurse janë krimet që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe kategori të tjera, që bëjnë krime, qoftë ato që janë gjatë procesit të votimeve, apo kundër medieve të lira dhe krime të ngjashme, të cilat do të theksohen me nene të theksuara.

Gjatë përpilimit të këtij ligji për amnisti, Qeveria e Republikës së Kosovës do të kujdeset dhe të njëjtën kohë do të kërkojë që nismëtarët e kësaj iniciative ligjore të kujdesen për t'i respektuar normat ndërkombëtare që rregullojnë këtë çështje.

Natyrisht, në këtë drejtim do të kujdesem maksimalisht. I kemi konsultat e domosdoshme me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, me ekspertët e shoqërisë civile po edhe me ekspertët të pavarur juridikë.

Por, të gjitha këto specifika dhe debate rreth amnistisë së kategorive të caktuara do të shqyrtohen në hollësi gjatë diskutimit për Ligjin për amnisti, të cilin Ministria e Drejtësisë është duke e përgatitur në përputhje me praktikë dhe modelet më të mira evropiane, nën koordinim të plotë edhe me përfaqësuesin ndërkombëtar, atë të EULEX-it dhe të ambasadave me ndikim.

Të nderuar deputetë, sipas vizionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, amnistia si institut duhet përdorur për të arritur pajtimin shoqëror ndërmjet personave të përfshirë në procese të ndryshme të dhunshme në të kaluarën, falja e të cilëve do të sillte më shumë dobi shoqërore, sesa ndëshkimi dhe provat për një risocializim të tyre përmes korrektimit.

Pikërisht kështu është përdorë amnistia në vende të tjera në botë, e veçanërisht në ato vende që kanë pasur një të kaluar me luftë, apo edhe një të kaluar, po e quaj jo të qetë. Përmes amnistisë është arritur dhe do të arrihet një paqësim i shumë raporteve të turbullta shoqërore dhe nga ndjekja e të cilave më së paku përfiton e ardhmja e shoqërisë.

Është koha që Republika e Kosovës duhet të vendosë vetë për mbylljen e këtij kapitulli...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdo, edhe një minutë!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Është koha kur Kosova duhet të vendos vetë për të mbyllur një kapitull të tillë dhe amnistia është vetëm njëra nga mjetet që duhet t'i përdorim për pajtimin e dëshiruar shoqëror.

Më lejoni, të theksoj siç e kam dhënë edhe dje sqarimin, kjo amnisti dhe ky propozim nuk ka të bëjë me një specifikë të caktuar, s'ka të bëjë me një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, por ka të bëjë me një institut që ne e kemi kërkuar që nga viti 2011, gjegjësisht prilli i vitit 2011 dhe besoj që tanimë është radha që ta kemi, fillimisht në Kushtetutën e Republikës, pastaj në Ligjin për amnistinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne kemi sot në rend dite dy amendamente Kushtetuese. Amendamenti kushtetues numër 23 për nenin 65, ku thuhet kompetencat e Kuvendit pas pikës 14, shtohet pika 15. Kuvendi jep amnisti me ligj përkatës, i cili miratohet me 2/3-at e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Duhet të sqarojmë një gjë, që të jemi të qartë edhe për publikun dhe për të gjithë deputetët këtu. Ky amendament nuk jep amnisti. Ky amnisti e parasheh institutin e amnistisë, si kategori kushtetuese dhe njerëzit të mos presin që nesër apo pasnesër do të ketë amnisti.

Amnistia, nëse vjen do të vijë me një ligj tjetër ligj i cili parasheh se cilat kategori të veprave penale do të lirohen pjesërisht apo plotësisht, kështu që të mos rrisim pritshmëri te publiku dhe tek njerëzit, të cilët mendojnë se mund të përfitojnë personalisht.

Kur ka ardhur ky amendament në Komisionin për Legjislacion, ka qenë në një formë tjetër i shkruar. Dhe, Komisioni për Legjislacion ka dhënë vërejtjet e veta, sepse në amendament ka qenë e shkruar: “Kuvendi jep amnisti me ligj përkatës dhe amnistia duhet të jetë individuale dhe me emër.”, që realisht ajo nuk është amnisti por është falje. Dhe, vërejtja e Komisionit, e cila i është drejtuar propozuesit, në këtë rast Ministrisë së Drejtësisë, është marrë në konsideratë dhe është dërguar në Gjykatën Kushtetuese, ku Gjykata Kushtetuese ka aprovuar formën e re që është forma zyrtare, të cilën e keni ju përpara, që do të thotë amendamenti 23, sepse dy amendamente paraprake kanë të bëjnë me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës dhe ky është amendamenti 23, në nenin 65, ku pas pikës 14 shtohet pika 15 të kompetencat e Kuvendit, jep amnisti me ligj përkatës, i cili miratohet me 2/3-at e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit. Ta mbajmë mend 2/3-at e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Amendamenti 24 në nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 1 dhe 2 ndryshohen si në vijim:

- 7 anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga ana e gjyqësorit
- 2 anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, dhe të paktën njëri prej këtyre dyve duhet të jetë gjyqtar.

Këto janë dy elemente, për të cilat ka ndryshime substanciale. Elementi i parë është që Kuvendi nga 4 anëtarë të Këshillit Gjyqësor tashmë ka të drejtë t’i zgjedh vetëm 2. dhe, ministri duhet ta bindë Kuvendin pse Kuvendi duhet të heqë dorë nga kjo kompetencë e tij.

Kuvendi po heq dorë nga një kompetencë e tij. Ka një arsytim logjik që thotë që të mos kemi ndërhyrje politike në Këshillin Gjyqësor, si një institucion i pavarur, mirëpo ka edhe një shqetësim logjik po ashtu edhe të qëndrueshëm, ku thuhet se mund të abuzohet nga njerëzit me ndikim në pushtetin gjyqësor, që të mbrojnë interesat e veta apo të grupeve të caktuara.

Ju e dini, se ka pasur vërejtje dhe shqetësime, bile edhe deklarime nga zyrtarë të lartë të gjyqësorit në Kosovë, se në zgjedhjet e fundit për Këshillin Gjyqësor, sidomos për kryetarin e Këshillit Gjyqësor ka pasur manipulime. Dhe, në këtë rast, nëse Kuvendi heq dorë prej një kompetence, unë nuk po them se a duhet të heqë dorë apo nuk duhet të heqë dorë, unë po tërheq vërejtjen se Kuvendi po heq dorë nga një kompetencë e tij, ku nga 4 anëtarë që ka pasur të drejtë t’i zgjedhë po i zgjedh vetëm dy. Dhe, kjo heqje dorë vullnetare e Kuvendit nga një kompetencë e tij duhet të mendohet mirë se cilat janë refleksionet.

Çka jep kjo për pasoja në sistem? Unë mendoj që jep pasoja. Dhe, unë normalisht siç mund të jeni edhe të gjithë ju këtu, jam i shqetësuar për rrezikun e manipulimit. Nuk po flas për manipulim politik, sepse nuk ka. Nëse do të kishte një qëllim për manipulim politik, normalisht që do të ishte më e lehtë të përdorej nëpërmjet Kuvendit.

Unë po flas për një qëndrueshmëri të sistemit. Ministër, a është i qëndrueshëm sistemi, nëse Kuvendi heq dorë nga këto dy vende? Sepse, kemi pasur vërejtje serioze prej

anëtarëve të përfshirë në zgjedhjet në Këshillin Gjyqësor, se ka pasur manipulime, sidomos në zgjedhjet e fundit dhe kemi pas shqetësime serioze, ku kryetari i Gjykatës të Prishtinës është zgjedhur njeriu, i cili ka qenë me kontratë sprovuese, që është në kundërshtim me ligjin dhe Këshilli Gjyqësor e ka lejuar. Dhe, Këshilli Gjyqësor ka lejuar këtë shkelje dhe tashmë a duhet ta bëjmë këtë lëshim?

Unë kam dyshimet e mia dhe këto dyshime po i transmetoj te ju, që ju t'i keni parasysh dhe të vendosim me votë. Nuk ka të bëjë me qëndrim politik, ka të bëjë me shqetësim serioz.

Elementi i dytë, i cili ndryshohet me këtë amendament është se në kuadër të anëtarësisë në Këshillin Gjyqësor ka qenë e paraparë që të jetë edhe një anëtar nga Oda e Avokatëve. Unë mendoj, se është e drejtë heqja e këtij anëtari, sepse ka pasur shqetësime të vazhdueshme se përfaqësuesi i Odës së Avokatëve në Këshillin Gjyqësor është marrë më shumë me çështje personale dhe mbrojtje të rasteve individuale të avokatëve, duke kërcënuar gjyqtarët dhe duke shantazhuar ata me riemërim apo me procese tjera disiplinore. Kështu që, heqja e avokatit nga Këshilli Gjyqësor si konflikt interesi, mendoj që është e drejtë.

Pra, këto janë tri elemente të cilat duhet t'i kemi në konsideratë, prandaj me votën tonë i deklarojmë, mirëpo paraprakisht do të dëshiroja që të kemi edhe një arsyetim të ministrit, se a është e qëndrueshme heqja e kësaj kompetence nga Kuvendi dhe kalimi në Këshillin Gjyqësor, duke marrë parasysh edhe shqetësimet që janë vërejtur në sistemin gjyqësor. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar kryetar i komisionit, Fjala të është dhënë në emër të kryetarit të Komisionit dhe kryetari i komisionit paraqet qëndrimin e Komisionit. Prandaj, në emër të Komisionit thotë në fund, duke u bazuar në konstatimet e theksuara Komisioni për Legjislacion i rekomandon Kuvendit që t'i miratojë amendamentet kushtetuese të propozuara nga Qeveria.

Ky është rekomandimi i Komisionit.

(Ndërhyrje nga salla)

Pra, dëgjo se unë jam duke folur, përsëri po të them, pastaj vijnë qëndrimet e grupeve parlamentare, pas qëndrimeve të grupeve parlamentare mund të vijnë qëndrimet individuale. Kryetari i Komisionit paraqet materialin që e ka shqyrtuar Komisioni përkatës. Kjo duhet të jetë kulturë. Ta jap fjalën, po më vonë.

(Ndërhyrje nga salla)

Jo kam të drejtë me komentua, se ti e paraqet qëndrimin e Komisionit, jo tëndin. Vazhdojmë!

(Debat në sallë)

Unë kam të drejtë të bëjë komente, se ke gabuar edhe në Gjykatën Kushtetuese ku ke shkuar edhe tani. Ta jap fjalën kur të vjen rendi. Fjalën e ka nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, t'i jap mbështetje të plotë këtyre dy amendamenteve kushtetuese, me të cilat po bëhet ndryshimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Dhe, theksoj se ajo është një gjë shumë e mirë që pas shumë përpjekjeve po realizohet ideja e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë, për futjen e Institutit të Amnitisë.

Duke qenë edhe kryetar i Komisionit ad hoc kushtetues, dëshiroj të përsëris se kjo kërkesë komisionit i ka ardhur para më shumë se një viti, por për shkak të mandatit selektiv ne nuk kemi mund ta trajtojmë. Dhe, njëkohësisht me futjen e amnitisë në Kushtetutë, ne po e fusim një institut të cilin s'kemi mund kur e kemi shkruar Kushtetutën duke qenë edhe një nga autorët e Kushtetutës edhe atëherë ne kemi diskutuar për amnistinë, por për faktin se e kemi pasur një kohë mbikëqyrjen ndërkombëtare, ka pasur disa hezitime.

Dhe, mendoj se me futjen e amnitisë ne po mundësojmë dy gjëra:

E para, po fusim një institut kushtetues, që është tipik për sistemet kushtetuese,

E dyta, po garantojmë një të drejtë kushtetuese të qytetarëve, siç është e drejta në amnisti.

Ne e mirëpresim gatishmërinë e Qeverisë, që krahas këtij amendamenti së shpejti në Parlament të vijë edhe Projektligji për amnisti dhe ne urojmë që ky projektligj të draftohet me standarde më të larta të jurisprudencës penale, në mënyrë që amnistia të bëhet një praktikë penale në Kosovë dhe të fillohet të praktikohet realizimi i një të drejte kushtetuese.

Gjithashtu, ne mbështesim edhe amendamentin 24 dhe e vlerësojmë në funksion të realizimit të parimit kushtetues të pavarësisë së gjyqësorit dhe pamundësisë maksimale të ndikimeve politike që mund të vijnë.

Sa për informim, dëshiroj t'i njoftoj të gjithë deputetët, do ta lusja edhe sekretarinë që t'ua shpërndajë deputetëve tekstin e ri të Kushtetutës më 22 amendamente. Komisioni ad hoc për amendamentimin e Kushtetutës e ka bërë redaktimin dhe është publikuar dhe më lejoni të bëj një kërkesë që ky tekst i ri me 22 amendamente, që i kanë dhënë fund mbikëqyrjes ndërkombëtare t'u shpërndahet të gjithë deputetëve, të përkthehet edhe në gjuhën angleze, në mënyrë që të jetë sistemi kushtetues i kodifikuar. Por, siç duket Kushtetuta do të ndryshojë edhe me këto dy amendamente dhe ajo që unë dua të apeloj edhe si konstitucionalist, që ne ta ndërpresim praktikën e ndryshimeve selektive kushtetuese.

Unë e kuptoj që ky ndryshim ka qenë i domosdoshëm, për ta riparuar Kushtetutën në një segment, që nuk kemi mundur, por të rezervohemi nga ndryshimet selektive. Nëse kemi nevojë për të bërë ndryshime, atëherë bëjmë pako të amendamenteve dhe të krijojmë një stabilitet politik dhe kushtetues të vendit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Vjosë Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Faleminderit prej ministrit për sqarimet lidhur me dy amendamentet e propozuara!

Megjithatë, siç u deklarua edhe më herët nga kryetari i Komisionit për Legjislacion, Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon sqarime lidhur me propozimin në amendamentin e dytë, pra propozimin ku Kuvendit të Kosovës i hiqet e drejta për të votuar apo për të zgjedhur katër anëtarë dhe tani do të zgjidhen sipas amendamentit vetëm dy anëtarë.

Pra, LDK-ja e rezervon të drejtën për të votuar kundër, në qoftë se nuk kemi sqarime të sakta nga ministri. Pra, vendimi në qoftë se do të votojmë pro ose kundër, do të merret pasi t'i marrim sqarimet nga ministri.

Kurse, sa i përket amendamentit të parë, natyrisht Lidhja Demokratike e Kosovës, siç është deklaruar edhe shumë herë më parë, e përkrah përfshirjen e amnistisë si kategori kushtetuese, sepse natyrisht ka qenë një ndër kushtetutat shumë të pakta në botë, e cila nuk e ka përfshirë një kategori të tillë.

Përfundimisht zoti kryetar, ne si LDK ju lusim që votimi i amendamenteve të bëhet një nga një, sepse janë dy fusha të ndryshme, të cilat po amendamentohen. Prandaj, besojmë që njëherë duhet të votohet vetëm amendamenti 23, e pastaj amendamenti 24, pra jo të dyja përnjëherë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputetja Albulenë Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht është mirë që më në fund po sjellët propozim-amendamenti që instituti i amnistisë të futet si kategori kushtetuese te kompetencat e Kuvendit, pasi që të burgosurit kanë qenë të mashtruar për vite me radhë, edhe nga kjo Qeveri, por edhe nga qeveritë e mëparshme, konkretisht nga Ministria e Drejtësisë.

Ne si subjekt politik, ka kohë që e kemi kërkuar një amendament të tillë dhe jemi angazhuar në vazhdimësi, që të bëjmë presion tek Qeveria për sjelljen e një amendamenti të tillë, pra përmes pyetjeve parlamentare dhe deklarimeve të rendit të ditës. Madje, edhe i patëm përshëndetur të burgosurit, për të drejtat e tyre, që kërkonin të drejtat e tyre në formë të protestës.

Këtu ne sapo pamë ministrin e Drejtësisë në njëfarë mënyre duke u mburrur me atë, që ja ne prej vullnetit të mirë po e sjellim këtë amendament, mirëpo zoti ministër, e drejta e

amnistisë është e garantuar edhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve dhe asnjë qeveri në botë nuk ka të drejtë t'ua mohojë atyre tashmë një të drejtë të fituar.

Vetëm duhet ta shtrojmë pyetjen, se pse tash, pra pse kaq vonë, kur dihet tashmë se si pasojë e neglizhencës, shumë të burgosur pra nuk e kanë realizuar këtë të drejtë?

Sigurisht, që më pas duhet definuar qartë çdo procedurë për dhënien e amnistisë, në mënyrë që të mos manipulohet nga pushteti, për interesat e tyre. Pra, duhet t'i analizojmë në detaje procedurat që do të parashihen në Ligjin për amnistinë.

Shpresojmë, që qëllimi i sjelljes së këtij amendamenti të mos ketë në prapavijë amnistimin e strukturave ilegale kriminale të Serbisë në veri, edhe pse dihet tashmë që askush nuk mund të amnistohet pa u arrestuar, pa u gjykuar dhe pa u dënuar. Mirëpo, ju po jeni në gjendje, apo keni bërë shumëçka në dëm të interesave tona, kështu që kemi mjaft arsye për t'u brengosur.

Sa i përket pra këtij amendamenti, amendamentit 23, që ka të bëjë me çështjen e amnistisë, ne do ta përkrahim sigurisht, ndërsa, sa i përket amendamentit 24, që ka të bëjë me Këshillin Gjyqësor, unë ngre pyetjen edhe shqetësimin për ato që u thanë edhe nga LDK-ja, pse duhet Kuvendi që të heqë dorë nga kompetencat e veta, pra nga 4 gjyqtarë sa i ka zgjedhur deri më tani, po kërkohet që me këtë amendament të zgjedhën vetëm 2.

Pra, unë po pres arsyetim shtesë nga ministri, sepse ashtu siç u tha, qëllimi është depolitizimi i Këshillit Gjyqësor, është arsyetim i pamjaftueshëm. Dhe, në fund kërkojmë që këto dy amendamente të votohen ndarazi. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, fjalën e ka kryetari i grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Një pjesë e mirë e asaj që duhet të thuhet, u tha. Duhet cekur tani në këtë vazhdë se të gjithë ata që kanë qenë anëtarë të Komisionit Kushtetues, kur është hartuar Kushtetuta, një prej tyre kam qenë edhe unë edhe pse Qeveria ma ka fshirë emrin në libër, aty, edhe profesori Bajrami edhe zëvendëskryeministri Kuçi, i cili e ka udhëheq atëherë Komisionin, e kemi pasur të qartë, që ajo kushtetutë nuk do të mund të mbijetojë shumë gjatë dhe se duhet të ndryshohet. Domethënë, ka qenë fazë e zhvillimit të Kosovës së atillë.

Mirëpo, nuk ma merr mendja se cilido prej anëtarëve të atij komisioni, ka besuar që për më pak se 5 vjet do ta amendojmë dy herë. Kjo që po them ka të bëjë me nevojën që në Kosovë të ketë proces kushtetues. Do të thotë, që ndryshimet të cilat duhet të bëhen, me siguri që duhet të bëhen ndoshta edhe në të ardhmen, të jenë pjesë e një procesi dhe të mos kemi këso ndryshime ose amendime të Kushtetutës për çdo tre-katër muaj, për shkak se nuk është në rregull për një proces kushtetues në vend.

Sidoqoftë, mendoj se në rregull është që ta fusim këtë institucion të amnistisë. E kemi pasur të qartë se duhet të jetë një gjë e tillë pjesë e Kushtetutës sonë dhe ashtu siç jemi marrë vesh më herët, do ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Qeverinë dhe deputetët!

Duke marrë parasysh se sot kemi shqyrtimin e amendamentit 23 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria, mund të themi se në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, jep mbështetje të plotë amendamentit 23 dhe amendamentit 24, ku është esenca e pavarësisë së gjyqësorit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, deputetja Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsjedniče!

Absolutno je neophodno imati jednu pravnu instituciju, kao što je amnestija i da je to nedostajalo u Ustavu, tako da će parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke absolutno podržati i amndman 23 i 24 da se uvrsti u Ustav. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, kryetarja Myfera Shinik.

MYFERA SHINIK: Anayasadaki 23. ve 24. maddelerin değişikliğini yapan Hükümet tarafından verilen değişiklikleri destekleyeceğimizi bildirmek istiyoruz.

“6+” Parlamenter Grubu, bu maddelerin değişiklikliğini desteklemektedir.

KRYETARI: Tani e kanë radhën deputetët. Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje Kabinetit qeveritar!

Desha edhe unë për çështjen e Kushtetutës t’i them dy-tri fjalë, që në Kushtetutën tonë, që e kemi dhe nuk i ka as pesë vjet që e kemi miratuar e kemi filluar ta ndryshojmë disa herë, kjo është e dyta herë që e ndryshojmë, si kategori. Me 22 amendamente e kemi ndryshuar më herët, tash e ndryshojmë edhe me 2, kështu që Kushtetuta jonë është bërë si një Rregullore e Kuvendit dhe ku kemi thënë që e kemi një kushtetutë evropiane dhe një kushtetutë evropiane nuk ndryshon aq shpesh, ndërsa shtetet demokratike, të cilat janë ndërtuar dhe kushtetuta krijon stabilitet politik të vendit, ne nuk po mund të krijojmë një stabilitet politik me Kushtetutën tonë.

Shtetet si Evropa apo Amerika për 250 vjet vetëm 26 nene i kanë ndryshuar të kushtetutës së vet, ne për 5 vjet 22 + 2 bëjnë 24, e edhe sa do t’i ndryshojmë tutje, nuk e dimë. Por, megjithatë çështjen e amnistisë e mbështesim, çështjen e amendamentit të dytë nuk jam për ta mbështetur, por kërkoj që Kushtetuta jonë ose Qeveria, kryeministri, ministrat apo kush është, kush do ta marrë një vendim të tillë që në Kushtetutën tonë të

hyjnë ndryshimet e përgjithshme dhe ta kemi një kushtetutë, që do të jetë një kushtetutë për një afat më të gjatë, dhjetëvjeçar, pesëmbëdhjetë apo njëzet vjet, që nuk do të ndryshohet, por jo ta kemi një kushtetutë, që do ta ndryshojmë për çdo dy-tre vjet apo çdo vjet të ndryshojmë me amendamente.

Nëse ne kemi filluar vetëm çështjen e amnistisë, pse nuk është hyrë në ndryshim të amendamenteve edhe çështja e forcave të sigurisë të jetë ushtri e Kosovës? Kur do ta shtimë këtë amendament? Edhe këtë duhet ta bëjmë pas një viti ose gjysmë viti! Po, pse nuk e kemi futur tash, dhe të jemi pjesë e ndryshimeve, pjesë e të gjitha atyre ndryshimeve përmbledhëse, që do t'i ketë Kushtetuta dhe të krijojmë një stabilitet politik më afatgjatë?

Çështja e referendumit është e përcaktuar në Kushtetutë, nëse nuk e kemi ligjin. Pse nuk e bie Qeveria Ligjin për referendumin, që do të na jep mundësi që Kushtetuta të përcaktohet edhe në një formë baza e referendumit e vlerave të qytetarëve, e cila do të jetë bazë afatgjatë e ndryshimeve dhe stabilitetit të vendit? Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Sa për sqarim, këtu po gjendemi përballë të një procesi të vazhdueshëm të manipulimit me foltoren dhe të komentimit të deklarimeve të deputetëve, që është e papranueshme dhe tendencës së imponimit të mendimit dhe të mënyrës së artikullimit të deputetëve.

Deputetët janë të pavarur dhe shprehin mendimet e tyre dhe nuk mund kurrkush t'i komentojë dhe as t' i detyrojë se çka ata mendojnë dhe si mund të shprehen.

Sa i përket deklaramentit në emër të Komisionit, që ju kryetar iu referuat, është një deklarament të cilin unë e thashë dhe të njëjtën kohë, të gjitha këto që u thanë këtu janë tema, që janë diskutuar dhe debatuar në Komision. Unë reflektova si kryetar i Komisionit diskutimet që janë realizuar në Komision.

Sa i përket abuzimit tuaj me foltoren sot dhe javën e kaluar, lidhur me procesin gjyqësor, në Gjykatën Kushtetuese sa i përket Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, unë po ju njoftoj juve dhe publikun, se unë kam qenë i ftuar në cilësinë e kryetarit të Komisionit në Gjykatën Kushtetuese dhe unë kam deklaruar në Gjykatën Kushtetuese se kompozimi i Kuvendit dhe i Komisionit është i tillë, që mua nuk më lejon që unë të përfaqësoj Kuvendin.

Unë kam mendim ndryshe nga vendimi që ka nxjerrë seanca e Kuvendit. Prandaj, nëse juve ju intereson, e nderuar Gjykatë, mendimi personal apo i grupit politik, të cilin unë e përfaqësoj, unë mund t'ua jap, nëse juve ju intereson mendimi i Kuvendit, atëherë ju i keni letrat e shkruara dhe mund të veproni mbi to.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese më ka thënë se më intereson edhe vlerësimi i grupit politik dhe mendimi im. Unë i kam thënë kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të tjerëve

në pikën, që ju e keni vërejtur si shqetësim dhe po ta them edhe ty edhe po ta përsëris, edhe gjithë publikut, çështja ka qenë pyetja e gjyqtarit portugez Redrigues, a kemi ligj për bankat në institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare në Kosovë? Sepse, nga deklarimi i seancës rezulton se kemi mospërputhje në procesverbal, në transkript dhe në deklarim të kryetarit të Kuvendit.

Unë kam thënë se qëndrimi politik i grupit, të cilin unë e përfaqësoj, ka qenë që ne të braktisim seancën dhe unë nuk kam qenë brenda. Kemi braktisur seancën, me qëllim që të mos ketë kuorum Kuvendi. Dhe, pyetja tjetër ka qenë: A mendoni ju që mund të jetë manipuluar? Unë kam thënë që nuk mendoj, mirëpo kam dyshime të bazuara se mund të jetë manipuluar, sepse ka mospërputhje mes transkriptim, procesverbalit dhe deklarimit të kryetarit, i cili ekziston si mospërputhje dhe është mospërputhje e vërejtur nga gjyqtari Rodrigues dhe nga të gjithë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Vërejtja ka qenë sepse 54 vota janë për ligjin, 4 abstenime, 0 kundër dhe 1 e deklaruar nga ju si udhëheqës i seancës se është votim me dorë. 54 dhe 1 bëjnë 55 edhe 4 bëjnë 59. unë ju kam sqaruar se mund të ketë situata në Kuvend ku deputetët janë në seancë, por nuk marrin pjesë në votim. Dhe, kjo lejon që Kuvendi të ketë kuorum. Prandaj, nuk do të thotë automatikisht, se është manipuluar apo se nuk ka pasur kuorum, për t'u aprovuara ligji.

Nëse ju interesojnë çështjet teknike, unë nuk kam qenë në seancë dhe nuk mund të jap deklarim. Ka video, ka incizime, ju mund t'i konstatoni ato, unë nuk jap vlerësime, për këto çështje.

Kjo është ajo që kam thënë unë në Gjykatën Kushtetuese, kjo është ajo që po ta përsëris këtu dhe kjo është ajo që po të kërkoj që të mos manipulohet me foltoren e Kuvendit, siç manipulove javën e kaluar, siç manipulove sot kur foli deputeti Imri Ahmeti dhe siç po vazhdon tani duke ndjell kesi lloj diskutimesh dhe kesi lloj situatash të tensionuara. Prandaj, me gjithë respektin dhe konsideratën për Kuvendin, unë isha i detyruar që të jap sqarimet dhe këto janë vlerësimet, të cilat unë i jap. Merre, lexoje transkriptin, të gjithë deputetët e kanë marrë dhe e shohin se unë kam dhënë vlerësimet e mia, sepse qysh në fillim, në seancën gjyqësore kam deklaruar se unë nuk mund të përfaqësoj Kuvendin dhe nuk kam përfaqësuar Kuvendin. Faleminderit!

KRYETARI: Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që t'ju përshëndes të gjithëve dhe të përshëndes edhe sjelljen në Kuvend të njëjës prej propozimeve.

Fatkeqësisht, kësaj radhe nuk mund ta mirëpres kështu siç është edhe të dytën, dhe kjo nuk e vë në pyetje respektin për ministrin dhe punën që bën ai.

E mbështes të parën, sepse e konsideroj të drejtë dhe shpjegimet janë të mjaftueshme, po ajo që na ka rënë në sy dhe mua më bën përshtypje është që për propozimin e parë u bë një shpjegim i gjerë. Edhe në materialet që kemi, ka një shkresë shpjeguese. Për propozimin e dytë, nuk ka shkresë shpjeguese dhe është një kusht që çdo nismë ligjvënëse, aq më shumë nëse është ndryshim kushtetuese, ta plotësojë edhe këtë kusht.

Po nuk është vetëm kjo. Gjykata Kushtetuese të cilës me rregull Kuvendi i është drejtuar, për të vlerësuar kushtetutshmërinë ka konstatuar pa dhënë shpjegimet pse bëhet kjo nismë. As Qeveria nuk na e ka sjellë – pse kjo nismë, kush e bëri, nga erdhi, për çka bëhet, si do të zbatohet, cilat do të jenë efektet?

Tani dëgjuam një argument, që më duket i pamjaftueshëm. Po Gjykata ka konstatuar se kjo nuk pakëson të drejtat nga kapitulli 2, kurse brenda në diapozitiv thotë që Gjykata vlerëson jo vetëm nga kapitulli 2, por edhe nga fryma dhe gjuha e gjithë materies kushtetuese dhe është e drejtë. Por, një vlerësim i tillë do të nxirrte një përfundim tjetër.

Për më tepër, në tekstin që kemi marrë thuhet se në afatet e parapara kryetari i Gjykatës Kushtetuese ka caktuar gjyqtarin Altai Surroi, gjyqtar raportues dhe ka caktuar kolegjin shqyrtues për këto dy amendamente në përbërje: Almiro Rodrigues, kryesues, Snezhana Botushorova dhe Ivan Çukalović, anëtarë. Respekt për të gjithë ata, por asnjë shqiptar në një shqyrtim kaq të ndjeshëm. Si shpjegohet kjo? A flet kjo diçka?

Për më tepër, pa u fiksuar se dal shumë pretendues, nuk ma mbush mendjen vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese ashtu siç është, se nuk pakuaka të drejtat nga kapitulli 2 dhe nga Kushtetuta. Dhe, unë dua të tërheq vërejtjen siç u tha në dispozitën që kemi në Kushtetutë, përbërja e Këshillit Gjyqësor ka paraparë një përfaqësim 4 anëtarë nga gjithë deputetët e zgjedhur në mënyrë të rregullt, do të thotë nga gjithë efektivi i Kuvendit, dy nga deputetët e komunitetit serb, dy nga komunitetet tjera.

Tani propozohet që kjo 4 të zvogëlohet në 2, të përgjysmohet, jo vetëm që pakëson do të thotë, një të drejtë një kompetencë, që ka të bëjë midis raportit midis pushteteve. Është çështje par exelance kushtetuese dhe cenon pushtetin legjislativ. Për më tepër e rrit absurdin për dyfish më shumë. Veni re tani çfarë raporti krijohet!

“Një komunitet i caktuar duhet të ketë aq përfaqësues sa të gjitha komunitetet tjera pakicë”. A nuk është kjo një anomali?! Ku e gjen këtë? Shpjegimi mund të jetë - është më shumë numerikisht, po nëse është më shumë numerikisht, si mund të jetë ky më shumë se komuniteti shumicë, sepse komuniteti shumicë këtu përjashtohet fare, e në Kushtetutë, ne në nenin 3 e kemi se shteti i Kosovës është shtet i qytetarëve të saj, po shprehimisht thuhet i shqiptarëve dhe i komuniteteve tjera. Dikush mund të thotë e shqiptarët janë në këtë reston, që mbetet, po kjo resto është 2.

Dhe 2 nënkupton që të jenë shumica dhe të tjerët. Nëse Kuvendi i Kosovës do të delegonte vetëm 2 shqiptarë, Kuvendi i Kosovës do të kishte probleme me kriterin e përfaqësimit gjithëpërfshirës, se kemi dispozita kushtetuese që na obligojnë që si

institucione të jemi gjithëpërfshirës, po dispozitat tona edhe na inkurajojnë që të punojmë në gjithëpërfshirje si qytetarë edhe enklavizojnë, getoizojnë dhe krijojnë absurde.

Është absurd, zonja e zotërinj që 90% të jenë barabar me gjysmën e pakicave dhe atë ta kenë të ndarë pastaj përsëri me të tjerët. Kujt i duhet kjo, pse? Çfarë efekti ka kjo dhe kush e ka kërkuar?

Ne, kohë më parë, kishim procesin e ndryshimeve kushtetuese që lidhen me mbikëqyrjen ndërkombëtare. U përmyll dhe komisioni i ka diskutuar këto çështje. Kemi konstatuar anomali të shumta, por në përpjekjen për t'i korrigjuar ato, u ndodhëm para një muri se janë çështje që dalin jashtë suazave. Po kjo çështje a del jashtë suazave, pse copa-copa?

Fjalja e parë e Kushtetutës sonë është difektoze. Ne populli me një gjuhë, 'mi gradjani' në një gjuhë tjetër dhe 'populli e gradjani' nuk është e njëjta gjë, 'we' dhe 'people' në anglisht. Por, ne nuk mundëm ta ndryshojmë sepse del jashtë suazave, po tani po nxirret vetëm një çështje. Për më tepër, siç u theksua, kjo e redukton në masë të madhe ndikimin e pushtetit legjislativ dhe, për mendimin tim, kjo nuk duhet të bëhet fët e fët, siç po bëhet.

Ka kuvende ku e gjithë zgjedhja e anëtarëve, e trupave të tillë, madje edhe e gjyqtarëve shkon nëpër parlament. Propozohet nga trupat profesionale. Ka vende ku gjyqtarët zgjidhen nga qytetarët. Ata pushtetin nuk e marrin vetëm nga profesioni i tyre, por duhet t'u japë dikush, dhe ndarja e pushteteve, që u theksua këtu, nuk duhet të kontestohet, por ndarja e pushteteve nuk e përjashton ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e pushteteve. Ky është thelbi i asaj check and balance ndërmjet pushteteve. Ndryshe, ne e rrezikojmë pavarësinë e Gjyqësorit nga Gjyqësori, nga drejtësia, nga juristët. Ka një moto për mjekët, thuhet: 'Medice cura teipsum!' - 'Mjek, shëroje veten!', por edhe gjyqtarët kanë nevojë ta drejtojnë veten, ose ta shikojnë drejtësinë brenda vetes, sidomos në kushtet tona.

Çka fitojmë nëse ne e përjashtojmë rolin e Kuvendit, aq më tepër që Kuvendi do të mund ta zgjidhte së pak u gjysmën, duke qenë gjyqtarët e avokatët, e kjo që nuk pajtohem me kolegun, pajtohem me vërejtjet tjera, pse nuk u dashka të jetë një avokat, e me këtë privohet qenia e Odës së Avokatëve. Oda e Avokatëve e mbron gjysmën e drejtësisë. Drejtësia nuk është vetëm gjykatësit e prokurorët, është edhe pjesa tjetër dhe ajo duhet të ketë përfaqësim tjetër. Ne kemi qenë në udhëtim studiues në Arizonë dhe atje kjo është e siguruar madje nga prania e shoqërisë civile. Pse te ne e privojmë sistemin e drejtësisë nga mekanizma të tillë demokratikë

Për më tepër, ky është një precedent i rrezikshëm edhe në fushat tjera. Kujt i duhet ky precedent? A k diku vend në botë që përfaqësimi në organin më të lartë të drejtësisë të bëhet në këtë mënyrë? A ka diku parametra të tillë dhe e ndihmon kjo integritimin? Jo. efektet janë kontraproduktive dhe pikërisht këtu janë disa synime djallëzore tani edhe në procesin negocues për të krijuar jo paralelizma, siç po thuhet, por për ta rilegjitimuar sistemin e vjetër të drejtësisë në Kosovë. Të lëshosh pe në këto do të thotë ta lejosh edhe një gozhdë Nasradini. Na u bënë shumë gozhda të Nasradinit, zonja e zotërinj.

Artisti shqiptar Altin Lala hyri në Librin e Ginisit me mozaikët e tij me gozhda. Druaj mos po hyjmë edhe ne në Librin e Ginisit me do gozhda të artit absurd. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Si anëtarë i Komisionit për Legjislacion, fillimisht e përshëndes punën e zëvendëskryeministrit, konkretisht të ministrit të Drejtësisë për procedimin e këtyre dy amendamenteve, meqë në radhë të parë amendamenti 23 ka të bëjë kryesisht me themelimin e institutit sa i përket amnistisë, e jo Ligji për amnisti.

Në këtë amendament nuk kam fare dilemë për faktin se e kuptoj qartë qëllimin dhe rolin e këtij amendamenti, ndërsa te amendamenti 24 qëndrimi dhe mendimi im personal është në reduktimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, nga 4 në 2, për fatin se në konkursin e fundit, në emërimin e kryetarit të Këshillit Gjyqësor kishim shumë parregullsi brenda vetë votimit të atij këshilli për kryetar dhe dilemat dhe problemet që ndodhën pas zgjedhjes së atij kryetari. Prandaj, mirëpres nga zëvendëskryeministri ndoshta të na sqarojë në mënyrën se si do të ketë produktivitet reduktimi nga 4 në 2.

Pika e dytë që do të kisha dëshirë të ndërlihem është në fjalimin e deputetit Arsim Bajrami, i cili si hartues i Kushtetutës së Republikës së Kosovës preku shumë çështje, në radhë të parë edhe këto dy amendamente, por edhe 22 amendamente të tjera, shkoqiti se nuk pajtohet që të ketë ndryshime selektive në Kushtetutë. Unë jam i mendimit për ndryshime, qoftë selektive, qoftë të përgjithshme të Kushtetutës, për faktin se, qoftë në mendjet e njerëzve, qoftë legjislatura nga legjislatura evoluon dhe pa dyshim ato ndryshim-amendamente duhet të jenë të pranishme, qoftë si selektive, apo të tërësishme me përgjegjësi.

Por, pyetja ime kryesore do të ishte për profesor Bajramin, konkretisht te Kushtetuta, në nenin 8, i cili e ka dualizmi sa i përket gjuhës. Unë desha ta pyes profesorin: Ky lloj dualizmi, a ka ndodhur i qëllimshëm apo është gabim teknik, ngase në gjuhën shqipe, neni 8 thotë: Kosova është shtet laik, ndërsa në gjuhën serbokroate shkruan '*sekularna država*' dhe në gjuhën angleze '*sekular stejt*'. Ne e dimë shumë mirë dhe unë personalisht e di dallimin ndërmjet shtetit sekular dhe shtetit laik, do të thotë ka dallime shumë të mëdha, diametralisht të kundërta. Prandaj, pyetja ime për profesorin, ky ndryshim, ky dualizëm brenda vetë Kushtetutës a kemi të bëjmë me gabim teknik gjuhësor, apo ka ndodhur që kjo të jetë e qëllimshme? Se, nëse është e qëllimshme, atëherë është fatale për Kushtetutën dhe për ne si Legjislativ, kur brenda vetë Kushtetutës të kemi dualizëm, çka presim nga ligjet dhe udhëzimet tjera që pasojnë pas asaj? Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Pak a shumë u thanë të gjitha ato që ishin edhe preokupime tona rreth amendamentit 24, që ka të bëjë me përbërjen e Këshillit Gjyqësor. Me të vërtetë duhet të kemi kujdes, po e them edhe nga praktika ndoshta, dhe sigurisht që edhe ministri e ka parasysh dhe do të japë informata shtesë që të na bind ne se nuk është ashtu siç është, apo që ne po mendojmë për momentin, por të jemi të saktë në vlerësimin e asaj se cila do të jetë përbërja e plotë e Këshillit Gjyqësor.

Është e vërtetë që deri më tani kanë qenë 7 anëtarë të zgjedhur nga anëtarët e Gjyqësorit, por kjo nënkupton që pjesa e katërt gjithmonë është votuar prej shumicës, që nënkupton shqiptarët, dhe 4 të tjerë prej komuniteteve tjera, gjë që ka qenë e pranueshme. Por, nëse kjo reduktohet tash në shqiptarë, po kuptohet 4 në 2, dhe rritet numri paraprak në 5, që është kompetencë e Këshillit Gjyqësor, i cili është i rregulluar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, ku prapë çdoherë kemi pasur edhe aty emëtime nga komunitetet tjera, është kjo. Nëse ne kemi përcaktim të saktë që 7-shja që vjen nga Këshilli Gjyqësor, që propozohet nga Gjykata Supreme, Gjykata Themelore e tjera, ashtu siç e parashih ligji, ajo çka unë dëshiroj dhe mendoj edhe pjesa e grupit tjetër parlamentar të LDK-së, por edhe deputetët tjerë, të kemi përkufizim të qartë të përbërjes, të popullatës dhe Gjyqësorit, në përgjithësi. Kjo është ajo çka mua më intereson, sepse kjo lëvizje e numrave, nga 4 në 2, dhe pjesa tjetër që është e garantuar 2 serbë dhe dy komunitete tjera, të mos e kemi një disbalancë, apo mund të ketë një disbalancë. Deri më tani, edhe unë tash po paragjykoj se cila do të jetë mundësia në të ardhmen. Unë dëshiroj të kemi përkufizim të saktë, cila është përbërja e kësaj 7-shes që emërohet nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Arsim Bajrami, të lutem shkurt, sepse e ke pasur fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Po, kam folur në emër të Grupit Parlamentar...

KRYETARI: Jo, jo, tash nuk flet në emrin tënd, mund të përgjigjesh në pyetjen e bërë.

ARSIM BAJRAMI: Para se të përgjigjem në pyetjen e kolegut, dy fjalë për bashkëpunimin e Kuvendit me Gjykatën Kushtetuese në procesin kushtetutëdhënës. Mendoj se kjo çështje duhet të rregullohet mirë. Ddo të rregullohet mirë, sepse ne kemi bashkëpunim intensiv me Gjykatën Kushtetuese dhe përfaqësimi në Gjykatën Kushtetuese duhet të jetë institucional, pra jo partiak, jo individual, por institucional, dhe unë kërkoj që në kuadër të debateve për Rregulloren e re të Punës, kjo çështje të rregullohet, sepse nuk i lejohet një deputeti, i cili shkon në emër të Komisioni, apo në emër të Kuvendit, që të shfaqë bindjen e partive politike, apo bindje individuale. Këto bindje mund t'i shfaqë në qoftë se thirret në atë cilësi. Deputetët mund të jenë edhe propozues të Gjykatës Kushtetuese, por kur një deputet e përfaqëson Kuvendin, e përfaqëson Kuvendin si palë, në një ligj të Kuvendit ai duhet ta mbrojë Kuvendin dhe është krejt e patolerueshme që dikush që shkon, në vend që ta mbrojë një ligj, të Kuvendit, ta ndihmojë palën tjetër, e cila është palë paditëse, kështu që unë uroj që me Rregulloren e re kjo çështje të rregullohet dhe të ndërpritet kjo praktikë që nuk është

aspak e mirë, që në Gjykatën Kushtetuese, në vend që të mbrohen aktet e këtij Kuvendi, në fakt i bëhet një shërbim propozuesit të autorizuar dhe të luhet një rol krejtësisht tjetër.

Sa i përket deputetit Kelmendi, disa herë ia kam sqaruar këtë çështje, sepse ai është në Komisionin Legjislativ, dhe ne e kemi diskutuar disa herë. Komisioni Kushtetues e ka rregulluar jashtëzakonisht mirë në nenin 8 raportin me fenë dhe e ka përcaktuar se Republika e Kosovës është shtet laik edhe neutral ndaj çështjeve të besimeve fetare dhe për ne ky është teksti. Çfarë kanë bërë pastaj në përkthim në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze, nuk ka qenë përgjegjësi e komisionit. Përgjegjësi i komisionit ka qenë të jetë i qartë dhe ne kemi qenë jashtëzakonisht të qartë. Ne e kemi kuptuar pastaj se në tekstin në gjuhën serbe kanë punuar edhe strukturat jashtë Kuvendit, kanë punuar edhe organizatat ndërkombëtare dhe kjo është një praktikë e parregullt, sepse komisioni gjithë kohën ka punuar në tekstin në gjuhën shqipe dhe ju e keni parë se teksti origjinal i Kushtetutës i ka edhe nënshkrimet e anëtarëve të komisionit dhe ne mbajmë përgjegjësi vetëm për atë tekst. Sa i përket redaktuarës në gjuhësore dhe terminologjike, ajo nuk është përgjegjësi e komisionit, sepse redaktura gjuhësore dhe përkthimi zyrtar është bërë nga shërbimet profesionale të Kuvendit, por siç kemi kuptuar edhe nga disa institucione ndërkombëtare, të cilat kanë sponsoruar apo e kanë financuar një përkthim të tekstit në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze, e kjo është praktikë e parregullt, sepse të gjitha tekstet e Kuvendit duhet ta kenë vetëm autorësinë e Kuvendit, e jo edhe të institucioneve jokompetente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për replikë, Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit kryetar,

Sa për sqarim se nuk kam plan të replikoj me profesorin e nderuar, me gjithë respektin që e kam. Në komision, unë nuk e kam marrë asnjëherë një sqarim të tillë, e para. E dyta, e di ndoshta mund të jetë siç po thotë profesori, në të kaluarën është bërë një lëshim i tillë, por nuk po flas për të kaluarën, po flas për të tashmen, se profesori e kryeson një Komision ad hoc për ndryshime kushtetuese, prandaj nëse një lëshim i tillë ka ndodhur në të kaluarën, pa dyshim që është dashur të evitohet, ngase nuk që bën Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i vendit, të ketë dualizma të tillë. Unë prapë po e përmendi, nuk është e rastësishme ajo çka ka ndodhur 'laik' në gjuhën shqipe edhe 'sekular' në gjuhën serbe dhe angleze. Nuk e di mbështetjen ligjore, se ku e ka marrë Komisioni për hartimin e Kushtetutës për faktin se shumica e vendeve të Bashkimit Evropian, përjashtimisht Franca, e kanë në Kushtetutën e tyre 'shtet sekular', prandaj ku e kanë marrë këta bazën ligjore se pikërisht Kosova që synon rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian të shtet laik, e të mos jetë sekular.

KRYETARI: Replikë, Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit për korrektësi dhe për sqarim të asaj se çka ka ndodhur në seancën e Gjykatës Kushtetuese, së cilës iu referua zoti Bajrami. Unë po ia sqaroj dhe po ia lexoj, po ia citoj procesverbalin. Para se ta lexoj procesverbalin, po ia kujtoj zotit Bajrami, nuk e di a ka qenë i pranishëm në komision. Në komision ne e kemi diskutuar dhe kam thënë që unë nuk jam i interesuar që të shkoj e ta mbroj vendimi e Kuvendit,

sepse nuk e përfaqësoj atë mendim. Komisioni më ka thënë ‘t’i dërgoji letrat dhe nëse Gjykata të pyet për mendimin tënd, mund ta japësh’. I kam thënë kryetarit të Gjykatës se jeni në dijeni se Kuvendi është trupë politike dhe përbërja e komisioneve është përbërja politike dhe vendimmarrja në fund politike, zakonisht qëndrimet dhe vlerësimet janë të ndara. Edhe kur bëhet fjalë për vlerësime profesionale, janë të ndara.

Po e citoj pyetjen e gjyqtarit Rodrigues, ndër të tjera, thotë: “Sipas nenit 69 të Kushtetutës, për të marrë vendim, Kuvendi duhet të ketë kuorum prej 61 deputetëve”. Dhe, unë i kam thënë, po citoj: “Për pyetjen tuaj, ju keni të drejtë për referencën, neni 69 e Kushtetutës. Ditën e votimit, Grupi Parlamentar, në cilën bëj pjesë unë dhe grupet tjera parlamentare opozitare e kanë lëshuar seancën, me qëllim që Kuvendi të mos ketë kuorum të vendosë për këtë ligj. Ne nuk kemi qenë në sallë, na është thënë që ka pasur kuorum, rezultati që unë kam janë 55 vota për, 0 vota kundër, 4 abstenime, mirëpo duhet ta kemi parasysh se mund të jeshë në seancë, ta bësh kuorumin dhe të mos marrësh pjesë në votim. Unë nuk e di a ka pasur apo jo kuorum, sepse nuk kam qenë në sallë”.

Pyetja tjetër e gjyqtarit Rodrigues: “Ka mospërputhje ndërmjet transkriptit, procesverbalit, deklarimit të kryetarit dhe rezultatit final”. Thuhet 58 deputetë kanë votuar, citoheni ju kryetar, ose kush ka qenë kryesues nuk e di saktë, citohet se 58 deputetë kanë votuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Replikë ishte. Fjalën do ta marr unë, si deputet.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
Procesi për këto ndryshime ka filluar më 22.6.2012. Më 20 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese e ka kthyer, amendamenti i ri i propozuar, amnistia, paragrafi i parë përkitazi me personat e cekur me emër i pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara në kapitullin 2 të Kushtetutës, dhe është ndryshuar e është dërguar, kurse për amendamentin 2, pika 4 e Gjykatës Kushtetuese, thotë: amendamenti 2, i propozuar, neni 108, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i Kushtetutës nuk i pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut të parapara me kapitullin e dytë të Kushtetutës.

Rekomandimet e komisionit, ku ka marrë pjesë pozitë dhe opozitë, nuk ceket askund për atë që u tha individualisht pas gati një viti, nëntë muaj e sa. Do të thotë, rekomandimet e komisionit kanë qenë për miratimin e këtyre dy amendamenteve. Unë nuk e mohoj të drejtën e secilit deputet për ta pasur qëndrimin e vet, por kur deputeti e prezanton që në rastin e parë Kuvendin, meqenëse unë kam biseduar me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe i kam thënë që Kuvendin e prezanton kryetari i Kuvendit, e jo tjetërkush, kurse materiali që del nga seanca dhe është i votuar, ti vendimet i merr në bazë të materialit që e ke nga seanca, e nuk ke pse e fton asnjë deputet për ta prezantuar vetveten në Gjykatën Kushtetuese.

Realisht, unë kam reaguar në atë që e ka thënë deputeti Arben Gashi dhe ai ka thënë kështu: “Unë po e lexoj, siç e kam transkriptin. Numërimi në Kuvend, procedura: bëhet

numërim nga Administrata, e cila numëron që unë nuk kam dyshim dhe nuk besoj se është numërim i saktë, sepse mund të jetë edhe brenda marzhës së gabimit njerëzor ai lloj numërimi. Është numërim elektronik, me të gjitha kartat që janë aty, që do të thotë se nuk kanë qenë 61 veta me karta dhe jam dakord me ju, nëse mund të nxirret si konkluzion. Ka mospërputhje të të dhënave, ndryshe thotë transkripti, ndryshe thotë votimi elektronik dhe ndryshe thotë deklarata e kryetarit, ose e kryesuesit të seancës. Besoj se ka dyshim të bazuar, sepse unë personalisht nuk kam qenë brenda”. Unë e lexova qysh është në transkript, jo si e kisha formuluar unë me fjalët e mia.

Tjetër, edhe një herë po i kthehem vërejtjes për ata që e keqpërdora unë. Jo unë dola këtu, nuk e keqpërdora. Nuk e shfrytëzoja as herën e parë, e as tash, mikrofonin atje, por po e shfrytëzoj këtu. Po e them edhe një gjë: unë jam angazhuar për të ndërtuar shtet demokratik, e jo policor. Ne kemi kaluar nëpër sistem, kur shërbimi informativ i ka bërë verifikimet e deputetëve, apo të njerëzve që i ka zgjedhur dhe nuk ke mundur ndoshta as në universitet të jesh pa qenë i verifikuar nga UDB-a. Ne nuk po kërkojmë mekanizma të tillë, prandaj mos pritni prej meje që të kërkoj nga Agjencia e Inteligjencës së Kosovës për të verifikuar, a janë...

(Reagime nga salla)

...jo nuk e kërkon ligji. Për mua nuk e kërkon ligji. Ai që dyshon në vetvete, mund të kërkojë për vetveten. Kjo është e drejtë juaja e secilit. Unë e mbroj demokracinë. Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, ministër i Drejtësisë, e keni fjalën për t'i arsyetuar edhe një herë vërejtjet në amendamentin 24.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Deputetët të nderuar,

Ju falënderoj për debatin dhe po dua të them, nëse më lejohet ta jap një vlerësim subjektiv dhe e kam pritur një kah të tillë, edhe sa i përket amnistisë, kam pritur që do të ketë një përkrahje edhe për tri arsye. E para, një institut i ri që i atakon dhe duhet ta ketë Republika jonë, e dyta për humanitetin që mund ta kemi secili prej nesh dhe, e treta, natyrisht për kompetencën që shtohet si organ ku jemi ne dhe vendosim.

E kam pritur dhe e pres një reagim edhe për përbërjen e Këshillit Gjyqësor dhe nëse më lejohet, do t'i jap disa sqarime shtesë. Sqarimi i parë duhet ta pranojmë faktin, ndikimi i sistemit e gjyqësisë në kohën moderne nuk është thirrja në telefon, nuk është kërcënimi, por bëhet në disa forma dhe e para formë do të jetë ndikimi në emërim, ndikimi në disiplinim, ndikimi në buxhet, ndikimi në buxhet, ndikimi në menaxhim dhe ndikimë në Rregulloren e Punës të Këshillit Gjyqësor. Dhe, kush e bën këtë?

Emërimin, disiplinimin, menaxhimin, buxhetin, rregulloret e punës i bën Këshilli Gjyqësor. Dhe, unë po ju them se deri sot përbërja ka qenë kështu: 8 veta përfaqësues të

Kuvendit të Republikës së Kosovës; 5 veta nga gjyqtarët. E nëse e merrni parasysh sa herë që propozohen njerëzit, atëherë është parë që gjithmonë njerëzit e zgjedhur nga Kuvendi kanë mundur t'i mbivotojnë të tjerët që kanë qenë aty.

Zoti Gashi e tha një çështje që besoj duhet ta sqarojmë këtu. Nëse do të dëshironim ndikim politik partiak, do ta mbanim kështu, bile do t'i kërkoja Kuvendit t'i bëjë edhe disa anëtarë të tjerë. Por, unë mendoj që ne nuk duhet ta bëjmë një gjë të tillë. E kuptoj ndjenjën kur dikush duhet ta japë një të drejtë dhe unë e di këtë që ka qenë në Kushtetutë dhe ju ka takuar kjo e drejtë. Dhe e kuptoj ndjenjën që dikush duhet të heqë dorë nga ajo e drejtë me bindje që po ia jep dikujt që është më pak i pjekur sesa ne, por kjo nuk mund të ndodhë në vendet ku ka sisteme të ndara të pushteteve dhe më lejoni të jap argumente për këtë, përveç asaj që u përmend.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës u përmend amendamenti. Unë jam ithtar që jeta është më evolutive sesa norma juridike dhe unë e them kur Kushtetuta dhe ligji s'i bie tamam një populli, duhet ndërruar kushtetuta e ligji, e jo popullin. S'po i bie tamam, duhet ta ndërrojmë. Nuk duhet ta marrim tragjedi këtë.

E para, amnistinë e kemi ndërruar edhe në Komisionin Kushtetues. Nuk na kanë lejuar. Dhe, unë besoj, po e them shumë hapur, rrëshqitja për amnisti ka qenë më '99, kur është dashur të rregullohet. Por, maksimum me Kornizën Kushtetuese të vitit 2001. Dhe, atëherë do të kishte qenë e mundur që raporte shoqërore të jenë më të rregullta se tash, por fjala popullore thotë 'më mirë vonë se kurrë' dhe ndërdija ime nuk është të rriten pritjet e njerëzve që janë nëpër burgje sot për amnisti, por ndërdija ime është të rriten pritjet e atyre që janë risocializuar dhe që Kuvendi vendos me 2/3.

Po ashtu, ta pranojmë një fakt, propozimi të nxirret ligji me 2/3 është i Qeverisë. Ka pasur mundësi të propozohet me 51%, sikur në shumë vende të botës, por cilido pushtet që do të ishte do të kishte mundësi të abuzonte pak me këtë të drejtë dhe do të kishte mundësi që në momente të caktuara, kategori të njerëzve, të shoqërisë, t'i amnistojë.

Sa i përket përbërjes së Këshillit Gjyqësor, po i referohem edhe koleges Osmani dhe të tjerëve.

E para, me Kushtetutën tonë Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut ka zbatim direkt. E dyta, e drejta ndërkombëtare, po hyj pak në zanat, sipas Kushtetutës sonë, paravlen mbi të drejtën vendore, që do të thotë në rastin konkret, Konventa Evropiane është mbi ato që ndeshen me ligjet tona. E treta, po ua përmend një konventë, apo një rregullore të Këshillit të Evropës, Komitetit të Ministrave, nr. 9412, të datës 13 tetor '94 dhe kështu thotë: Në pikën 4, pika b, thotë: pushteti legjislativ dhe ekzekutiv duhet të sigurojë një pavarësi të plotë të gjyqtarëve dhe çdo hap që e merr, duhet të mos e vërë në rrezik këtë pavarësi të Gjyqësorit. Pika 4 c, thotë: Të gjitha vendimet që merren lidhur me emërimin dhe karrierën e gjyqtarëve duhet të bazohen në kriteret objektive dhe duhet të seleksionohen gjyqtarët në bazë të meritës dhe kualifikimeve që kanë, integritetit dhe aftësisë së tyre, Po e përkthej kështu dhe nëse më lejohet, pra thuhet: autoritetet që i

marrin këto vendime duhet të seleksionohen kryesisht nga gjyqtarët. Shumica e tyre, edhe që bëjnë rregullore, edhe që emërojnë, pra duhet të jenë gjyqtarë.

Deri më sot, po e përsëris, është kërkesë dhe është mendim imi dhe besoj edhe ju duhet ta mbështetni, duhet ta bëjmë sikur e kanë vendet tjera. Ne duhet të jemi ata që bëjmë balancat e pushteteve, por nuk duhet të jemi ata që kontrollojmë dhe çojmë njerëz, qoftë edhe gjyqtarë që i do Kuvendi i Kosovës, që i emërojnë gjyqtarët dhe prokurorët tanë. Unë mendoj se duhet t'i lëmë ata që t'i kenë, nuk janë krejt. Mementalisht me ndryshimet që po i propozoj do të jenë 7 me 6. Pra, 7 të Këshillit Gjyqësor, 6 që i dërgon Kuvendi. Unë mendoj se këtu s'ka asgjë të keqe, po u japim një të drejtë që ata t'i zgjedhin njerëzit e vet. Kjo ndodh njëjtë, si të themi një komision i Qeverisë, kryesisht janë anëtarë të Qeverisë, si të themi njëjtë, Komisioni i Kuvendit e ka më shumë një komision ad hoc, me deputetë se të tjerë.

Unë e di që organi më i lartë në këtë vend është Kuvendi. Besoj që bashkë me ju, por unë e di një, që sistemi gjyqësor është i pavarur edhe prej Kuvendit. Dhe këtë duhet ta kemi të qartë, bile prej Monte Skijes dhe Xhon Lokut, fryma e ndarjes së pushteteve është shumë e qartë. Ne duhet ta ruajmë balancën, por jo ndërhyrjen në njëri-tjetrin. Nëse ne emërojmë njerëz që janë në përbërje të Këshillit Gjyqësor, sa të jem unë ministër dhe ne jemi në pushtet, ne na duket mirë, por po ju them për vendin nuk është mirë. Dhe gjyqtarët, prokurorët tanë do të frikësohen kush janë ata që i propozojmë ne në përbërje të Këshillit Gjyqësor.

A ka lëshime në Këshillin Gjyqësor? Po as ata nuk janë imunë. A ka dobësi në Këshillin Gjyqësor? Nuk janë as ata imunë. Unë nuk them se atje janë perfekt, atje janë disa engjëj që flenë, ndërsa në vende tjera janë ndryshe, edhe ata janë pjesë e shoqërisë tonë, por duhet t'i bëjmë mekanizmat ligjorë që i menaxhon, i kontrollojnë, por jo mekanizmat politikë. Dhe, në këtë rast unë kërkoj mirëkuptimin tuaj, edhe për hir të asaj që kemi vullnet, edhe për hir të asaj që duhet të tregojmë gatishmëri po edhe për hir të asaj që është me konventa ndërkombëtare. I duket që po e heq një kompetencë Kuvendi, po unë po e them për dy veta, dhe po e them se Kuvendit i ndihmon, po edhe sistemit juridik në Kosovë, i ndihmon që të funksionojë në mënyrë të pavarur, por varësia jonë e të gjithëve është Kushtetuta dhe ligji. Aty duhet të bashkohemi ne dhe jo me kompetenca të ndërlidhura. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Duke u bazuar në nenin 144, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e 2/3 të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë edhe 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.

Pra, nevojiten 80 vota, përfshirë këtu së paku edhe 16 vota të komuniteteve tjera në Kosovë.

Para se të kalojmë në procedurën e votimit, kërkoj nga deputetët që me votim elektronik të konfirmojnë praninë e tyre në mbledhje.

Regjia, votojmë tash!

Qëllimi ishte ta verifikojmë praninë dhe 105 janë për, 2 kundër dhe 2 abstenime, gjithsej praninë e kanë treguar 109 deputetë, kurse prania fizike është 112.

Është mirë që deputetët që janë të pranishëm, të mos na krijojnë probleme dhe se sa herë janë këtu ta shtypin butonin, qoftë për, qoftë kundër, qoftë abstenim, pra të tregojnë praninë e tyre fizike në Kuvend.

Pra, konstatoj se në mbledhje janë të pranishëm, me prani fizike, 112 deputetë, me praninë e treguar elektronike, 109 deputetë.

Lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim të amendamenteve.

E votojmë amendamentin 23.

Për amendamentin 23, kanë votuar 108 deputetë, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, përfshirë këtu edhe votat e gjithë komuniteteve që janë të pranishëm sot në Kuvend.

Tash vazhdojmë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për të votuar amendamentin 24.

Amendamenti 24, paragrafi 2 i nenit të Kushtetutës ka marrë këto vota: 67 për, 34 kundër dhe 1 abstenim, që do të thotë nuk ka kaluar.

Të nderuar deputetë, konstatoj se Kuvendi e miratoi vetëm amendamentin 23 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi, menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ndërsa amendamenti 24, nuk kaloi.

Ky është rezultati i këtij votimi.

Tash vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Zgjedhja e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozimin e panelit të Bordit të Bankës Qendrore për përzgjedhjen e kandidatit për guvernator të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet e Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, ta paraqesë arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Propozimi i panelit vlerësues për kandidatët për guvernatorë të Bankës Qendrore është dërguar në Kuvend, bazuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, përkatësisht në nenin 38, paragrafi 2, sipas të cilit Kuvendi përzgjedh personin për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe pastaj kandidati i përzgjedhur përmes votimit të fshehtë i dërgohet presidentes për miratim dhe emërim.

Kryesia e Kuvendit, me përfundimin numër 04/P-138 K, të datës 25 shkurt 2013 e ka ngarkuar Komisionin për Buxhet e Financa, si Komision FunkSIONAL, të shqyrtojë propozimin e panelit vlerësues për kandidatët për guvernatorë të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandimet.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozimi në panelit të Bankës Qendrore të Kosovës, për kandidatët e propozuar për guvernatorë dhe kanë vlerësuar përmbushjen e kushteve procedurale dhe përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore nga kandidatët e propozuar ashtu siç është paraparë me Ligjin për Bankën Qendrore të Kosovës.

Në bazë të nenit 38 pika 2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, bordi i Bankës Qendrore, me vendimin numër 03/209 të datës 27.12.2012, ka shpallur konkursin për plotësimin e pozitës për guvernator dhe e ka emëruar panelin seleksionues.

Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 38 të Ligjit, paneli ka publikuar konkursin për plotësimin e kësaj pozite në gazetën ditore në gjuhën shqipe dhe në mediat relevante serbe dhe konkursi ka qenë i hapur deri më 21 janar 2013.

Për plotësimin e kësaj pozite kanë konkurruar shtatë kandidatë dhe pas shqyrtimit të aplikacioneve, paneli i ka ftuar për intervistë të gjithë kandidatët.

Pas vlerësimit të kualifikimeve dhe performansës së aplikuesve, të ftuar për intervistë, paneli e ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve që i kanë plotësuar në tërësi kushtet dhe kriteret që kërkohen me Ligjin e Bankës Qendrore të Kosovës.

Si rrjedhojë, në pajtim me nenin 38 pika 2 të Ligjit për Bankën Qendrore, paneli i ka dërguar Kuvendit dhe Qeverisë listën me emrat e kandidatëve të nominuar për plotësimin e pozitës për guvernatorin e Bankës Qendrore dhe ata janë Bedri Hamza dhe Gani Gërguri.

Qeveria e Kosovës, në pajtim me nenin 38 pika 2, mund t'i dërgojë një mendim Kuvendit të Kosovës lidhur me kandidatët e përzgjedhur nga paneli seleksionues me kusht që ky mendim të dërgohet brenda afatit prej 15 ditësh.

Materialit, të cilin ne e kemi në disponim, i është bashkëngjitur edhe mendimi i Qeverisë që pajtohet me propozimet e bëra nga paneli seleksionues për guvernatorin e Bankës Qendrore.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, pas analizës që i ka bërë propozimit të panelit vlerësues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore ka arritur në përfundim se janë respektuar procedurat ligjore të parapara me nenin 38 pika 2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me propozimin e panelit vlerësues që nënkupton shpalljen e konkursit për pozitën e lirë për guvernator, intervistimin e kandidatëve dhe dorëzimin e propozimit me kandidatët që i kanë plotësuar kushtet ligjore për përzgjedhjen në Kuvend.

Në bazë të CV-ve apo në bazë të fotografive, të cilat u janë bashkëngjitur, shihet se të dy kandidatët e propozuar nga paneli i formuar nga Banka Qendrore, i plotësojnë kushtet dhe kriteret e domosdoshme të parapara me nenin 40 të Ligjit për Bankën Qendrore të Kosovës, ku parashihet që personat që kualifikohen për t'u zgjedhur dhe që shërbejnë në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore, duhet të jenë me integritet dhe të kenë diplomë universitare si dhe të kenë të paktën 10 vjet përvojë profesionale apo akademike në fushat e ekonomisë, të financave, të bankave, të kontabilitetit apo çështjet juridike.

Meqenëse janë respektuar procedurat ligjore, të parapara me nenin 38 pika 2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të dy kandidatët e propozuar, Bedri Hamza dhe Gani Gërguri i përmbushin kriteret e parapara me nenin 40 të këtij ligji, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të përzgjedhë njërin prej kandidatëve për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës me votim të fshehtë.

Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, në bazë të nenit 38 pika 2 të Ligjit numër 03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës duhet t'i përcillet presidentes për miratim dhe emërim në pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Nëse më lejohet zoti kryetar e kisha thënë edhe një mendim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, a mund të vazhdoj?

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar propozimin apo vlerësimin e panelit intervistues të Bankës Qendrore dhe e përkrah këtë vlerësim dhe rekomandon që deputetët të vlerësojnë kandidatin që ka përgatitjen profesionale si dhe ka kredibilitetin e dëshmuar për të udhëhequr këtë institucion të rëndësishëm, siç është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e kemi thënë edhe më herët dhe po e përsërisim qëndrimin dhe shqetësimin tonë që gradualisht po përfundon gjithë cikli i politizimit dhe i shndërrimit të institucioneve të ashtuquajtura të pavarura, në institucione të varura dhe partiake.

Është shumë e qartë që kandidatët, gjegjësisht kandidati zoti Bedri Hamza është eksponent i lartë i Partisë Demokratike të Kosovës dhe unë vetëm po ua lexoj se kur flasim për Kushtetutë, flasim për respektim të Kushtetutës në mënyrë selektive.

Neni 140 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thotë:” Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është institucion i pavarur, i cili i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës”. Dhe, nëse me Bedri Hamzën, guvernator është e pavarur, kjo është shakaja më e madhe që i bëhet qytetarëve të Kosovës, njëkohësisht është turpi më i madh që i bëhet këtij vendi me vazhdimin e kësaj çfarë po ndodh.

Banka Qendrore e Kosovës, lirisht, prej momentit që të zgjidhet zoti Bedri Hamza, do të jetë banka private e PDK-së ose banka e Qeverisë, njësoj është ajo, dhe absolutisht nuk qëndron ajo se nuk shkruan në ligj kurrkund që s’mund një ish ministër deri dje, bile ende është i ngjirë, sepse s’e kanë zëvendësuar duke pritur çka po ndodh, nuk shkruan, l por shkruan qartë se ky është institucion i pavarur dhe këtë e thotë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, të cilën e respektojnë atëherë kur u konvenon dhe që rrallë ndodh, të mos them, gati kurrë dhe shkelet me të dy këmbët, si në rastin konkret.

Unë kam dëshiruar sinqerisht të besoj që e ka përnjëmend zoti kryeministër kur ka pas thënë këtu, që për shembull bordin e ish-AKM-së - AKP-së do ta depolitizojë dhe t’i heqë ministrat, ju e dini që kanë qenë ministra, kanë qenë edhe ministra të LDK-së, ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut, ka qenë edhe përfaqësuesi më vonë i LDK-së dhe edhe sot e mbështes qëndrimin po të mbahej i tillë që të mos jenë të politizuar.

Dhe çka ndodhi? Në vend të ministrit, erdhi një ish-zëvendësministër dhe kjo domethënë nuk qëndron, nuk është e vërtetë dhe ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, me aktin e lëshimit të seancës që asnjëherë s’i gëzohemi lëshimit të seancave, por është e vetmja mënyrë për të treguar se këtu po ka veprime që po shkelin Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ne nuk dëshirojmë të bëhemi pjesë e shkeljeve të tilla, qoftë edhe me praninë tonë fizike.

Andaj, ne e kundërshtojmë fuqishëm zgjedhjen e personit partiak në institucion të ashtuquajtur të pavarur dhe ne do ta lëshojmë seancën. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka, në emër të Grupit të “Vetëvendosjes”, kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

U tha këtu shumëçka për njërin prej kandidatëve, po edhe për zotin Hamza i cili ka qenë deri vonë ministër i Financave edhe më herët dhe zëvendësministër i Financave dhe i cili ka qenë po ashtu edhe kryesori me sa e kam parë në media për numërimin e votave të brendshme në PDK. Besoj dhe po duket që aty dikujt ia ka lënë ëmbël dhe tash po duan që paratë e krejt Kosovës t’i numërojnë njëjtë sikur votat e PDK-së brenda. Natyrisht që këto dikujt do t’i shërbejnë.

Po mua po më çudit diçka. E tha edhe zoti Beqiri këtu që sa i përket kushtit kryesor të këtij kandidati, pra kushtit të paanshmërisë dhe pavarësisë, ky jo që s’e plotëson, po është në kundërshtim me të, është pra e kundërta, opozita e këtij kushti.

Po edhe diçka tjetër, mua po më çudisin ngapak edhe këto kushtet profesionale, për shkak se ne kemi parë në këto dokumente që na janë dorëzuar këtu që Bedri Hamza e ka numrin më të madh të pikëve. I ka diku 95 pikë dhe mos gabofsha, ndërkohë që tjetri, Gani Gërguri që është aktualisht guvernator, i ka 88 pikë.

Ndërkohë që kur e shfletojmë pastaj dokumentacionin që e kanë dorëzuar vetë këta në momentin e aplikimit, pra ato përmbledhjet, rezymetë e përvojës së tyre të punës edhe akademike e kështu me radhë, e shohim se Bedri Hamza e ka një faqe e gjysmë CV e Gani Gërguri i ka nëntë. Dhe kjo është një diçka që unë s’mund ta kuptoj për shkak se aty përshkruhet profesionaliteti, të paktën ata si e deklarojnë që e kanë kryer këtë shkollë apo atë shkollë, kanë punuar në këtë vend pune apo kanë punuar në atë vend pune dhe këto janë përgjegjësitë që i kanë.

Dhe po i lexoj te Bedri Hamza, meqenëse janë pak, mund t’i lexojmë shpejt.

Në vitin 2011, siç e thashë dhe e ka lënë këtu, domethënë, të hapur, pra që vazhdon të jetë, ministër i Financave, pastaj i ka renditur këtu përgjegjësitë që i ka pasur në kuadër të Ministrisë.

2008 - 2012, zëvendësministër, po ashtu në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave; 2000 - 2003 ka qenë drejtor i Departamentit të Shërbimeve Publike; dhe 1987 - 1990, udhëheqës i financave dhe kontabilitetit në Metalurgjinë e Plumbit.

Pra, drejtor i Departamentit ka qenë në komunën e Mitrovicës, e pastaj në Kombinatin “Trepça” deri në vitin 1990.

Dhe pastaj në një rresht këtu thuhet që prej vitit 1990 deri në 1999 dhe po ashtu prej vitit 2003 deri 2007, ka punuar në sektorin privat, menaxhim, financa dhe kontabilitet.

Kjo është përvoja e guvernatorit të ardhshëm, shpresoj të mos jetë, por siç po duket do të jetë guvernator i ardhshëm i Bankës Qendrore, pra, kontabilitet, në sektorin privat, i ka mbajtur librat e kompanive.

Ne konsiderojmë se me propozimin e kandidatit të tillë, do të thotë agresion i hapur ndaj funksionimit të sistemit financiar dhe Bankës Qendrore dhe praktikisht uzurpim nga kryeministri i këtij sektori.

Pra, besoni deputetë të nderuar, është një hap cilësor në kapjen e shtetit. Pra, jo vetëm që është hap në kapjen e shtetit nga klanet e caktuara, por është hap cilësor, për shkak se institucioni i Bankës Qendrore të një vendi, është institucioni më i rëndësishëm financiar në atë vend dhe ne e dimë që sektori financiar është sektori më i rëndësishëm i ekonomisë, i sovranitetit dhe i ndërtimit të shtetit.

Banka Qendrore e një vendi, pra është, siç edhe parashihet në direktiva dhe Traktatin e BE-së, duhet të jetë e pavarur nga presionet, këshillimi apo ndikimi nga Qeveria, apo cilido organ tjetër në vendimmarrjen e saj.

Çdo lloj veprimi i këtij institucioni duhet të jetë tejet transparent, derisa përgjegjësia duhet të jetë shembull udhëheqës për gjithë sistemin në të cilin operon.

Në këtë kuptim, çdolloj i ndikimit shkel mbi pavarësinë e këtij institucioni, e në rastin konkret ndikimi, pra me përzgjedhjen e Bedri Hamzës si kandidat për guvernator, do të thotë që kryeministri e ka në plan që de fakto ta drejtojë Bankën Qendrore, pra t'i zgjasë duart e tij në të gjitha paratë dhe financat e Kosovës.

Kështu, zaptimi qeveritar e partiak i Bankës Qendrore, nënkupton kontrollin e drejtpërdrejtë mbi Fondin e Privatizimit, në rregullat për sistemin pensional dhe Fondin Pensional, në kursimet e qytetarëve, kontrollin dhe rregullat e sistemit financiar në Kosovë, kontrollin tek licencat që çdo operator kërkon nga Banka Qendrore, financiar për t'u futur në industrinë e financave dhe në sektorë specifik siç është ai i sigurimeve.

Pra, ne gjykojmë se përpjekja për kapjen e sistemit financiar me anë të guvernatorit të Bankës nga kryeministri Hashim Thaçi, është një rrezik real për funksionimin dhe mbarëvajtjen e të gjithë sistemit financiar të vendit.

Për këtë arsye, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk do ta legjitimojë kandidaturën e këtij partiaku të PDK-së për Bankën Qendrore, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sot dhe nuk do të marrim pjesë në këtë proces të votimit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të AAK-së, kryetari Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se është evidente që zoti Bedri Hamza është person politik. Sidoqoftë, nga ato që i dëgjova nuk po mund të mos konstatoj që edhe deri më tani krejt politik kanë qenë. Në të njëjtën kohë nuk po mund të mos konstatoj që krejt ato që u përmendën më përpara që mund të ndodhin tash e tutje në Bankën Qendrore, kanë ndodhur edhe më përpara, ju kujtohen debatet tona goxha të ashpra të viteve 2008, 2009, 2010, kanë ndodhur.

Edhe një herë po ju them, trasimi i rrugës për emërime politike, pa dashur të lëshohem në vlerësimin e zotit Bedri Hamza, mendoj se unë personalisht kam më tepër respekt për të se shumë tjerë në Qeveri që janë, mirëpo Aleanca do t'i qëndrojë konsistent vendimit të vet që nuk e lëshojmë sallën e Kuvendit, e do të votojmë kundër. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit kryetar!

Koalicioni për Kosovë të re e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe do të shihet kush do t'i fitojë votat për guvernator. Ne i kemi dy kandidatë

këtu dhe nga dy kandidatët vota është ajo e cila përcakton cili do të jetë guvernator i ardhshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, deputetja Jelena Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedniče!

Samostalna liberalna stranka je razmatrala predlog Komisije za budžet i finansije i pažljivo smo razmotrili predlog za guvernera Banke i mi ćemo pristupiti glasanju. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, kryetarja Myfera Shinik e ka fjalën.

MYFERA ŞINIK: Teşekkür ederim.

Bütçe ve Finansi Komisyonunun önerisini “6+” Parlamenter grubu olarak destekliyoruz.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e lexoj vetëm një paragraf.

Tani e votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash!

Konstatoj se më 83 vota për, 4 kundër dhe 5 abstenime Kuvendi e miratoi Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në sallë kemi 94 deputetë.

Kështu kanë votuar deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të gjithë ata që sot e braktisën sallën, pra e kanë votuar këtë ligj në bazë të cilit sot zgjidhet guvernatori i Republikës së Kosovës.

Ligji thotë, shkarkohet ose largohet prej pozitës nëse guvernatori merr pjesë aktive në aktivitetet politike, pasi është emëruar si anëtar i Bordit të Bankës Qendrore.

Pra, nuk e kanë harruar deputetët ta futin aty sikur ka qenë rasti te Komisioni i Pavarur i Medieve, ku shkruan qartë që Shefki Ukaj nuk ka drejtë të jetë anëtar i atij komisioni.

Aty është shkruar qartë që nëse merr pjesë aktive, në dy vjetët e fundit ka qenë aktivisht në politikë, atij nuk i mundësohet.

Javën e kaluar, është për keqardhje që nuk janë deputetët e LDK-së, ata e mbrojtën zotin Shefki Ukaj këtu, thanë që edhe përkundër faktit që na ka futur ne në lajthitje, unë kam qenë kryetar i Komisionit ad hoc dhe ai nuk e ka treguar të vërtetën, ka qenë deputet, këshilltar në Kuvendin komunal.

Pra, problemi i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk është ligji, problemi për ta është personi. Për sa kohë një person është i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ata nuk e kanë problem që ta zgjedhin në secilin bord të mundshëm duke e shkelur ligjin.

Ndërsa, në rastin konkret, unë mendoj që zoti Bedri Hamza për sa kohë e respekton këtë ligj, unë konsideroj që është njëri prej kandidatëve më të mirë për postin e guvernatorit të Bankës Qendrore. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Një pjesë e asaj që kisha ndërmend ta them e theksoi parafolësi dhe unë desha të vë theksin pikërisht te kjo që të mos na bëhet një precedent që gjithçka të politizohet dhe të krijohen klishe sipas të cilave politizimi të matet me angazhimet e mëparshme, se s'duhet të jetë i politizuar një organ, ka të bëjë me të sotmen dhe të ardhmen.

E mira do të ishte që të kihet kjo parasysh gjatë ndërtimit të kandidaturave për të siguruar konsensusin, e mira do të ishte që, siç po themi për gjyqësorin të përpiqemi t'i ndërtojmë të njëjtat parametra e relacione edhe në fusha tjera. Dhe qysh po përpiqemi të krijojmë funksionim të pavarur për një komunitet, le të përpiqemi edhe kur janë ndëretnike, le të jenë edhe atje mundësitë e funksionimit të pavarur dhe jo të instrumentalizimit. Na duhet një qasje ma parimore që besoj na krijon konsensusin.

Por megjithatë në rastin konkret, meqë askush nuk e konteston profesionalizmin dhe plotninë e kushteve tjera të kërkuara me ligj të kandidatit Bedri Hamza, për mua madje ka qenë befasi ajo përkrahje në këtë aspektin profesional që u tha, madje u tha edhe nga përfaqësues të grupeve opozitare, edhe nga udhëheqja e Kuvendit e tjera, mendoj që nuk do të duhej kontestuar, sepse krijohet precedenti i rrezikshëm që asnjë nga ata që kanë një të kaluar politike, të mos mund të angazhohet pastaj në organe të pavarura. Nuk është në rregull.

Ne në këtë funksion kemi pasur një ish lider të rinisë komuniste. Nuk e ka kontestuar askush angazhimin e tij politik, nuk ka thënë askush se ai s'mund të jetë i pavarur politikisht për shkak të kaluarës së tij dhe i dolën do telashe, por jo për shkak të pedigresë politike, prandaj mendoj që duhet ndarë këto dy çështje.

S'është me rëndësi emri, është me rëndësi fenomeni. Unë këtë desha ta theksoj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dhe deputeti pa grup, Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Dëshiroj t'i them disa mendime këtu lidhur me këtë çështje, pasi që e konsideroj një çështje shumë të rëndësishme dhe me një rëndësi qenësore të zhvillimit dhe ndërtimit institucional të Kosovës dhe jo vetëm çështje teknike procedurale.

Në këtë drejtim, mendoj se forcimi i Bankës Qendrore dhe roli i saj aktiv dhe i pavarur ka rëndësinë jetike për zhvillimin e ekonomisë së lirë, të konkurrencës së barabartë dhe ofrimit të kushteve për një financim më të mirë të zhvillimit tonë.

Ne kemi krijuar një sistem relativisht stabil bankar, por kemi probleme serioze me financimin e bizneseve, me norma të larta të interesave dhe probleme tjera.

Prandaj, sa do që mund të lëvdojmë Bankën Qendrore se ka arritur një rezultat dhe një stabilitet, nuk ka arritur rezultat në krijimin e konkurrencës sa duhet edhe në uljen e normave të interesit që janë jetike për zhvillimin e Kosovës.

Në këtë drejtim, në tërë këtë tregim të zgjedhjes së guvernatorit duhet të jemi të kujdesshëm shumë në disa momente. Zoti Bedri Hamza ka qenë një nga edhe është, një nga ministrat më agil të Qeverisë, me një profesionalizëm, i vyeshëm dhe unë do të kisha dashur që deri sa të jetë kjo Qeveri, ai vërtet ta kryejë edhe punën e ministrit. Lënia e Ministrisë në gjysmë të rrugës dhe konkurimi në Bankë atje, nëse i marrim këta kandidatë, nuk kanë ndonjë diferencë të madhe njëri me tjetrin, në aspektin e profesionalizmit, pra të dy janë diku barabar edhe pse ky që është tash, domethënë problemi i vetëm është normat e larta të interesit, tjerat gjëra, s'kemi pasur ne dobësi të mëdha të Bankës Botërore dhe referencat e tij në industrinë bankare janë më të mira se ky, e tash referencat makro-ekonomike si ministër i Financave, i ka Bedri Hamza, janë aty diku, por problemi është te paneli dhe zgjedhja, te procedurat.

Paneli që e ka marrë në pyetje, unë kam vërejtje shumë të mëdha, edhe kur na i ka pru anëtarët e Bordit, edhe kur na i ka pru këtu. Në mesin e atyre që kanë konkurruar për Bordin dhe që kanë konkurruar për guvernatorë ka ekspertë, sepse fatbardhësisht i njoh shumicën prej tyre, i kam pasur studentë dhe i njoh çfarë kanë punuar mbasandaj dhe çfarë kompetencash kanë të gjithë. Ka pasur shumë ekspertë më të aftë se sa këta dy që i kemi këtu.

Njëri nga ata që s'ka hyrë në procedura e s'është vlerësuar hiç, profesor Valentin Toçi, domethënë, as që ka shkuar në Komision si propozim, as që janë dhënë të dhënat e tij. Njëjtë mund të gjejmë edhe te bordi.

Prandaj, përbërja e panelit ka qenë joadekuatë në aspektin politik, mos të them profesional se ata formalisht i kanë do kualifikime, por edhe në përbërje të panelit dy veta shihet që kanë, domethënë mund të kenë edhe simpati politike dhe angazhime politike, prandaj ata e iniciojnë krejt këtë proces që nuk është i mirë dhe ne mund t'i biem tash në pozitë të palakmueshme edhe zotin Gërguri edhe zotin Hamza në këtë situatë kështu.

Zgjedhja pra, nuk është adekuatë dhe mendoj se mënyra se si po shkojmë ne kështu, nuk është mënyra e duhur. Nuk besoj që është mënyra e duhur as për Qeverinë, as për Kuvendin, as për partitë politike.

Unë pajtohem me zotin Hyseni në atë pjesë kur thotë se për këto çështje Agjencia e Privatizimit, Banka Qendrore, disa çështje duhet të ketë një ndjeshmëri për një, jo të them ashtu konsensus, por për një konsultim, për një arritje të pajtimit. Dhe në qoftë se ne

duam që me forcën e votës dhe me panele të tilla, me këto të tilla t'i shtyjme gjërat, atëherë nuk mendoj që ne po i bëjmë shërbim demokracisë dhe pavarësisë së Bankës Qendrore.

Në këtë drejtim ne e kemi analizuar me Grupin E-15 dhe mendojmë se ky trend nuk është i mirë. Ky trend nuk është në drejtimin e duhur dhe mu për këtë, sado që ne jemi kundër, të mos votohet, jemi kundër dhe mos të lëshohet në këto çështje të rëndësishme qysh ka qenë Agjencia e Privatizimit edhe Banka Qendrore, unë kam marrë qëndrim dhe porosi prej Grupit E-15 që të mos marrë pjesë në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Në sallë janë 70 deputetë, do të thotë e kemi kuorumin për të vazhduar me punë.

Të nderuar deputetë meqë janë propozuar dy kandidatë për pozitën e guvernatorit, ndërsa me ligj nuk është përcaktuar mënyra dhe forma e përzgjedhjes, propozoj që votimi të jetë i fshehtë, ndërsa zgjedhja bëhet me shumicën e votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë, neni 51 i Rregullores.

Lus deputetët që të deklarojnë për formën e votimit të fshehtë. Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka dhe me shumicën absolute u mor vendimi që votimi të jetë i fshehtë.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i Komisionit votues nga përbërja e deputetëve me mbështetje të zyrtarëve të administratës.

Ftoj përfaqësuesit ose kryetarin e Grupit të Partisë Demokratike ta propozojë një kandidat për Komision. Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e vlerëson shumë lart këtë institucion dhe së pari keqardhje në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, për mohimin e një të drejte të deputetëve për të shprehur vullnetin e tyre, edhe pse ne kemi bërë përpjekje që për çështje të kësaj rëndësie të kemi konsensus, megjithatë po shihet qartë se si po na shkojnë punët dhe sa është gatishmëria për të pasur institucione funksionale.

Sidoqoftë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e propozon për anëtar të Komisionit zotin Ramiz Lladrovci.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, e ka fjalën Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e propozojmë deputeten Time Kadrijaj, për anëtare të Komisionit.

KRYETARI: Koalicioni për Kosovë të Re, kryetare, kë e propozoni ju?

MYZEJENE SELMANI: Koalicioni për Kosovë të Re, e propozon deputeten Sevdije Lama.

KRYETARI: A është këtu Sevdije Lama? Jo. Mirë, vjen. SLS, Sasha Millosavljeviq, kënd e propozoni ju?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!
Mi predlažemo Jelenu Bontić za člana Komisije.

KRYETARI: Grupi “6+”, kryetare?

MYFERA SHINIK: “6+” Parlamentar Grubu olarak Duda Balje'yi öneriyoruz.

KRYETARI: Lus deputetët që me ngritje dore ta miratojnë Komisionin.

Kush është për? Janë shumica e votave.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim nuk ka. Miratohet edhe Komisioni.

Konstatohet se Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit votues.

Lus Komisioni që të fillojë me procedurën e votimit, ndërsa deputetët të ftohen. Le ta zë vendin Komisioni.

(Ndërprerje e incizimit)

Adem Grabovci, Afërdita Shaqiri, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Syla, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Jakup Krasniqi...

(Mbledhjen e merr nën drejtim nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

...Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Sfirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinković, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi, Imri Ahmeti, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Lutfi Haziri, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Myfera Shinik, Muhamet Mustafa, Mursel Halili, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyçi, Sasha Milosavljeviq, Petar Miletic, Rada Trajković, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Asllanaj, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanović, Sevdije Lama, Shaip

Muja, Skënder Hyseni, Boban Todoroviq, Sreten Ivanoviq, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbona Dibra, Xhevahire Izmak, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti.

Konstatohet se është kryer. Fjalën e ka kryetari i Komisionit, zoti Ramiz Lladrovci, që ta komunikojë rezultatin.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni votues për zgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, raport mbi rezultatet e votimit për zgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38 pikë 2, të Ligjit numër 03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues i formuar me vendim të seancës plenare, datë 14 prill 2013, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar,

- Ramiz Lladrovci, PDK,
- Time Kadrijaj, AAK,
- Sevdije Lama, AKR,
- Jelena Bontiq, SLS,
- Duda Balje, GP “6+”.

Komisioni votues, pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 14 mars 2013, konstaton si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 67 deputetë.

Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, e pavlefshme, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, E pavlefshme, Bedri Hamza, E pavlefshme, Bedri Hamza, E pavlefshme, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Gani Gërguri, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, E pavlefshme, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Gani Gërguri, Bedri Hamza, Bedri Hamza, Bedri Hamza.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Ramiz Lladrovci, si kryetar i Komisionit për numërimin e votave.

RAMIZ LLADROVCI: Të nderuar deputetë, në votim kanë marrë pjesë, siç thamë edhe më herët, 67 deputetë.

Të pavlefshme 6 fletë votime.

Bedri Hamza i ka fituar 58 vota.

Gani Gërguri i ka fituar 3 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38 pikë 2 të Ligjit numër 03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është zoti Bedri Hamza, i dërgohet presidentes të Republikës së Kosovës për miratim dhe emërim në pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, edhe Komisionit, edhe juve, zoti Ramiz Lladrovci për korrektësinë. Pra, u tha edhe nga ana e kryetarit të Komisionit dhe s'ka nevojë që ta përsëris të njëjtën gjë.

Konstatohet se sot zoti Bedri Hamza është zgjedhur guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës nga Kuvendi i Kosovës.

Në bazë të nenit 38 pikë 2 të Ligjit numër 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, vendimi i dërgohet presidentes së Republikës për emërimin e guvernatorit. Faleminderit!

Deri në orën 15:00 e kemi pauzën e drekës. Mirupafshim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pasdite

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë!...

Është mirë të kërkojmë prej kryetarëve të grupeve parlamentare që ta menaxhojnë më mirë kohën, se thotë një fjalë se koha është ar, por ne po më duket se kemi shumë ar!

Megjithatë, fillojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendi ia ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji.

E ftoj deputeten Albanë Gashi, që në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, propozuese, para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Më lejoni që sot para jush ta paraqes për miratim në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre.

Më 21 mars të vitit 2000, organizata joqeveritare humanitare amerikane Human Rights Watch e ka publikuar një raport 37 faqesh, ku janë përshkruar rastet e dhunimeve gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999 dhe e ka dhënë shifrën prej 20 mijë personave që janë dhunuar gjatë kësaj periudhe.

Mirëpo, fatkeqësisht, këto raste nuk janë trajtuar asnjëherë deri vitin e kaluar, pra më 9 mars 2012, kur u mbajt një debat parlamentar për nder të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, kur është debatuar gjerë e gjatë për pozitën e gruas në Kosovë, me ç’rast është diskutuar edhe për rastet e personave që janë viktimat të abuzimit seksual dhe dhunimit gjatë luftës së fundit.

Në fund të debatit, Kuvendi i ka miratuar disa rekomandime, ku ndër të tjera është kërkuar edhe trajtim i veçantë institucional i këtyre rasteve.

Më tej, më 4 tetor 2012, në Prishtinë, është mbajtur Samiti Ndërkombëtar i Gruas, ku po ashtu është dalë me disa rekomandime, duke u thirrur në disa konventa ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas. Ky është po ashtu një dokument, i cili është votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Këto rekomandime i kanë hapur rrugë nismës sonë për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre.

Arsyeja se pse kemi kërkuar plotësim-ndryshimin e ligjit aktual dhe jo hartimin e një ligji të veçantë është për shkak se kjo është kërkesë e vetë kësaj kategorie. Ato janë produkt i luftës sikur kategoritë tjera dhe nuk duan trajtim të veçantë nga ta, gjë që do bënte që këta persona edhe më tej të jenë të stigmatizuar nga shoqëria.

Ligji aktual nuk përfshin edhe viktimat e abuzimit seksual e të dhunimit. E drejta themelore e tyre është e drejta për t’u njohur si viktimat dhe më pastaj të konsiderohen edhe detyrime tjera institucionale pas evidentimit.

Përdhunimi është formë e krimit kundër njerëzimit. Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, i miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së i sanksionon torturën dhe përdhunimin si forma të rënda të krimit kundër njerëzimit. Statuti i kësaj gjykate për herë

të parë në historinë e njerëzimit e njëj përdhunimin si krim të luftës dhe krim kundër njerëzimit.

Ky projektligj ka për qëllim njohjen e statusit të viktimave të abuzimit seksual e të dhunimit si kategori e veçantë e viktimave civile të luftës.

Ky projektligj është hartuar në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe kombëtare. Ndryshimet e bëra janë harmonizuar me konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, me theks të veçantë të të drejtave të viktimave seksuale gjatë luftës. Këto konventa janë:

- Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas,
- Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325, 1820 dhe
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Prandaj, ky plotësim vetëm sa do ta kompletonte infrastrukturën ligjore në respektimin e të drejtave njerëzore të të gjitha kategorive të prekura nga lufta në Kosovë.

Propozimi është që titullit të ligjit aktual në fuqi t'i shtohet edhe kategoria e personave të dhunuar gjatë luftës dhe më tej të inkorporohet ajo kategori në nene. Pra, projektligji të quhet Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personat e dhunuar gjatë luftës dhe viktimave civile dhe për familjarët e tyre.

Ky projektligj ka gjithsej 10 nene dhe në fund i është bashkangjitur edhe shtojca ku është paraparë lartësia e pensioneve për secilën kategori të prekur nga lufta, duke përfshirë këtu edhe kategorinë e personave të dhunuar.

Sigurisht që ne presim vërejtjet dhe sugjerimet tuaja për këtë projektligj, në mënyrë që ato më pas ato të dërgohen në Komisionin Funksional si amendamente.

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ju bëj thirrje në emër të tyre që ta përkrahni këtë projektligj, sepse e kemi për detyrë që nëpërmjet këtij ligji të njihet krimi ndaj tyre e t'u lehtësohet vuajtja, t'u ofrohet përkrahja institucionale dhe shoqërore, gjë për të cilën kjo kategori ka nevojë më së shumti. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale, në bazë të Rregullores së Kuvendit dhe vendimit të Kryesisë së Kuvendit të datës 28 janar 2013, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, e shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligji 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe për familjarët e tyre dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim:

Të mos miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe për familjarët e tyre.

Komisioni, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, diskutoi për Projektligjin për miratim në parim dhe konstatoi se Projektligji i propozuar e trajton një çështje të ndjeshme dhe shumë komplekse dhe nuk ofron një zgjidhje të plotë të problematikës së trajtuar.

Për hartimin e projektligjit nuk janë bërë analiza gjithëpërfshirëse të çështjes dhe ka mungesa të dhënash për numrin e saktë të përfituesve nga miratimi i këtij projektligji.

Komisioni nuk e përkrah projektligjin në formën siç është hartuar, prandaj kërkon një analizë më gjithëpërfshirëse në gjetjen e një zgjidhjeje për këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka një rekomandim.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, edhe pse nuk është Komision FunkSIONAL, në këtë rast është i ngarkuar nga Kryesia që ta bëjë shqyrtimin e Projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit numër 04/L-054 për statusin e të drejtave të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre, prandaj e ka respektuar këtë vendim dhe e ka shqyrtuar.

Thënë të drejtën, në raste të tilla je edhe në dilema të mëdha se si të veprosh dhe si të bësh, meqenëse është një kategori e ndjeshme e shoqërisë sonë dhe ndoshta kjo shoqëri i ka obligim kësaj kategorie që ka pësuar gjatë luftës së fundit, megjithatë Komisioni për Buxhet dhe Financa e shqyrton koston financiare, implikimet buxhetore që mund të ketë projektligji në këtë vit dhe dy vjetët e ardhshme, prandaj me kujdes të madh e ka shqyrtuar në mbledhjen e mbajtur më 20.3.2013 dhe ka ardhur në përfundim se ky projektligj përmban implikime buxhetore shtesë dhe për zbatimin e tij në periudhën trevjeçare 2013-2015 kërkohen mjete buxhetore shtesë në vlerën 216 milionë euro, çka do të thotë se për çdo vit janë të parapara diku 74 milionë euro buxhet shtesë për këtë kategori, siç është rregulluar problematika e saj në projektligj.

Po ashtu, mungesa e të dhënave për numrin e përfituesve nga ky projektligj krijon paqartësi financiare dhe mund të ketë ndikim në rritjen e koston buxhetore për zbatimin e ligjit.

Duke pasur parasysh faktin se projektligji prodhon kosto shtesë të lartë buxhetore, e cila nuk është e përfshirë në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, por njëkohësisht nuk është e përfshirë as në kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin

2013-2015, mungesa e të dhënave për numrin e përfituesve nga ky projektligj, që ndikon në vlerësimin e saktë të ndikimit buxhetor në zbatimin e këtij ligji, Komisioni ka vlerësuar se miratimi i këtij ligji do të jetë i pazbatueshëm në të ardhmen, prandaj rekomandimi është që të mos votohet.

KRYETARI: Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Grupi ynë Parlamentar i ka shqyrtuar amendament e ardhura për Ligjin për të drejtat e familjeve të dëshmorëve, për të drejtat e invalidëve të luftës, veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të personave të zhdukur ose të pagjetur, si dhe viktimave civile.

Ne këtë ligj e kemi pasur në dorë dhe temën të cilën po e debatojmë sot e kemi diskutuar edhe në kuadër të komisionit, sepse kemi parë se në veçanti, krahasuar me ligjin paraprak, para se të ndryshohet ligji totalisht, ka ekzistuar fjala ‘abuzimet e luftës’, ndërsa në këtë ligj kjo fjalë nuk ekziston. Mirëpo, edhe kështu siç ishte, Ligji për veteranët e luftës, siç thuhet shkurt, ka implikime të mëdha buxhetore dhe si i tillë ka pasur mjaft kontroll gjatë shqyrtimit të tij dhe nxjerrjes përfundimtare. Ne kemi qenë të monitoruar nga organizatat që e kontrollojnë Buxhetin e Kosovës, sepse është një ligj që vërtet e tejngarkon atë për këto kategori të veçanta. Natyrisht, ne kurrë nuk mund t’ua kthejmë atyre kontributin për lirinë, por edhe kapacitetet buxhetore të Qeverisë sonë të re janë të limituara.

Do të ndalem në disa çështje, për të cilat është kërkuar të kemi të dhëna të sakta kur e nxjerrim ligjin, e këto janë të dhënat e sakta për dëshmorët, për numrin e tyre, për numrin e veteranëve dhe e dimë se kjo është në fazë të them përfundimtare ose e numërimit të veteranëve dhe klasifikimit real të tyre të pjesëmarrjes në luftë, pastaj numrin e saktë të invalidëve të luftës, numrin e saktë të pengjeve të luftës, numrin e saktë të të zhdukurve dhe viktimave civile. Natyrisht që edhe personat e abuzuar gjatë luftës dhe që kanë pësuar dhunë seksuale meritojnë t’i kenë të drejtat e veta, njësoj si të gjithë të tjerët që kanë pësuar nga lufta.

Por, po e shohim se çfarë po ndodh me numrin e veteranëve. Ne e kemi një shifër të paparapare të veteranëve, e cila duhet të verifikohet se sa është e saktë dhe sa mund ta bartë këtë pasojë dhe këtë numër, që të shpërblehen ata që e meritojnë.

Sipas statistikave për personat e dhunuar dhe të abuzuar gjatë luftës, ekzistojnë statistika shumë të çuditshme dhe të ndryshme. Këto statistika janë nga organizatat ndërkombëtare që kanë vepruar për një kohë të gjatë në Kosovë, e ky numër është prej 20 000 deri në 40 000, dhe ne nëse flasim për këto shifra e shohim se sa të papërgatitur jemi për ta bërë një ndryshim-plotësim të ligjit dhe ta kemi edhe pasqyrën reale të buxhetit për këtë çështje.

Megjithatë, abuzimi seksual i personave për shkak të përkatësisë së tyre kombëtare, sigurisht që është një plagë që e dëmton shëndetin dhe jo vetëm atë, por edhe tërë familjen, dhe plagë e cila nuk shërohet deri në vdekje të tyre.

Ne e dimë se kjo çështje është shpallur edhe si krim ndaj njerëzimit dhe po dënohet edhe në gjykatat ndërkombëtare.

Nëse ekziston mendimi që të merren parasysh, kjo varet nga vota që do të jepet dhe vota mund të jetë e lirë, në shqyrtim kjo çështje do t'i takojë Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe natyrisht kërkon një punë shumë të angazhuar dhe jo në këtë formë se si është sjellë ky propozim dhe kryesisht duhet të mbështetet në statusin e viktimave në bazë të abuzimit dhe dhunimit seksual.

Ç'është e vërteta, edhe në ligjet paraprake, këta persona kanë pasur mundësi që të kategorizohen në këto kategori që i përmendëm dhe kryesisht ndoshta viktimat civile të luftës t'i përfitojnë të drejtat e veta. Duke e marrë këtë parasysh dhe përvojën personale timen, konstatoj se një numër shumë i vogël prej tyre ka përfituar nga ligji paraprak.

Fatkeqësisht, Bosnja e ka nxjerrë ligj të veçantë për personat e abuzuar gjatë luftës, por numri është shumë simbolik, krahasuar me numrin real të grave dhe personave seksualisht të abuzuar.

Prandaj, kërkoj që së pari, nëse u jepet një e drejtë, atëherë është pikërisht pranimi që këto gra janë abuzuar gjatë luftës si një kategori e veçantë e viktimave të luftës. Dhe, pranimi që në mesin e tyre ka një numër shumë të madh, dhe duhet konstatuar sa është ky numër i grave, i vajzave, burrave dhe, fatkeqësisht, edhe i fëmijëve. E përsëris, fatkeqësisht, edhe i fëmijëve!

Duhet dëshmuar dhe duhet konstatuar se çfarë dokumentesh duhet të kërkohen për ta vërtetuar këtë abuzim dhe 15 vjet pas luftës të themi se ky është një krim ndaj njerëzimit, që ndodhi edhe në Kosovë në kohën e luftës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Nazane Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre është një projektligj shumë i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me trajtimin e një kategorie shumë të ndjeshme të shoqërisë sonë.

Ne si LDK, në parim jemi që kjo kategori e shoqërisë sonë të trajtohet me seriozitet dhe me anë të ligjit t'i fitojë beneficinet e merituara.

Projektligji të cilin ne e kemi para vetes ka shumë zbrazëtira dhe mangësi mu për shkak të asaj se ende nuk dihet numri i saktë i atyre që do të përfitonin nga ai. Për shkak të këtyre mangësive dhe zbrazëtirave, ky projektligj nuk ka kaluar edhe në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në parim dhe mendojmë që ka vërejtje edhe prej komisioneve tjera, andaj mendojmë që duhet të kthehet, të plotësohet dhe kjo kategori të trajtohet më me seriozitet për t'i marrë beneficionet e merituar, e pastaj i plotësuar të na vijë për miratim.

Duhet që me kohë të ndahet një vijë buxhetore, në mënyrë që kjo kategori të trajtohet ashtu siç duhet. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë ka kohë që presin njohjen ligjore të statusit të tyre.

Në luftën e fundit në Kosovë, si pjesë e strategjisë së regjimit serb ishte edhe dhunimi seksual, si armë e luftës, sepse në këtë mënyrë regjimi serb e sulmonte qenien tonë kolektive dhe shoqërore në të gjitha dimensionet e mundura.

Këto krime shpesh kryheshin edhe në praninë e familjarëve, në sy të të cilëve po e përdhosnin dinjitetin njerëzor, ku po i nëpërkëmbnin familjet shqiptare nëpërmjet akteve të tilla.

Ndaj personave të dhunuar gjatë luftës është kryer krim i dyfishtë. Krimi i parë ndaj këtyre personave, qofshin vajza, gra apo edhe burra, ka ndodhur në momentin e dhunimit të tyre nga forcat policore, ushtarake e paramilitare të Serbisë. Ndërsa, krimi i dytë ndaj këtyre personave është bërë pas luftës nga institucionet relevante, që në vend të përkrahjes, e kanë heshtur këtë.

Pra, heshtja e krimit përbën krim të ri. Këtu bëjmë pjesë edhe ne, si shoqëri. Duam ta heshtim, sepse e konsiderojmë turp, e kështu krimin e forcave të Serbisë e mbulojmë në heshtje.

Në këtë sens, kjo heshtje shoqërore, politike dhe institucionale vazhdon ta përbëjë mallkimin kryesor të tyre, duke i lënë këto viktima në një situatë pa shtegdalje.

Ato mbeten pa përkrahje, të braktisura në shumë drejtime, madje, siç kanë pohuar disa aktiviste të shoqërisë civile, që u morën me trajtimin e këtyre rasteve, nga shumë prej tyre ishte kërkuar që edhe t'i braktisnin fëmijët e burrat, e të tjera ishin braktisur nga ta, kurse shoqëria ua kishte kthyer shpinën, vetëm pse ishin viktima të përdhunimit.

Para dy javësh, në emisionin “Anima” janë intervistuar disa nga këto viktima të komunës së Drenasit. Dhe, a mund ta imagjinojnë sesi jeton një grua e cila është dhunuar, së cilës ia kanë vrarë burrin dhe e vetme e me shumë plagë e trauma, e përqeshur, e nënçmuar dhe e

izoluar, përpiket t'i rrisë dy fëmijë në një gjendje të rëndë ekonomike. Ato, të cilat mbijetuan, vuajnë tashmë nga sëmundje të ndryshme shëndetësore, vuajnë nga depresioni, steriliteti i përjetshëm, problemet me veshkat, dhimbjet e vazhdueshme të kokës, por jo vetëm kaq.

Ne e kemi iniciuar këtë projektligj dhe është shumë e rëndësishme që i njëjti ta ketë përkrahjen tuaj, të nderuar deputetë, mirëpo vetëm kjo nuk mjafton. Duhet njëherë e mirë ta sqarojmë me veten tonë se fatkeqësia e tyre është fatkeqësi e secilit prej nesh, sepse u ndodhi vetëm e vetëm në emër të të qenët shqiptare.

Plagët në zemrat e tyre janë të pashërueshme, por së paku le të jemi solidarë dhe t'ua zgjatim dorën për të ecur bashkërisht drejt të ardhmes. Le t'ua bëjmë me dije se ne e ndajmë fatin e përbashkët. Le t'u ndihmojmë që drejtësia të vihet në vend.

Kategoria e personave të dhunuar gjatë luftës duhet të normohet, pasi kjo paraqet krim kundër njerëzimit.

Në fund, dua të jua bëj me dije, që sipas informacioneve që i kemi të konfirmuara tashmë, Parlamenti Evropian në raportin e ardhshëm mbi të drejtat e grave në Ballkan, kërkon nga shtetet përmirësimin e pozitës së gruas, ndërkaq një amendament i veçantë është për Kosovën, i cili rekomandon institucionet e Kosovës që ta amandamentojë Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe për familjarët e tyre dhe njohjen e statusit të grave të dhunuara gjatë luftës.

Si shoqëri e kemi për obligim moral kthimin e dinjitetit njerëzor dhe përkrahjen institucionale për këto kategori. Ju ftoj që ta votoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Time Kadriaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sipas dy komisioneve, në të cilat është trajtuar ky projektligj, edhe Komisioni i Shëndetësisë, por edhe Komisioni për Buxhet e Financa e kanë dhënë rekomandimin që ky projektligj të mos kalojë.

Arsyet pse janë dhënë këto rekomandime është sepse kanë kosto buxhetore, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, ky projektligj nuk është hartuar ashtu siç duhet dhe nuk është shumë konkret, në mënyrë që kjo kategori të trajtohet ashtu siç e meriton.

Ne si Grup i Aleancës e kemi trajtuar këtë projektligj dhe jemi që ky ligj sot të kalojë në parim për shkak se nuk është e drejtë që kësaj kategorie t'u mohohet e drejta për gëzimin e beneficioneve dhe trajtimin institucional nga Qeveria e Kosovës. Mirëpo, meqenëse edhe në projektligj është paraparë krijimi i komisionit, është një e mirë, sepse në këtë komision do të ekzistojë mundësia e regjistrimit të kësaj kategorie të grave dhe në

mënyrë ekzakte të dihet numri i grave të dhunuara gjatë luftës, e më pas të vazhdohet me procedurat tjera të trajtimit dhe të kompensimit, ashtu siç e meritojnë.

Ne do ta përkrahim në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji, i cili ka ardhur në procesim në Kuvendin e Kosovës, pa dyshim se i trajton kategoritë më të ndjeshme të vendit tonë, njëkohësisht edhe kategorinë e cila e ka dhënë kontributin më të çmueshëm për lirinë e këtij vendi.

Sa i përket kësaj të dytës, do të thotë dëshmorëve të rënë dhe invalidëve të luftës në vitin e kaluar, ne si komision, mendoj në përgjithësi, pa dallim nga grupet parlamentare, kemi qenë unikë dhe e kemi dhënë kontributin tonë, dhe e kemi dhënë fjalën përfundimtare me atë rast, duke u munduar dhe duke e amendamentuar ligjin e tillë në favor të veteranëve, dëshmorëve dhe invalidëve të luftës.

Por, arsyetimet e Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe kostoja buxhetore e atij ligji, me arsyetimin bazë, do të thotë me vend, arsyetim me vend në mungesë të numrit real të kategorisë së tillë, kanë bërë që ato amendamente nga komisioni të shfuqizohen dhe më pas ligji të kalojë si i tillë, qysh e ka formën në lexim në parim nga Qeveria.

Përndryshe, ne e dimë që komisioni aktual në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës është duke e kryer punën e tij, është duke e identifikuar dhe konstatuar numrin e saktë, faktikisht duke e regjistruar numrin e veteranëve, e më pas do të dalë me të dhëna zyrtare se sa është numri i saktë i atyre që kanë marrë pjesë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Por, sa i përket kategorisë tjetër që përmendet në këtë projektligj, do të thotë viktimave civile, konkretisht grave të dhunuara gjatë luftës, unë nuk besoj që në Kuvendin e Republikës së Kosovës ka ndonjë deputet, ka grup parlamentar që është kundër që t'i ndihmohet kësaj kategorie të ndjeshme, e cila ka pësuar gjatë luftës në Kosovë.

Por, poenta është që të gjendet vërtet saktë, të evidentohet numri i atyre të cilët kanë pësuar nga kjo luftë, e kur jemi te evidentimi i saktë i tyre, unë mund të them me përgjegjësi të plotë morale, si mjek profesionist, është shumë vështirë të vërtetohet një numër i tillë për faktin se nuk ka ekspertizë ligjore gjinekologjike dhe obstetrike, e cila e vërteton saktë se sa ka qenë numri i tyre.

Ky është një fakt tjetër, që na bën të mendojmë përballë këtij ligji, e para. E dyta, e dimë se pjesa dërrmuese e gjinisë femërore, që ka pësuar gjatë luftës në Kosovë, ka ngurruar

dhe vazhdojnë të ngurrojnë të dokumentojnë se ato kanë qenë pjesë e këtij krimi në Kosovë.

Prandaj, duke i pasur parasysh këta dy faktorë, mungesën e regjistrimit të saktë të tyre dhe ngurrimin e tyre që të deklarojnë se kanë qenë vërtet të dhunuara, bën që ne si deputetë të hamendemi dhe të mendojmë pak më larg se kujt në fakt po dëshirojmë t'i ndihmojmë, kujt dëshirojmë t'i çojmë me një fjalë popullore, siç thotë populli ujë në mulli, për faktin se nëse ne e legjitimojmë një ligj të tillë, duke menduar t'u ndihmojmë atyre dhe në fakt nuk u ndihmojmë atyre, se ato nuk po deklarohen, po ngurrojnë të dalin dhe ta marrin ndihmën. Me këtë fakt ne dihet shumë mirë se politikisht po e dëmtojmë kauzën tonë, po e dëmtojmë vendin tonë për faktin se, ne të gjithë e dimë, fatmirësisht edhe opinionin ndërkombëtar e di që në Kosovë ka pasur gjenocid, ka pasur krime, deportime dhe ka pasur dhunime masive seksuale, por me këtë ligj ne do të hapim dyer tjera, të cilat do ta disfavorizojnë situatën tonë politike përballë faktorit ndërkombëtar, duke menduar që do t'i ndihmojmë kësaj kategorie dhe, në fakt, nuk kemi mundësi që t'i ndihmojmë për faktin siç e përmenda më herët, kjo kategori, konkretisht pjesa dërrmuese e gjinisë femërore, që kanë pësuar gjatë luftës, po ngurrojnë të deklarohen dhe ka metodë, apo nuk ka metoda ekzakte për ekzaminimin e vërtetë të tyre.

Unë si deputet i Koalicionit për Kosovë të Re, në parim jam që të formohet një komision brendaqeveritar me evidentimin e saktë të tyre. Prapë po them, është shumë vështirë të evidentohen, por fillimisht të bëhet e njëjta procedurë siç është duke ku bërë me dëshmorët dhe invalidët e luftës, të evidentohet saktë numri i tyre dhe atëherë të gjenden mundësitë dhe ligji që ata të ndihmohen, për faktin se nëse në këtë rast kalon ky ligj, atëherë pa dyshim do të dëmtohet kauza e vendit tonë, do të dëmtohem politikisht para opinionit ndërkombëtar dhe kjo nuk do t'u bëjë nder atyre, po as vetes si shoqëri. Faleminderit!

KRYETARI: SLS, nuk është lajmëruar. “6+” gjithashtu. Tani e kanë radhën deputetët. Kemi të lajmëruar 8 deputetë. Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritjeje i nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndoshta fjala ime do të lidhet konkretisht me fjalën e zotit Kelmendi për shkak se edhe unë jam në të njëjtën vijë me atë që u tha paraprakisht këtu.

Unë mendoj që ne si shoqëri ende nuk kemi statistika të sakta lidhur me viktimat civile të luftë së fundit në Kosovë për shkak se çdo vit variojnë shifra, të cilat ende nuk janë të evidentuara si shifra të sakta të viktimave civile që janë të prekura nga lufta e fundit në Kosovë.

Prandaj, ajo që unë sot dua të them është që të apeloj te shoqatat që t'i ofrojnë të dhënat dhe të gjitha ato institucione që janë marrë me këtë kategori të ndjeshme të shoqërisë të ofrojnë të dhëna të sakta, në mënyrë që ne të kemi mundësi që kësaj kategorie t'i dalim në ndihmë. Edhe ideja ime është që të formohet një komision brenda Qeverisë për shkak

se kam frikë që duke u munduar ta bëjmë një ligj dhe vërtet t'i ndihmojmë kësaj kategorie të shoqërisë, mos po ndikojmë që ky numër i këtyre të rritet për shkak se fatkeqësisht kemi shumë pak viktimë, të cilat janë deklarohen se janë viktimë civile të luftës së fundit në Kosovë. Kjo është fjala ime. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë do të flas shumë shkurt vetëm për dy çështje dhe po flas në emrin tim personal, do të thotë si deputete, e nuk shpreh ndonjë qëndrim të partisë.

Çështja e parë që duhet të sqarohet, sepse i dëgjova një numër deputetësh duke thënë se domosdoshmërisht duhet të përcaktohet numri dhe pastaj të miratohet ligji. Në fakt, nuk funksionon ashtu. Një herë miratohet ligji, pastaj krijohen mekanizmat, siç janë komisionet, shembull, të cilat e përcaktojnë numrin e saktë dhe statistikat e sakta.

Nuk mund asnjë organ qeveritar të veprojë pa ekzistuar baza ligjore për përcaktimin e këtij numri, prandaj unë personalisht e përkrah ekzistimin e këtij ligji.

E dyta, në qoftë se flasim për praktikën ndërkombëtare, këtu do të lidhem me diçka që u përmend më herët lidhur me vërtetimet mjekësore. Zoti kryetar, Tribunali Ndërkombëtar i Hagës, zonjave që kanë dëshmuar si qytetare të Kosovës për dhunimet ndaj tyre, nuk u ka kërkuar vërtetime mjekësore. Prandaj, ne duhet ta kemi parasysh këtë praktikë ndërkombëtare.

Ky është një krim, të cilin nuk duhet ta harrojmë. Ky është një krim të cilin Kosova duhet ta përmendë çdo kund, se Serbia e ka kryer në raport apo ndaj qytetarëve të Kosovës në luftën e fundit që u bë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë jam shumë e shokuar dhe e çuditur se si disa deputetë të Kuvendit të Kosovës ia lejojnë vetes të flasin me një gjuhë të tillë, ta mohojnë një krim tepër të shëmtuar, ndoshta krimin më të tmerrshëm që ka ndodhur në Kosovë gjatë luftës, por krimin i cili ka qenë edhe më i tmerrshëm sa i përket mënyrës se si janë trajtuar këto gra.

Nuk e di se ku këta deputetë e marrin guximin dhe thonë që mos të abuzohet, të mos dalin me qindra-mijëra gra dhe të deklarohen në mënyrë të rrejshme se qenkan të dhunuara. A jetojnë në Kosovë këta deputetë, apo jo? A kanë folur ndonjëherë me ndonjë grua të dhunuar gjatë luftës?

Ju garantoj se duhet të punohet shumë e shumë me ato gra, në mënyrë që ato ta krijojnë një lloj besimi për ta rrëfyer historinë e tyre dhe për të përfutur. Në rast se këto gra do të ishin nga ato që vrapojnë për të përfutur, me siguri se këtë do ta kishin bërë shumë më përpara.

E vërteta është që ato ngurrojnë, janë të diskriminuara nga shoqëria, janë të diskriminuara nga paragjykimet e kësaj shoqërie dhe, mbi të gjitha, janë të diskriminuara nga institucionet, të cilat deri më sot nuk kanë bërë asgjë.

Nuk e shoh të rastit që edhe në ligjin, i cili u përgatit për viktimat e luftës, nuk u fut kjo kategori.

‘Anapullat’ e tilla, si krijime komisionesh e tjera, pse nuk u bënë këto më përpara, përpara se të miratohej Ligji për invalidët e luftës? Është e njëjta procedurë që duhet të ndiqet. Sot e shohim një komision në të cilin vrapojnë me qindra-mijëra njerëz, të cilët pretendojnë se janë veteranë të UÇK-së, ndërkohë është e habitshme se si një kategori kaq të diskriminuar t’i mohohet e drejta që së paku të përfitojë diçka të vogël financiarisht, e cila kurrësi nuk ua kompenson dhimbjen dhe humbjen e madhe që i kanë pësuar këto viktima. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni fillimisht të ju informoj se flas në emrin tim personal dhe në këtë çështje distancohem nga qëndrimi i Grupit tim Parlamentar dhe qysh në fillim dëshiroj të them se dëshiroj të jua lexoj arsyetimin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, i cili propozon që këtë projektligj të mos ta votojmë dhe i cili e arsyeton vendimin e tij, duke thënë se projektligji i propozuar e trajton një çështje të ndjeshme dhe shumë komplekse dhe nuk ofron një zgjidhje të plotë të problematikës së trajtuar.

Natyrisht se kjo është një çështje shumë e ndjeshme dhe shumë komplekse. Por, ne duhet ta trajtojmë, ta shqyrtojmë dhe të gjejmë zgjidhje. Ne për atë edhe jemi këtu, jemi institucion legjislativ dhe duhet të punojmë në këtë drejtim.

Unë personalisht kam kontakte me gratë të cilat janë viktima dhe kanë qenë të dhunuara gjatë luftës dhe sikur të kishit pasur edhe ju kontakte me ta, atëherë me siguri se do ta kishit pranuar këtë propozim të paraqitur nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

Gjendja e tyre shëndetësore, gjendja e tyre psikike tregon se kanë nevojë për ndihmë urgjente, e jo që ky ligj aq i rëndësishëm, apo të them ky propozim-projektligj të anashkalohet në këtë mënyrë, qysh e shoh unë në këtë sallë që është kah mundohet të bëhet, që të mos votohet.

U tha këtu se nuk ekziston numri i saktë i femrave të dhunuara, ku ka edhe burra besa, e numrin e saktë, nëse na shohin nëpërmjet televizionit, natyrisht se nuk do ta kemi asnjëherë, sepse po shihet që nuk ekziston përkrahja për to dhe natyrisht se do të hezitojnë të lajmërohen.

E dyta, u tha se nuk ka metodë ekzakte për ekzaminimin e dhunimit, me çka nuk pajtohem. Është pak më vështirë të dëshmohet, mirëpo mund të dëshmohet nëpërmjet dëshmitarëve, prandaj një deklaratë e tillë nuk qëndron, apo një arsyetim për të mos u votuar ky projektligj nuk qëndron.

Prandaj, në këtë drejtim mendoj se është dhënë një propozim i qëlluar, mendoj se duhet ta përkrahim dhe unë personalisht do ta përkrah këtë propozim-projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet ministre,

Vërtet, Kuvendi i Kosovës ka trajtuar shumë çështje të rëndësishme, po një nga më të rëndësishmet është edhe çështja e dhunës seksuale, që është bërë gjatë luftës nga policia dhe ushtria serbe, prandaj të kërkohet që të mos mbështetet kjo kategori është një absurditet i llojit të vet, që e bën edhe Kuvendi në këtë radhë. Deputetët, të cilët nuk e tregojnë ndjeshmërinë, as përgjegjësinë e tyre, po ikin ndoshta në rrethana të caktuara politike, por megjithatë duhet të trajtohet kjo çështje, sepse ne kemi të bëjmë me një kategori shumë të ndjeshme të dhunës seksuale, që është bërë ndaj motrave, nënave e grave tona, prandaj ne mund të falim shumë sende, mund t'i falim Serbisë shumë sende, por nuk mund t'ia falim dhunën seksuale që na e ka bërë dhe torturat që i ka bërë ndaj nesh.

Prandaj, unë e mbështes iniciativën që edhe kjo kategori të mbrohet, jo me një shpërblim, se një shpërblim i tyre me çfarëdo çmimi që do të jetë nuk është një çmim që do t'i lehtësojë ato, por mbrojtja me ligj e kësaj kategorie do të thotë që Kuvendi i Kosovës, deputetët, qytetarët, krijojnë vlera për mbrojtjen e kategorive të njerëzve, të cilat kanë pësuar gjatë luftës.

Kjo është një kategoria më e ndjeshme, më e pambrojtur, sikur kanë qenë edhe të burgosurit që kanë qenë kategori e pambrojtur.

Prandaj, këto kategori duhet të mbrohen me ligj dhe duhet t'i tregohet Serbisë se ka bërë krime, ka bërë dhunë dhe këto nuk harrohen, dhe nuk do të kalohen, sepse nëse ne i tejkalojmë sot, atëherë kjo do të na përsëritet vazhdimisht.

Unë e mbështes edhe deputeten Vjosa, kur i përmendi ato dëshmitë e Hagës dhe këtu nuk kërkohen receta apo ekzaminime, por këtu kërkohet dëshmi dhe këto dëshmi i kemi me shumë fakte dhe rrethana, të cilat i kanë njerëzit që kanë qenë pjesë e asaj kohe, ose dëshmitarë të rasteve të ndryshme, të cilëve duhet t'u jepet mundësia ta dëshmojnë dhe të tregojnë një mbrojtje, sepse ne e mbrojmë një vlerë, e mbrojmë nënën tonë, e mbrojmë edhe të ardhmen tonë, familjet tona. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryetar!

Në parim nuk dua të replikoj, sa dua të sqaroj edhe bashkëkolegen e Grupit Parlamentar, deputeten Novobërdaliu, por edhe deputeten Vjosa Osmani. Unë thashë dhe në pajtim këto u pajtuan që as Tribunali i Hagës nuk kërkon dëshmi mjekësore, ndërsa deputetja Novobërdaliu tha se ka metoda mjekësore, por në parim doli se ka dëshmitarë. Tjetër është metoda mjekësore, tjetër janë dëshmitarët.

Tash dua të dal te kauza në aspektin profesional. Nuk ka metodë ligjore obstetrike gjinekologjike për dikë që është dhunuar para 13 vjetëve. Dëshmitarët janë. Kur jemi te dëshmitarët, arsyeja është, ne në komision kemi qenë unik dhe unë e thashë edhe më herët, po e them prapë, nuk ekziston një deputet që nuk dëshiron t'i ndihmohet kësaj kategorie, po këtu është problemi ndryshe, se unë fola me një gjuhë politike, tash po më duhet të bie në nivelin popullor. Nëse ne këtë ligj e miratojmë, e funksionalizojmë dhe kërkohet legjitimimi apo konfirmimi i atyre grave të dhunuara, dy apo tre dëshmitarë, në këtë rast a mendoni se mund të na paraqitet tjetërkush në vend të atyre që vërtet janë dhunuar. Kjo ka qenë dilema jonë në Komisionin për Shëndetësi. Do të marrë tjetërkush merita në vend të atyre që vërtet e meritojnë. Kjo ka qenë dilema jonë kryesore.

KRYETARI: Ju lutem, ne e dëgjuam! Fjalën e deputetja Suzan Novobërdaliu, replikë.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Kryetar!

Unë shumë qartë e thashë që nuk është gjë që nuk mund të dëshmohet. Nuk flas për ekzaminime mjekësore, flas për dëshmitarë, duke e ditur mënyrën sistematike të dhunimit të grave, domethënë grumbullimi i grave dhe vendosja në ndërtesa si janë vendosur më herët, mirëpo nuk e shoh disponimin për ndihmë me metodat e shtypjes së butonit për jo. Kjo nuk është ndihmë për to.

KRYETARI: Replikë, deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

E kërkoja fjalën edhe një herë për shkak se si duket edhe kësaj radhe, edhe sot kur ne po diskutojmë për viktimat civile, për një kategori jashtëzakonisht të ndjeshme, mikrofonit dhe foltoret e Kuvendit po shfrytëzohen për përfitime politike dhe unë po e them publikisht se më vjen shumë keq për shkak se zona dhe vendi prej nga unë vij, është zona që është më e prekura nga lufta e fundit dhe unë jam e vetëdijshme për viktimat e dhunës që ndodhin, që vijnë nga komuna ime dhe në gjithë Kosovën, mirëpo askush nuk e kontestoi çështjen e Ligjit dhe të mirat që ky ligj i ofron për të gjitha këto viktima civile. Mirëpo, të gjithë ne si deputetë, që këtu diskutuam, ishte çështja se ne ende nuk posedojmë statistika të sakta lidhur me këtë kategori dhe kërkoj që të mos keqpërdoret mikrofonit edhe sot kur po diskutojmë për gratë e dhunuara, që janë jashtëzakonisht të ndjeshme për shoqërinë tonë.

KRYETARI: Deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që këtu pati shumë kolegë deputetë në kuptimin e asaj që dikush ishte pro, dikush ishte kundër këtij projektligji. Është një ligj shumë i veçantë dhe një ligj që kërkon që kjo kategori e veçantë të mbrohet me legjislacion. Unë e përcolla me vëmendje kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili deklaroi se ky ligj është i pamundur që të implementohet në praktikë. Prandaj, unë mendoj se nëse ne e aprovojmë një ligj të tillë në parim, realisht i mashtrojmë krejt kategoritë e veçanta të cilat kanë nevojë shumë për mbrojtjeje. Nëse në praktikë nuk implementohet dhe siç shihet në kornizën afatmesme 2013-2015 nuk ka para, një ligj i tillë do të jetë i pamundur që të jetë afër dhe njëkohësisht t'i mbulojë kërkesat e kësaj kategorie, prandaj është bërë shumë politikë në kuadër të saj, sepse unë mendoj që asnjë deputet, asnjë grup parlamentar, asnjë parti politike nuk është kundër këtij ligji, por duhet të shikohet mirë dhe saktë se a mund të jetë apo nuk mund të jetë i implementueshëm.

Nga Komisioni Funkcional është deklaruar dhe është kërkuar që të kthehet edhe një herë, të përpunohet edhe një herë, t'i përfshijë të gjitha kategoritë më specifike dhe prandaj të silltet edhe një herë në Parlament dhe të bëhet aprovimi i një ligji të tillë. Prandaj, do të ishte mirë që sa më pak të ketë fjalë, sepse po e shohë që shumë deputetë janë të interesuar për të diskutuar për këtë projektligj, por kërkoj që edhe një herë të shihet mundësia e implementimit nëse do të implemtohet apo nuk do të implemtohet. Faleminderit!

KRYETARI: Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Vërtet kam menduar që kur të silltet ky ligj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, shumica e deputetëve, të mos them të gjithë, do të jenë për të, e sigurisht se do t'i kenë edhe vërejtjeje e veta dhe mënyrat e veta se si duhet të trajtohet kjo çështje, por që do të jetë dikush që mendon se kjo çështje do të shtyhet, ose të mos trajtohet fare, këtë nuk e kam pritur. Por, ja që paskam gabuar për shkak se këtu të gjithë e dimë dhe të gjithë e thanë në njëfarë mënyre që e dimë se dhunimet që kanë ndodhur gjatë luftës në Kosovë kanë qenë speciale e luftës, pra ka qenë pjesë e luftës kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, segmenti i luftës speciale kundër nesh.

Pra, nuk ka qenë shfrenim i disa ushtarëve që kanë mundur të jenë të dalë nga burgjet Serbi, e kështu me radhë, por ka qenë një program i planifikuar dhe i centralizuar shtetëror me qëllim që ta sulmojë fibrën shoqërore të popullit të Kosovës, të organizuar atëbotë rreth strumbullarit të solidaritetit të bashkimit dhe rezistencës e luftës kundër okupatorit.

Por, ky ka qenë qëllimi i kësaj lufte speciale në Kosovë dhe këtë e ka bërë me planifikim shteti serb nëpërmjet policisë së vet, nëpërmjet ushtrisë së vet, nëpërmjet trupave paramilitare që i ka dërguar në Kosovë dhe të tjerëve. Dhe, tash ne këtu po diskutojmë pikërisht për plotësim-ndryshimin e një ligji, i cili ua njeh kategorive të ndryshme të dëmtuara gjatë luftës të drejtën e kompensimit. Pra, jo vetëm kompensimit financiar, por kompensimit në përgjithësi.

Me ligj, ne ia njohim si shoqëri një sakrificë dhe një dëmtim që i është bërë dikujt gjatë luftës dhe këtë në njëfarë mënyre ia shpërblejmë dhe shpërblim nuk është vetëm financiar. Bile mendoj që komponenti financiar është çështja e tretë, por janë edhe dy çështje tjera, të cilat shteti dhe shoqëria e Kosovës ua ka borxh, më së paku thënë, këtyre personave, të të dëmtuarave gjatë luftës, dëshmorëve, familjeve të tyre, invalidëve të luftës, veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të burgosurve politikë dhe grave e vajzave të dhunuara gjatë luftës, për të cilat sot po flasim në këtë seancë.

Pra, për mendimin tim, janë 3 lloj kompensimesh. Një çështje që kisha dashur ta ngre, e për këto kompensime do të flas më vonë, është që i dëgjova këtu disa deputetë, bile edhe arsyetimin e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i cili thotë se ligji nuk ofron zgjidhje. Unë mendoj që e kemi një perceptim të gabuar të asaj se çka duhet të bëjë ligji. Ligji normon nga asketi juridik korniza brenda të cilave pastaj gjenden zgjidhjet, ligji nuk ofron zgjidhje. Ligji nuk është teknik, që thotë bëja kështu edhe të del kështu. Ligji e normon një të drejtë dhe ia vendos kornizat ligjore asaj të drejte, të cilën duhet ta gëzojë secili qytetar, e pastaj janë organet tjera, të cilat e gjejnë zgjidhjen përbrenda kësaj kornize legjislative. Në këtë rast Ekzekutivi, por edhe institucionet tjera, të cilat i prek ligji.

Dhe, në përgjithësi, ligji është për këtë, që ta krijojë një rrethanë të re në sfondin e të drejtave, përgjegjësi, obligimeve që i ka pushteti karshi qytetarëve, por veçanërisht qytetari karshi shtetit të vet. Ndërkohë, këtu tash po kërkojnë që me ligj të ofrohet zgjidhja. Pra, teknikisht të rregullohet kjo çështje, po kjo nuk është çështje teknike. Edhe ligji nuk duhet ta trajtojë në këtë mënyrë fare. Mendoj që janë tri lloj kompensime sh që duhet t'ua japim këtyre kategorive.

Kompensimi i parë është ai shoqëror, veçanërisht është i rëndësishëm për këtë kategori për të cilën po flasim sot. Pra, shoqëria duhet ta njohë këtë si krim dhe ta luftojë atë, në vend se që t'ia sigurojë këtij krimi jetëgjatësinë. Pra, ta shndërrojë krimin, siç e kemi shndërruar deri tash, në një përditshmëri e cila u vjen vërdallë përditë këtyre viktimave dhe të cilat madje edhe janë të ndrojtura ta përmendin atë për shkak se shoqëria nuk e pranon. Mendoj se ky ligj do ta ndihmonte që ta thyejmë këtë qasje që e kemi aktualisht karshi këtyre personave.

I dyti është kompensimi politik dhe juridik. Pra, masat e organizuara shtetërore që duhet t'i ndërmarrë Kosova për dënimin e këtij krimi, dënimin e këtyre kriminelëve dhe kërkimin e drejtësisë për këto viktima gjithandej nëpër botë. Nëse ne nuk e njohim këtë si krim në ligjet tona, atëherë në njëfarë mënyre po ia ndihmojmë Serbisë që ta fshehë këtë krim, të cilin e ka kryer tashmë në Kosovë, e nuk mund t'i flasim askujt për këtë krim që e ka kryer Serbia në Kosovë për shkak se në vetë ligjet tona nuk e kemi normuar si krim, pra nuk e njohim si të tillë me dokumentet tona juridike.

Dhe, kompensimi i tretë është ky financiar, për të cilin u fol këtu shumë. Pra, u fol që nuk ka para, do të na kushtojë shumë shtrenjtë, nuk e dimë sa persona janë, do të bëhet Komisioni, e kështu me radhë. Në secilin praktikë, dhe këtu pajtohem plotësisht me deputeten Vjosa Osmani, pa e pasur një bazë ligjore nuk mund të krijojmë komision, e

kur ta kemi bazën ligjore pastaj krijohet komisioni, i cili sigurisht se do ta verifikojë numrin e këtyre personave për aq sa e ka të mundur ta bëjë këtë në mënyrë objektive.

Pra, dhe çështja e dytë është e shumë e çuditshme qysh nganjëherë për disa raste dhe për disa kategori, fjala e parë që na bie ndërmend në Kuvend është që nuk ka para, ndërkohë që për disa gjëra tjera përherë ka para. Bile ka ma shumë sesa duhet! Për luksin e pushtetit, për të ardhurat e tyre, përherë po i gjejnë paratë, madje edhe për të ardhurat tona si deputetë. E, kur vjen puna për personat e rrezikuar, për ata nuk po kemi para. Pra, e kemi nisur nga kjo logjikë se për gratë e dhunuara nuk ka para, nesër do të themi as për veteranët e luftës nuk ka para, pasnesër do të themi pensionistët nuk duhet të hanë se nuk ka para, dhe pastaj do të themi që edhe personeli shëndetësor dhe ai i arsimit publik nuk duhet të hanë se nuk kanë para dhe ku do të përfundojë kjo? Pra, kur do të ketë para edhe për popullin, përveç se për institucionet. Kjo është një pyetje shumë e rëndësishme.

Dhe, e dyta, ta zëmë që nuk paska para, se në njërën anë komisioni thotë që nuk dihet numri i sakët i këtyre viktimave, ndërsa në anën tjetër thotë që nuk kemi para se kjo kushton 74 milionë. Bazuar në çka? Bazuar në cilin numër? Pra, a po u ditka numri, apo nuk po u ditka numri? E nëse nuk dihet numri, si e kanë llogaritur këtë 74 milionë. Kah erdhi ky? Ndonëse duhet ditur numrin e njerëzve dhe nga sa i marrin në muaj për ta ditur se sa do t'i paguajnë në muaj. Nëse nuk e dinë numrin e njerëzve, atëherë ky x ta pamundëson rezultatin e ekuacionit, apo jo? Çështja tjetër, nuk po flitet këtu për nivelin e pensionit, se mund të thotë dikush që kompensimi që është propozuar në ligj mujor është shumë i lartë, ta zëmë. Nuk ka para për aq shumë të lartë, mund ta kemi shumën më të ulët, apo mund ta kemi shumë të ulët vetëm sa, në njëfarë mënyre, ta njohim krimin që është bërë ndaj tyre dhe si shoqëri të ndihemi përgjegjës karshi këtij krimi. Por, nuk po thuhet ashtu, po hedhet poshtë tërësisht ligji, vetëm e vetëm me arsyetimin se nuk paskemi para për ta zbatuar.

Dhe, çështja e fundit që dua ta ngre është ajo që i dëgjova nga disa deputetë këtu, që mendoj që përveçse se janë të pavërteta, janë edhe shumë perverse për t'i menduar. Pra, u tha që kjo e drejtë, në njëfarë mënyre nuk duhet të sanksionohet me ligj për shkak se pastaj ekziston mundësia e abuzimit të kësaj të drejte. Pra, në njërën anë mendoj që për secilën të drejtë dhe për secilin ligj ekziston mundësia e abuzimit, e nëse nisemi nga ky parim, ne kurrëgjë hiç nuk duhet të kalojmë këtu, se të gjitha ato mund të abuzohen nga dikush, apo jo? Por, në anën tjetër, mendoj që kur po flasim për kategoritë e veçanta edhe të zihet mundësia e abuzimit të këtyre të drejtave që po ua japim ne, mendoj që është një mendim në kokat e disa deputetëve që qytetarët e Kosovës janë vërtet të prishur në mendje dhe mezi presin që ta kenë një mundësi për të abuzuar diçka. Pra, e kanë ë keqkuptuar pushtetarin me qytetarin. Pushtetari është i tillë, por jo qytetari, prandaj e mos i përzhini këto dy gjera. Qytetari nuk është me mendje të korruptuar. Fatkeqësisht të gjithë ata që kanë qenë me mendje të korruptuar i kemi këtu prapa, por atje jashtë nuk janë. Prandaj, çlirohuni nga kjo mendësi. Mos i barazoni këto të dyja. Faleminderit!

KRYETARI: Donika Kada-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADA-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që u tha ajo çfarë e pata mendjen ta them, por veç të shtoj që ka tepër shumë vende ku duhet të kursejmë në institucionet e Kosovës dhe ndoshta vendi ku nuk duhet të kursejmë janë pikërisht tragjeditë që u kanë ndodhur vajzave dhe grave të Kosovës gjatë luftës së fundit. Prandaj, është e tepërt që po flasim për koston e projektligjit në fjalë, i cili, në fakt, as nuk po dihet. Edhe e dyta, për t'i hequr dilemat, u fol shumë për verifikim, si do të verifikohen viktimat. Ekzistojnë të dhëna të sakta, informata të shumta të cilat janë dhënë nga vetë viktimat, qoftë nëpër gjykata vendore, qoftë nëpër ato ndërkombëtare.

Por, edhe nëpër shënimet e tjera, siç janë librat të cilët i përmbajnë të dhënat e sakta, vendet e dëshmitarët në ngjarjet e tmerrshme, të cilat mund të verifikohen shumë lehtë, prandaj as kjo nuk është një shqetësim për të cilin ishte dashur sot të diskutojnë deputetët. Unë pajtohem, ashtu si shumica e grave në këtë Kuvend, që në fakt ne duhet ta kalojmë ligjin në parim dhe pastaj me një punë të jashtëzakonshme të arrijmë që ky ligj të jetë i zbatueshëm dhe këto viktima të kompensohen, edhe pse dhimbjet dhe vuajtjet e tyre nuk do të kompensohen nga çfarëdo ndihme materiale që u jepet. Duhet të kemi parasysh se ato dhe familjet kanë nevojë edhe për rehabilitim tjetër, përveç aspektit material. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo çka rastësisht më shqetëson në kuadër të këtij projektligji, apo që parashtruesi e ka parashtruar në këtë rast, është tentativa për përfitime politike në tragjedinë e dikujt tjetër. Përfitimi politik në emër të një akti të dhunës, i ushtruar nga pushtuesi, dhe 13 vjet pas luftës tentativa për të përfituar politikisht, duke tentuar të implementohet ky përfitim politik me anë të një ligji apo plotësim-ndryshim të një ligji për familjet e dëshmorëve, invalidët, veteranët dhe viktimat civile të luftës, është paturpësia më e madhe e parashtruesit të kësaj nisme për ndryshim-plotësimin e këtij ligji.

Gjithsesi, dhimbja e të gjithë neve si deputetë dhe ndjenja dhe obligimi, së pari si institucionalist, është që këto kategori të trajtohen dhe të trajtohen veçanërisht me një ligj të veçantë, ku do të trajtoheshin të gjitha këto gra të dhunuara gjatë luftës. Mirëpo, kompensimi pastaj do të kërkohet me anë të atij ligji të veçantë dhe kompensimi do të kërkohet nga ushtruesi i dhunës, nga abuzuesi me mjetet, të cilat i ka përdorur gjatë kohës së luftës dhe ky kompensim do të duhet të parashatrohet gjithsesi në formë të organizuar në gjykatat kompetente ndërkombëtare, në Gjykatën e Strasburgut. Dhe kompensimi do duhet të kërkohet nga ata të cilët i kanë udhëhequr në mënyrë të organizuar këto dhunime të femrave gjatë luftës, por assesi nuk guxojmë të tentojmë të përfitojmë politikisht nga tragjedia e të tjerëve, në emër të përfitimeve politike.

Kërkoj nga parashtruesi, do të ishte morale që vetë ai të bënte tërheqjen e këtij projektligji për arsye të qëllimeve, të cilat i ka. Nuk mund të përfitohet në dhimbjen e dikujt tjetër politikisht. Është e pamoralshme, nuk është etike, nuk është morale. Do të ishte mirë që ky, nëse ekziston një gatishmëri, por edhe e kolegëve deputetë, të cilët e kanë parashtruar

këtë nismë ligjore, që të fillojnë një nismë të re, dhe ajo nismë t'i dedikohej vetëm kësaj kategorie dhe në kuadër të asaj nisme pastaj të kërkoheshin edhe kompensimet konform legjislacionit ndërkombëtar, e jo në këtë formë të parashtrohej dhe të abuzohej në emër të familjeve të dëshmorëve, në emër të viktimave të luftës, në emër të invalidëve-veteranëve, të ndërtohej të krijohej një kolaps shtetëror dhe të krijohej një mekanizëm, një precedent dhe ne të krijojmë një ligj, i cili është i paimplementueshëm. Derisa Komisioni Funkcional, në këtë rast, dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka dhënë miratimin për këtë ligj, dhe ky projektligj në fakt nuk ka as deklaratë financiare nëpërmjet së cilës do të bëhet implementimi i tij, mendoj se është i pajustificueshëm trajtimi apo votimi i tij. Faleminderit!

(Mbledhjen e merr nën drejtim nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rita Hajzeraj-Beqaj e ka fjalën

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë po flas në emrin tim personal.

Sa i përket çështjes së grave të dhunuara, na e dimë shumë mirë se sa herë përmendet kjo fjalë, çdo herë ne i hapim plagët e atyre grave.

Nën 1, nëse ne nisemi nga mentaliteti i popullit tonë dhe i shoqërisë sonë, prapëseprapë kjo çështje nuk mund të vijë aty ku ne po dëshirojmë. Sa i përket termi që ta futim në ligj si gra të dhunuara, unë jam kundër këtij termi dhe jam që ta futim si viktimë të dhunës, sepse edhe përdhunimi është dhunë dhe në kuadër të kësaj edhe gratë tona, gratë kosovare, mund të lajmërohen a mund të paraqiten shumë më lehtë se sa si gra të dhunuara.

Në bazë të disa statistikave të një agjencie, e cila ka bërë hulumtim në Bosnjë, ku ka ndodhur i njëjti fenomen sikur ka ndodhur te na, thuhet që 90% e femrave, të cilat janë deklaruar si të dhunuara, ato femra janë injoruar nga mentaliteti i shoqërisë së tyre dhe shumica e tyre tash jetojnë jashtë shtetit. Kështu që të mos vijmë deri te kjo, unë propozoj që kjo kategori të quhet si viktimë të dhunës në ligj dhe shteti shumë më lehtë mund t'i identifikojë ato viktimë, pa i quajtur si gra të dhunuara, sepse deri më sot statistikën tregojnë që vetëm ato të cilat janë deklaruar që janë të dhunuara, nuk e arrijnë as numrin 2 000, ndërsa e dimë që në Kosovë ka shumë më shumë gra të dhunuara, të cilat sot janë nëna, të cilat kanë krijuar familje, të cilat as nuk duan që çështja e tyre të hapet prapë. Edhe sikur të çohet shteti me benificionet më të mëdha t'u japë këtyre grave, prapëseprapë dhimbja dhe vuajtja e tyre nuk mund t'u hiqet. Prandaj, trajtimi më i mirë ndaj kësaj kategorie është që këto gra të hyjnë në kategorinë e viktimave të dhunës, e jo si gra të dhunuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Zoti Zemaj e ka fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Unë, për dallim edhe nga shumëçka çfarë u tha, ndoshta edhe për dallim edhe nga vetë qëndrimi i shprehur i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, më lejoni të theksoj se ndoshta sot është dashur që Kuvendi i Kosovës apo institucionet e Kosovës të kërkojnë falje publike dhe të tregojnë që ne jemi shumë të vonuar në këtë aspekt për trajtimin e kësaj çështjeje, që edhe nga vetë komisionet parlamentare quhet e ndjeshme. Por, unë besoj që më e ndjeshme është që të fshihet krimi i ndodhur në Kosovë, një krim që ka qenë mirë i organizuar dhe ka qenë i organizuar për qëllime të spastrimit etnik edhe nëpërmjet formës së dhunimit që ka ndodhur ndaj popullit shqiptar, por pa i anashkaluar edhe rastet tjera që mund të jenë të përfshira.

Kolegë deputetë,

Katër konventa të Gjenevës për të drejtën e luftës e përcaktojnë qartë kategorinë e femrave të dhunuara si viktime të luftës dhe këtu nuk ka dilemë. Sot edhe vetë zëvendëskryeministri i Kosovës e tha se e drejta ndërkombëtare është mbi të drejtën vendore dhe ne mund të bazohemi konkretisht në këto konventa, në këto ligje ndërkombëtare për kategorizimin e kësaj të keqeje që i ka ndodhur vendit tonë dhe qytetarëve tanë. Prandaj, mua më duket sot anomali që të kemi arsyetime, edhe financiare, edhe mjekësore, edhe çfarëdo qofshin për identifikimin e këtyre rasteve dhe rehabilitimin e këtyre qytetarëve, qytetareve, motrave, grave, nënave, që kanë ndodhur gjatë luftës së fundit. Dhe, ngritja e këtyre paralelizmave mendoj se është shumë absurde. Si mund të kemi ne identifikim, si mund të kemi statistika kur nuk kemi legjislacion? Kjo është pyetja dhe a domethënë se me votimin e parë mbaron e tërë puna? Nuk mbaron. Cila është detyra e komisioneve funksionale, e komisionit i cili e trajton? A e kanë të ndaluar ata plotësim-ndryshimin e mëtutjeshme të këtij propozimi që është dhënë në ndryshimin këtij projektligji? Mendoj se jo. Rregullorja e punës e përcakton edhe terminologjinë, nëse dikush dëshiron ta ndryshojë.

A e ka të përcaktuar nxjerrjen e kostos buxhetore dhe komisioni kryesor. Ne sot kemi paragjykim për shifrën e paraqitur dhe besoj që, kolegë deputetë, kjo është tepër skandaloze që ne të kemi arsyetime të tilla, krahasime të tilla në bazë të paragjykimeve. Ajo çka dihet, është që kjo ka ndodhur në Kosovë dhe duhet të ketë vullnet për ta trajtuar këtë çështje. E thashë edhe një herë, po e përsëris, jemi të vonuar në trajtimin institucional të kësaj çështjeje. Nuk mund të lejohet që organizatat joqeveritare dhe organizatat e ndryshme të merren me këtë çështje, por duhet që institucionet e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe, e fundit, cila është përgjegjësia para shtetit që nesër ne do të kërkojmë kompensim? Cila është përgjegjësia e institucioneve të Kosovës, e shtetit të Kosovës, para shtetit serb?

Ne sot po fshihemi nga e keqja, po tentojmë të fshihemi nga e keqja që na ka ndodhur, duke marrë parasysh që na vijnë propozime, çfarëdo qofshin, me arsyetime të keqpërdorimeve. Prandaj, unë ju kisha lutur që me gjakftohtësi ta trajtojmë këtë temë, jo duke e fshehur krimin, çfarëdo krimi qoftë, por duke e deklaruar krimin këtu dhe duke i dhënë hapësirë ligjore trajtimit të kësaj çështjeje. Dhe, mendoj që institucionet i bëjnë nder vetvetes dhe i bëjnë nder edhe asaj te keqeje shumë të keqe, duke e rregulluar në mënyrë ligjore e specifike që të ndahet e mira prej të keqes që ka ndodhur këtu. Prandaj, të mos kemi dilema ndërmjet nesh se kush mund të dalë në mbrojtje, a kush nuk mund të

dalë në mbrojtje. Kjo është një e keqe e përgjithshme dhe të gjithë bashkë duhet ta trajtojmë njësoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Rekomandimet e komisioneve përkatëse që të mos aprovohet ky ligj në parim në pamje të parë mund të duken si indiferencë, por kjo nuk është indiferencë, përkundrazi është një kujdes shumë i mbretë i këtyre dy komisioneve dhe mbështetësve të këtyre dy komisioneve, pra një kujdes i veçantë që të mos trajtohet kjo temë tani.

Në këtë rast, Qeveria nuk po donë të paguajë për viktimat në fjalë, por viktimat tashmë po e paguajnë atë çfarë ka bërë krimi ndaj tyre.

Krimet e Serbisë në Kosovë, normalisht që duhet të vazhdohet të dënohen edhe me ligj dhe normalisht, paraprakisht duhet të normohen kategoritë si viktimat e këtij krimi të Serbisë.

Heshtja e Qeverisë nuk i bën të heshtura traumat e viktimave apo traumat që kanë viktimat.

Ekzaminime gjinekologjike u dëgjua këtu, mungesë e statistikave, pastaj edhe rritja artificiale e mundshme e numrit, krijimi i komisioneve, pastaj e përmend se nuk duhet të trajtohet kjo tanimë se është çështje e ndeshme, janë vetëm disa prita që i vihen si arsye për të mos kaluar ky ligj.

Edhe një herë, zonja dhe zotërinj deputetë,

Ne duhet ta dimë që nuk është turp për ata ndaj të cilëve është shtruar dhunë, por është turp për ata të cilët nuk e identifikojnë këtë dhunë dhe trup për ata të cilët nuk e demaskojnë këtë dhunë, respektivisht nuk përkrahen viktimat e dhunës.

Te kërkesa për ekzaminime mjekësore, normalisht se nuk mund të ndihen të qetë të gjithë ata që e ndjejnë nga larg e domosdoshmërisht edhe viktimat e kësaj dhune, pra, nuk mund të ndihen të qetë kur përmendet ekspertiza gjinekologjike e viktimave në këtë rast.

Po, a ju kujtohet në publikime të ndryshme që a ka mund dikush t'ia bëjë ekspertizën gjinekologjike një vajze në Gjakovë, e cila pasi është dhunuar është vrarë? Në këtë rast, për fat të keq, më shumë po flet një viktimë e vrarë se sa një viktimë e mbijetuar.

Kryetari i Komisionit për Shëndetësi me entuziazëm shumë të madh doli kundër këtij ligji, madje ai u kujdes edhe që ta arsyetojë kundërshtimin e tij. Nuk e di se në kohën kur ka ndodhur kjo luftë kah ka qenë i rreshtuar ai po i them sot se sot është rreshtuar shumë gabimisht.

Për atë çka di opinioni i brendshëm dhe i jashtëm janë diku rreth 20 mijë femra, në këtë rast, të identifikuar si viktimat të dhunës seksuale ndaj tyre. Nuk mund të jemi i saktë për shkak të specifikave që paraprakisht nuk është vënë.

Por, është një statistikë tjetër që po del në dukje tani, është statistika e aplikuesve për veteranët e luftës dhe aplikacione më shumë se 50 mijë janë tërhequr, këtu po dinë, tregohemi të kujdesshëm që të përfitojmë nga të qenit veteranë dhe nuk po jemi së paku kaq bujarë që së paku ne veteranët të lëshojmë radhë që fillimisht nëse është për t'u shpërblyer, le të shpërblehen viktimat e krimit serb.

Siç tha edhe kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk është thjesht çështja e shpërblimit material, normalisht edhe unë dua ta rikujtoj edhe një herë që çështja e shpërblimit apo e rehabilitimit financiar do të renditej së paku e treta. Por e para do të duhej të ishte një solidaritet më i madh me viktimat, pastaj bashkë me të edhe dënimi i atij krimi që këto edhe këta njerëz i ka kthyer në viktimat.

Më mirë tek e fundit të përfitojmë politikisht duke i mbrojtur viktimat, gjë që nuk është qëllimi i yni, sepse po të ishte një përfitim politik do ta bënte Qeveria këtë para nesh. Pra, më mirë të përfitojmë politikisht duke i mbrojtur viktimat se sa duke i ridhunuar psikikisht ato. Mungesa e respektit për viktimën është respekt për dhunuesin.

Pra, ne para se të jemi kaq të kujdesshëm për dhunuesin do të duhej të ishim shumë më të kujdesshëm e aq më tepër të ndjeshëm për të dhunuarit.

Në këtë rast ftoj, i edhe një herë deputetët që ta përkrahin këtë ligj në parim në lexim të parë dhe prej sot e deri në lexim të dytë të japim kontributet tona si gjëja më e vogël që ne mund dhe duhet të bëjmë për viktimat e luftës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë e ka fjalën Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, nënkryetar!

Veç ta sqaroj një çështje, këtë arsyetim unë e kam lexuar në emër të Komisionit, por Komisioni e ka vendosur për këtë arsyetim dhe për këtë rekomandim, jo si Fikrim Damka. Edhe të dytën si Fikrim Damka, unë kam qenë në Kosovë, as në Shqipëri, as në Maqedoni, as në Turqi, në kohë të luftës.

KRYESUESI: Kundër-replikë, Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Edhe unë pajtohem që zoti Damka ka qenë në Kosovë, por edhe dhunuesit ka qenë në Kosovë, dhe jo vetëm ata.

KRYESUESI: Zoti Osmani, e keni fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Është një çështje goxha e mirë që po diskutohet në Parlament edhe mund të diskutohet në forma të ndryshme, qoftë me emocione, qoftë në humanizëm, por besoj që më së shumti duhet të diskutohet nga aspekti institucional, shtetëror që është përgjegjësi e të gjithëve.

Drafti të cilën e kemi shikuar është i arsyeshëm, mirëpo mënyra qysh është parashtrua mendoj që është dashur të ketë një kujdes më të madh. Nuk diskutohet që kjo kategori duhet të trajtohet me ligj, por jo në formën që është paraqitur këtu.

Konsideroj që kjo shoqëri, ky shtet ka nevojë që të kujdeset për njerëz të vet, për shoqërinë e saj.

Mirëpo, bota demokratike këto çështje i ka të zgjidhura në forma tjera, jo me formë të pensionit, jo me formë të kompensimit financiar. Në botën demokratike janë themeluar institucione të veçanta që merren me trajtimin e njerëzve të traumatizuar nga dhuna në luftë. Shoqëria kujdeset për ta në forma të ndryshme duke i privilegjuar apo duke i hequr nga pagesa e shërbimeve të ndryshme shtetërore. Bota demokratike këtë kategori e trajton duke i dhënë hapësirë më të madhe të socializmit dhe të punësimit të kësaj kategorie. Ajo që unë këtu po e vërej ka koncepte të ngatërruara.

Sponsoruesi i ligjit që e arsyetoi edhe e arsyetoi edhe diskutimin e Albulenës me emocion shumë të arsyeshëm, ka kërkuar kompensim dhe kemi një kategori të deputetëve që po kërkojnë kjo dukuri të trajtohet në formë institucionale në institucione ndërkombëtare nga shteti, ushtria e cilës ka kryer dhunë në Kosovë, që unë e arsyetoj plotësisht. Mirëpo nuk është shtet në botë që e kompenson këtë kategori nga buxheti i vet nga ajo që ka pësuar.

Ajo që e vlen të thuhet se po i dëgjoj deputetët që nuk po e bëjnë shumë të rëndësishme çështjen e pagesës së financave.

Në këtë dokument të sponsoruar është një kosto buxhetore dhe një shifër e cila është qitur aty sa mund të jem pretendues në dokument është 20 mijë veta. Tash të jesh joinstitucionalist thotë njeri nëse janë 20 mijë femra të dhunuara në Kosovë, çka lypin këta burra këtu të jetojnë këtu më tutje. Domethënë e vërteta është që kemi ardhur në një fazë, unë e përkrah ligjin po e përkrahi në formë tjetër, unë nuk dua të kemi keqkuptime.

Jemi ardhur në një fazë, kryetar, kur kemi arritur një kulm të të hyrave buxhetore, të hyrave të shtetit. Integrimet e mëtutjeshme ndërkombëtare do të na e zvogëlojnë këtë të hyrë, ne varemi prej të hyrës në kufij dhe kemi një numër të shtuar të ligjeve që kanë implikime të jashtëzakonshme buxhetore, janë reformat në shëndetësi, janë disa ligje që kanë të bëjnë me arsimin, janë ligje tjera që kanë të bëjnë me këto kategori për të cilat po flisni sot dhe ajo që unë e tërheq vërejtjen si një njeri që kam punuar vazhdimisht në këtë Komision për Buxhet dhe Financa, që ne si shoqëri si Kosovë brenda disa viteve, shumë pak viteve kemi për të rënë në një kolaps financiar për arsye se s'do të mund t' i kryejmë obligimet ndaj asaj që ne tash po i bëjmë me ligj.

Prandaj, mendimi im është që ky ligj duhet të kalojë, po ky ligj duhet të përmirësohet, që mos të jetë kërkesa kryesore kompensimi financiar, po të jetë kompensim institucional në

forma tjera të cilët kjo shoqëri mund t'i lirojë prej disa obligimeve edhe një tretman i veçantë i shtetit ndaj kësaj kategorie. Por, të mos të jetë forma e veçantë edhe eksplicite vetëm kompensimi në formë të pensionit.

Ky është mendimi im dhe besoj që kjo është diçka e cila mund të rregullohet në amendamentim të mëtutjeshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit!

Zoti kryesues, mendoj që poshtërsia më e madhe që mund të bëhet nga një deputet në këtë Kuvend, është të thuhet se jam kundër përfshirjes së një kategorie të tillë të viktimave të dhunuara brenda ligjit dhe të njëjtën kohë ta lozësh rolin e hipokritit duke thënë se bashkëndjen me viktimat. Unë këtij deputeti i them monstrum, një lloj arsyetimi i tillë është monstruoz këtu.

Unë dua të flas për katër çështje lidhur me ligjin duke filluar nga çështja e parë që është arsyetimi i Komisionit, duke e quajtur këtë një çështje të ndjeshme dhe të ndërlikuar.

Mendoj që pikërisht këto janë dy arsye pse çështje duhet të zgjidhen me ligj, pikërisht pse janë të ndjeshme dhe pikërisht pse janë të ndërlikuara, sepse po të kishin qenë çështje të pandjeshme dhe të thjeshta, shoqëria njerëzore nuk kishte pasur nevojë as për ligje, bile. Po pikërisht pse punët janë të ndërlikime në shoqëri edhe të ndjeshme ato duhet të rregullohen me ligje, që të mos lënë vend për interpretime subjektive.

Sa i përket numrit të pasaktë që po thuhet si justifikim për këto viktima, unë po them që kurrë nuk do ta kemi numrin e saktë të tyre, por edhe nëse nuk janë 20 mijë, a janë 15 mijë, nëse nuk janë 15 mijë, a janë 10 mijë, e nëse nuk janë 10 mijë a janë 5 mijë, e nëse janë 5 mijë, duhet të ketë ligj për këtë punë dhe ato duhet të futen si kategori të mbrojtura me ligj? Domethënë fakti që ne nuk do të mund të arrinim deri te numri 20 mijë, nuk është justifikim që këtyre kategorive edhe ashtu të marginalizuar t'u mohohet e drejta e përkujdesjes institucionale dhe me ligj.

Po ashtu, është përmendur edhe kostoja buxhetore. Ky është një arsyetim banal. Unë mund t'ju numëroj këtu me dhjetëra ligje të cilat i ka shtyrë Qeveria e Republikës së Kosovës, për të cilat thotë se nuk ka pare madje deri në vitin 2016, ka plot ligje a që ka shtyrë Qeveria e Kosovës, por kur vjen për një ligj të një interesi kaq jetik, për një pjesë kaq të harruar të shoqërisë së Kosovës, këtu befasisht shpiken arsyetime financiare.

Dhe në fund fare po them se partia në pushtet, vetëm gjysmën e manipulimeve partiake me librezë të veteranëve të kishte reduktuar, unë po ju them që kishin pasur pare edhe për këtë kategori të shoqërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Veteranët nuk i bën partia, veteranët do të jenë veteranë ata që kanë pasur lidhje me UÇK-në dhe nuk janë të partisë ata. Megjithatë është mirë të kihet kujdes në raport me diskutimet e kolegëve, sepse mendimet janë të ndryshme dhe

mund të kundër asaj që e keni ju si mendim politik, qoftë si grup parlamentar, qoftë si individë edhe të tjerët kanë të drejtë ta ruajnë mendimin e tyre. Dhe unë kisha sugjeruar që të kemi kujdes në raport me kolegë mos t'i ofendojmë pse kanë mendim tjetër. Fjalën e ka zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Sa për një konfirmim të saktë edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës edhe unë do ta votojmë këtë projektligj. Është një aspekt tjetër që më bëri ta marrë fjalën, ai aspekt është mosfunksionimi i parlamentarizmit këtu në Kuvend të Kosovës, më tepër e kam fjalën për mosfunksionim të debatit jashtë seancës plenare.

Ne i kemi deputetët tanë në komisione aty zhvillohet debat. Grupet parlamentare ekzistojnë dhe duhet pasur nominalish të paktën në debat, ne pimë kafe gjithë ditën bashkë edhe mund të kemi debat edhe për një temë kësioj unë po befasohem pse ka nevojë për t'u shprehur kaq shumë, dy orë në vend se të kemi debat normal para seancës edhe kur të vijmë në seancë duke e ditur sa e rëndësishme është dhe sa e vlefshme është ta votojmë edhe ta dërgojmë në Komision e të shohim çka mund të bëjmë në lexim të dytë, nëse ka nevojë eventuale të bëjmë diçka edhe pse s'po më duket.

Edhe një herë po them nuk është duke funksionuar se po të funksiononte normalisht ky Parlament krejt këto debate që u thanë para kamerave kanë mund të zhvillohen thjeshtë, për t' u deklaruar grupet parlamentare, të tregojnë që na ndiejmë për këto viktima edhe të votojnë pa pasur nevojë të kallëzojnë gjerë e gjatë se çka po thonë se kur nisim të kallëzojmë gjerë e gjatë atëherë dikujt i shkon mendja që ndoshta edhe përnjëmend po bëjmë politikë me këtë ligj. Faleminderit, pata nevojë t'i them këto fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kjo sot që po diskutojmë është një temë jashtëzakonisht sensitive dhe është një temë e cila nuk mund të marrë përgjigje meritore dhe mendimi imi personal është që nuk ka pasur nevojë të vijë në seancë dhe të jetë vlerë politike nga një grupacion, i cili donë ta spekuloj si situatë të dhimbshmërisë, pa analizuar në kompleksitetit si problem.

Këtu shihet që ka një qasje joprofesionale për problemin e lëndimit shpirtëror që është caktuar, që ju ka bërë një kategorisë, këtu flitet për femra, ka edhe meshkuj, ka fëmijë, ka të tjerë, pra në shtetet sociale dhe ligjore ekzistojnë mekanizma të cilët janë të shtrirë duke filluar nga trajtimi shëndetësor që quhet si PTSD (post trauma sindroma) dhe i cili nuk është në rënie po është në rritje dhe kjo sindromë duhet të trajtohet në mënyrë të organizuar nga pjesa profesionale e mjekësisë.

Mandej, është pjesa tjetër e cila trajtohet si lëndim shpirtëror që me kompensim material dhe me formë të selektimit të një grupi hipotetik që ne mund të themi 20 mijë, po ndoshta mund të jenë 50 mijë, 60 mijë nga aspekti jo vetëm në Republikën e Kosovës, por në të gjitha shoqëritë tjera kjo çështje nuk e ka lënduar vetëm të dhunuarin, por e ka lënduar

tërë rrethin familjar dhe i cili mbetet si kategori sociale në trajtimin nëse është si kategori e paaftë për të qenë pjesë integruese në shoqëri. Mënyra si po dom ne ta konvertojmë këtë në ligj edhe ta krahasojmë me veteranët, është spekulim politikë, është nevojë e cila për ata që s'janë lënduar asnjëherë shpirtërisht, mundohen të flasin për ata që janë lënduar shpirtërisht.

Prandaj, më shumë shihni kush është lënduar dhe Nasradini ka thënë duhet të vijë të më shoh ai që ka rënë prej dardhe, jo ata që s'janë rënë prej dardhe për t' i kuptuar dhimbjet e mia. Prandaj, është mirë me qenë shumë realisht dhe ...

Urdhëro, jo ne mund të vazhdojmë deri në mëngjes, por unë me jo joprofesional nuk mund me spekulant politikë nuk mund të flas, sepse kjo është spekulim politik për të arritur për një kategori një formë kinse ju jeni kujdestar të dhimbshmërisë kombëtare. Ky problem është shumë sensitiv, ky problem duhet ne të ngremë kapacitete profesionale mjekësore që duhet të trajtohen dhe nëse klasifikohen nga ekspertë mjekësorë futen në skeda sociale. Ne duhet të them të rriten skedat te përkrahjet sociale për këtë kategori e jo ne të futemi në një diçka e cila po themi hipotetikusht po i kompensojmë me një pjesë materiale, u harxhua pjesa materiale çka do të bëjë shoqëria tutje, prapë do jetë barrë e shoqërisë, ai problem.

Prandaj, unë iu kisha lutur deputetëve që tema të tilla mos të jenë tema të cilat mund të jenë pa zgjidhje, por më shumë vjen në suaza të spekulimit dhe ofendime që mundohen të bëhen, janë më shumë të një vlerësimi që nuk do t' ju sjellin vota as në të ardhmen po as sot nuk do t' ju vlerësojnë tek ata, sepse ne në përditshmëri duhet të merremi me atë kategori dhe ajo nuk është vetëm ajo kategori problematike, por janë edhe kategoritë tjera. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Një listë të vërejtjeve që i pata, një pjesë u thanë, por një pjesë u shtua në ndërkohë. Po thuhet ligji i veçantë, do të duhej të ishte ligji i veçantë, do të duhej të mos përfshiheshin në Ligjin për veteranët, por është pikërisht që kjo kategori nuk duhet të ndahet, nuk duhet të stigmatizohet. Kjo duhet të jetë pikërisht pjesë, bashkë me këto kategori tjera dhe nëse ndahen të gjitha pastaj mund të ndahet edhe kjo. Dhe, është kjo ajo mundësi e cila i bënë ata pjesë të shoqërisë, pra i bënë pjesë si viktima të luftës që ka ndodhur e që krejt populli i ka përjetuar, po dikush më rëndë e dikush më lehtë.

Për sa i përket kompensimit nga dhunuesi, unë jam shumë dakord që kompensimi të ndodhte nga dhunuesi, pra jo vetëm këtu në këtë rast po janë shumë të vrarë e shumë të pagjetur, janë shumë shtëpi të dëmtuara, janë fabrika të shkatërruara, janë dëme ekonomike e të gjitha rend që vinë që dhunuesi në këtë rast do të duhej t'ia paguante dhe t'ia kompensonte Kosovës, të bënte një dëmshpërblim të luftës. Por, kjo gjë do duhej të ishte kusht në negociata e jo të përdoret tash si argument në ndërkohë që negociatat ndodhin dhe këto gjëra nuk përmenden asnjëherë. Pra, kjo është një hipokrizi e llojit të veçantë.

Sa i përket kolapsit shtetëror që po mund të ndodhë prej kësaj kategorie, unë mendoj që kolapsi shtetëror do të vijë nga korrupsioni, kolapsi shtetëror do të vijë nga hajnitë, po kur se si nuk do të mund të vinte nga kjo çështje. Dhe, kur këto raste trajtohen, përpiqen të trajtohen me elemente teknike e jo mjekësore, jo po u dashkan analiza mjekësore këto gjëra, kjo është kulmi i banalitetit. Kjo është kulmi i ofendimit për këtë kategori që përpiqemi në një t'ia vejmë në dyshim se po u dashka ata patjetër të futen në disa procedura mjekësore, dhe tjetra është që ne duhet ta paragjykojmë këtë kategori si të poshtër. Pra, gratë në Kosovë janë të poshtra sipas këtij arsytimi dhe ato mund të vijnë dhe të lajmërohen sikur qenkan të dhunuara edhe të gënjejnë dhe në këtë rast të përfitojnë beneficion nga ky ligj. Nuk duhet të nisemi nga këto paragjykime që njerëzit janë të poshtër, njerëzit janë të mirë përgjithësisht dhe ata do të vijnë nëse kanë vuajtur dhe nëse ne ua hapim derën përmes këtij ligji.

Për sa u përket parave dhe votave, ju kisha lutur që ta largoni pak mendjen veç nga këto dy shprehje se krejt çdo gjë po sillet në krejt këto diskutime vetëm rreth këtyre dy çështjeve. Mendoni që ka diçka edhe përtej kësaj pune, këto punë duhet t'i krijojë ligji, mendoni pak shoqërinë pak më ndryshe, mos mendoni parat, votat se vetëm para, vota, para, vota, para vota e asgjë tjetër nuk po dëgjoj këtu. Mendoni që ka ndjenja, mendoni që ka ndodhur diçka, mendoni që ka dikush nevojë që të kompensohet dhe kjo nuk është aspak politike, në fund të fundit këtu sa munda të shoh dikush kundërshton, dikush e përkrah, kjo është më së paku politike në këtë rast dhe më së paku vota mund të ketë nga kjo çështje.

KRYESUESI: Zoti Muja, replikë.

SHAIPI MUJA: I nderuar kryesues,

Unë u mundova aq sa m'u dha mundësia në foltore t'i prek shkurtimisht nga aspekti profesional lëndimet shpirtërore çka janë ato.

Parafolësi dhe parashtruesit dhe kategorikisht që mundohen ta mbrojnë për mua janë spekulant të tipit të veçantë dhe të cilët mundohen të imponohen në një kategori të lënduar, e cila është shumë vështirë për t'u identifikuar në këtë strukturë të mentalitetit shoqëror. Unë thashë dhe e them prapë që Kosova duhet të ketë mënyrë permanente përkujdesje institucionale, shëndetësore dhe sociale për këtë kategori e cila është jo vetëm nga ata të cilët janë të dhunuar direkt, por nga shoqëritë të cilat kanë qenë në një mënyrë të dhunuar si kolektiv nga strukturat e pushtetit serb dhe nga aparati shtetërorë serb edhe ushtarak. Prandaj, ky spekulim tregon se kemi të bëjmë me një kategori të njerëzve që janë në politikë dhe janë joprofesional për trajtimin emocional, psikologjik, social dhe psikiatrik të rasteve dhe si të tillë e klasifikojnë veten në formë të spekulantëve politikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Aliu.

LIBURN ALIU: Mos u bëni vetë racistë kur thoni për mentalitetin, mos i ndani njerëzit me mentalitete, ky është racizëm edhe çka është më e keqja vetë racizëm, po e trajton mënyrë raciste vetveten, s' duhet trajtuar sendet me mentalitet.

Sa u përket statistikave është rasti që nëpërmjet këtij ligji të krijohet komisioni dhe të gjendet kjo shifër më e drejtë. Pra, të hapim derën, të krijojmë mundësinë ligjore që të ndodhë një diçka e tillë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Unë e mora fjalën, jo për të dytën herë, tani e marrë për të parën herë mbasi që herën e parë fola në emër të Komisionit.

Nuk është çështja e grave të dhunuara një çështje që të themi, domethënë e ndjeshme ose jo, kjo është çështje e krimeve të luftës të bëra në Kosovë.

Nuk pajtohem me të gjitha akuzat që u drejtuan në fjalën kur fola në emër të Grupit, nga disa politikanë që nuk i kanë parë këto gra, nuk i kanë takuar këto gra dhe që mundohen tani të dalin në përkrahje të këtyre grave. Mirë është kur shoqëria është e ndjeshme dhe del në krah të atyre që 15 vjet nuk i pa askush.

Merrem prej vitin 1998 me fatin e këtyre grave e jo këto gra qysh në kohën e luftës kur u abuzua ndaj tyre, ndaj burrave të tyre, fëmijëve të tyre. Edhe një herë e përsëris, jam dëshmitare para gjykatësit të Hagës për të gjitha abuzimet ndaj gruas në Kosovë edhe si mjeke.

Kam 400 histori dhe pra historitë nuk na duhen, ato i kemi, 400 dosje desha të them, asnjëra nga këto gra të cilat i vizitoj dhe takohem me to nuk kanë pranuar të jenë dëshmitare në Hagë, sepse në gjyqe ato dhunohen për së dyti.

Këto gra vështirë që do të pranonin të dëshmojnë edhe në bazë të ligjit të propozuar, amendamentimit. Ato kërkojnë një përkrahje të shoqërisë ndryshe, kërkojnë që tema e dhunimit në Kosovë të mos jetë një temë tabu për të cilën nuk do të flasim shpeshherë, qoftë edhe në këtë formë qysh folëm sot.

Ato kërkojnë që dhunimi në Kosovë të njihet si një dhunë u shkaktua në Kosovë, pra të pranohet si e tillë dhunim ndaj gruas në emër të përkatësisë së saj nacionale. Ato kërkojnë që dhunuesit dhe ushtruesit e dhunës të dënohen, nëse mendoni se s'kemi dëshmi ja unë do t'ua ofroj dëshmitë. Prandaj, kërkoj që këta dhunës më në fund t'i njehni, kam edhe fotografi ata mund të dënohen, mund të gjinden dhe të dënohen, kjo është arsyetimi i këtij ligji.

Të ndërtohen mekanizma siç thanë disa që të dalin në mbrojtje të grave të dhunuara dhe të tjerëve të dhunuar dhe ata të respektohen si viktimat e luftës. Thamë mekanizma, sepse mekanizma të tilla nuk ekzistojnë, ato janë lënë në fatin e shoqërisë civile e cila nuk mjafton.

Dhe, më lejoni të them ato gra jetojnë në mesin tonë dikund edhe kanë gjetur strehim. Institucioni që e bartë peshën më të madhe është familja dhe ajo shpeshherë edhe është e

traumatizuar edhe vetë. Këto gra me gjithë plagët e veta nuk kanë qejf t'i prekin plagët, sepse ato edhe kullojnë gjak dhe dhimbje.

Do ta përmend një rast për të qenë një dëshmi e gjallë. Gruaja është nga Kishnica, sot është në moshën time, është 50-vjeçare e dhunuar, ndoshta nga bashkëvendësit e saj, nga forcat paramilitare dhe militare, nga shumë të tillë. Asaj tentuan pas dhunimit t'ia presin edhe krahun, burrin ja vranë edhe djali është i zhdukur, ajo humbi vëmendjen dhe si e tillë kur unë e njoha ne nuk kishim mekanizma institucional t'i dalim në ndihëm, ajo s'kishte as leje njoftimi për ta dëshmuar vetveten dhe t'i marrë ndihmat sociale për shkak të moshës. Këtu është ish- ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, besoj që është prezent dhe e dinë rastin e tillë. Por ju të tjerët, a e njihni këtë grua e cila jeton në Shtime dhe ka shumë të tillë që kanë nevojë për ndihmën tonë dhe e presin ndihmën tonë?

Dhe ne kemi nevojë të japim shumë dëshmi edhe për dhunimet, sidomos në Këshillin për dëshmitë e luftës, kemi nevojë ta plotësojmë Ligjin për viktimat e luftës, ndoshta ky draft nuk na pëlqeu si i tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne jemi deputetë dhe jemi në Parlament ku bëhen ligjet, bëhet legjislatura dhe konsideroj se 15 vjet pas luftës e kemi një temë jashtëzakonisht të ndjeshme e që nuk është dashur t'i lëmë 15 vjet të kalojnë për shkak se çdo dëmtim që i është bërë Kosovës në çfarëdo forme, duhet kërkohet llogari dhe ne duhet të përcaktohem a dom të jemi shtet që funksionon me ligje a duam që t'i lëmë çështjet e paprekura dhe të merren shoqatat, të merren organizatat edhe 15 vjet tjera të na kalojnë neve me një plagë, e cila duhet megjithatë të marrë një formë ligjore për trajtimin e një kategorie të dëmtuar në shoqërinë tonë?

Si të gjitha kategoritë tjera që kanë pasur trajtim në Kuvendin e Kosovës dhe që janë mbuluar me ligj, duhet edhe kjo kategori, e cila është dëmtuar nga një shtet që sistematikisht me program ka vepruar ndaj qytetarëve të Kosovës.

Çështja e mentalitetit, e mënyrës së sjelljes, është çështje edukate që ka ndodhur në popullin tonë, por nuk duhet të bëhemi si struci, ta futim kryet në rërë, gjoja se nuk ka pasur kurrgjë, e nuk po dimë kurrgjë dhe nuk po duam ta trajtojmë një temë, e cila duhet me ligj, në mënyrë që të mos e lëmë edhe më tutje të merren kategori të ndryshme shoqërore, qoftë edhe siç po thuhet për përfitime. Pse t'ia lëmë mundësinë kujtdo qoftë që ta keqpërdorë një kategori të caktuar të shoqërisë sonë, e cila është dëmtuar në një mënyrë tjetër, siç ka ndodhur edhe në rastet tjera, me vrasjet, me plagosjet, me dëmtimet materiale, me të gjitha.

Prandaj, konsideroj që duhet të bëhet ligji, sepse e garanton një të drejtë qytetare. Edhe sot, në kushte paqeje, në çdo shtet, dhunimi është vepër penale dhe i dëmtuari megjithatë trajtohet.

Në bazë të ligjit, edhe në kushte normale, kur edhe një individ është në pyetje, e ne po flasim për një kategori, e cila është dëmtuar gjatë luftës dhe duhet të trajtohet me ligj absolutisht. Çështje tjetër pastaj është numri, çështje e mekanizmave tjerë që duhet ta vërtetojnë dhe që duhet ta implementojnë ligjin. Por, që duhet të bëhet ligji, duhet të bëhet në mënyrë që të mos lejojmë edhe më tutje të kemi në vazhdimësi vetëm trajtim anësor të kategorive të shoqatave e të aspekteve tjera, që nuk e kanë mundësinë ligjore ta bëjnë një ndihmë të tillë.

Prandaj, trajtimi duhet të jetë ligjor dhe shtetëror. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vërtet është një temë shumë e ndjeshme për të gjithë dhe shoqëria duhet të merret besoj me këtë çështje. Por, mendoj se emërtimi i ligjit që është miratuar nuk është i qëlluar. Është dashur të jetë i ndarë ligji për dëshmorët, për veteranët dhe për pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ligj i veçantë të jetë për viktimat civile, për familjarët dhe për kategorinë, për të cilën po diskutojmë sot.

Megjithatë, ne i kemi para vetes dy propozime. Sipas Rregullores, unë dua t'i hedh në votim rekomandimet e të dy komisioneve, të cilat e kanë shqyrtuar propozimin dhe bashkë me to edhe ligjin.

Debati ka përfunduar.

(Dëgjohet debat nga salla)

Cilëndo! Mirë, i nxjerrim në votim! Do të votohen të dyja përnjëherë. Për njërin do të votojmë 'për' dhe për tjetrën 'kundër'. Mirë, uluni pra! Unë po i hedh në votim rekomandimet e dy komisioneve lidhur me propozimin për ndryshimin e ligjit.

Kryesia ua ka përcjellë komisioneve për ta vlerësuar propozimin dhe sipas Rregullores, në qoftë se rekomandimet të cilat i kemi kërkuar bashkë...

(Ndërhyrje nga salla)

...unë s'po dua të veproj qysh keni qejf ju, po qysh duhet të veprohet, sipas Rregullores. Ky nuk është projektligj.

(Debat nga sallë)

Ky është propozim i një grupi parlamentarësh dhe propozimi... Rregulloren unë e zbatoj, mos bërit! Bëju pak me kulturë! Sillu si njeri, burrë! Po unë po sqaroj.

Dhe, në qoftë se ju mendoni ndryshe, unë e bëj ndryshe. Nuk mund me britma të më detyrosh të ndryshoj qëndrimin tim dhe mënyrën sesi procedoj me Rregulloren. Kot e ke! As të më nervozosh. Unë jam këtu!

Unë po dua ta sqaroj: propozimi ka ardhur siç ka ardhur, në rregull është. Kryesia ka kërkuar nga dy komisionet funksionale mendim lidhur me projektligjin e propozuar nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”.

Sipas rregullave, ne do të duhej t’i votojmë propozimet e dy komisioneve: të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Në qoftë se votohet kundër propozimit të dy komisioneve, miratohet ligji. Kjo është rregulla.

Në qoftë se doni ju dhe mendoni si deputetë që ne duhet ta ndryshojmë për hatër tuajin, unë e ndryshoj mendimin e grupeve parlamentare, s’ka problem.

Seanca nuk mund t’i ndryshojë praktikën dhe rregulloret.

(Debat në sallë)

Ia jap fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. A jeni për ta ndryshuar konstatimin tim dhe mënyrën si është proceduar deri sot, që të votohet mendimi i komisioneve?

Fjalën e ka zoti Sabri Hamiti, për procedurë.

SABRI HAMITI: Zotni kryesues, faleminderit!

Unë veç do të flas për situatën në të cilën jemi, sepse e përcolla. E di vendimin. Dy mendimet e komisioneve janë negative. Ne e dimë si dokument, e dimë edhe në Kryesi, e pamë edhe këtu. Problemi është tjetër, që e kemi një rrëzim të këtij mendimi në diskutime. Sepse diskutimet, njerëzit ose i kanë dy mendime, unë flas për anëtarë të komisionit, se i përcolla. Kanë folur edhe anëtarët e komisioneve, mendime që janë të nuancuara, për të mos thënë nuk janë të njëjtat me mendimin e komisioneve.

Ajo që thoni ju, zoti kryesues, është shumë e vërtetë, që mendimet e komisioneve hidhen në votim edhe nuk ka çka hidhërohet kurrkush, se është rregull. Por, megjithatë, ne jemi në një situatë kur diskutimi po ofron diçka të nuancuar. Kështu që, kini kujdes, më lejoni t’i them tri fjalë, pastaj komentoni. Unë po e marr kohën time për çfarë desha të them.

Prandaj, unë thashë, ndoshta është mirë që kryetarët e komisioneve ta deklarojnë edhe një herë mendimin. Kaq! Tjetër nuk mund të bëjnë, sepse në lexim të parë ne nuk mund të ndërrojmë kurrgjë. Propozojmë gjëra, themi kalon, ose nuk kalon. Faleminderit!

KRYESUESI: Realisht, praktika jonë në këto raporte e gabueshme është krejtësisht, sepse në asnjë vend të botës, ku ligjet nuk kalojnë në komisione nuk duhet të shqyrtohen në Parlament.

Megjithatë, unë ua jap edhe një herë fjalën përfaqësuesve të komisioneve, sipas kërkesës së nënkryetarit Hamiti. Por ata, prapë nuk kanë tjera fjalë besoj, përveç asaj që e kanë thënë, sepse këta duhet të mbledhen edhe një herë që ta ndryshojnë atë.

Megjithatë, unë po e hedh në votim, sipas Rregullores, propozimin e komisionit. Në qoftë se kanë ndryshuar mendim le të votojnë kundër propozimit të komisioneve. Edhe u krye!

Atëherë, e hedh në votim. Kush voton për propozimin e komisioneve, voton kundër propozimit të projektligjit.

Votojmë tani! Faleminderit! Miratohet projektligji i propozuar nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” me 33 vota për, ndërkah nuk miratohet propozimi i dy komisioneve. Kanë votuar 29, gjithsej 30 vota (një pa kartelë). Sepse unë e kam harruar... A jeni të kënaqur ju?

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës dhe ka rekomanduar mosmiratimin në parim të këtij projektligji.

Jo! Është fenomen interesant ky yni. Në rregull. Po, ne si Kryesi mendoj që duhet të ndryshojmë diçka, se kështu nuk funksionon...

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zonjën Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Kije parasysh që Komisioni Funksional ka rekomanduar që të mos miratohet ky projektligj.

ZËVENDËSMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni që para jush ta paraqes Projektligjin për Agjencinë për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Ky projektligj është miratuar nga Qeveria me vendimin nr. 100/100, më 12. nëntor 2012.

Nxjerrja e këtij projektligji ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, që përfshin pronën bujqësore dhe pronën private komerciale, si dhe krahaskimin e zgjidhjen e dallimeve ndërmjet dokumenteve kadastrale origjinale, të marra në Kosovë nga pushteti serb para qershorit të vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës për pronën private komerciale, për pronën private dhe të bashkësive fetare.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në përcaktimin e funksionimit dhe organizimin e Agjencisë për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, me të cilën do të lehtësohej zbatimi, zgjidhja e kërkesave, zbatimi i skemës së qirasë, si dhe pranimi, krahaskimi dhe verifikimi i dokumenteve kadastrale.

Me këtë projektligj, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka shqyrtuar një sërë opsionesh të mundshme dhe opsioni i rekomanduar është nxjerrja e një ligji të ri, me qëllim të zbatimit të konkluzioneve të dialogut teknik, që kanë të bëjnë me dokumentet kadastrale dhe është krijimi i një sistemi të mirëfilltë ligjor dhe efikas, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si rezultat i konkluzioneve operative me lehtësimin e Bashkimit Evropian, në mënyrë që dokumentet që janë marrë në kohën e luftës të kthehen në Kosovë.

Projektligji në fjalë i rregullon detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, si dhe funksionimin dhe organizimin e bordit mbikëqyrës të agjencisë, sekretarisë ekzekutive, Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Komisionit për Verifikimin dhe Vendosjen për Prona.

Projektligji në fjalë është për gatitur nga Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Kosovare të Pronës, si dhe institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare, që kanë dhënë kontribut në hartimin dhe finalizimin e këtij projektligji.

Duhet theksuar që kostoja financiare po ashtu ka pasur rëndësi dhe ne i kemi kushtuar kujdes të madh, ngase nuk është themeluar ndonjë mekanizëm i veçantë që do të shkaktonte shpenzime shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës, po Agjencia aktuale e Pronës do të shndërrohet në Agjencinë për Krahassim dhe Verifikim të Pronës. Kjo nënkupton që vazhdojnë të qëndrojnë në postet e tyre deri në skadimin e afatit, për të cilin janë emëruar edhe ata persona të emëruar dhe që veprojnë sipas dispozitave ligjore të ligjeve tona.

Po ashtu, vlen të theksohet se ky projektligj ka rëndësi të veçantë, sepse do të mundësojë t'i japë zgjidhje një problemi të madh që e kemi pas luftës në Kosovë, e që është çështja e pronës dhe që një çështje e tillë natyrisht se është jo vetëm në interes të qytetarëve, por edhe në vënien e një rendi dhe rregulli në çështjen e pronave.

Andaj, ju ftoj që ta miratoni projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Komisioni FunkSIONAL, në këtë rast Komisioni për Legjislacion, e ka marrë këtë ligj në trajtim. Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL, para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhje plenare, e shqyrton projektligjin në parim dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandimin për mosmiratim ose miratim të projektligjit në parim.

Komisioni vlerësoi se nenet 6.2, 7.1, 8.2, 9.1, 16.8, 25.2.3.4 dhe 29.1 të Projektligjit për Agjencinë për Verifikim dhe Krahassim të Pronës janë në kundërshtim me amendamentin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 5 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve, që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për Agjencinë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës vlerësoi se projektligji nuk i plotëson kushtet për miratim në parim dhe i rekomandon Kuvendit që të mos e miratojë atë.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të grupit të PDK-së nuk është paraqitur askush. Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Për një shtet sovran, si ky projektligj, ashtu edhe agjencia, që ky projektligj e themelon, janë absolutisht të panevojshme.

Ky projektligj është rrjedhojë dhe e formalizon pranimin kriminal, që librat kadastralë të Kosovës t’i mbajë Serbia. Është kriminal, pasi Serbia i ka vjedhur këta libra kadastralë nga Kosova dhe, në anën tjetër, për shkak se administrimi i dhunshëm që Serbia ia ka bërë pronës private të shqiptarëve në Kosovë, prej se e ka uzurpuar këtë, ka qenë kriminal.

Ky ligj nuk synon sanksionimin e krimit, por formalizimin e tij, duke u kujdesur në disa raste ta lehtësojë pasojën që rrjedh nga krimi. Pra, ne nuk e kemi problemin vetëm me nenet që i ka cekur Komisioni për Legjislacion. Sigurisht që ato janë kundërkushtetuese dhe ne nuk do t’i përkrahim, mirëpo ne kemi problem edhe me tërësinë e këtij projektligji.

Pas tërë atij pompoziteti të përmbylljes së mbikëqyrjes së pavarësisë, tash po e themelojmë një agjenci, e cila formalisht do të jetë në kontroll të plotë nga përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian. Pra, shumica e anëtarëve të bordit, sekretarisë dhe të komisioneve do të emërohen drejtpërdrejt nga PSBE-ja.

Por, shtrohet pyetja se prej nga e merr mandatin PSBE-ja për të emëruar funksionarë ekzekutivë në Kosovë? Pra, ku është baza ligjore?

Pushteti ekzekutiv mbi administrimin e pronës është thelbësor për sovranitetin. Pra, ky projektligj nuk ka bazë as në Kushtetutë, madje as në Pakon e Ahtisarit, në të cilën shpesh thirreni. Me këtë projektligj po duan ta ndërtojnë një regjistër të ri kadastral, i cili do t’i marrë disa të dhëna nga i vjetri dhe disa të tjera nga ai i ri. Por, cili do të ketë përparësi? Në rast të mospërputhjeve, a do t’i besojë Kosova regjistrin të vet kadastral, apo atyre kopjeve nga Serbia, të verifikuara nga EULEX-i.

Pra, është e paprecedent për një shtet që të mos e ketë regjistrin historik të evoluimit, të transaksioneve pronësore. Pra, kopjet nga Serbia ne do t’i marrim si të mirëqena.

Me këtë aranzhim të kompletimit të regjistrin kadastral, shqiptarët rrezikojnë që prapë t’u merren pronat e tyre, të cilat i kanë blerë dhe paguar më shumë se një herë. Janë mbi gjashtë procese të kolonizimit të Kosovës me kolonë serbë që prej vitit 1912, dhe në vend

se të korrigjohet padrejtësia historike e këtij kolonizimi, ne me ligj po i hapim derë një kolonizimi të ri potencial.

Sigurisht që Lëvizja “Vetëvendosje” e ka kundërshtuar fuqishëm tri herë, sa ka qenë në rend dite në Komisionin për Legjislacion, dhe sigurisht se do ta kundërshtojmë fuqishëm. Edhe këtu do të votojmë kundër dhe i ftojme të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të mos votojnë për këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të LDK-së, zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah rekomandimin e Komisionit për Legjislacion.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe një herë disa çështje të vogla, në fakt nuk janë të vogla, po çështje të cilat kanë të bëjnë me ne.

E vërteta është se nëpër komisione parlamentare, grupet parlamentare i delegojnë deputetët e tyre dhe funksionimi normal do të ishte ai, në të cilin secili deputet në komisionin parlamentar e përfaqëson mendimin e grupit e jo të vetin, në mënyrë që të mos vijë në seancë plenare, e të na dalë ndryshe vota në komision, e ndryshe vota e grupeve në seancë plenare.

Çështje tjetër është se në këtë demokracinë tonë parlamentare, kur Qeveria propozon projektligje dhe politika, duhet t’i ketë deputetët në sallë për t’i mbështetur ato politika të saj.

Nuk mund të provojë t’i kalojë ligjet e vetat, nëse shumicën dërmuese të deputetëve, të cilët e kanë zgjedhur Qeverinë, nuk i ka në sallë kur i kalon ato ligje. Nuk ka kurrfarë obligimi opozita ta mbështesë asnjë ligj, asnjë politikë të Qeverisë. Domethënë është vendim i saj nëse e mbështet, apo jo.

Tani, për këtë projektligj dua të them se u dështua të na tregohet se çka duan të bëjnë, dhe kemi mbetur në njëfarë forme të anticipojmë dhe të kuptojmë vetë. Çfarë po dëshiron të bëjë Qeveria me këtë ligj? Edhe ajo që e kemi kuptuar, nuk na duket që është konform legjislacionit dhe Kushtetutës, të cilën e kemi tani në fuqi.

Mendoj se nëse për shkak të marrëveshjeve duhet ta kalojmë një ligj, atëherë kemi të bëjmë me ratifikim, e jo me votim të ligjit, për shkak se e kemi një rezolutë këtu. E, në anën tjetër, nëse Qeveria mendon se është e domosdoshme, mund të gjejë metoda tjera për ta implementuar një politikë, e cila i duket që është në rregull.

Sidoqoftë, edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet rekomandimin e Komisionit, që ky ligj të mos votohet në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kelmendi, në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

Për të mos e zgjatur më shumë nga ajo që u tha, edhe ne si Koalicion për Kosovë të Re e mbështetim, që do të thotë nuk e miratojmë projektligjin.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Miletqi e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poslanička Grupa Samostalne liberalne stranke smatra da ovaj zakon treba da bude izglasan i protivi se mišljenju Komisije za zakonodavstvo, iz nekoliko razloga.

Prvo, ovaj zakon je na kraju rezultat dijaloga između Beograda i Prištine, i mislim da je to onda na kraju i međunarodna obaveza Kosova, odnosno Vlade Kosova.

S druge strane, znamo da je bilo puno manipulacija imovinom u poslednjih desetak-petnaest godina i zloupotreba dokumentacije o imovini. I zato odlaganje ovog zakona, praktično znači odlaganje rešenja ovog problema sa imovinom, koji je ogroman. Oni koji se zalažu za neusvajanje ovog zakona, ustvari se zalažu za nastavljnje manipulacije imovinom.

Takođe bi se oslobodili i sudovi, koji su pretrpani slučajevima o zloupotrebi imovine i dokumentacijom imovine i katastarskim knjigama. Takođe smatramo da je uloga Evropske unije u radu Agencije za upoređivanje i verifikaciju imovine vrlo značajna, prosto sve odluke bi imali mnogo veći kredibilitet, ukoliko bi ljudi iz Evropske unije bili i učestvovali u radu ove agencije.

U svakom slučaju, ponavljam naš stav: mi mislimo da je zakon dobar i da ga treba izglasati.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar dhe kryesues!

Ne e kemi trajtuar jashtëzakonisht gjatë këtë projektligj dhe kemi pasur mendime të ndara. Një pjesë, e cila e ka thënë mendimin e vet në komision, dhe një pjesë, e cila ka dominuar në Grupin tonë Parlamentar dhe ka premtuar që në bashkëpunim me Qeverinë të ndikojë në leximin e dytë dhe këtë kontribut do ta jap ndërmjet dy leximeve.

Kështu që, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shumicën sot për ta mbështetur deri në leximin e dytë dhe kontributin do ta japë brenda grupit parlamentar dhe në bashkëpunim me Qeverinë dhe gjithashtu edhe me komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Çështja e pronës dhe e të drejtës në pronë është njëri prej problemeve më të ndjeshëm dhe më delikat në Kosovë, posaçërisht që ende nuk e kemi një dokumentacion të mirëfilltë dhe të besueshëm, mbi të cilin duhet të rregullohet kjo e drejtë.

Duke u nisur nga ky fakt, atëherë edhe projektligji për Agjencinë për Krahësim dhe Verifikimi të Pronës është tejet i rëndësishëm. Rëndësia e tij nuk qëndron vetëm në funksionimin e kësaj agjencie, por ndryshon rrënjësisht praktikën e deritashme për rregullimin e kësaj çështjeje.

Rreth kësaj çështjeje kam disa vërejtje parimore dhe disa konkrete, por unë sot do t'i përmendi vetëm vërejtjet konkrete, të cilat janë në këtë projektligj.

Nën një, neni 2, pika 3, janë të paqarta. Për atë që kam kuptuar, kjo pikë lejon paralelizma ndërmjet institucioneve të gjyqësisë dhe kësaj agjencie. Këtu thuhet se asgjë nuk i cenon të drejtat e parashtruesve të kërkesave që të ushtrojnë pranë gjykatave kompetente kërkesa që nuk përfshihen në kërkesat e paraqitura në paragrafin 2 të këtij neni.

Pra, kërkesa mund të bëhet edhe në gjykatë, edhe në agjenci. Domethënë, ky ligj u jep mundësinë e njëjtë, si gjykatave, edhe agjencisë.

Nën dy, neni 3 e përkufizon bordin dhe kompetencat e tij. Për këtë kam dy vërejtje:

- a) projektligji fare nuk merret me kualifikimin e anëtarëve të bordit, e as me përvojën, përkatësisht karrierën e tyre të mëparshme.
- b) pse dy anëtarë të bordit, të cilët emërohen nga Kuvendi i Kosovës, duhet të propozohen nga kryeministri?

Esenca e problemit qëndron në faktin se nuk ka kurrfarë procedure për identifikimin e kandidatëve të mundshëm. Do të thotë, kryeministri ka të drejtë ta emërojë secilin individ që ai mendon se duhet ta ketë në këtë, meqenëse aty nuk kërkohet as përgatitje e caktuar profesionale.

Nën 3, neni 7 - përgjegjësitë e sekretarisë, në pikën 2.2 thuhet: "Kur gjenden dallimet apo mospërputhjet, njoftohen palët".

Nën 4, neni 11, kërkesat e pranuar dhe rastet e krijuara në pikën 3, ndër të tjera thuhet se për zgjidhjen e kontesteve për bazë merren kopjet origjinale të skenuara. Së pari, nuk ka kopje origjinale, meqenëse dokumenti është ose kopje, ose origjinal. Së dyti, dokumenti i skanuar nuk është dokument origjinal, por një foto e tij. Së treti, dokumentet origjinale, në këtë rast ato për pronë duhet të jenë në pronësi të institucioneve shtetërore, e jo ato të punojnë me kopjet e tyre.

Në nenin 16, e drejta e ankesës, pika 11, thuhet se pas ankesës në Gjykatën Supreme, nëse ofrohen fakte të reja, ato mund të mos merren parasysh. Nëse vërtet këto fakte nuk

kanë qenë të mundshme të sigurohen deri në këtë moment, atëherë ato kurrësi nuk duhet të refuzohen. Pra, rasti të kthehet në rigjykim, meqenëse faktet e reja imponojnë procedurë të re.

Në nenin 19, mjetet juridike, në pikën 1, ndër të tjera, si mjet juridik përfshihen: “Shkatërrimi i strukturave të paligjshme”. Nuk është e precizuar se çka nënkuptojmë me këtë shprehje.

Në nenin 22, pronat nën administrimin e agjencisë, në pikën 1.3 thuhet se nën administrim merret prona: “...pas largimit të banuesit aktual, në rast se kërkuesi nuk mund ta riposëdojë pronën.” Sipas kësaj pike, agjencia në secilin rast nuk garanton se poseduesi mund ta marrë sërish në pronësi pronën që ka. Nëse nuk mund ta bëjë këtë, atëherë është i pakuptimshëm dhe i panevojshëm ekzistimi i kësaj agjencie.

Unë vlerësoj se ky projektligj duhet të tërhiqet dhe pajtohem plotësisht me komisionin që ky ligj nuk duhet të procedohet më tutje dhe i ftoj deputetët që të mos e aprovojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë e mora fjalën si anëtar i Komisionit për Legjislacion për atë se çka kemi debatuar ne pak si gjatë në atë në afatin kohor dhe cili ka qenë interesi i përgjithshëm për trajtimin e këtij projektligji.

E para, pajtohem me mendimin e shumicës së kolegëve të mi, anëtarë të komisionit, sepse kemi parë edhe një mosinteresim për këtë çështje shumë të rëndësishme nga vetë propozuesi, që nënkupton Qeveria e Republikës së Kosovës, derisa komisioni ka këmbëngulur që ne ta kemi një trajtim të veçantë, sepse ky është ligj politik dhe që derivon nga marrëveshjet e arritura në bisedimet teknike me palën serbe.

Dhe, besoj që edhe sot është dashur të trajtohet në mënyrë shumë më serioze, sidomos nga mazhoranca, sepse po shihet që nuk është interes i veçantë dhe unë po e jap tash mendimin tim se si ne e kemi trajtuar.

Ajo çka unë kam menduar personalisht dhe e mbroj është se duhet të ekzistojë një mekanizëm, që e bën verifikimin e pronës në Kosovë, sepse prona publike apo shoqërore është keqpërdorur dhe ka tendenca që të keqpërdoret edhe më tutje, por gjithnjë duke u mbështetur në ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kur ne kemi kërkuar që të kemi arsyeshmëri pse vjen një projektligj i tillë, atëherë zëvendëskryeministrja Edita Tahiri na ka dërguar konkluzionet e arritura nga kjo marrëveshje. Dhe, këtu do ta them edhe një çështje, që lidhet edhe me vetë kryetarin e Kuvendit. Në konkluzionet e arritura thuhet që BE-ja e mbikëqyr një agjenci të tillë, ndërsa në projektligjin që na rezulton me shkelje të kushtetutshmërisë dhe të ligjeve tjera, thuhet që ata e udhëheqin agjencinë, domethënë ose ka emërim nga BE-ja.

Prandaj, këtu është ai dallimi. Nëse marrëveshja ka qenë konform Kushtetutës, pse ne duhet që me projektligj e me ligj ta shkelim Kushtetutën dhe Ligjin për ndryshimin, që ka qenë për përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë. Dhe, këtë sqarim besoj që edhe zëvendëskryeministrja duhet ta japë.

Dhe e fundit, në letrën që ka ardhur dhe parashkruhet qartë: zonja Edita Tahiri ia bën të qartë Kuvendit, thotë po ju dërgoj, kryetar, konkluzionet e fundit të të gjitha marrëveshjeve që janë arritur. Pse ato nuk u janë shpërndarë deputetëve të Kosovës? Pse të gjitha ato marrëveshje nuk na shpërndahen dhe ne të njoftohemi, pasi qenkan në Kuvendin e Kosovës, apo në zyrën e kryetarit të Kuvendit? Edhe ne të njoftohemi për çdo detaj, të mos flasim në mënyrë hipotetike, siç kemi folur deri më sot, kur thuhet në një dokument të tillë. Të dihet kanë ardhur, apo nuk kanë ardhur. Nëse zëvendëskryeministrja thotë që i ka dërguar në Kuvendin e Kosovës dhe nuk janë shpërndarë, ta dimë se ku është kjo e metë, apo ku është faji.

Ndërsa, sa i përket këtij projektligji, unë them që duhet të tërhiqet dhe të jetë konform asaj marrëveshje dhe konform Kushtetutës dhe Ligjit për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Zonja Tahiri mund ta merrni fjalën, në emër të Qeverisë.

EDITA TAHIRI: Të nderuar deputetë,
E para, besoj që ndoshta nuk ka nevojë të flas edhe një herë për rëndësinë që ka zgjidhja e çështjes së pronës në Republikën e Kosovës dhe dua të ju përmend që shumë vende të rajonit me dekada nuk e kanë zgjidhur këtë problem.

E dyta, për vendet që kanë qenë në luftë, pas luftës kanë filluar kohërat e dëmshpërblimeve dhe të kthimit të atyre gjërave, të cilat i kanë marrë nga vendi që e kanë okupuar.

E treta, duhet pasur parasysh që në këtë projektligj me të vërtetë ka pjesëmarrje të Bashkimit Evropian, por ju e dini se me ndryshimet kushtetuese që kanë reflektuar përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur është aty një nen, i cili ua zgjat mandatin ndërkombëtarëve edhe për një kohë. Tash do të jua lexoj, zoti Gashi. Dhe, ky projektligj është në harmoni me ato çështje. Do të jua lexoj nenin.

Tjetër që desha të ju them: ne i kemi ndërtuar kadastrat e shtetit tonë, por mos harroni - ato nuk janë të kompletuara, sepse një pjesë është ende në Serbi. Dhe, kthimi i tyre si skanim i vërtetuar nga Bashkimi Evropian është një formë legjitime dhe kredibile, sepse Serbia, ua kam thënë edhe herët tjera, në procesin e suksesionit sot e kësaj dite, shteteve të reja, që kanë lindur nga ish-Jugosllavia, nuk ua ka dhënë dokumentet origjinale, por vetëm të kopjuara dhe të vërtetuara.

Tjetër? Mos harroni se Agjencinë për Krahësimin dhe Verifikimin e Pronës nuk e mbikëqyr Bashkimi Evropian. Kjo është agjenci, ku vendimet finale i merr Gjykata

Supreme e Republikës së Kosovës, ndërsa sa u takon konkluzioneve është një komision, të cilin e udhëheq BE-ja, që merret me zbatimin marrëveshjeve teknike, po jo me mbikëqyrje të agjencisë.

E fundit që desha të ju them, kjo agjenci është një formë e shndërrimit të Agjencisë Kosovare të Pronës në këtë agjenci të re, ku do të integrohet edhe Agjencia e Pronës, sepse ajo tashmë është zvogëluar, meqenëse e ka zgjidhur një pjesë të madhe të çështjeve.

Edhe e fundit, edhe një herë po ju them, të gjitha marrëveshjet e arritura në dialogun teknik unë i kam dërguar te kryetari i Kuvendit dhe Komisionit për Legjislacion ia kam dërguar kopjen e letrës së komunikimit, bashkë me marrëveshjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Albulena Haxhiu, replikë.

ALBULENË HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Shumë shkurt! Zonja Tahiri tha që një pjesë e kadastrës është në Serbi. Po, ju po harroni zonja zëvendëskryeministre, pasi ju vetë ia keni lënë kadastrën Serbisë, ju vetë jeni marrë vesh që kadastra të mbetet atje. Ne nuk kemi faj, apo jo?

KRYESUESI: Zonja Tahiri, kundër-replikë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Zonja deputete Haxhiu,

E kam parasysh që në kohën kur ne e kemi bërë luftën dhe kur populli ka vuajtur, ju keni qenë ende e vogël dhe ma merr mendja që nuk ke pas shumë mundësi ta lexosh historinë e shtypjes e të okupimit të Kosovës, por nëse nuk të ka interesuar çështja e okupimit të Kosovës, mjafton t'i lexosh okupimet e popujve në botë dhe ta kuptosh se kur ndodh okupimi, ndodhin edhe dëmtime të ndryshme. Sot diskutoam për një prej dëmtimeve shumë të rëndësishme, pra për gratë e dhunuara, por ka edhe shumë të tjera.

Në anën tjetër, ka pasur edhe dëmtime të shtetit dhe të dokumentacioneve shtetërore, po unë do të thosha që kjo çështje është në interesin e Kosovës.

Zgjidhja e çështjes së pronës, t'ua përmendi, Shqipëria 20 vjet ende nuk e ka nisur zgjidhjen. Jo, që kam optimizëm se ne e bëjmë shpejt, po së paku të mundësojmë që të kthehen dokumentet dhe të bëhet verifikimi dhe krahasimi.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Tahiri. Por, më duhet që edhe ju të jua tërheq vërejtjen që të mos ngacmoheni në raporte personale. Albulena e ka një traditë në familje dhe nuk është mirë, përderisa ne e njohim, që të reflektojë kjo prapë, çështje të cilat dikush nuk i di.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim. Në sallë janë 55 deputetë. Ne mund t'i shqyrtojmë ligjet, edhe ndonjë, ose e ndërpresim. Atëherë, e ndërpresim. 57 deputetë janë tash...

(Ndërprerje e incizimit)

Përnjëmend, në qoftë se ka kuorum, e vazhdojmë seancën. I kemi edhe katër pika, i kryejmë! Tash u bënë 80 veta në sallë.

(Ndërprerje e incizimit)

Unë nuk e kam lëshuar vendin, as nuk e kam ndërprerë seancën.

(Debat nga salla)

(Ndërprerje e incizimit)

Domethënë, pika e gjashtë e rendit të ditës, ishte kërkesa të mos miratohet, të kthehet, nuk mund të votohet, se s'ka kuorum. E lëmë për nesër.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale

Ministri ka kërkuar që kjo pikë të shtyhet, për arsye se ai nuk është këtu. Nuk kemi kuorum për ta votuar, por besoj se është në rregull, meqenëse ka kërkuar me shkrim, të miratohet që të shtyhet në kohën kur ai të jetë këtu.

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Dardan Gashi, i cili nuk është këtu, që para Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë ligjin.

Grupi Parlamentar i LDK-së është këtu, të tjerët më pak, disa kanë mbetur, disa kanë shkuar.

Vetëm 37 deputetë janë në sallë. Është mirë që të mos e zgjatim më, prandaj e ndërpres seancën dhe për vazhdimin mendoj që mund ta diskutojmë a do ta bëjmë nesër, apo të hënën.

(Debat nga salla)

Regjia, janë 37 deputetë në sallë. Ja ku e kam unë numrin e deputetëve. Janë 37, sipas Sekretarisë. Vazhdojmë nesër. Mirupafshim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes më 15 mars 2013
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z.Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Kosovës, të filluar më 14 mars 2013.

Po ta kishim numrin e mjaftueshëm të deputetëve do të votonim për pikën e gjashtë të rendit të ditës, por pasi nuk e kemi këtë numër, vazhdojmë me pikën e shtatë:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale

Jemi në vazhdim të seancës. Urdhëro! Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, faleminderit!
Dje ka humbur kuorumi dhe dihet që nuk ka qenë e mundur të merren qëndrimet.

Unë kërkoj që sot të vazhdojmë me rendin e ditës siç e kemi për seancë të re, se edhe kjo në fund kërkon të votim, domethënë është debati - seancë e re - dhe nuk shohim asnjë arsye që të debatojmë, e në fund të mos kemi përsëri kuorum.

Prandaj, ju lutem, procedoni sipas rendit të ditës. Nuk ka rëndësi ajo që nuk ka përfunduar. Mund të përfundojë edhe më vonë, a tjetër ditë. Sot e kemi datën e caktuar për seancë të re.

KRYETARI: Ne e kemi në gjysmë seancën e djeshme dhe duhet ta kryejmë rendin e ditës. Kur ta kryejmë rendin e ditës së djeshme, merremi vesh për seancë të re, që e kemi në rend dite. Mund ta vazhdojmë sot, por seanca mund të vendosë edhe ndryshe.

Mendoj që është krejt e paarsyeshme që ligjet për seancën që është dashur të kryhet dje nuk ka pasur kuorum. Kjo është një çështje tjetër.

(Debat në sallë)

Ismet, e ke fjalën. Fjala për kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,
Ajo që nuk po më pëlqen janë - ndërhyrjet. Nuk ka nevojë nga anash të na ndërhyhet. Kur është dashur të votohet, i keni pasur 115-116 deputetë. Shikojeni sa deputetë të opozitës kanë qenë kur është ndërprerë seanca. Dhe, seancën realisht e ka pamundësuar që të vazhdohet PDK-ja. Kjo është e qartë. Merreni shikojeni! Dje 37 deputetë i keni pasur, 20 e më shumë, afër 30 i keni pasur të opozitës.

Prandaj, nuk janë mirë këto lojëra që po na bëhen, se puna po bllokohet. Tash po e fillojmë këtë seancë, në pjesën e dytë këta sërish do të shkojnë në shtëpi. Kështu po i bie kjo.

Prandaj, nuk është korrekte edhe nga anash të na thuhet: “E kemi lëshuar se ju jeni lodhur, shkoni pushoni!”.

Prandaj, zoti kryetar, unë e di që e keni përgjegjësinë si udhëheqës dhe është vështirë t’i menaxhosh njerëzit, që nuk menaxhohen. Ne kërkuam që të vazhdojë seanca dhe shikojeni kush po e humb kuorumin. Ndërkaq, kur LDK-ja del për arsye parimore dhe ligjore, thuhet diçka tjetër.

Pra, kërkesa jonë ishte që të vazhdojë seanca. Dhe, unë kërkoj që seanca të vazhdojë ashtu siç është në rend të ditës. Nëse jo, le të vendosë kjo seancë, vendosin deputetët.

KRYETARI: Atëherë, cili është mendimi i grupeve tjera parlamentare? Po fillojmë me kryetarin e Grupit të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë së pari kërkoj nga zoti Beqiri që të jetë korrekt. Ne grupet parlamentare, përkatësisht deputetët u dakorduam dje, meqë u bë vonë, ta ndërpresim dhe të shkojmë. Nuk po e fajësoj asnjë grup, as grupin tjetër, po thjesht me mirëkuptim ka qenë që të ndërpritet dhe seanca të lihet për sot.

Kështu, ne si grup parlamentar nuk kemi asgjë kundër, që nëse doni vendosim për seancë të re, nëse doni vazhdojmë aty ku e kemi lënë, mirëpo duhet ta kemi parasysh se janë disa ligje, të cilat duhet të votohen dhe të kalojnë. Tash si të vendosë seanca, absolutisht nuk kemi diçka kundër.

KRYETARI: Unë mendoj që veprimi i djeshëm ka qenë i paarsyeshëm, sepse në shumë parlamente seancat fillojnë pasdite, në kohën kur ju e keni ndërprerë.

Vazhdojmë! Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri, për mocionin e Lidhjes Demokratike.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë që dje seanca është ndërprerë disi dhe madje në mënyrë shumë të çuditshme. Na ka rastisur të dalin prej seancës disa deputetë për shkak se u ndërpre seanca, pastaj e kemi parë që po vazhdon dhe jemi kthyer, e kur jemi kthyer prapë na është thënë që është ndërprerë për shkak të mungesës së kuorunit.

Është e qartë në secilin parlament që përgjegjësinë dhe barrën kryesore për kuorumin duhet ta ketë pozita, pra ata që konsiderojnë që e kanë shumicën në Kuvend, për shkak se ata mund ta mbajnë apo ta prishin kuorumin. Po ashtu është shumë e vërtetë kjo që e thotë zoti Beqiri, që dje në fakt, shumica e deputetëve në Kuvend kanë qenë të opozitës, jo të pozitës.

Pra, dihet kush e ka ndërprerë, ose arsyeja pse është ndërprerë dje, pse dje ka munguar kuorumi.

Ne si grup parlamentar konsiderojmë që dy debatet, të cilat janë të listuara për sot janë tejet të rëndësishme për aktualitetin politik dhe mendojmë që duhet të vazhdojmë me atë rend dite që e kemi paraparë për sot, pra me dy debatet. Ndërkohë, të merremi vesh për këto pikat tjera se kur do t'i procedojmë. Mund t'i procedojmë sot pas këtyre debateve, apo ndonjë ditë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, deputetja Donika Kadaç-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAÇ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Nuk është hera e parë që kjo pozitë në fakt e ka prishur vetë kuorumin dhe e ka lëshuar seancën. Kjo ka ndodhur edhe dje. Ne pajtohemi që të vazhdojmë me dy pikat e rendit të ditës, sepse të dyja janë me prioritet dhe pastaj vazhdojmë, kthehemi te pikat të cilat kanë mbetur.

Dhe, herëve tjera do të duhej pasur pak më shumë kujdes dhe pak më shumë etikë në veprimet parlamentare, sepse shumë shpesh ky Kuvend po e humb edhe nivelin për shkak të veprimeve të tilla. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetarja e Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani, e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për ministrat dhe deputetët,

Duke pas parasysh se dje ishte një marrëveshje, kur iu kërkua kryesuesit të seancës që të ndërkrehet seanca për arsye të lodhjes së deputetëve dhe dalje-hyrjes së tyre pa kuorum brenda seancës, e nuk duhet të thuhet se është lëshuar seanca nga deputetët e pozitës, mirëpo kemi kërkuar që seanca e djeshme të vazhdojë sot.

Në rast se vendos ky Kuvend, që seanca e re, e cila është paraparë për sot, atëherë urdhëroni votoni. E drejta e çdo deputeti është të vendosë a do të jetë seancë e re sot, apo do të vazhdojë seanca e djeshme.

KRYETARI: SLS-ja, Sasha Milosavljević e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poslanici Samostalne liberalne stranke smatraju da treba da nastavimo sednicu koju smo juče prekinuli, jer stvarno imamo važne zakone, koje trebamo izglasati, i mi smo za to da se, ukoliko danas na vreme završimo sednicu, koju smo juče prekinuli, da nastavimo sa debatama koja su zakazana za danas. Hvala!

KRYETARI: Grupi “6+”, kryetarja e Grupit, Myfera Shiniq.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim sayın başkan,

Meclisin işlevselliği doğrultusunda dün kaldığımız noktadan devam etmemiz gerektiğine ve ondan sonra sıralı gündeme geçmemizi kabul ediyoruz. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Faleminderit!

Kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri, e ka sërish fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Kur përdoret kërkitimi për korrektësi, unë e kërkoj të kundërtën: këta le të jenë korrektë. S'po ua përmendi emrin. Nuk ka pas kurrfarë marrëveshje që të ndërpritet seanca. Nëse kanë qenë pikat aq të rëndësishme, meqë tash po na moralizojnë këtu, pse nuk kanë ndenjur dje në seancë? Pse nuk kanë qëndruar në seancë partitë në pushtet, meqë qenka e rëndësishme për këto pika, sipas tyre.

Por, kjo është demagogji. Prandaj, qëndrimi ynë dhe kërkesa jonë është që të vazhdohet me rendin e ditës dhe pastaj për të tjerat merremi vesh. Ky është minimumi i korrektësisë, që duhet pasur, në qoftë se dëshirojmë ta respektojmë një rend dite, për të cilin jemi marrë vesh.

Po të ishin të rëndësishme, dhe ne i llogaritim të rëndësishme sepse kemi qëndruar në sallë, ne opozita, do të qëndronin edhe të tjerët. Kjo është ajo.

KRYETARI: Vetëm edhe Xhavitit, pasi në rolin e nënkryetarit e ka udhëhequr dje seancën. Fjalën ia jap Xhavitit, e pastaj vazhdojmë edhe me ju, nëse doni.

XHAVIT HALITI: Faleminderit!

Zonja dhe zotërinj kolegë deputetë,

Më e vështirë është të udhëhiqet sesa të diskutohet, por nganjëherë edhe kur e merr për barrë të udhëheqës ndodh që gabon, ose të futin të tjerët në lajthitje, ndonjë këshilltar eventualisht mund të të fusë në lajthitje, ashtu siç më ndodhi mua dje, pjesërisht.

Unë dua të kërkoj korrektësi prej të gjithë juve për dje. Nuk është e vërtetë që nuk jeni ngritur të gjithë në këmbë për të dalë. Të gjithë, pa përjashtim. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kanë qenë pothuajse të gjithë në këmbë dhe ka pasur edhe kërkesa “mjaf!” , duke ma treguar orën, “më nuk qëndrojmë”.

Deputetët janë ftuar me zile disa herë dhe, më vjen keq, por kur është ndërprerë seanca, në sallë janë bërë më shumë se 70 deputetë. Domethënë para se të ndërpritej seanca, kur nuk kishte kuorum, ishin 53-54 deputetë në sallë. I ramë ziles që deputetët të futen në sallë, nuk hyri askush. “S’ka kuorum”, thashë, “duhet ndërprerë, si duket”. Në momentin që e kam thënë këtë janë futur në sallë ata që kanë qenë prapa në bife dhe janë bërë rreth 70 deputetë, besoj. Dhe, pastaj kanë filluar të dalin. Një pjesë e deputetëve, këta të LDK-së kanë dalë jashtë, të PDK-së kanë dalë jashtë, disa kanë mbetur, SLS-ja ka dalë jashtë, AKR-ja nuk e di a ka mbetur ndonjë, “Vetëvendosje” kanë dalë jashtë e janë kthyer kur e kanë parë që janë kthyer të LDK-së.

Prandaj, të mos luajmë me këto çështje. Përgjegjësia është e të gjithëve njësoj, po besoj. Ka qenë një lojë kush kujt po ia le “gile”. Prandaj, mos e politizoni këtë çështje. Nuk ka nevojë t’i lihet faji kurrkujt. Jeni marrë vesh - s’jeni marrë vesh, nuk është çështje që duhet të diskutohet sot, por realiteti është ky. Kur ka dalë PDK-ja jashtë, pastaj jeni koncentruar, keni thënë nuk janë. Me 37 veta nuk mbahet seanca.

Ky ishte detyrim imi për ta sqaruar çfarë ka ndodhur dje dhe nuk po dua që t’i dal në krah as grupit, nga i cili jam unë, PDK-së, por po dua ta them një realitet, që ka ndodhur dje.

Është e drejtë e grupeve parlamentare. Kjo është praktikë presje është krijuar Parlamenti, që për çështje të ndryshme e lëshojnë mbledhjen. Publikisht jam deklaruar, edhe në këto raporte, në cilin pozicion duhet të jetë në Parlamentin e Kosovës. Opozitës i lejohen më shumë këto çështje, megjithatë unë mendoj që Grupi Parlamentar i PDK-së nuk është fajtor, siç po interpretohet këtu, por gjendja në sallë ka qenë e tillë, kur jemi ngritur të gjithë në këmbë për të dalë. Kur u mbush salla, unë thashë ‘në rregull, e vazhdojmë’. Pastaj, e lëshuat me radhë. Ju, të dyja grupet u koncentruat në sallë. Prandaj, jeni kthyer nga jashtë brenda. E vërtetë është, unë e kam parë.

Dhe, kjo është gjendja. Nuk është mirë të shtyhet më tutje. Unë kërkoj nga kryetari që propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike ta hedhë në votim dhe të shkojmë më tutje.

KRYETARI: Ju lutem! Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar,

Ju e dini që të dyja këto materie i kemi diskutuar gjatë në Kryesi dhe i kemi sistemuar në dy ditë, mu për t’i respektuar të dy agjendat. Të parën, e para sepse janë ligje të rëndësishme, të dytën për sot, sepse janë diskutime të rëndësishme. Dhe, për rëndësinë s’duhet të bisedojmë më.

Për mbledhjen e djeshme, nuk është e vërtetë që kanë qenë në sallë 70 deputetë, sepse mbledhja në të vërtetë është iniciuar jo publikisht që të ndalet, sepse mungonin deputetët që ta votojmë ligjin që e diskutuam. Po të ishin 75 deputetë, ne do ta votonim dhe do të vazhdonim. Kaq! Mbledhja ka ardhur në krizë, sepse nuk kanë qenë 61 që ta votojmë ligjin, të cilin e mbaruam së diskutuari. Puna tjetër është, që duhet të vlejë për të gjithë deputetët, s’ka të bëjë me një grup, që këtu është bërë zakon, që si të bie terri kujtojnë që duhet të ndërpritet mbledhja e Kuvendit. Po të punonim, ne do t’i kryenim ato pika. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ne...

(Ndërhyrje, Xhavit Haliti: Veç dy fjalë.)

XHAVIT HALITI: Është shumë e vërtetë që kur është bërë numërimi për gjendjen në sallë kanë qenë 53-54 deputetë, por kur kemi thënë që të ndërpritet mbledhja, në sallë

kanë qenë më shumë se 70 deputetë. Kanë hyrë nga bufeja. Shumica, do të thotë, ky numri 20 i deputetëve shtesë kanë qenë në bufe duke pirë kafe.

KRYETARI: Mirë. Ju lutem! Vazhdojmë! Ne e kemi një mocion, që duhet ta hedhim në votim. Është mocioni i kërkuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Ismet Beqiri, që seanca e ndërprerë të vazhdojë më vonë dhe të fillojmë me seancën që e kemi të planifikuar për sot, për dy debatet.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Të pranishëm janë 90 deputetë. Votojmë tash!

Me 47 vota për, 35 kundër, 1 abstenim, e vazhdojmë seancën e re.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes më 19 mars 2013

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z.Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 14 mars 2013.

Konstatoj se në sallë janë 64 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushtet që të vazhdojmë me punën.

Vazhdojmë me pikat e mbetura.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Debati për këtë shqyrtim të parë të Projektligjit është përfunduar në seancën e 14 marsit 2013.

Tani shkojmë në votim. Sipas prezencës elektronike, deri tani i kemi 73 deputetë. Kërkoj që të vendosen të gjitha kartelat dhe të marrin pjesë në votim. E votojmë shqyrtimin e parë të Projektligjit për Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Nuk votojmë rekomandimin, e votojmë Projektligjin. I kemi diskutuar ato çështje dhe unë sot s'i përsëris. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Në sallë, prezencë fizike, janë 79 deputetë, me elektronikë është e njëjta, një më pak, se e tërhoqi tash. Do të thotë e kemi të barabartë praninë, edhe fizike, edhe elektronike.

Me 49 vota për, 23 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raport me rekomandime.

Unë e hedh në votim si gjithëherë projektligjin.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Ferid Agani, që para deputetëve të Kuvendit të paraqet dhe arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në kuadër të pakos reformuese legislative të Ministrisë së Shëndetësisë si dhe nevojës për harmonizimin e legjislacionit aktual me projektligjet e tjera reformuese, Ministria e Shëndetësisë ka finalizuar ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale.

Këtij projektligji i nënshtrohen të gjitha autoritetet publike, ndërmarrjet publike e private si dhe personat juridikë dhe fizikë që merren me prodhimin, tregtimin e produkteve dhe pajisjeve medicinale si dhe aktivitetet tjera të lidhura me to, produkte të cilat përmbajnë substanca radioaktive apo që kanë të bëjnë me sigurinë e përdorimit të rrezatimit radioaktiv, preparateve imunologjike dhe derivateve të gjakut, preparateve vitaminoze, minerale dhe herbale, preparateve dietale dhe kozmetike me veprim terapeutik, lëndëve të para për prodhimin e produkteve medicinale, si dhe gjysmë produkteve të produkteve medicinale.

Duke i pasur parasysh rrethanat ekzistuese jemi të bindur që ndryshimi dhe plotësimi i këtij projektligji do të ketë efekte pozitive, sepse do të mundësohet kontrolli i plotë i produkteve dhe pajisjeve medicinale si dhe do të rregullohen procedurat e regjistrimit konform legjislacionit të Bashkësisë Evropiane.

Anë tjetër pozitive është se do të bëhet klasifikimi detaj i produkteve medicinale, produkteve herbale, produkteve galene, vitaminave si dhe klasifikimi i pajisjeve medicinale, do t'u përcaktohen kushtet e licencimit prodhuesve farmaceutikë dhe të prodhuesve të pajisjeve medicinale, kushtet për licencimin e qarkulluesve farmaceutikë me shumicë e pakicë si dhe qarkulluesve të pajisjeve medicinale me shumicë dhe pakicë.

Në këtë mënyrë ligji do të ketë ndikim me rëndësi edhe në rritjen e të hyrave në buxhetin e Kosovës, pasi do të shtohen kategoritë e të hyrave.

Ndryshimet e Ligjit për produktet dhe pajisjet medicinale do të ngrisin nivelin e kontrollit të cilësisë së produkteve farmaceutike dhe pajisjeve medicinale si dhe efektivitetin e procedurave e regjistrimit të tyre sipas standardeve ndërkombëtare.

Gjatë procesit të elaborimit të projektligjit theksi i veçantë është vënë në harmonizimin e dispozitave ligjore me direktivat e Bashkësisë Evropiane dhe mund të thuhet lirisht se ky projektligj është në përputhshmëri të plotë me standarde të Bashkësisë Evropiane, natyrisht në përputhje me nivelin e zhvillimit të sektorit farmaceutik në vendin tonë, pra kapaciteteve zbatuese të tij.

Po ashtu, vëmendje e veçantë i është kushtuar funksionalizimit optimal të procedurave të importit dhe eksportit, si dhe prodhimit të ndërlidhur në kontekstin e harmonizimit të politikave të tjera reformuese të Ministrisë së Shëndetësisë.

Grupi që ka punuar në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale është konsultuar me shumë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe me grupe të ndryshme të interesit, që kanë të bëjnë me këtë, si Shoqata e Farmacistëve të Kosovës, Katedra e Fakultetit të Farmacisë, të Fakultetit të Mjekësisë dhe pjesëtarët e Shoqërisë Civile.

Në veçanti duhet theksuar kontributin e ekspertëve nga Republika Federale e Gjermanisë dhe Polonia, të cilët kanë qenë bartës të projektit mbështetës të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale, të financuar nga Komisioni Evropian.

Projektligji i ka 5 kapituj dhe 42 nene, nëpërmjet të cilit:

- Rregullon në mënyrë të detajuar dhe përcakton qartë qëllimin dhe fushën zbatimit të tij, duke përcaktuar në mënyrë të qartë edhe përkufizimet e termave të përdorura;
- Rregullon në mënyrë të detajuar prodhimin e produkteve mjekësore duke përcaktuar standardet më të larta të cilësisë;
- Përcakton kriteret dhe kërkesat që duhet plotësuar për importin e produkteve,
- Përcakton rregullat dhe kriteret për qarkullimin me shumicë të produkteve mjekësore si dhe dispenzimin dhe shitjen me pakicë të produkteve medicinal,
- Rregullon funksionimin e laboratorëve galenike në Republikën e Kosovës,
- Detajon rregullimin e formave të marketing-autorizimit,
- Rregullon dhe përcakton formën dhe mënyrën e zbatimit të hulumtimeve klinike,
- Përcakton mënyrën e prodhimit, të importit dhe eksportit të pajisjeve mjekësore duke synuar standarde në pajtim me direktivat evropiane,
- Përcakton tarifën për kryerjen e shërbimeve dhe gjobat për rastet e shkeljes së dispozitave ligjore me çka garantohen të hyra shtesë në buxhetin e Kosovës.

Po ashtu, përmes këtij ligji është përcaktuar edhe themelimi dhe funksionalizimi i disa organeve dhe autoriteteve që janë përgjegjëse dhe zbatuese të drejtpërdrejta të këtij ligji, siç janë: Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, si organ i pavarur ekzekutiv i Ministrisë së Shëndetësisë, Inspektorati Farmaceutik që ushtron mbikëqyrjen e jashtme të prodhuesve, importuesve dhe qarkulluesve me shumicë dhe pakicë të

produkteve medicinale dhe të pajisjeve mjekësore, që me këtë projektligj përcaktohet si strukturë organizative e Inspektoratit Shëndetësor, laborator i kontrollit të cilësisë së produkteve dhe pajisjeve medicinale si strukturë organizative e Agjencisë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Me këtë projektligj përcaktohen edhe komisionet funksionale të kësaj Agjencie, siç janë Komisioni për Vlerësimin e Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale, Bordi i ankesave dhe Komisioni Etik.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh nevojat e mëdha për rregullimin bashkëkohor të sektorit farmaceutik si dhe në veçanti nevojën e parandalimit të dukurive të shumta negative në këtë sektor të ndjeshëm të sistemit shëndetësor, ju lutem që ta bëni miratimin e këtij projektligji në dëgjim të parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, shqyrtoi në parim Projektligjin për produkte medicinale dhe pajisje medicinale.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të projektligjit vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara të nenit 54 të Rregullores të Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit miratimin në parim.

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin për produkte dhe pajisje medicinale, konsiderojmë se është projektligj i rëndësisë së veçantë duke pasur parasysh faktin se rregullon një fushë të ndjeshme.

Në parim e përkrahim këtë projektligj, megjithatë kemi disa vërejtje. Për shembull te neni 1, te qëllimi i projektligjit, ku thuhet: ligji ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për prodhim, kontrollin e cilësisë, importin e tjera, por nuk përmendet eksporti, kur dihet se në Kosovë tanimë ka prodhues dhe prodhuesve vendorë duhet t'u jepet mundësia e eksportimit të produkteve të tyre.

Gjithashtu te neni 3, paragrafi 1.22, ku flitet për efektin e padëshirueshëm serioz, aty thuhet se efekt i padëshirueshëm serioz është kur rasti përfundon me vdekje, është jetëkërcënues, kërkon hospitalizim të pacientit, e tjerë, ose është defekt i lindur kongjenital. Ne mendojmë se duhet të jetë: shkakton defekt të lindur kongjenital.

Gjithashtu te neni 7, ku flitet për vlerësimin e produkteve dhe pajisjeve medicinale, sipas këtij neni Komisioni për vlerësim përbëhet nga 7 anëtarë, prej tyre janë 4 farmacistë, 2 mjekë dhe 1 anëtar kimist, biokimist apo i fushës përkatëse.

Ne mendojmë se më mirë do të ishte që të përfshihen më shumë ekspertë të lëmive të ndryshme e jo numër i madh i ekspertëve të lëmisë së njëjtë për shkak të shumëllojshmërisë së pajisjeve medicinale, sidomos të pajisjeve medicinale.

Pra, më mirë do të ishte të mbetet siç është në ligjin në fuqi se sa të zvogëlohet numri i ekspertëve siç është në projektligj.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të punojë shumë me përkushtim gjatë amendamentimit të këtij ligji, në mënyrë që ky ligj të jetë sa më i zbatueshëm në praktikë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Bahri Thaçi e ka fjalën.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Ligjin për produktet dhe pajisjet medicinale.

Ky ligj ndikon direkt në rregullimin e sektorit farmaceutik në Republikën e Kosovë, pasi që përfshin fushën e furnizimit me barna dhe pajisje medicinale në të dy sektorët, si në sektorin privat edhe në sektorin publik.

Është interesant se këtu ministri tha që është punuar nga ekspertët, por fatkeqësisht ka lëshime të shumta në këtë ligj. Unë mendoj se ne si Grup Parlamentar do ta përkrahim, por vërejtjet tona do t'i japim nëpërmjet Komisionit Funksional.

Për shembull, në qoftë se nisemi te neni 3, paragrafi 1.5, “produkt medicinal imunologjik”, çdo produkt medicinal i përbërë nga vaksinat, toksinat, serumet ose produktet alergjene, vaksinat, toksinat dhe serumet do të mbulojnë veçanërisht. Domethënë, mendoj se duhet të hiqet kjo “veçanërisht” dhe duhet t’u lihet fushë e barabartë të gjitha vaksinave.

Për shembull, thotë agjentët e përdorur për të prodhuar imunitet aktiv siç është vakcina e kolerës, PSZH vaksinat, vaksinat e polimelitit, vaksinave të lisë”. Do të thotë, këtu nuk është e nevojshme, sepse në njëfarë mënyre këtyre u jepet përparësi kur ceken kështu në ligj, ndërsa të tjerat në njëfarë mënyre injorohen, ose duhet të hiqet emërimi i këtyre vaksinave ose duhen të futen të gjitha vaksinat që përdoren.

E njëjta gjë vlen edhe te agjentët e përdorur për t’ia freskuar gjendjen e imunitetit dhe duke përfshirë në veçanti tuberkulinë dhe tuberkulinë PPD, toksina për test e tjera. Domethënë kjo tuberkulinë dhe tuberkulinë PPD është e njëjta fjalë po përsëri qëndron ajo, ose duhet të hiqen komplet ose duhet të shtohen të gjitha ato testet të cilat ekzistojnë.

Kemi për shembull që nganjëherë krijohet përshtypja që janë bërë disa përkthime bukfalet dhe i ka humbur krejt nenit kuptimi, sikur që e kemi për shembull te neni 3, paragrafi 1.8.3, thotë: “nëse nuk ekzistojnë metodat e kënaqshme për diagnostikim, parandalim dhe trajtimin e kushteve të caktuara shëndetësore”. Po e ceku “kushte të caktuara shëndetësore” ose në qoftë se ekzistojnë metoda të tilla për produktet medicinale janë dokumentuar si të dobishme për personat që kanë një gjendje të tillë shëndetësore. Për shembull, këtu shihet që vetëm është përkthyer, sepse trajtimin e kushteve të caktuara shëndetësore nuk mund ta bëjmë, por mund ta bëjmë trajtimin e gjendjeve të caktuara shëndetësore. Kështu që kemi edhe shumë vërejtje, po besoj se të gjitha këto vërejtje ne do t’i japim në Komision dhe do të kontribuojmë që të dalë një ligj sa më i mirë, sepse ka nevojë shumë për këtë ligj në Kosovë, ku i dimë rrethanat në të cilat jemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet! Në emër të “Vetëvendosjes” e ka fjalën Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryetar!

Projektligjin për produkte medicinale dhe pajisjet medicinale, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka trajtuar dhe do ta votojmë në parim.

Përpos vërejtjeve të vogla teknike, vërejtje parimore nuk kemi, prandaj mendoj që ato vërejtje teknike do të trajtohen në Komision, do të eliminohen dhe ligji do të jetë edhe më i mirë se sa që është tash. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, e ka fjalën deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës duke ditur rëndësinë e këtij projektligji do ta përkrahë në parim edhe pse kemi disa vërejtje të cilat disa sot do t’i elaboroj, ndërsa tjerat gjatë punës që do ta bëjmë në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Vërejtje tek përkufizimet janë: pika 1, pikë 14 të nenit 3 thotë: “produkt i falsifikuar”. Çdo produkt ose pajisje medicinale me përfaqësim të rrejshëm të identitetit të tij juridik përfshin paketimin dhe etiketimin, emrin ose përbërjen e tij lidhur me cilindo përbërës, përfshin eksperimentet dhe fuqinë e këtyre përbërësve, burimit, përfshirë prodhuesin e tij, vendin e prodhimit të tij, vendin e origjinës së tij ose bartësit e autorizimit për marketing ose historinë e tij. Ky definicion nuk përfshin defektet e paqëllimshme të kualitetit dhe nuk paragjykon shkelje të tjera të ligjit ose çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e pronës intelektuale.

Sqarim: Sipas udhëzimit të tij ri të EMA-sa, duhet të jetë: “produkt i falsifikuar”, çdo produkt ose pajisje medicinale që nuk i përmbush kërkesat ligjore të parashtruara me këtë ligj dhe aktet nënligjore që thirren me këtë ligj, sepse tani çdo defekt pa marrë parasysh sa është i madh, trajtohet si falsifikat.

Pika 1.15 të nenit 3 thotë: “produkt galenik”, çdo produkt medicinal i cili përgatitet në laborator galenik të licencuar në përputhje me një farmakope të njohur që nuk prodhohet

në mënyrë industriale dhe nuk prodhohet me metoda që përfshijnë një proces industrial për të cilin nuk kërkohen as autorizim prodhimi, as autorizim marketingu, duhet të shkruhet: “çdo produkt medicinal i cili konform PMP-së prodhohet në përputhje me një farmakope të njohur për të cilin nuk kërkohet as autorizim prodhimi, as autorizim marketingu, sepse laboratorin galen si vend i prodhimit, është i shkrirë në termin “prodhues i produkteve medicinale”.

Pika 1.16 e nenit 3 thotë gabimisht se: “përgatesa magjistrale” - çdo produkt medicinal, i cili përgatitet në barnatoren e licencuar në pajtim me përshkrimin mjekësor për pacientë individualë për të cilët nuk kërkohet autorizim prodhimi apo autorizimi për marketing, duhet të shkruhet: “çdo produkt medicinal, i cili përgatitet në laboratorin galen të barnatores së licencuar, në pajtim me përshkrimin mjekësor për pacientë individualë për të cilët nuk kërkohen autorizim prodhimi apo autorizimi për marketing”

Pika 1.18 e nenit 3, thotë gabimisht se “produktet e linjës kufitare”, produktet të cilat janë afër kufirit nëpërmjet produkteve medicinale të cilat kanë nevojë për autorizim marketingun dhe produktet siç janë suplementet ushqimore kozmetike të cilat nuk kanë nevojë për autorizim marketingu. Klasifikimi i tyre varet ose nga përbërësit ose nga deklarata e prodhuesit, ose të dyja.”, duhet të jetë: “produktet e linjës kufitare”, produktet të cilat janë afër kufirit ndërmjet produkteve medicinale të cilat kanë nevojë për autorizim marketingu dhe produktet siç janë suplementet ushqimore kozmetike, të cilat nuk kanë nevojë për autorizim marketingu, duhet të kërkohet mendimi i ekspertëve që në bazë të dokumentacionit të ofruar dhe natyrës së produktit të bëhet klasifikimi i tyre.

Në pikën 1, pikë 14 të nenit 3, duhet të hiqen fjalët “i prodhuesit, apo importuesit”, sepse këtu kemi të bëjmë me një përkufizim “të personit të kualifikuar”, person i kualifikuar i prodhuesit apo importuesit, personi i punësuar përgjegjës për sigurim të cilësisë posedon diplomë, certifikatë ose evidencë tjetër të kualifikimit zyrtar të fituar pas përfundimit të studimeve universitare në kohëzgjatje prej së paku 4 vjetëve të studimeve teorike dhe praktike në njërin nga këto disiplina shkencore: farmaci, mjekësi humane, kimi, biologji, teknologji kimike farmaceutike”.

Pika 1, pikë 43 të nenit 3 duhet të ndërrohet, sepse titulli nuk korrespondon me përshkrimin e detyrave.

1.43. Inspektimi farmaceutik, kontrolli i kushteve të prodhimit dhe të importit të produkteve medicinale dhe të substancave aktive dhe ndihmesë të përdoret si material fillestar të përdorura në prodhimin e produkteve medicinale që kryhen nga inspektorët farmaceutikë. Sqarim: Këtu kemi përzierje të kompetencave dhe nocioneve, sepse Inspektorati Farmaceutik dhe Inspektorati për Kontroll të Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale kanë përgjegjësi dhe detyra të ndryshme, andaj këtu duhet të flitet për Inspektoratin për Kontroll të Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale, kurse Inspektorati Farmaceutik do të gjejë hapësirë në Ligjin farmaceutik i cili duhet të funksionojë në bazë të këtij ligji.

Kemi edhe vërejtje të tjera, te neni 5 – Organet e AKPPM-së, pastaj në nenin 1.1. të nenit 5, ku inspektorati emërohet si në vijim: “Inspektorati për produkte dhe pajisje medicinale, më tej Inspektorati Farmaceutik, asnjëherë nuk duhet të bëhet përzierja e këtyre dy termave, sepse Inspektorati për Kontroll të Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale i nënshtrohet këtij ligji, kurse Inspektorati Farmaceutik i nënshtrohet Ligjit farmaceutik që në Kosovë nuk e kemi.

Inspektorati Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale, pika 3 e nenit 17, që thotë: “kryeinspektori dhe inspektorët duhet të kenë së paku përgatitje profesionale adekuate për kryerjen e veprimtarisë në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore në pajtim me këtë ligj”, duhet të rishikohet dhe strikt të definohet e jo siç është në formë konfuze. Sqarim: Udhëzuesit evropian me qëllim që të merren vetëm personat e autorizuar përcaktojnë strikt profesionin, andaj ky nen duhet të jetë kështu: “Inspektori, inspektorja duhet të jetë person i kualifikuar sipas nenit 49 të Direktivës 2001/83 që thotë se “person i kualifikuar, person i punësuar përgjegjës që posedon diplomë, certifikatë ose evidencë tjetër të kualifikimit zyrtar të fituar sipas përfundimit të studimeve universitare, në kohëzgjatje prej së paku 4 vjetëve të studimeve teorike dhe praktike në njërin nga këto disiplina shkencore: farmaci, mjekësi humane, mjekësi veterinare, kimi, biologji, teknologji kimike farmaceutike me më së paku 2 vjet përvojë pune në profesion”.

Kemi edhe vërejtje të tjera po ato do të mundohemi që gjatë amendamentimit të këtij ligji t’i përfshijmë në Komisionin Parlamentar. Faleminderit!

(Mbledhjen e merr nën drejtim nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re e ka fjalën zoti Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si Koalicion për Kosovë të Re e mbështesim procedimin e këtij projektligji në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe njëherit përshëndesim punën që është bërë nga ana e ministrit dhe Ministrisë së Shëndetësisë në këtë ligj për faktin se ky projektligj, përveç që ka një rëndësi të ndjeshme, mund të them se renditet në mesin e ligjeve me prioritet sa i përket mirëqenies dhe shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Këtë e them me përgjegjësi të plotë ngase jemi dëshmitarë të gjithë që 13 vjet pas lufte se qytetari i Republikës së Kosovës, në mungesë të laboratorëve të mirëfilltë për kontrollimin dhe verifikimin e kualitetit të produkteve medicinale, në mungesë të informatave të mjaftueshme dhe të një izolimi është bombarduar, konkretisht, vetë Kosova është invaduar nga produkte me prejardhje të dyshimta farmaceutike dhe jo rrallë herë kemi pasur edhe pasoja të këtyre produkteve në shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe në vetë statusin ekonomik e social.

Prandaj, puna që është bërë në këtë ligj, padyshim se paraqet një bazë infrastrukturë ligjore për rregullimin e të gjitha atyre mangësive që deri tash kanë hasur produktet dhe vetë menaxhimi i farmaceutikës në përgjithësi.

Dua të cek se kur jemi te prejardhja, konkretisht ilegaliteti i produkteve të ndryshme medicinale që e ka invaduar Kosovën, vlen të përmendet edhe një fakt se në mesin e shumë produkteve që sot qytetarët e Kosovës, fatkeqësisht me apo pa dëshirën e tyre përdorin është edhe substanca të cilën vetë shteti bazë të cilën e prodhon Finlanda e ka kufizuar përdorimin dhe shitjen e tij, ndërsa te ne është ndër preparatet më të shitura, fatkeqësisht. Fjalën e kam për një mesulidin. Shumë vende të Bashkimit Evropian e kanë ndaluar shitjen e këtij produkti në vendet e tyre, ndërsa vetë Finlanda e ka kufizuar për shkak të efekteve në mëlçi, konkretisht efekteve hepatotoksike, prandaj te ne ky preparat ndodhet në formë të pluhurit si një analgjetik i cili jepet edhe pa recetën e mjekut, konkretisht është ndër preparatet më të shitura.

Prandaj, ardhja e këtij ligji paraqet një bazë ligjore që për shumë produkte të cilat deri tash e kanë vërsuar Kosovën, të bëhet kufizimi i tyre dhe fatmirësisht ne si Komision për Shëndetësi gjithashtu e kemi pasur rastin t'i vizitojmë disa fabrika vendore dhe është bërë një hap edhe sa i përket laboratorëve, edhe pse laboratorët në përgjithësi nuk i plotësojnë të gjitha kushtet për kontrollimin dhe verifikimin, por e kam parë që laboratorët aktualë vendorë janë hapur dhe janë në avancim e sipër, kështu që për një kohë të shkurtër presim një zhvillim pozitiv sa i përket kontrollit dhe verifikimit të produkteve medicinale.

Edhe një herë e them se në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, përshëndesim punën që është bërë në këtë projektligj dhe jemi optimistë duke u bazuar në infrastrukturën ligjore të këtij ligji se ky ligj, padyshim për të ardhmen e këtij vendi do të paraqet një shenjë pozitive konkretisht në ardhjen e produkteve medicinale nga të cilat në kohë të fundit, fatkeqësisht është invaduar qytetari i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, zonja Shinik.

MYFERA SHINIK: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sayın başkan, bakanlar ve milletvekilleri,

İlaç ve Tıbbi Malzemeler Yasa Tasarısı, eski değişikliklerin çoğunu gerçekleştirdiği için yeni bir yasa teklifi olarak karşımıza çıkmaktadır.

Halkımızın sağlığını yakından ilgilendiren ve ilaç sektörünü düzenlemekle, bir şekilde bu sektörü bir düzene koyacaktır. Bugün, ilaç piyasasında lisansı olmayan ve illegal bir şekilde Kosova'ya gelen ilaçların önüne geçilmesi konusunda düzenleme yapmaktadır.

Kosova ilaç sektöründe bu Yasa Tasarısı ile ilaçların Avrupa Standartlarına uygun olmasını şart gerektirmektedir.

İlaçların ithalatı gerçekleşirken Kosova'da, üretimde bulunan ilaç fabrikalarını desteklemek için bu Yasa Tasarısı ile olanak yaratılmaktadır.

Bugüne kadar Avrupa standartlarında üretim yapan, hatta Avrupa'nın çeşitli ülkelerine ilaç ihraç eden Türk ilaç şirketlerinin, Kosova piyasasına girebilmeleri için lisans alabilmeleri adına yıllarca bekletilmelerine anlam veremiyoruz.

Umarız bu Yasa Tasarısı, bu konuyu da düzenleyerek işi kolaylaştıracaktır.

Bu uyarılarla 6+ Parlamento Grubu ilaç ve Tıbbi Malzemeler Yasa Tasarısının birinci okunuşu için de fonksiyonel komisyonda katkımızı sunacağız. Teşekkür ederim

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për produktet dhe pajisjet medicinale do të jetë ligj i cili do ta zëvendësojë Ligjin për produkte dhe pajisje medicinale 03/L-188 të 18 tetorit 2010.

Pra, është një kohë relativisht e shkurtër, për më pak se 2.5 vjet, ku po paraqitet nevoja për ndryshimin e këtij ligji dhe atë me pretekstin kryesor për harmonizimin me direktivat e BE-së, edhe pse direktivat e BE-së që ndërlidhen me këtë ligj, datojnë para vitit të aprovimit të ligjit që është aktualisht në fuqi, pra para vitit 2010.

Këto direktiva të BE-së janë të viteve 2001, 2004, 2007 dhe 2009, andaj duke mos pasur direktiva të reja, nuk shoh arsye se pse duhet ligj i ri për harmonizim me direktivat e BE-së.

Nga ana tjetër, në opinionin e Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave për vlerësimin e ndikimit buxhetor në buxhetin e Kosovës si rekomandim paraqitet se ky projektligj kërkon kosto shtesë si dhe nuk është pjesë e buxhetit të aprovuar dhe për atë më tepër nuk është paraparë as në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2013 - 2015.

Se pse ky ligj nuk është paraparë as në kornizën afatmesme, mendoj se është çështje për të cilën do të duhej sqarim.

Ndër arsyet tjera, se pse ka nevojë për ligj të ri, përmendet edhe funksionalizimi i importeve dhe eksporteve si dhe prodhimit e produkteve medicinale dhe pajisjeve mjekësore, me çka më duhet të them se pajtohem, se ka nevojë për funksionalizim, madje lehtësim do të thosha, sepse aktualisht ka shumë procedura administrative që e bëjnë të vështirë funksionimin e këtyre veprimtarive. Madje, pos procedurave për importim, kam informata që ka procedura e procedura, madje edhe vështirësi të shumta edhe për eksport të produkteve medicinale që prodhohen në vend, që personalisht e shoh si absurde.

Andaj, sinqerisht shpresoj se me këtë ligj do të lehtësohen dhe shpejtohen procedurat administrative, por patjetër që për funksionalizimin e këtij sektori duhet të merren parasysh opinionet e palëve të interesit që drejtpërdrejt ballafaqohen me këto procedura.

Sa i përket vetë projektligjit, ka disa definime në pjesën e përkufizimeve të cilat nuk janë të qartësuar sa duhet, siç është rasti me pikat 1.8.2, 1.8.3 dhe 1.56.2.

Pastaj, hasen gabime në versionin shqip, që thjesht reflekton përkthim të gabuar siç është rasti të fjalës e fundit në pikën 1.24, apo rastet ku përsëritet e njëjta gjë dy herë brenda të njëjtit përkufizim si në pikën 1.2.

Në anën tjetër, disa terme që përdoren këtu, i preferoj ashtu si i kemi njohur më herët, për shembull preferoj të thuhet preparate magjistrare, përpara përgatesë magjistrare, por për diçka të tillë edhe mund të merren mendimet nga ekspertët e ngushtë të lëmisë.

Si një shqetësim tjetër që do ta ngre lidhur me këtë projektligj, është numri i madh i akteve nënligjore që parashihen të dalin nga ky ligj dhe që janë rreth 25 sish.

Ndërsa, në veçanti do të ndalem tek neni 16, që ka të bëjë me përshkrimin e produkteve medicinale. Sot të gjithë jemi të vetëdijshëm se çfarë liberalizimi mbretëron tek ne sa i përket ardhjes deri te cilido medikament, pa recetë dhe pa udhëzim të mjekut, madje pa ndonjë problem të madh mund të vihet edhe deri te ato medikamente që përmbajnë substanca narkotike. Një gjë e tillë duhet të trajtohet me shumë seriozitet.

Në projektligj substancat narkotike, thuhet se janë subjekt i recetës speciale për narkotikë që ashtu edhe duhet të jetë, por çka nëse një gjë e tillë nuk aplikohet. Ndërkaq, te neni 36 nuk figuron asnjë gjobë specifike për këtë shkelje ligjore.

Në parim, ne si Lëvizje për Bashkim do ta votojmë këtë projektligj, por konsiderojmë se duhet të merren parasysh vërejtjet e palëve të interesit, që besoj se do të ftohen në dëgjim publik nga ana e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi në mënyrë që ligji të bëhet sa më funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit zoti nënkryetar!

Zotërinj ministra,

Kolegë deputetë,

Do të mundohem t'i them disa fjalë për ligjin, në aspektin të themi konceptual më shumë dhe nga qasja ndaj kësaj lëmie të cilën besoj të gjithë jemi të vetëdijshëm se kemi shumë vështirësi në rregullimin e saj.

E para, e kam një përshtypje të them se me ligj tentohet për të rregulluar më shumë sa që është nevoja, përmes rregullimit administrativ, përmes shumë licencave të rregullohen shumë çështje të cilat në realitet nuk funksionojnë.

Ne jemi të gjithë të vetëdijshëm që kemi një shpërputhje të madhe prej asaj që është në ligj dhe implementimit të ligjit në praktikë. Nuk do të doja në këtë rast të hy cilat janë problemet apo cilat janë fajtorët, megjithatë duhet të merren parasysh në kohën kur është bërë ligji i ri, të merren parasysh edhe implementimi i ligjit dhe përvojat që kanë qenë në praktikë gjatë implementimit të ligjit.

Nëse e kemi një ligj, i cili me çdo kusht mundohet ta rregullojë çdo fazë dhe në realitet ajo nuk funksionon, unë besoj se duhet shkuar në anën tjetër për ta bërë derregullimin e asaj fushe në mënyrë që të kemi një liri më të madhe të veprimit të gjithë aktorëve në këtë fushë.

Si çështje tjetër do të përmendi se nuk është vetëm rasti i këtij ligji, por edhe i ligjeve e tjera, një tendencë të themi për zhvlerësimin e diplomave universitare. E pash në ligj kemi farmacistë të licencuar, kemi licencë profesionale për farmacistë e tjera. Të them, unë e kam një dilemë tash nëse dikush e kryen fakultetin me tendencën që e kemi në shumë ligje për të krijuar disa leje apo licenca apo profesione të ndryshme të licencimit, nuk di se çka i nevojitet dikujt fakulteti. Nuk di nëse dikush e kryen, është farmacist, pse duhet të shkojë në Ministri për t'u licencuar për farmacist?

Unë e kuptoj që nëse dikush nuk e ka farmacinë dhe do të merret me këtë lëmi do të duhej të ishte një kurs i ri apo do të duhej të ishte të themi një shkollim plotësues për këtë çështje, por ai që e ka farmacinë, nuk besoj që ka nevojë të shkojë edhe një herë për t'iu nënshtruar një kursi të ri apo një provimi të ri që të jetë farmacist i licencuar. Kështu që është një tendencë jo vetëm në këtë ligj, por edhe me ligjet tjera, ne e patëm para një jave, në realitet para një muaji, ligjin e kaluam për Inspektoratin që edhe inspektorët e tregut të futen në një lloj të themi- kurse shtesë apo verifikimi shtesë të dijenisë së tyre, pa një arsye të caktuar. Kështu që besoj se duhet të shqyrtohet kjo çështje, që mos të kemi tendencë të vlerësimit nëse studentët tonë kryejnë diplomat e tyre, ajo diplomë të jetë e vlefshme në të gjitha institucionet, por jo të jetë ajo diplomë e vlefshme vetëm për sektorin privat, kurse në institucionet publike duhet të kryhen kurse të caktuara apo duhet të merren prapë licenca të caktuara për një profesion të caktuar.

Çështje tjetër, që dua të theksoj është çështja e hapjes së barnatoreve. Ligji e përcakton se për të hapur një barnatore duhet të jesh farmacist.

Unë besoj se është një kundërshti me logjikën e biznesit. Në gjithë botën, çështja e menaxhimit prej çështjes së pronësisë është e ndarë, kështu që nuk do të duhej të ishte që patjetër për të hapur një barnatore duhet të jetë farmacist. Tjetër është që në barnatore duhet të jetë farmacisti apo biznesi që regjistron një barnatore, që e ka veprimtari shitjen e produkteve medicinale duhet ta ketë farmacistin, po jo që pronari duhet të jetë farmacist. Ajo besoj se nuk ka kurrfarë logjike në ekonominë e lirë.

Një çështje tjetër që është prapë çështje konceptuale e që e kam përmendur edhe në kohën sa kam qenë në qeverinë e kaluar, është rregullimi i çmimeve nga ana e Ministrisë. Unë mund ta kuptoj që rregullimin e produkteve të barnave të kemi, mund ta kuptoj për shkak të një logjike tjetër, por në realitet unë jam ithtar i madh i tregtisë së lirë, ithtar i madh i asaj që çmimet të përcaktohen edhe nga tregu. Pavarësisht sa është një qeveri, unë nuk besoj që ka qeveri në botë, që është rregullator më i mirë se sa tregu. Tregu është ai që përcakton çmimin e çdo produkti. Rastet e përcaktimit të çmimeve apo përcaktimit të marzhave, themi mund të bëhen vetëm në raste, kur kemi një ofertë plotësisht elastike në treg, që nuk është rasti te produktet medicinale.

Megjithatë, përderisa unë mund ta kuptoj, mund ta pranoj që mund të kemi një rregullim të marzhave apo një përcaktim të çmimeve për barna, nuk mund ta kuptoj pse duhet të kemi për pajisje medicinale rregullim të çmimeve. Ato janë pajisje, duhet të veprojnë tregu i lirë dhe natyrisht që duhet t'i përshtaten të gjitha rregullave të tregut.

Kështu që, propozimi im është që gjatë amendamentimit të ligjit, të kihet parasysh që nëse mbahet bile rregullimi i barnave po të hiqet nga rregullimi i çmimeve, themi për pajisjet medicinale.

Është një çështje administrative, më shumë ka të bëjë me dy komisione që ekzistojnë. Njëri ka të bëjë me Komisionin për vlerësimin e produkteve medicinale dhe tjetri me bordin e ankesave. Unë nuk besoj që është mirë, që të dy komisionet, edhe komisionin edhe bordin t'i emërojë ministri. Ministri duhet ta mbajë ose komisionin e ankesave, emërimin ose të komisionit të ankesave, që unë besoj se është mirë të lihet te sekretari apo te kryeshefi i Agjencisë për Produkte Medicinale, kurse ministri t'i emërojë vetëm ata që i shqyrtojnë ankesat, në rastin konkret që është bordi i ankesave.

Nëse kemi rastin, që ministri i emëron të dyja, besoj që është një, nuk po them që është në kundërshtim me ligjin, po është një çështje që bien rregullimi nga ana e ministrit i të dy lëmive.

Dhe, në fund një çështje që ka të bëjë me gjobat, është një parim në të gjitha ligjet deri më tani kanë pasur gjoba, të them gjoba minimale me maksimale sillet një me tre apo një me pesë. Këtu e kemi një rast të themi ekstrem, është prej 500 deri në 100 mijë euro, që është një me njëzetë dhe është një hapësirë jashtëzakonisht e madhe. Nuk po dua ta paragjykoj thjesht manipulimin me gjobat në themi terren më rastin e inspektimit, ndërsa besoj se sikurse ligjet tjera kjo hapësirë duhet të ngushtohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Është bërë praktikë që në Kuvendin e Kosovës të vijnë ligje pas dy apo tri vjetëve, kur nuk po gjejnë zbatim ato vijnë prapë dhe riamandamentohen dhe riplotësohen.

Në këtë rast është edhe Ligji për pajisje dhe produkte medicinale. Ky ligj nuk i ka as tri vjet që ka kaluar në Parlamentin e Kosovës. Po ashtu, nëse e shohim zbatimin e këtij ligji, ky ligj as 30% e tij nuk zbatohet në praktikë. Sot, në barnatore tona ne gjejmë mjaftë barëra, të cilat shiten pa banderola e që është përgjegjësi e kësaj agjencie, po ashtu edhe e Ministrisë së Shëndetësisë.

Gjithmonë ka pasur probleme sa i përket bashkëpunimit në mes Agjencisë AGPM dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Përveç arsytimit të ministrit unë mendova të dëgjoj më shumë fakte dhe argumente, pse ky ligj do të duhej të ndryshohej tani? I vetmi argument ishte se ky ligj tani është punuar sipas standardeve evropiane.

Po ashtu, edhe ligji paraprak ka qenë i punuar sipas standardeve evropiane, po ashtu kanë qenë të involvuar edhe ekspertë ndërkombëtarë, po ashtu janë konsultuar të gjitha institucionet, të cilat kanë qenë kompetente, mirëpo unë mendoj që kryesorja përmoszbatimin e këtij ligji është mungesa e mekanizmave nga institucionet tona dhe mosvullneti i institucioneve tona për t'i zbatuar ligjet në praktikë, sidomos Ligji për produkte dhe pajisje medicinale, i cili është një ligj shumë i ndjeshëm në sektorin e shëndetësisë.

Fakt tjetër, përmendet që ky ligj do t'i shtojë të hyrat në buxhetin e shtetit. Si keni menduar që do të shtohen të hyrat, përderisa ende nuk janë përcaktuar as në këtë ligj gjërat të cilat do t'u vihen atyre kompanive apo atyre barnatoreve, të cilat e shkelin këtë ligj?

Tjetër fakt me rëndësi janë procedurat tejet të ndërlikuar administrative, të cilat kompanitë private ballafaqohen me këto procedura. Fakt tjetër është edhe monopoli, që është krijuar tash e vite me radhë, vite të kaluara, që është krijuar ndaj disa kompanive ndërsa kompanitë tjera nuk kanë shansin që të afrohen apo që të kryejnë këtë veprimtari.

Unë shpresoj që ligji i ri të gjejë zbatim, të bëjnë ndryshimet e nevojshme deputetët tanë, po ashtu të ketë edhe përkrahjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të japë garanci se ligji do të zbatohet në praktikë duke e shtuar vëmendje sepse është një sektor, i cili është jashtëzakonisht i ndjeshëm dhe i cili asnjëherë sa i përket shëndetësisë në përgjithësi, mbetet varra kryesore e shoqërisë sonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Unë desha vetëm dy çështje, që t'i them lidhur me këtë ligj dhe gjendjen që e kemi ne në Kosovë, sa i përket ilaçeve.

Në bazë të informatave që unë posedoj, tregu i ilaçeve është ndër tregjet më profitabile në Kosovë, ku lulëzon kontrabanda dhe evazioni fiskal, janë ilaçe dhe produkte të llojllojshme dhe nga prodhues të llojllojshëm, nganjëherë të etiketuar e të falsifikuar me tiketa si produkte vendi.

Prandaj, unë mendoj që krahas këtyre vërejtjeve që janë për ligjin ose për shitjen nëpër barnatoret dhe hapjen e barnatoreve, do të thosha që ne kemi nevojë për ilaçe dhe jo produkte. Dhe, ilaçet dihet tani për tani ku prodhohen.

Kosova duhet ta ndërmarrë hapin e duhur, t'i përjashtojë nga tregu i saj të gjitha produktet e ilaçeve, të cilat janë të prodhuara jashtë ISO-standardeve evropiane, dhe në qoftë se tregu kosovar mbushet me ilaçe me ISO-standarde, atëherë dua të them që shëndeti i popullit është tjetër dhe është më i mirë dhe kemi mundësi që të themi se po kujdesemi për shëndetin e qytetarit.

Në këtë çështje shumë e lehtë është që dikush të thotë, çmimet e këtyre ilaçeve janë më të shtrenjta, po shëndeti i njeriut është më i shtrenjtë se sa çmimi i ilaçeve. Faleminderit, zoti ministër! Unë mendoj, që në qoftë se nuk përjashtohet kontrabanda e ilaçeve, në qoftë se nuk përjashtohen ilaçet e falsifikuara nga tregu i Kosovës dhe nuk gjenden

mekanizma, ne mund të bëjmë ligje sa të doni, por shëndetin e popullit nuk mund ta kurojmë.

Fjalën e ka zoti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne sot po diskutojmë për një ligj, i cili edhe parafolësit diskutuan, që nuk u dha ndonjë shpjegim shumë i qartë i ligjit ekzistues që ishte. Ndërsa, konkludimi që edhe me ekzistimin e ligjit ekzistues kanë ekzistuar edhe keqpërdorimet në sistemin farmaceutik dhe në produktet medicinale. Mirëpo, unë prapë mendoj dhe kthehem te konkludimi se me ligje dhe me legjislacionet të cilat janë në letër nuk mund të përfundojnë të gjitha kontrollimet dhe ndalimi i keqpërdorimeve, të cilat janë duke u bërë në Republikën e Kosovës.

Po qe se funksionon sistemi i monitorimit që nga hyrja dhe prodhuese dhe fillon deri tek distribuimi në mënyrë monitoruese, që quhet monitorimi elektronik i medikamentit deri tek përdoruesi i fundit, atëherë do të ndalohen, sepse janë ndaluar edhe në Evropë. Pse në Evropë nuk flitet që ka qarkullim ilegal? Sepse, monitorimi është nga furnizuesi deri tek shfrytëzuesi i fundit, në këtë rast pacienti.

Këto kushte kanë mundur të gjitha ministratë t'i përfundojnë, që nga viti 2002, kur kanë filluar të financohet sistemi i informimit shëndetësor në Republikën e Kosovës, ka ekzistuar një vullnet i mangët apo i cektë, që këto mekanizma monitorues të ngritën dhe përkundër përpjekjeve, që unë nuk jam në dijeni se sa janë duke u bërë këto dhe kur do të implementohen, që mendoj edhe pas dy-tri vjetëve nuk do të kenë mundësi, ky ligj do të lerë mundësi prapë për keqpërdorime të mundshme.

Çështja që të ketë një lehtësim, meqë ne aspirojmë si shtet për të qenë anëtarë në Bashkimin Evropian dhe të jemi të standardizuar me ligjet e Bashkimit Evropian, në këtë ligj kam disa vërejtje, të cilat janë në shpërputhje me politikat e Bashkimit Evropian dhe për të cilat në amendamente do të mundohem t'i cekë me arsyeshmëri të plotë. Ndërsa, sa i përket çështjes jashtë komunitetit të Bashkimit Evropian, unë mendoj që çdo kompani në rruzullin tokësor, e cila plotëson kushtet dhe standardet, duhet të lejohet të tregtojë në Kosovë, por në Kosovë të ngritën kapacitetet monitoruese, laboratorike dhe kontrolluese.

Sot ne kemi një laborator që quhet “fiktiv”, në agjencinë e barnave dhe ai laborator nuk funksionon, është bërë sikur Ura e Rozafës. Kur është instaluar ai laborator është ngritur në media, si e arritur shumë e lartë, më e larta në Ballkan, ndërsa, pas një muaji është vërsuar nga uji. Tash nuk bëhet asnjë analizë atje. Në rast se një skandal, ku shihet edhe format e monitorimit të absorbimit të medikamentit që është detyrë edhe e mjekëve gjatë hulumtimeve, po edhe e laboratorit, që të ndiqet performansa e medikamentit, këto janë mekanizma që janë duke munguar.

Pse futen sot, mandej një fakt tjetër është që në tregun e Kosovës është edhe legjislacioni i prokurimit, i cili jep mundësi të abuzimit në formën e çmimit. Në çdo rast çmimi më i

lirë nuk është çmimi më i mirë për shëndetin e popullatës, prandaj ne duhet më parë cilësinë ta kërkojmë mandej duhet të vijë çmimi, i cili do ta përcaktojë se cilin ilaç duhet ta përzgjedhur edhe sistemi i prokurimit.

Janë disa vërejtje tjera në formën e zhdoganimeve dhe për prodhuesit vendorë po ashtu, të cilat janë të ngritura kryesisht në lëndën e parë, e cila duhet të shihet ndoshta edhe gjatë diskutimit ndërmjetësues deri në leximin e dytë, ku besoj që komisioni do të ketë së bashku me Ministrinë një përkushtim për të mbrojtur prodhimin vendor dhe për të ngritur kapacitete provokuese me standarde, që firmat të cilat janë evropiane kanë qenë të interesuara, janë atë interesuara të vijnë të prodhojnë në Republikën e Kosovës, sepse janë favoret shumë të mira për të prodhuar në Kosovë dhe për të qenë distributorë jo vetëm për republikën e Kosovës. Dhe, kryesisht e kam fjalën për kompani evropiane, të cilat veprojnë me të gjitha standardet edhe të cilat i kanë medikamentet e veta të certifikuara dhe të sprovuara tanimë në tregun e tyre Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! S'ka tjerë të paraqitur. Zoti ministër, në qoftë se dëshironi, e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht më lejoni të ju falënderoj të gjitha grupet parlamentare për mbështetjen në parim të këtij projektligji dhe deputetët me diskutimet konkrete dhe sugjerimet konkrete, në funksion të përmirësimit të tekstit të këtij projektligji, projektligj tejet me rëndësi për sektorin e shëndetësisë. Për informatë tuajën, ky projektligj është vënë në agjendën legjislative të Qeverisë, menjëherë pasi që e kam marrë mandatin si ministër, pra qysh në vitin 2011. Grupi i punës është themeluar në maj të vitit 2011, ende pa u bërë as gjashtë muaj, prej kur është miratuar ai në Kuvend të Kosovës, sepse qysh në atë kohë është vërejtur se ka mangësi tejet të mëdha, sepse gjatë punës në këtë projekt dhe deri në momentin kur është miratuar shumë prej standardeve evropiane, të cilat kanë qenë të miratuara dhe të akceptuara brenda tekstit të projektligjit, po flas në bazë të deklaratave të anëtarëve të grupit punues, janë ndryshuar dhe kanë marrë dimensione tjera. Dhe, projektligji në fund, kur ka dalë prej Kuvendit të Kosovës, nuk ka qenë ai që ka reflektuar nevojat e sistemit shëndetësor dhe ka qenë burim i shumë problemeve më tutje.

Natyrisht, kjo është vetëm një dimension i krejt problemit. Problemi në sektorin farmaceutik është problem i cili i cilëson të gjitha sistemet shëndetësore edhe në Bashkësinë Evropiane, sot. Javën e kaluar kam qenë në Londër në takim me udhëheqësit e Agjencisë Evropiane të Barërave, të cilët problemin e kanë “tërfilin” që thonë ata ose barërave ilegale, trafikimit ilegal të barërave, e dinë si problemin më të madh në Evropë, sot në sektorin farmaceutik.

Pra, është një problem tejet serioz, i cili kërkon një veprim në nivele të ndryshme, që i tejkalojnë edhe suazat e veprimtarisë së Ministrisë së Shëndetësisë, po përfshijnë edhe Ministrinë e Financave e përfshijnë edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, përfshijnë edhe doganat në veçanti kur është në pyetje zhdoganimi i barërave dhe pajisjeve medicinale e tjerë.

Ne jemi duke bërë përpjekje jashtëzakonisht të mëdha, që të vëmë rend dhe rregull në këtë aspekt. Ky projektligj është një kontribut konkret në këtë drejtim, është punuar me shumë kujdes. Po e theksoj dhe një herë me ekspertë evropianë, personalisht kam punuar në këtë projektligj, kam qenë i angazhuar në të gjitha fazat e përpunimit të tij, veçanërisht në fazën përfundimtare. Po ju them, se ka pas ndërhyrje të fuqishme edhe gjatë elaborimit të këtij projektligji për t'i mbrojtur interesat e grupeve të ndryshme të interesit, qysh në atë fazë, por nuk i kemi lejuar dhe këtë tekst të projektligjit që e keni, me ato lëshime teknike që mund të jenë dhe që natyrisht, mund të elaborohen në Komisionin përkatës funksional, ky tekst është tekst, i cili reflekton standarde evropiane në këtë lëmi dhe do të na shërbejë neve si një instrument i fuqishëm në përpjekjet tona për rregullimin e këtij sektori, në të cilin funksionon një sistem shumë i sofistikuar i kontrabandës i instaluar shumë vjet më herët, dhe mund të them lirisht, prej viteve të para të pasluftës në institucionet e vendit dhe që po na krijon probleme jashtëzakonisht të rënda. Ka pasur shumë hapësira brenda legjislacionit aktual, që kanë lejuar këtë mundësi.

Marrëveshjet, që kemi nënshkruar si Ministri e Shëndetësisë dhe unë e nënshkrova edhe javën që shkoj, e nënshkrova në Agjencionin Rregullator të Britanisë së Madhe të Barërave dhe Produkteve Medicinale. Kemi nënshkruar marrëveshje për njohjen reciproke të autorizimeve për marketing të produkteve medicinale, barërave dhe pajisjeve mjekësore. Kjo marrëveshje së bashku me marrëveshjen e nënshkruar në Institutin Federal të Republikës Federale të Gjermanisë, më herët para dy vjetëve, do të ndihmojë shumë që të lehtësohen procedurat e regjistrimit të këtyre produkteve dhe që lejet për autorizim, marketing të jepen më shpejtë dhe të kontrollohen në mënyrë shumë më efikase.

Pra, përpjekjet nuk mungojnë, do të vazhdojnë, do të jemi dëshmitarë të këtyre përpjekjeve edhe në ditët në vijim, sepse janë duke shkruar shumë procedura hetimore në raste konkrete, të cilat janë duke i zbuluar shumë mangësi të legjislacionit aktual dhe jo vetëm legjislacionit, por edhe implementimit të legjislacionit, siç e theksuat me të vërtetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Shqip, do replikë? Hajde, vazhdo!

SHAIP MUJA: Desha edhe një herë për çështjen e... ministri është mirë të rezervohet nga fjalët e kontrabandës, se kontrabanda është në dy nivele, në nivelin privat dhe shtetëror, fatkeqësisht.

Në nivelin shtetëror, lista esenciale e cila bëhet nga selektimi dhe vërejtjet të cilat vijnë të njëpasnjëshme në Ministrinë e Shëndetësisë, për listën esenciale që është një grup i ashtuquajtur që selektojnë medikamentet dhe i ekskludojnë kompanitë tjera, janë me vërejtje të cilat janë të bazuara.

Prandaj, në fjalimin tim kur thashë që duhet të ngritën kapacitetet monitoruese nga laboratorit dhe nga absorbimi tek efektet tek pacienti, ku mund të ekskludojë përgjithmonë një medikament, ato duhet të kenë parasysh. Mandej, janë në ligj disa pika, të cilat nuk janë në përputhshmëri edhe për Inspektoratin dhe të cilat unë do t'i paraqes

me shkrim, si amendamente të cilat ndoshta do të jenë të dobishme që ligji të jetë më funksional. Por derisa nuk bëhet monitorimi në mënyrë elektronike, nga hyrja doganore, sistemi doganor, mund të bëjë dhe nga hyrja doganore është porta e parë dhe porta e fundit është pacienti dhe e tërë kjo rrugë apo guidë e medikamentit mund të shoqërohet me kontrollim elektronik.

Këtë nuk ka dashur asnjë ministër ta bëjë. Po më vjen keq, as ju nuk jeni duke e bërë as laboratorit për kontrollin e ilaçeve nuk është duke e bërë, drejtori aktual shumë i ka pas dhënë zor, para se të bëhej drejtor, që kam për t'i bërë këto, tash ka filluar është akomoduar me formën e vjetër të punës, prandaj, janë vërejtje të cilat ne nuk po i kërkojmë për interes tonin personal, por janë për interes të përgjithshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A dëshironi kundër-replikë zoti ministër?

MINISTRI FERID AGANI: Unë desha në fjalën time që të kufizohem vetëm në projektligj dhe të mos hyjë në detaje tash, se çka ka bërë Ministria në sektorin farmaceutik këto dy viteve, vetëm për informatë edhe të opinionit tuaj, natyrisht.

Në Ministrinë e Shëndetësisë që dy vjet është duke funksionuar sistemi i monitorimit elektronik të farmaceutikëve dhe pajisjeve mjekësore. Ky sistem i përcjell barërat nga momenti i hyrjes në depon qendrore të Ministrisë së Shëndetësisë deri tek institucionet shëndetësore dhe më tutje, deri te repartet e veçanta të secilit institucion. Është sistem funksional, mund ta vërtetoni çdo ditë, mund të vini në Ministri të Shëndetësisë dhe mund të shihni se jemi në gjendje ta përcjellim çdo medikament, prej momentit kur hyn në depo deri në momentin deri në momentin kur shkon deri te pacienti.

Kur është në pyetje kapaciteti i laboratorit, keni të drejtë pjesërisht, laboratorit është duke i ngritur kapacitetet e tij, por ende nuk është në nivelin e duhur, i cili kërkohet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Në sallë janë 63 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota për, asnjë kundër, një abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale.

Ngarkohet Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor zotin Gashi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

Të nderuar deputetë, ju lus për qetësi në sallë!

DARDAN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit Qeveritar,

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i procedurave për legalizimin e ndërtimeve pa leje në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj zbatohet për ndërtimet pa leje të identifikuar në hartën orto-foto-digjitale, bazuar në incizimin ajror në territorin e Republikës së Kosovës.

Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje përbëhet prej 6 krerëve dhe 21 neneve. Me hyrjen në fuqi të këtij projektligji të gjitha komunat do t'i legalizojnë ndërtimet pa leje në pajtim me të njëjtin. Çdo ndërtim pa leje i shënuar në regjistrin kombëtar të ndërtimeve, të cilit nuk i është dhënë leja për legalizim do të përfshihet në listën e rrënimave dhe rrjedhimisht do të rrënohet nga organet përkatëse.

Ndërtesat, ndërtimi i të cilave ka filluar pas hartës orto-foto-digjitale nuk kualifikohen për legalizim. Sipas këtij projektligji, çdo ndërtim i filluar pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji, do të trajtohet sipas Ligjit të ri për ndërtim dhe Ligjit të ri për planifikim hapësinor.

Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje është pjesë e programit legjislativ për vitin 2012. Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese dhe për zbatimin e tij nuk nevojiten mjete shtesë buxhetore, mirëpo i njëjti do të gjenerojë të hyra. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji për qytetarët tanë, ju ftoj që ta votoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarit të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zotit Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritet ministër!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe Komisioni kërkon, që ky projektligj të votohet në lexim të parë, që më tutje të fillojmë edhe shqyrtimin dhe amendamentimin e nevojshëm, të cilin e parasheh me disa vërejtje të vogla, që ka mundësi t'i ketë ky ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky është ligji i pasojës, i cili na ka ardhur në këtë Kuvend dhe të cilin ne do ta miratojmë, shpresoj për t'i legalizuar disa ndërtime që duhet të legalizohen në bazë të këtij ligji.

Të gjitha vendeve tona në rajon, po edhe Kosovës tashti i ka ardhur radha që ta kalojë këtë fazë. Ne duhet t'i legalizojmë këto ndërtime, megjithëse këto ndërtime kanë lënë pasoja shumë të mëdha edhe për tokën bujqësore, por edhe për shfrytëzimin e resurseve, për mundësinë e shfrytëzimit të mirë të resurseve nëntokësore dhe mbitokësore, që janë në vendin tonë.

Në të vërtetë ndërtimet e egra ky ligj i trajton në mënyrë të butë, parashikon që t'i ofrohet mundësia çdonjërit që t'i legalizojë ndërtimet, mjafton që ato vetëm t'i kenë të plotësuara kriteret shëndetësore dhe standardet e qëndrueshmërisë. Po ashtu, edhe mënyra e legalizimit të ndërtesave shumëkatëshe do të bëhet vetëm në rastet, kur arrin që të legalizohet vetëm një e tillë.

Në rend tjetër, edhe pagesat për legalizimin nuk do të jenë të rënda, do të jenë të pranueshme për ata që i legalizojnë, do të jenë afërsisht të njëjta me ato pagesa që bëhen për kërkesat e pronarëve për ndërtim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e konsideron si një ligj të mirë, si një ligj që është i nevojshëm që të miratohet dhe ne kemi marrë qëndrim që ta miratojmë kështu siç është, ndërsa në fazën e mëtejme do ta japim kontributin tonë, për ta pasuruar këtë ligj, në mënyrë që ky të bëhet i zbatueshëm plotësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i LDK-së e ka fjalën zoti Morina.

SALI MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka bërë një analizë, megjithëse e ka disa vërejtje kryesore, të evidentuara në Projektligjin për trajtimin e ndërtimit pa leje.

Shqetësim kryesor mbetet në trajtimin jo të duhur të problemeve të cilat hasin komunat në hartimin e regjistrit komunal të ndërtimeve pa leje. Kjo ndodh për shkak të mungesës së fondeve dhe stafit të pamjaftueshëm në kompletimin e të dhënave.

Bazuar në këtë projektligj nuk është e qartë nëse do të bëhet respektimi i planeve rregulluese urbane të aprovuara nga kuvendet komunale, si dhe përcaktimi i konfirmimeve për vitet e ndërtimit të objekteve, sipas planeve urbanistike.

Edhe ministri e di, që një numër bukur i madh i komunave nuk i kanë të miratuara planet urbanistike, prandaj do të ishte mirë që ndoshta, me një kërkesë nga Ministria dhe në bazë të ligjeve, që parashihet, komunat kanë për obligim t'i miratojnë këto plane urbanistike dhe pas miratimit të planeve urbanistike, duhet të fillojë procesi i legalizimit apo mosprocesi i legalizimit të atyre që bien ndesh me këtë ligj.

Bazuar në këtë projektligj asnjë dispozitë nuk parasheh çështjen e ndërtimit pa leje në pronat publike, shoqërore, bujqësore, si dhe ato me interes të veçantë, pronat e uzurpuara apo pronat të cilat nuk i kanë të zgjidhura problemet pronësore.

Patjetër të konsiderohet se ligji duhet të qartësojë të drejtën fqinjësore në raport me mundësitë e ndërtimeve pa leje. Duhet të precizohen qartë obligimet e ofruesve të shërbimeve publike, në nenin 7 të këtij ligji, sikurse janë KEK-u, ujësjellësi, kanalizimi, apo ngrohja. Nuk dihet se kush do të jenë kompetentët për marrëveshje në këto plane, prandaj edhe ky nen do modifikim.

Bazuar në këtë projektligj regjistri komunal thuhet se duhet të vërtetohet nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit. Ky veprim përcjell mesazh për një centralizim të një përgjegjësie të pushtetit lokal, prandaj duhet të shikohet, se në pjesën më të madhe do të thotë të kompetencave duhet t'u lihet kuvendeve komunale.

Tek neni 9, pika 1.3. nuk po përcakton veprimet se si do të trajtohen ndërtimet pa leje pa pasur udhëzim administrativ, aq shumë të nevojshëm në kategorizimin e objekteve. Nevojitet sqarim i mëtutjeshëm se si do të veprohet në trajtimin e njësive banesore, ndërtesave kolektive, i cili sipas nenit 17.1, nëse një pronar i një prone në pronësi të përbashkët paraqet një kërkesë për t'u përfshirë në regjistrin komunal të ndërtimit pa leje të ndërtesave ose ndërtimit pa leje në pronësi të përbashkët, do të përfshihet në regjistër.

Nevojitet sqarim i mëtutjeshëm se si do të veprohet në persona të cilët kanë bërë kërkesë për legalizim e që nuk u është dhënë leja komunale, po të cilët kanë vazhduar me ndërtime pa leje. Dhe, ajo çka nuk duhet të legalizohet përmes këtij ligji, ne si Grup Parlamentar konsiderojmë se duhet të ndalohet legalizimi i objekteve të ndërtuara pa leje në pronat komunale e cila ka mundur eventalisht të jetë uzurpuar deri në momentin e legalizimit.

Të ndalohet legalizimi i ndërtimeve në toka të cilët janë të shpalla interes të përgjithshëm apo në zonat mbrojtëse, brezi i sigurisë rrugore i autostradave, brezit të sigurisë lumore dhe zonat e rezervuara bujqësore, pastaj objektet të cilat eventalisht janë të ndërtuara mbi ndonjë infrastrukturë nëntokësore, ato në afërsi të largpërçuesve të tensionit të lartë elektrik.

Të ndalohet legalizimi i ndërtimeve në tokat bujqësore të klasës së parë dhe të klasës së dytë apo edhe të klasave të tjera që janë me interes për qytetarët si dhe ndërtimet në afërsi të zonave të cilët paraqesin rezervatet ujore për pije, zonave sportive rekreative, parqeve publike, parqeve natyrore, zonave arkeologjike, hulumtuese si dhe zonave turistike, lapidareve apo përmendoreve dhe hapësirave të varrezave.

Të ndalohet legalizimi i objekteve të ndërtuara në tokat e huaja private si dhe në tokat dhe hapësirat që nuk e kanë të zgjedhur problemin pronësor. Pra aty ku kemi konteste me pronën do të thotë duhet shikohet që ky legalizim të mos bëhet derisa të verifikohet edhe nëpërmjet organeve të gjyqësisë.

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike në parim do ta miratojë këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit që do të bëhen në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka trajtuar Projektligjin e ndërtimeve pa leje. Ne kemi vërejtje të shumta parimore të cilat shpresoj që do të trajtohen në projektligj, po janë vërejtje tejet parimore prandaj ne do ta votojmë kundër këtë projektligj me shpresë që këto vërejtje tona do të trajtohen dhe të krijojnë kushte që pastaj të votojmë për.

Pasi që trajtimi i ndërtimeve pa leje vërtet është i nevojshëm, mirëpo janë disa kritere bazë të cilat do të duhej të respektoheshin.

E në këtë rast mendoj se ky projektligj në raport me qytetarët e thjeshtë në zonat rurale ta zëmë, është një ligj tejet i vrazhdë, tejet i ashpër, ndërsa kur bëhet fjalë për ndërtimet e larta, kur bëhet fjalë për objekte është shteti i butë nga ana tjetër.

Ky ligj nuk bën ndarje të qartë mes zonave rurale dhe zonave urbane dhe nuk bën ndarje të qartë në periudhat kohore.

Ky ligj nuk bën ndarje mes objekteve të mëdha dhe objekteve të vogla, por të gjitha bashkë paguajnë një taksë prej 100 eurosh, taksë administrative. Pra, pavarësisht sipërfaqes së objektit taksa administrative do të jetë e njëjtë dhe bëhet për një objekt pa leje. Po ta zëmë në zonat rurale ku qytetarët mund të kenë natyrisht që të gjitha janë objekte pa leje në zonat rurale ku jetojnë sot qytetarët, për të gjitha objektet që i kanë pa leje ata po u dashka

tani që të plotësojnë dokumentacionin dhe të nxjerrin nga 100 euro taksë administrative për secilin objekt. Pra, mund ta kenë objektin e banimit, mund ta kenë stallën cilado familje do t'i ketë nëpër zonat rurale dhe për secilën prej tyre tash u dashka të paguajnë taksë prej 100 eurosh dhe të zbatojnë procedura tjera, pavarësisht që ata jetojnë aty me dhjetëra vite në ato zona dhe natyrisht që janë ndërtime pa leje.

Pra, duhet bërë qartë një dallim mes këtyre zonave dhe zonave urbane dhe në aspektin e taksës, taksa ose duhet të jetë në përputhje me metrat katrorë ose duhet të jetë në përputhje edhe me pozitën ku qytetarët jetojnë, sidomos edhe me gjendjen sociale në të cilën ata janë.

Për sa i përket elementeve të tjera ligji ka ta zëmë kur bëhet fjalë për kriteret që do të vendosen në lidhje me legalizimin aty caktohen kushte që do duhet të plotësohen dhe ndër të tjera paraqiten edhe dokumentet teknike që do të duhej t'i plotësojë aplikuesi për legalizim.

Te këto objekte nuk ka dallim fare së cilës kategori ato i takojnë, pra procedura është e njëjtë, qoftë ai objekt i kategorisë së parë, qoftë i kategorisë së dytë apo të tretë.

Duhet ta kemi të qartë që aplikimi për legalizim te këto objekte bëhet në bazë të gjendjes ekzistuese, pra vizatimet bëhen në gjendjen se çfarë është objekti dhe në këtë aspekt ku kemi të bëjmë me objekte të kategorisë së dytë dhe të tretë, duhet ta kemi të qartë që aty duhet të jemi të sigurtë për sa i përket sigurisë statike dhe në këto kushte nuk përcaktohet asnjë lloj elementi ku do të duhej të jepej mendimi statik për objektet e kategorisë së dytë dhe tretë. Pra, kemi të bëjmë këtu me objektet shumë banesore të cilat objekte madje mund të fillojë procedura legalizimi dhe hiqen nga lista e objekteve për t'u rrënuar nëse vetëm njëra njësi e këtyre objekteve legalizohet.

Pra, shikuar nga kjo anë është një ligj tejet, tejet me kritere të buta dhe mendoj që do të duhej të definoheshin qartë pra kriteret në këtë projektligj.

Po ashtu do të duhet të sqarohet niveli komunal dhe ai qendror. Ministria po duket se është tash do të ketë kompetenca vetëm mbi objektet të kategorisë së tretë, mirëpo këtu thuhet në një vend që është neni 4.1.5 bëhet formulari standard kërkesë për t'u shënuar në listën e ndërtimeve pa leje. Tash, këtë dokument në nenin 4, thuhet që Ministria do ta hartojë për komunat, ndërsa në nenin 5.4, thuhet që komunat do ta hartojnë për vete të njëjtin formular. Bëhet fjalë pra saktësisht për të njëjtin formular që nuk dihet kush tash do të jetë kompetent, pra në njërin anë thuhet që Ministria do t'ua përgatisë këtë komunë dhe do t'ua japë këtë formular, në nenin tjetër thotë që komunat vetë do ta përgatisin këtë formular për veten e vet.

Duhet pastaj të sqarohet çështja e definimit të pronave, mendoj se këtu lihet mundësia që në emër të lehtësive të definimit të pronave madje thuhet që edhe me fatura, me çështjen e faturave pra kur bëhet fjalë për dëshmi a posedimi të përdorimit faktik mund të përfshijë, por nuk duhet të kufizohet në kopjen e faturave të shërbimeve publike, pagesave të takimit në pronë e të tjerë.

S'ka nevojë të përmendet, nuk ka nevojë të thuhet mund ta përfshijë, por nuk duhet të kufizohet me, sepse nuk është dokument me të cilin pastaj po lihet mundësia, lihet zbrazëtira që një ndërtim të fillojë legalizimi i tij vetëm duke u bazuar në disa fatura, sepse këtu lihet në një farë mënyrë mundësia për diçka të tillë.

Po ashtu duhet të definohet tek neni 9.1.3, kriteret themelore të planifikimit hapësinor, kjo mbetet të sqarohet ose në Komision ose le të na sqarojë ministri tani nuk është problem.

Objektet thotë duhet t'i plotësoj kriteret themelore të planifikimit hapësinor, a ka të bëjë kjo drejtpërdrejtë me planin hapësinor, sepse nëse dy objekte, si do të trajtohen dy objekte të ndërtuara pa leje kur njëri bie tash në kuadër të planit hapësinor të jetë i pranueshëm dhe një tjetër bie të jetë i papranueshëm, pra njëri rrënohet dhe tjetri nuk rrënohet, a ka ndonjë lloj dallimi në mes tyre si do të definohet proceduralisht kjo çështje?

Mendoj që janë edhe disa nene tjera të cila duhen të sqarohen dhe se gjatë punës në Komision do t'i sqarojmë dhe shpresoj që këto vërejtje do të merren parasysh, sidomos do të caktohen vijat në mes zonave rurale dhe atyre urbane si dhe çështja e taksës administrative. Përndryshe ne kemi nevojë që të definohet me ligj dhe të filloj legalizimi i objekteve pa leje dhe në këtë aspekt ky ligj është tejet i nevojshëm, por natyrisht duhet të rregullohen këto çështje që janë tepër parimore për Lëvizjen “Vetëvendosje” Faleminderit!

KRYEUSEI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, në emër të Grupit parlamentar të AAK-së.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Është e vërtetë që ky ligj është shumë i rëndësishëm edhe me të vërtetë duhet përgëzuar ministrin për punën që e ka bërë. Shumë qytetarë presin që ky ligj do t'ia zgjidhë problemet, sidomos në kryeqytet ku e dimë fare mirë që ta marrim shembull vetëm Kodra e Trimave, është mbi 80% e palegalizuar dhe presin që ky problem do të zgjidhet me këtë ligj.

Natyrisht që ligji ka shumë mangësi të cilat shpresoj që në Komision do t'i amendamentojnë, sidomos tek taksat ku duhet të kategorizohet secila pjesë e shoqërisë, të hapësira, po ashtu po fatmirësisht e kemi edhe një hulumtim të Drejtorisë për Hulumtime, e cila e ka bërë një përshkrim edhe të rajonit se çfarë forme e kanë përdorur këta, është te inkasimi i mjeteve një problem ku është paraparë me ligj që shumica e fondeve të hyra ose si i quajmë do të shkojë në buxhetin e shtetit, ndërsa vetëm 20% do t'i mbesin komunave që mendoj që është një gabim, duhet ta zgjidhim edhe këtë problem.

Çështja tjetër që ky ligj duhet të ketë parasysh, duhet të harmonizohet edhe me vendimet ose planet rregullative të qyteteve, për shkak se ky ligj nuk e parasheh edhe unë mendoj që edhe ministri duhet ta gjejë një zgjidhje se si do të harmonizohet me Ligjin për planifikim hapësinor, me vendimet e marra nëpër komuna, domethënë duhet ta gjejmë formën se kah do të shkojmë.

Në parim, Aleanca do ta mbështesë këtë projektligj dhe do ta japim kontributin tonë në Komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, zonja Lama.

SEVDIJE LAMA: Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrahë në parim, kontributin tonë do ta japim në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar SLS, zonja Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Hvala predjedavajući!

Parlamentarna Grupa Liberalne Stranke je razmatrala ovaj Nacrt zakona i primedba je sledeća.

Kao da postoje dve verzija jednog istog zakona, verzija na Albanskom i verzija na Srpskom jeziku. Jer je ovo još jedan u nizu zakona gde se verzija na Albanskom i Srpskom jeziku razlikuju. Te primedbe ne mogu nazvati samo jezičkim primedbama zato što utiču na suštinu samog zakona.

Ja ću navesti samo jedan primer. Recimo u članu 20, u verziji na Engleskom jeziku je da zgrade čije je izgradnja počela posle orto-foto karte neće ispunjavati uslove za legalizaciju. A u verziji na Srpskom jeziku da zgrade čije je izgradnja počela pre digitalne orto-foto karte neće ispunjavati uslove za legalizaciju. Što znači da su to potpuno dve različite suštinske stvari koje utiču na primenu zakona.

Podržaćemo ovaj Nacrt Zakona ali uz primedbu i apel da se usklade verzije na oba zvanična jezika i da ne bude poteškoća u primeni. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “6+” e ka fjalën zoti Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući
Parlamentarna Grupa “6+” razmotrila je Nacrt Zakona o tretiranju izgradnje bez dozvole, smatramo da je ovaj Zakon od velike važnosti i daćemo dati svoj doprinos u daljem radu.

U načelu podržavamo ovaj Nacrt zakona i glasaćemo kao Parlamentarna Grupa “6+”.
Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Fjalën e ka zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar, nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Do të provoj të jem i shkurtër për arsye se një pjesë të vërejtjeve u thanë edhe nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i procedurave për legalizimin e ndërtimeve pa leje në Republikën e Kosovës, me një fushë të zbatimit për ndërtimet pa leje të identifikuar të bazuara në incizimet ajrore.

Ky ligj ofron një program unik për trajtimin e ndërtimeve pa leje që do të zbatohet në tërë Republikën e Kosovës dhe me një kohë të caktuar të veprimit apo fuqisë kohëzgjatjes së tij prej 3 vjetësh nga momenti që hyn në fuqi.

Ky ligj do të rregullojë legalizimin e ndërtimeve pa leje, një brengë shumë e madhe e shumë qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë ndërtuar apo rindërtuar objektet e tyre prej përfundimit të luftës e këndej.

Gjithsesi ky ligj do të rregullojë formën dhe kriteret për legalizim të ndërtimeve pa leje.

Duke pasur parasysh që Kuvendi i Republikës së Kosovës ka votuar dhe miratuar Ligjin për ndërtim, kërkoj një respektim të legalizimit të ndërtimeve pa leje, bazuar në këtë ligj por gjithsesi duke e respektuar kriteret sipas ligjit për ndërtim si ligj bazik, sepse Ligji mbi ndërtimet është ligj me koherencë afatgjate, ndërsa Ligji për legalizim është ligj për një periudhë të caktuar kohore prej 3 vjetësh.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjitha ndërtimet pa leje që do të trajtohen me këtë ligj nëse plotësojnë kriteret sipas Ligjit për ndërtim, duhet të legalizohen, por nëse ndërtimet pa leje janë në kundërshtim me Ligjin për ndërtim, gjithsesi edhe ndaj atyre ndërtimeve duhet të vepohet sipas ligjit edhe ato të rrënohen. Dhe me këtë ne të vëmë një herë e përgjithmonë në binarë një problematikë e cila mbetet të jetë një brengë edhe e shumë qytetarëve, mirëpo edhe e dukjes së parë më së shumë qyteteve në Republikën e Kosovës.

Një problematikë shumë me rëndësi që trajton dhe rregullon ky ligj që është brengë e shumë qytetarëve është edhe legalizimi i ndërtesave në bashkëpronësi për arsye se shumë qytetarë kanë blerë ndërtesa të tilla, objekte të tilla në ndërtesa me bashkëpronësi, ndërsa për kundër pagesave që kanë bërë me shuma marramendëse të parave, ato ende mbesin të pa legalizuara, ndërsa ky ligj rregullon këtë materie.

Duke shprehur mirënjohjen dhe e përgëzoj Ministrinë dhe ministrin për punën e bërë, gjithsesi se jap mbështetje miratimit të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit, zoti Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë po them më në fund e përshëndes iniciativën që ne përpara ta kemi alternativën për Ligjin për legalizimet dhe arsyeja është që domethënë edhe 12 vjet pas vitit '99 kur Kosova nuk ka pasur planin hapësinor as në nivelin nacional as në ato lokale, ndërsa qytetarët kanë pasur nevojë, pra që të ndërtojnë si sektori privat, po ashtu edhe ai i ndërmarrjes. Kështu që ajo ka qenë një rrugë paralele në mes të legalizimit dhe nevojave të qytetarëve, ndërsa ne sot po diskutojmë për një ligj dhe unë e përshëndes që në fillim ky ligj ka tendencën e krijimit të data-bazës ose bazës së shënimeve të ndërtimeve pa laje. Dhe kjo gati prej fillimit e deri në fund përafërsisht qëllimi kryesor i këtij ligji që ia ka dalë të definuar është kjo.

Unë edhe një herë dua të theksoj se dihet se planet hapësinore në komuna i kanë dy komponentët kryesor, pjesën zhvillimore që duhet të harmonizohet me Ministrinë dhe shihet se a janë në pajtueshmëri me planet zhvillimore nacionale dhe interesat nacionale në ato prona si dhe planin urban dhe atë rregullativ që ekskluzivisht është kompetencë komunale dhe si e tillë duhet të mbetet edhe pse nuk është thënë asnjëherë ndryshe, por nuk është cekur në mënyrë decitive. Prandaj, kjo lidhet edhe me komplet të hyrat dhe shpenzimet, të gjitha çështjet, duhet të nënkuptohet se prona komunale, planet urbane dhe

zhvillimore janë kompetencë komunal si dhe vetë evidencat të cilat pastaj akumulohen dhe krijohet edhe një data-bazë qendrore që nuk ka të keqe këtu.

Ndërsa, kur flasim për legalizimin, unë mendoj se ky ligj është vetëm një hyrje në legalizim, mirëpo nuk ka dhënë kriteret dhe nuk e ka definuar se çka dhe si do të shkojë legalizimi.

Nëse mendohet se legalizimi do të rregullohet me akte nënligjore, me udhëzim administrative, unë mendoj që nuk është e drejtë, sepse kemi të bëjmë me kundërshtime, kemi të bëjmë me ankesa deri edhe me padi. Si do t'i zgjedhim ne nesër paditë nëse në ligj nuk i kemi definuar dhe themi se kjo ka qenë pastaj një udhëzim administrim?

Unë edhe një herë po e tërheq vërejtjen se veç te ne këtu në Kosovë ndodh që udhëzimi administrativ pretendon të ketë më shumë se vetë ligji. Prandaj, edhe ne kemi edhe shumë konteste gjyqësore që ne humbim dhe komunat paguajnë alimet mjeteshe, sepse nuk ka mbulesë ligjore.

Ndërsa, nëse Ministria që duhet ta ruajë nivelin e shkallës së dytë në rast të ankesave në nivel lokal, Ministria duhet të jetë pra shkalla e dytë e shqyrtimit të ankesave.

E dyta, duhet Ministra që tash të angazhohet dhe të jetë një institucion i fuqishëm që të bashkëpunojë me komunat që të mos ketë drejtësi selektive, sepse edhe ky është problemi i Kosovës. Më shumë është duk e dëmtuar Kosovën drejtësia selektive sesa edhe mos marrja me çështje të drejta. Ne e dimë në secilin janë interesat, çka ka ndodhur në të kaluarën, çka mund të ndodhë nesër dhe nuk përjashtohet mundësia që për vota një regjion i tërë mund të dëmtohet, sepse dikush, ose një person i fuqishëm, mund të ketë ndikime atje.

Dhe, nëse ne do t'i shkruanim disa prej parimeve themelore nga përvojat e mira të legalizimit, sot do ta kishim një ligj më të mirë. Por unë mendoj se kemi kohë, që prej çështjes së pronës nuk mund askush ta legalizojë ndërtimin në pronën që nuk është e tij, ai duhet të lidhë së paku kontraktuale me pronarin, qoftë ai institucioni shtetëror apo edhe dikush tjetër.

Pastaj, çështja e mbindërtimeve, ne flasim këtu se do të bëhet po si do t'i trajtojmë mbindërtimet, e kujt do të jetë prona e mbindërtimit, a duhet ai të paguajë dikujt, pse e ka bërë një mbindërtim?

Pastaj, çështja e sigurisë, kush do t'i paguajë ekipet e ekspertëve që do të shkojnë dhe do të vlerësojnë se a i plotëson kushtet minimale të sigurisë në objekt para se të legalizohet? Kush, ligji nuk i definon këto, si do të behën nesër, ose do të kemi një udhëzim administrativë prapë i pa qartë sikurse ligji dhe pastaj do të kemi, 38 komuna i ka Kosova, 38 akte nënligjore ose vendime të komunave në një laramani. Por, që pastaj gjithë qytetarët do të bëjnë ankesa në Ministri, mbi 38 akte nënligjore, që është e papranueshme.

Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha këto, unë mendoj se është momenti i rëndësishëm dhe njëkohësisht duke filluar që momenti kur ligji hyn në fuqi pretendimi një vit që të ketë të dhëna nga data-baza, duhet vendimi të bazohet në ligj nuk duhet pengohet që komunat prej tash të vazhdojnë me legalizimin që mos bëhet fyt i madh pas një vjetëve që përnjëherë t'u hyhet me mijëra legalizimeve, se pas një viti do të duhen edhe 3 vjet tjera edhe do të shikojmë.

Ndërsa, shumë i drejtë do të kishte qenë vendimi me ligj që prej momentit të këtij incizimi orto-foto dhe hyrjes së këtij ligji në fuqi, të mos ketë mundësi të legalizimeve të mëtejme, në mënyrë që të fillohet të bëhet një kthesë e veçantë.

Prandaj, unë edhe një herë po them sido që të jetë ose të japim kohë ende Ministrisë, që të fillojë dhe ta bëjë Ligjin për legalizimet, sepse është ky është ligji për data-bazën, shënimet e ndërtimeve pa leje. Nëse ka këtë ambicie ligji ose t'i kthehet ose ta votojmë sot në parim, por që gjatë punës nëpër grupe funksionale vërtet nëse ka nevojë edhe të tejkalohet afati ligjor në mënyrë që ta bëjmë një ligj për legalizimet sipas ligjeve në fuqi dhe sipas praktikave më të mirë. Përndryshe po të na vijë si i tillë unë do t'ia kisha ndërruar titullin dhe do të kisha thënë: Ligji për grumbullimin e shënimeve të ndërtimeve pa leje. Por unë besoj se mund ta bëjmë, por duhet të jemi të guximshëm, Ministria duhet t'i merr përgjegjësitë e veta, por s'duhet t'i prekë përgjegjësitë e komunave. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur.

Ministër a doni fjalën? Jo. Atëherë lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Konstatohet se me 54 vota për, 9 kundër dhe një abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për blegtorinë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Stavileci që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar deputetë,

Vendi ynë karakterizohet me një zhvillim ekonomik të bazuar në masë të madhe në sektorin e blegtorisë, sepse si sektor i rëndësishëm, përveç që absorbon një numër të konsiderueshëm të fuqisë punëtore në zonat rurale, ka ndikim të madh edhe te sektorët e

tjerë bujqësorë, në veçanti me sektorin e lavërtarisë nga i cili sigurohet baza ushqyese si dhe me sektorin e industrisë agropërpunuese ku bëhet përpunimi i qumështit dhe i mishit.

Duke kuptuar rëndësinë në nëpërmjet këtij ligji synojmë t'i mbrojmë, t'i përmirësojmë dhe t'i ruajmë cilësitë e burimeve gjenetike të kafshëve me qëllim të nxitjes së fermerëve në shtimin e prodhimeve blegtorale, në përmirësimin e cilësisë së prodhimeve blegtorale dhe në ruajtjen e ndryshueshmërisë gjenetike të bagëtisë.

Pra, përmes këtij ligji përcaktohen kushtet dhe praktikat blegtorale e moderne për një mbarështim të mirë të bagëtisë në fermë.

Pastaj, gjithashtu përcaktohen metodat e teknologjitë e mbarështimit të kafshëve, kushtet për hartimin dhe miratimin e programeve racore, ndryshimet dhe ruajtja e cilësive blegtorale, ruajtja e ndryshueshmërisë gjenetike dhe ruajtja e racave autoktone. E gjithashtu një segment tjetër i rëndësishëm që rregullohet përmes këtij ligji janë edhe marrëdhëniet ndërmjet mbarështuesve të bagëtive në industrinë përpunuese të prodhimeve blegtorale, bazuar në klasifikimet e standardizuara dhe sistemet e kategorizimit për çmimin e tyre duke implementuar edhe standardet e rëndësishme mjedisore.

Si autoritet kompetent për ekonominë blegtorale, bazuar në këtë ligj është Ministria e Bujqësisë, e cila do të zhvillojë procedura për aprovimin e organizatave për ekonomi blegtorale, do të ushtrojë mbikëqyrje profesionale, do të ofrojë shërbime këshilluese dhe do të nxjerrë akte nënligjore për një rregullim sa më të mirë të kësaj fushe.

Në këtë ligj parashihet edhe krijimi i një Këshilli për blegtori i cili do të përbëhet nga zyrtarët e Ministrisë së Bujqësisë, profesorët e Fakultetit të Bujqësisë dhe të Veterinarisë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, Qendra Gjenetike Genkos, shoqatat e mbarështuesve dhe të tjerë, i cili do të jetë organ këshillues për Ministrinë dhe do të bashkëpunojë ngushtë për programin mbështetës dhe vendimet e rëndësishme për këtë sektor.

Të një rëndësie të veçantë janë edhe shërbimet shkencore dhe profesionale në blegtori si dhe organizatave të mbarështuesve të kafshëve, tregtimit të materialeve racore, inspektimit e të tjerë.

Duke ditur rëndësinë e këtij projektligji ju ftoj që ta apromoni. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e zotit Hasani, në emër të Komisionit.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për blegtorinë dhe Kuvendit i rekomandon që ta kalojë në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, e ka fjalën zoti Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kosova e ka pasur Ligjin për blegtori, të miratuar në vitin 2004, mirëpo ky ligj nuk ka qenë kompatibil me ligjet e Bashkimit Evropian, ka pasur shumë lëndë të panevojshme të përfshira në të dhe si i tillë është dashur të plotësohet dhe të ndryshohet.

Ky plotësim - ndryshim ka tejkaluar ato limite që i lejojnë Ministrisë të bëjë, prandaj ka ardhur si ligj i ri i hartuar nga Ministria.

Ky ligj ka përfshirë ushqimin e koncentruar për kafshë, i cili realisht nuk është dashur të jetë pjesë e këtij ligji, por është dashur kontrollin e ushqimit duhet ta bëjë Agjencia Ushqimore dhe Veterinare e Kosovës, e cili do të merret me këtë problematikë në të ardhmen, sepse me sa jemi në dijeni edhe Ligji për ushqimin e kësaj agjencie është në miratim e sipër, është në procedurat e hartimit në fakt.

Po ashtu edhe tregtia e ushqimit me kafshë duhet të rregullohet me një ligj tjetër e që në këtë ligj nuk duhet të jetë pjesë përbërëse e tij.

Në këtë ligj janë të definuar më qartë procedurat e licencimit të subjekteve që merrem me mbarështimin e kafshëve, po ashtu edhe janë saktësuar më mirë masat ndëshkimore sipas kategorive.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e falënderon Tajeksin për kontributin që ka dhënë për hartimin e këtij ligji. Ne do ta mbështesim miratimin e këtij ligji në parim dhe do ta japim kontributin tonë në procedurat e mëtejme të pasurimit të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së zonja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Projektligji për blegtorinë është e rëndësishme të kalojë në lexim të parë dhe ne si Grup Parlamentar nuk do të shohim ndonjë arsye për mosmiratim, sepse ligji aktual nuk ka qenë i zbatueshëm për shkak të ndryshimit të rrethanave dhe hyrjes në fuqi të rregulloreve të reja.

Me këtë projektligj avancimet dhe risit konsistojnë atë që ky projektligj do të ketë rol organizativ dhe funksional për zhvillimin dhe përparimin e blegtorisë në bazat profesionale dhe ekologjike në Kosovë, duke ruajtur gjithmonë gjithmonë cilësitë e burimeve gjenetike të kafshëve në synim nxitjen e fermerëve për shtimin e prodhimeve blegtorale, përmirësimin e cilësisë dhe ruajtjen e ndryshueshmërisë gjenetike të kafshëve blegtorale.

Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë është deklaruar se zbatimi i këtij ligji nuk do të ketë implikime shtesë buxhetore dhe rritje të numrit të të punësuarve, por tërë kostoja do të mbulohet me buxhetin e rregullt.

Ne si Grup Parlamentar kontributin tonë do ta japim gjatë analizimit dhe amendamentimit të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Projektligjin e blegtorisë, Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje” e ka trajtuar, do ta votojmë për. Kemi disa vërejtje të cilat nuk janë edhe vërejtje në kuptimin parimor. Mendoj se në ligj do të duhej të definohej qartë çështja se kush është autoriteti kompetent, pra mos të thuhet vetëm Ministria, por duhet të definohet, pra Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Janë çështje tjera që lidhen me mosdefinime të qarta përgjatë ligjit siç që është çështja e njësisë blegtorale, e cila duhet të qartësohet më tepër. Po ashtu, kur flitet për organizatën blegtorale, në vend që të ketë definim të qartë, aty thuhet vetëm se organizatat blegtorale do të jenë ato të mbarështuesve dhe të specializuara, pra duhet të definohet më qartë. Po ashtu duhet të ketë unifikim të termeve, mbarsim, mbarsje përgjatë projektligjit. Edhe te çështja e standardeve të cilësisë në prodhimin blegtoral nenin 31, duhet të harmonizohen me legjislacionin që lidhet me Agjencionin e Ushqimit dhe të Veterinës, po ashtu edhe çështja e akreditimit të laboratorit, të mos harrojmë se një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende.

Te neni 32, duhet prapë të qartësohet më qartë, të definohet se kush dhe si do të bëhet certifikimi i personave, pra të ekspertëve, ndërsa në nenin 57 thuhet që Ministria do të autorizojë një organizatë në bazë të konkursit publik, të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë dhe të thuhet vetëm një organizatë. Pra termat e tilla duhet të hiqen, duhet të definohet qartë, çfarë organizate, kush do të angazhohet, kjo kështu vetëm termat e përgjithësuar që vetëm jepen asisoj dhe nuk janë të thelluar më tepër.

Po ashtu, te dispozitat ndëshkimore, pika 1 është thënë që me gjobë 100 deri 2000 euro do të dënohet personi fizik për kundërvajtje, mirëpo nuk definohet se për çka, nuk thirret, nuk është thirrur në cilin nen, pra të shkelet nga cili nen për të cilat shkelje dhe për cilin nen bëhet fjalë kur të vendoset gjoba, pra gjoba nuk mund të vendoset pa e definuar shkeljen dhe bazimin në cilin nen duhet të bëhet ajo. Duhet po ashtu të definohet se si bëhet financimi i Këshillit Blegtoral, si do të paguhet personat që janë në Këshillin Blegtoral? Këto janë vërejtje mendoj që nuk ndikojnë që ne tani në parim të kemi hamendje. Pra, ne do të votojmë “për” Projektligjin për Blegtorinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së e ka fjalën zonja Kymete Bajraktari

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim do ta përkrahë. Vërejtjet dhe sugjerimet do t'i japim në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, zonja Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Edhe përkundër investimeve që janë bërë në sektorin e blegtorisë, ky sektor megjithatë vazhdon të përballet me probleme të shumta. Konkurrenca e madhe e produkteve të importuara nga vendet tjera, mungesa e mekanizmit modern bujqësor dhe vështirësitë në sigurimin e ushqimit për bagëti, janë vetëm disa nga problemet që po e pengojnë zhvillimin e veprimtarisë së blegtorisë në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe problemet që përballen përpunuesit e qumështit me konkurrencën e pabarabartë të produkteve në treg.

Vlen të theksohet angazhimi i Ministrisë së Bujqësisë në Zhvillimin e Blegtorisë në dhënien e subvencioneve dhe granteve investive, për ndërtimin dhe kompletimin e stallave për bagëti.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re, konsiderojnë që blegtoria mbetet ndër sektorët fitimprurës në Kosovë dhe përkrah në parim Projektligjin për blegtorinë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Parlamentar “6+”, e ka fjalën Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući

Parlamentarna grupa “6+” razmotrila je nacrt ovog zakona o stočarstvu, smatramo da je od velike važnosti tako da ćemo dati svoj doprinos o daljem radu glasaćemo ovaj nacrt zakona.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve, zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti kryesues, ju falënderoj!

Unë jam munduar të analizoj, por ndoshta edhe do të kontribuojmë në leximin gjatë mundësive për amendamentin e këtij ligji, është ligj shumë i rëndësishëm për zhvillimin bujqësor në përgjithësi, ndërsa blegtoria është një pjesë shumë e veçantë për çështjen e Kosovës dhe shëndetin e qytetarëve të Kosovës, prandaj ky ligj duhet të përkrahët dhe të votohet, por janë disa vërejtje të cilat mendoj që në këtë ligj do të mbesin vetëm në formë të letrës, po ashtu, sepse nuk e shoh në ligj për shembull formën se si do të garantohet zhvillimi i blegtorisë, blegtoria kërkon hapësira për kullosa. Sot kullosat janë në menaxhim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe për shembull në zonën e Dragashit thuhet se janë 25.000 hektarë të cilat i menaxhon Agjencia Kosovare e Kullosave dhe 400 hektarë në qytetin e Dragashit, dhe ajo pjesë është garantuese për zhvillimin e blegtorisë dhe ky ligj mund të vijë mandej në shprehje për kualitetin e blegtorisë që do të rritet atje për kualitetin e mishit dhe të gjitha të tjerat, ose në pjesë tjera të Kosovës, ku janë disa zona të cilat kanë mundësi dhe mendoj që në këtë ligj, duhet të shihet një vegëz e cila duhet të gjendet për t'iu dhënë mundësi ligjore monitoruese atyre që do të zhvillojnë blegtorinë sipas këtij ligji dhe që të kenë të garantuar edhe sistemin e kullosave.

Në të kundërtën, ne kemi zhvilluar me formën e privatizimit një lloj të blegtorisë e cila është e bazuar me parcelat të cilat janë edhe dëmtohen nga vetë prezenca e blegtorisë, por nuk mund të japin produktet të cilat sot në treg ne i gjejmë produktet e mishit të importuara nga vetë shtetet të cilat nganjëherë dhe në media i shohim, janë me dyshim për kualitet ose në vjetërsi ose kanë edhe toksocite të ndryshme. Në parim unë e përkrah dhe do të mundohemi që jemi kontribuues pozitiv në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Pasi të gjitha grupet parlamentare e përkrahën edhe unë po i përkrah dhe po them është një ligj i mirë, por desha t'i a përkujtoj ministrit se kur është zgjedhur ministër në këtë resor, është mirë që po demanton atë se Naim Maloku i patë thënë në fillim kur është zgjedhur ministër, dhe në këtë drejtim e ka përgatitur mjaft një ligj të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Ja bi se takođe nadovezala na prethodnim govornikom i pozvala ministra za Poljoprivredu da se malo više ulože u naš kraj s obzirom da Župski kraj, odnosno Šar Planinski ogradci gde su ruralna mesta, odnosno naša sela poseduju ekonomski, prirodni potencijal za razvoj stočarstva, a jako je malo ulaganja subvencija od strane naše Vlade u tom kraju pa vas molim ministre, nekoliko puta sam insistirala za ovom govornicom da malo više obratite pažnju na sve te kriterijume koje naša zajednica ne ispunjava i na dodelu subvencija za razvoj stočarstva. Zahvaljujem se.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Zoti ministër në qoftë se e dëshironi fjalën, por unë po dua të insistoj tek çështja e kullosave të cilat janë pothuaj se pronë e gjithkujt dhe e askujt dhe u tha këtu në menaxhim të AKP-së ose të Agjencisë së Pyjeve. Ministria duhet ta këtë, Qeveria dhe Parlamenti duhet ta kenë parasysh për t'i dhënë zgjidhje pronës e cila, ose për të cilin janë të thirrur shumë familje, por realisht në kadastrë është pronë shoqërore, ajo ose duhet të privatizohet ose duhet të menaxhohet në mënyrën e duhet të praktikohen metodat të cilat janë praktikuar gjithmonë që të mos ketë manipulime me çështjen e provave. Faleminderit!

Zoti Ministër e doni fjalën? Jo.

Atëherë në sallë janë 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Me 62 vota për, asnjë kundër asnjë abstenim, konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për blegtorinë.

Ngarkohen Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportit me rekomandime.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin për transport tokësor të mallrave të rrezikshme dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri deputetin Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetoj raportin me rekomandime. Zoti Pajaziti e keni fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim , Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka trajtuar dhe në leximin e dytë këtë projektligj. Projektligji për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme, është edhe një ligj i radhës i munguar që plotëson këtë fushë jashtëzakonisht të rëndësishme. Dëshiroj t'i falënderojë Grupin punues, anëtarët e Komisionit, Ministrinë dhe të gjithë ata që kanë punuar në ndërkohë për ta amendamentuar këtë projektligj dhe po ashtu kërkoj nga deputetët e Kuvendit, grupet parlamentare që ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në sallë janë të pranishëm 100 kartela të deputetëve dhe 72 deputetë. Fillojmë me miratimin amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Të nderur zonja dhe zotërinj deputetë, votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 75 deputetë. Të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet që me 67 vota për, dy kundër asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ujërat e Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ujërat e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Hasani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar,

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, ka shqyrtuar Projektligjin për ujërat e Kosovës dhe në bazë të Rregullores dhe në pajtim me nenet 56, 57, 58 dhe 60 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, në mbledhje të mbajtur me 11.12.2012, 22.1.2013, 25.2.2013, shqyrtoi Projektligjin për ujërat të propozuar nga Qeveria dhe vendosi që me këtë raport të arsyetojë që ky projektligj është i plotësuar dhe i rregulluar që me amendamentet që kemi mund t'i rregullojmë që më së miri të jetë menaxhimi në ujërat e Kosovës, në bazë të së cilit do të kemi një përmirësim të mjedisit të vendit. Mendoj që 52 amendamentet që i kemi shqyrtuar dhe i kemi bërë këtu, mendoj që e përmirësojnë ligjin dhe kërkojmë që ky dhe këto amendamente të miratohen edhe nga komisionet tjera që e kanë pruar, është i pajtimt që ky ligj të kalojë dhe ta përmirësojë gjendjen e ujërave në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e keni kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Ne zakonisht po procedojmë pak si shpejt me amendamente, sepse edhe amendamenti paraprak i Ligjit që ishte, amendamenti 32, ishte në kundërshtim me nenin 34 ku thuhet për transportin rrugor dhe rrugë të ligjit bazik, por sido që të jetë është mirë pak të jemi më të kujdesshëm

Në këtë projektligj, amendamenti 52 është në kundërshtim me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe me praktikën e hartimit të legjislacionit, sepse me një amendament nuk përmirësohen gabimet teknike, por janë amendamente bazë për çdo nen të këtij projektligji, prandaj kjo është dashur të inkorporohet në nenet e caktuara dhe ndryshimet janë substanciale dhe përmbytësore. Prandaj, unë mendoj që kjo nuk duhet të shkojë në

këtë formë, sepse mund t'ndryshojë amendamentet e caktuara ashtu siç janë paraqitur në radhë dhe ju mund ta shihni edhe në tabelën që është paraqitur nga Komisioni Funkcional.

E dyta, Kuvendi i Kosovës po e lejon një praktikë, e cila është po ashtu në kundërshtim me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe me praktikat e hartimit të legjislacionit, sepse po e shihni se më shumë se 50% ndryshon e ligjit bazë i cili kalon nga leximi i parë dhe kjo detyrimisht nënkupton që ne nuk kemi tash një ligj i cili miratohet në dy lexime, por po thuajse kemi një ligj të ri të tërësisht. Këto janë disa vërejtje parimore dhe besoj që Kuvendi nuk duhet t'i lëshojë kështu në këtë formë, sepse edhe në të ardhmen po kemi problematika edhe Zyra për Harmonizim, Standardizim, atëherë nuk po mund ta implementojë apo ta harmonizojë këtë gjuhën juridike të paraqitur me amendamente dhe nga ligji bazë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ti po mendon që ta heqim nenin 52 apo do, se nuk e kuptova propozimin tuaj tamam, zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Kryesues, unë vetëm po e përsëris...

KRYESUESI: Përderisa ka ardhur në Parlament dhe është shqyrtuar që 2-3 muaj, unë nuk e di pse nuk e kanë trajtuar këta, tani mund ta kthejmë, mund të ndryshojmë, mund të propozojmë, por në Parlament edhe është shqyrtuar që dy-tre muaj ditë, unë nuk e di pse nuk e kanë trajtuar këtë, tani mund ta kthejmë, mund të ndryshojmë, mund të propozojmë, por po më duket që është koha e papërshtatshme për t'u futur për së dyti ligjit.

(Ndërhyrje: Sa amendamente janë?)...52.

...Më fal zoti Zemaj, vazhdo. Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Kjo ishte shumë parimore, jo për shkak atë ndërhyrjeve që mund të kemi, sepse tash jemi para një akti i cili detyrimisht, unë e thashë duhet të kemi kujdes. Amendamenti 52 implikon në vete ndryshimet e shumë neneve që janë bazike paraprak. Për shembull kemi edhe fshirje të nenit, teksti si vazhdon, domethënë nëse atje lëvizin nenet, atëherë unë nuk e di Zyra për harmonizim e standardizim si do ta miratojë në fund apo si do të paraqitet kjo në Gazetë Zyrtare. Prandaj, unë e thashë nuk është praktikë që me një amendament të ndryshohen disa amendamente për gabime teknike apo çfarëdo qofshin, duhet të jetë bazike dhe të fillojë prej fillimit me radhë edhe pse këtu shihet që ka shumë plotësime-ndryshime, por e shihni janë diku 52 amendamente nga 114 nene që i ka pasur ligji bazë.

KRYESUESI: Zoti Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Në amendamentin 52 janë disa nene të cilët kërkohet të ndërrohen pjesëzat e fjalëve, për shembull lidhëza “dhe”, fjala “juridik” “dhe” mund “paragraf”, neni 4.2 të cilët kanë qenë

pjesë e ligjit, kanë qenë shtesat në të cilat i është kërkuar që me një amendament të plotësohen edhe të ndryshohen, e cila nuk e prish konceptin e ligjit, por e bën ligjin më funksional.

KRYESUESI: Atëherë, shpjegimet janë që nuk e prekin substancën e ligjit këtu ky variant, por unë në qoftë se ju jeni të interesuar që ta hedhim në votim për ta anuluar këtë amendamentin 52, unë e hedh në votim edhe propozimin tuaj, nuk kam çka të bëj.

Atëherë shkojmë në votim, i kemi 52 amendamente.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 41

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 42

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 43

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 45

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 47

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 48

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 49

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 50

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 51

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 52

Kundër? Dy. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e Projektligji në tërësi me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 70 deputetë. Votojmë tash! Faleminderit!

Konstatohet se më 57 vota për, 2 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për ujërat e Kosovës.

E vazhdojmë seancën në orën 14: 00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pasdite

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ende nuk e kemi numrin e plotë të kuorumit, por para se të bëhet kuorumi unë kërkoj nga Komisioni për Legjislacion që e ka në shqyrtim Ligjin për përgjegjësitë dhe privilegjet e deputetëve, ndoshta është mirë ta rishikojmë një tip zviceran të deputetëve. Deputeti e ka një pagë të caktuar, por nëse e ka pagën e caktuar, nëse është diku tjetër dhe e ruan vendin e vet të punës, të marrë shtesë për t'iu bërë paga e deputetit, nëse e ka pagën më të ulët. Por, deputetët që kanë shumë detyra, shumë angazhime, konsideroj që nuk po arrijnë t'i përmbushin detyrat dhe obligimet që kanë në raport me Kuvendin.

Dhe, unë mendoj që kjo çështje duhet të trajtohet seriozisht. Do të thotë, deputetët nuk kanë të drejtë të gëzojnë vetëm privilegje. Deputetët, para së gjithash, kanë përgjegjësi kur votohet, që të jenë shumica në Parlament, ose po e bëjmë që mëditjet ose shtesat që i marrin deputetët, pse janë deputetë dhe janë në seancë dhe në komisione, le të bëhet regjistrimi i tyre dhe ata që nuk janë të pranishëm e nuk votojnë, atëherë ta humbin shtesën që e kanë. Përndryshe, po vazhdojmë me papërgjegjësinë e deputetëve, prandaj disi duhet të ndëshkohet kjo papërgjegjësi.

Tani i kemi të pranishëm 63 deputetë dhe mund të vazhdojmë.

Do të thotë, ky ishte një propozim për komisionin përkatës, i cili e ka ligjin në shqyrtim.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe Kuvendit ia kanë parashtruar raportin me rekomandime.

Eftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministra,

Përshëndetje kolegë deputetë,

Komisioni për Bujqësi e ka shqyrtuar dhe ia ka ofruar raportin me rekomandime Kuvendit të Kosovës - seancës plenare.

Leximi i parë i Projektligjit është bërë më 13.9.2012. Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin në grupin punues, kur është kërkuar mendimi profesional nga zyrtarë kompetentë lidhur me këtë projektligj. Komisioni ka propozuar amendamentet, të cilat janë të miratuara në formën e cekur. Pas takimit të përbashkët me Komisionin për

Buxhet, Komisioni FunkSIONAL i ka sqaruar dilemat buxhetore të Ministrisë të Mjedisit të Planifikimit Hapësinor, siç është përshkruar në hyrjen e këtij raporti.

Përmbajtja kryesore e këtij projektligji është qëllimi, themelimi, misioni, organizimi, funksionimi, detyrat, përkatësisht përgjegjësitë e agjencisë si institucion përgjegjës në kuadër të nivelit qendror rreth nevojave të menaxhimit në komplekset memorialë. Komision për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka dhënë vërejtje në raport me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, të cilat kanë thënë se nuk kanë bazë juridike të mëtutjeshme. Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, të cilat përmbajnë implikime buxhetore shtesë, ndërsa me vijën buxhetore të kodit buxhetor që e ka ministria dhe departamenti për komplekset memorialë, ato i barten komplet agjencisë.

Komisioni për Komunitete dhe Kthim e ka shqyrtuar projektligjin me amendamentet të Komisionit FunkSIONAL dhe ka rekomanduar miratimin në mbledhjen plenare, pasi nuk përmban dispozitat me të cilat shkelen të drejtat e komuniteteve. Ka rekomanduar 4 amendamente në amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, të cilat janë inkorporuar.

Komisioni për Integritet nuk ka vërejtje dhe përfundon se ky projektligj nuk i cenon parimet e përgjithshme të Legjislacionit të BE-së, prandaj kërkoj nga deputetët që të votohen amendamentet e këtij projektligji mjaft të ndjeshëm dhe të krijohet agjencia, e cila është në të mirën e mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë sonë në Kosovë. Faleminderit!

KRYTEARI: Faleminderit! Fjalën e kanë kërkuar deputetët Daut Haradinaj, Salih Morina dhe Liburn Aliu. Po shkojmë me radhë, Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë që ky ligj është i një rëndësie të veçantë, edhe pse mendoj se pas krijimit të agjencisë mund të zgjerohet për shkak se nuk janë të përfshirë, sidomos në komuna, ku janë bërë selektimet e pjesëve, të cilat do të jenë të mbikëqyrura. Mund ta marr një rast shumë të thjeshtë në Pejë, për shembull, nuk ka hyrë kompleksi memorial “Ardian Krasniqi”, në Lug të Baranit. Unë mendoj se agjencia duhet t’i ketë parasysh mangësitë që i ka ligji, të zgjerohet në kohë, pas krijimit të saj. Përndryshe, ky ligj është i pranueshëm për ne dhe si Aleancë do ta votojmë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Kryetari i Komisionit i lexoi të dy rekomandimet që janë dhënë nga Komisioni për Legjislacion dhe po ashtu nga Komisioni për Buxhet dhe Financat, për të cilat Komisioni për Legjislacion ka konstatuar se nuk i plotësojnë kushtet për shkak që ligji ka pësuar ndryshime më tepër se sa duhet ndryshuar dhe se është në kundërshtim me nenin 79 të Kushtetutës dhe nenin 57, pika 4 të Rregullores së Kuvendit. Po ashtu, Komisioni për Buxhet ka vërejtje për implikime të mëdha buxhetore, për të vetmen arsye sepse në praktikë ky komision ka thënë se ky ligj mund të jetë i paimplementueshëm.

Përmendet një numër i punëtorëve të punësuar, diku rreth 47 zyrtarë të rinj. Buxheti, të cilin e ka ndarë Ministria e Planifikimit Hapësinor, ka të bëjë pikërisht me investimet kapitale që kanë të bëjnë për rregullimin e memorialëve dhe ne konsiderojmë se ka një ndjeshmëri. Ligji si i tillë e ka një ndjeshmëri bukur të mirë, por duhet të kemi kujdes që të mos jemi në kundërshtim edhe me Rregulloren në Parlament, e po ashtu edhe me Kushtetutën e Kosovës.

Ne kemi kërkuar si Lidhje Demokratike e Kosovës që ky ligj ndoshta nuk është në vendin e duhur, por është dashur t'i takojë Ministrisë të Kulturës, përkatësisht Departamentit të Trashëgimisë Kulturore, sepse pikërisht ka të bëjë me trashëgiminë e këtyre lapidarëve, e këtyre varrezave të dëshmorëve. Prandaj, unë kisha kërkuar nga ministri që këtu të na japë edhe një sqarim, sepse në lexim të parë ligji ka ardhur në emër të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, ndërsa tash themelimi i kësaj agjencie do t'i takojë drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës. Prandaj, kisha kërkuar që mos të biem në kundërshtim me rregulloret e parapara. Faleminderit!

KRYETARI: Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Ne nuk kemi ndonjë vërejtje për ligjin. Numri i punëtorëve do të duhej të korrespondonte me zgjerimin e listës së monumenteve, pra çështja është vetëm te zgjerimi i listës së monumenteve që duhet të trajtohen nga ky ligj. Mendojmë që është e mangët ende.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi më të paraqitur për diskutim. Urdhëro ministër, por mendoj se nuk bie ndeshë as me Rregulloren, as me Kushtetutën. Të kihet kujdes ndaj memorialëve. Kështu që shkojmë në votimin e amendamenteve. Të pranishëm janë 76 deputetë. Votojmë për amendamentet.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për ta votuar Ligjin në tërësi. Të pranishëm 78 deputetë, 94 me elektronikë, prania fizike 78. Votojmë tash!

Konstatohet se me 65 vota për, 5 kundër, dy abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

Këtu e përfundojmë mbledhjen e filluar më 14 mars 2013. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*